# RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
# MBI AUDITIMIN TEMATIK
# "Mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin doganor"

**TIRANË, korrik 2025**

| Nr. | Përmbajtja | Faqe |
|---|---|---|
| **I** | **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** | **3** |
| 1. | Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit | 3 |
| 2. | Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve | 4 |
| 3. | Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit | 6 |
| **II.** | **HYRJA** | **7** |
| 1. | Objektivat dhe qëllimi | 7 |
| 2. | Identifikimi i çështjes | 7 |
| 3. | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese | 8 |
| 4. | Përgjegjësitë e audituesve | 8 |
| 5. | Kriteret e vlerësimit | 9 |
| 6. | Standartet e auditimit | 10 |
| 7. | Metodat e auditimit | 10 |
| 8. | Dokumentimi i auditimit | 11 |
| **III.** | **PËRSHKRIMI I AUDITIMIT** | 11 |
| III.1. | Informacion i përgjithshëm | 11 |
| III.2.1 | Auditim mbi strukturat e përfshira në mbledhjen e detyrimeve doganore dhe bashkëpunimi me institucione të tjera. | 12 |
| III.2.2 | Auditim mbi kontabilizimin e detyrimeve të subjekteve debitore për të ardhurat doganore, krijimi i detyrimeve të reja dhe stoku i borxhit doganor në fillim dhe në fund të vitit buxhetor. | 21 |
| III.2.3. | Lloji dhe përbërja e detyrimeve doganore sipas strukturave konstatuese dhe përllogaritja e kamatëvonesave | 26 |
| III.2.4. | Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. | 29 |
| III.2.4.1 | Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. | 29 |
| III.2.4.2 | Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për Degën Doganore Tiranë | 35 |
| III.2.4.3 | Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për Degën Doganore Fier | 69 |
| III.2.4.4 | Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për Degën Doganore Lezhë. | 99 |
| III.2.4.5. | Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për Degën Doganore Berat. | 116 |
| **IV.** | **REKOMANDIME** | **130** |

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Ecuria, performanca dhe efektiviteti i masave të marra në lidhje me borxhin doganor është një proces në përgjegjësi të administratës doganore që përfshin marrëdhëniet e ndërsjellta midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degëve Doganore. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është institucion në varësi të Ministrisë së Financave përgjegjëse për arkëtimin e të ardhurave doganore sipas ligjit dhe planit të miratuar për çdo vit. Mos realizimi i të ardhurave doganore në disa raste së bashku me vendimmarrjet e autoriteteve doganore për shkelje në fushën doganore përbëhen shkak për lindjen e borxhit doganor. Në mbështetje të bazës ligjore mbi të cilën zhvillohet veprimtaria e konstatimit dhe arkëtimit të detyrimeve të papaguara doganore është konstatuar se veprimtaria kryesore mbi këtë proces kryhet nga Degët Doganore të cilat kanë autoritetin dhe kompetencën për marrjen e masave administrative me anë të Vendimeve për lindjen e detyrimeve doganore. Në fund të vitit 2024 rezulton një nivel detyrimi i papaguar doganor gjithsej në shumën 48,588,510 mijë lekë, e përfaqësuar nga 4684 raste. Nga krahasimi i të dhënave të detyrimeve doganore të papaguara në krahasim me një vit më parë rezulton se borxhi doganor ka një rritje prej 994,940 mijë lekë ose 2.1%.

## b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Auditimi i këtij subjekti është kryer sipas planit vjetor të miratuar për vitin 2025, nga Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit dhe në vijim të rëndësisë që ka auditimi i borxhit doganor në fushën e të ardhurave të buxhetit të shtetit dhe rritjes së përvitshme të tij sipas auditimeve të zhvilluara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Degë Doganore.

Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, me anë të një auditimi tematik me shtrirje në sistem vlerësohet njëkohësisht aktiviteti i Degëve Doganore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në drejtim të marrjes së masave jo vetëm për arkëtimin e detyrimeve doganore të mbartura, por edhe detyrimeve të krijuara rishtazi përgjatë vitit buxhetor. Me anë të këtij auditimi synohet të informohen strukturat e ngarkuara me qeverisjen për marrjen e masave për reduktimin e detyrimeve doganore.

## c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e konkluzionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024 në lidhje me ecurinë, përformancës dhe efektivitetin e masave të marra për rikuperimin e borxhit doganore. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjektet e audituara. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

1. Auditim mbi strukturat e përfshira në mbledhjen e detyrimeve doganore dhe bashkëpunimi me institucione të tjera.
2. Auditim mbi kontabilizimin e detyrimeve të subjekteve debitore për të ardhurat doganore, krijimi i detyrimeve të reja dhe stoku i borxhit doganor në fillim dhe në fund të vitit buxhetor.
3. Lloji dhe përbërja e detyrimeve doganore sipas strukturave konstatuese dhe përllogaritja e kamatëvonesave
4. Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme: Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse: Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit; Verifikimi i dosjeve të borxhit doganor - me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit; Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

**e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.**

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 27 gjetje dhe ka dhënë 27 rekomandime.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.**

-Nga auditimi i Sektorit të Monitorimit të Borxhit është konstatuar se në fund të vitit 2024 rezulton një nivel i detyrimeve të papaguara doganore në shumën 48,588,510 mijë lekë, e përfaqësuar nga 4684 raste. Nga krahasimi i të dhënave të detyrimeve doganore të papaguara në krahasim me një vit më parë rezulton se borxhi doganor ka një rritje prej 994,940 mijë lekë ose 2.1%. Gjithashtu edhe në numër rastesh, sipas përmbledhëses së hartuar nga DPD, borxhi doganor rezulton në rritje nga 4495 raste në fund të vitit 2023, në 4680 raste në fund të vitit 2024, me një rritje prej 185 rastesh më shumë. Ne fund të vitit 2024 rezultojnë debitorë 3196 subjekte, me një rritje prej 185 subjektesh debitorë, nga 3011 subjekte debitorë që rezultojnë në fillim të vitit. Nga auditimi konstatohet se detyrimet e papaguara doganore mbi 5 vjet nga momenti i lindjes së detyrimit janë në vlerën 44,048,161 mijë lekë ose në masën 90% mbi totalin e stokut të detyrimeve. Duke qenë se më shumë se gjysma e detyrimit të trashëguar në vite është mbi 5 vjet, situata paraqitet jo efektive mbi mënyrën e rikuperimit me forcë të detyrimeve të papaguara doganore nga ana e strukturave të doganës me pasojë rritjen e riskut të parashkrimit të mbledhjes së tyre.

-Sipas pikës 1.3 të Kreut IX "Ekzekutimi i Urdhrit të Ekzekutimit", të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* konstatohet se nga Degët Doganore jo në çdo rast ka informacion për statusin aktual të çështjeve të dërguara në përmbarim.

-Nga auditimi i dosjeve të subjekteve debitore në degët doganore objekt auditimi, konstatohet se në asnjë rast nuk ka bashkëpunim ndërmjet degëve me strukturat e brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për sekuestrimin sipas dokumentacionit të kërkuar sipas pikës XV, gërma l), ll) të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

- Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 ku përcaktohet që *"Administrata doganore përdor mënyrën me efikase dhe më të sigurtë për mbledhjen e shumës së detyrimeve të papaguara, nga ana e debitorit....* përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

-Nga auditimi konstatohet se në 6 raste në degët doganore Fier (një rast), Lezhë (një rast) dhe Tiranë (katër raste), llogaritja e kamatëvonesave nuk është kryer nga momenti i lindjes së mos përmbushjes së detyrimit doganor për ato mos përmbushje të trajtuara sipas neneve 74-77 të Kodit Doganor, por është kryer nga data e njoftimit të vendimit, duke qenë jo sipas përcaktimeve të pikës 4.2. b) ii) të kapitullit V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

-Nga auditimi mbi evidencën e detyrimeve doganore të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Doganave, konstatohen të paktën 613 raste në shumën 13,976,212,926 lekë ose 28% e totalit të borxhit në vlerë (pa përfshirë muajin dhjetor 2024 dhe vlerat nën 1,500 lekë), për të cilat, nuk ka të shënuar në evidencën e borxhit të dhëna mbi marrjen e Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, megjithëse referuar afateve dhe shumave të detyrimit, janë përmbushur kushtet ligjore për rikuperimin me forcë të këtyre borxheve doganore dhe nuk ka informacion të rifreskuar për situatën faktike të gjendjes së këtyre debitorëve, por vetëm shënimin në proces gjyqësor.

-Nga auditimi mbi evidencën e detyrimeve doganore të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Doganave, konstatohen konstatohet se megjithëse kanë kaluar vite nga data e Vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, ende nuk është kryer kërkesa në gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

-Nga auditimi konstatohet se megjithëse nga gjykata janë lëshuar urdhrat e ekzekutimit, nga Degët Doganore ende nuk është vepruar për dërgimin e tyre në përmbarim apo masa të tjera në kompetencë të autoritetit doganor, kjo konstatohet në të paktën 105 raste në shumën 404,347,092 lekë,

-Nga auditimi mbi evidencën e përmbledhur të borxhit në fund të vitit 2024, konstatohen të paktën 765 raste në shumën 14,284,686,504 lekë, ku megjithëse urdhër ekzekutimet janë dërguar për ekzekutim zyrës së Përmbarimit Shtetëror/privat, në asnjë rast nuk janë marrë masa nga vetë autoriteti doganor për rikuperimin e detyrimeve të papaguara për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera sipas kërkesave të pikës 2.2.2 *"Bashkëpunimi me institucionet e tjera për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit"* të Kapitullit IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

**g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

-Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të analizojë situatën e krijuar përsa i përket rritjes së stokut të detyrimeve të papaguara doganore vit pas viti, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore me qëllim rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore në shumën prej 48,588,510 mijë lekë, si dhe duke marrë masa për parandalimin e rritjes së mëtejshme të tyre.

-Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Degët Doganore, ti kërkohet informacion zyrave përmbarimore në të cilat janë dërguar për ekzekutim të detyrueshëm urdhrat e ekzekutimit dhe të analizohet situata e debitorëve rast pas rasti me qëllim vlerësimin e statusit aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

-Nga Degët Doganore të merren masa për vendosjen e urdhrit të sekuestros dhe të kërkohet bashkëpunimi me strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me qëllim sigurimin e efikasitetit dhe sigurisë për mbledhjen e shumës së detyrimeve të papaguara. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të monitorohet ky proces dhe të kryhet ekzekutimi i titujve

ekzekutivë edhe nga strukturat e mbledhjes me forcë të detyrimit pranë administratës doganore duke shteruar procedurën deri në konfiskim të pasurive të debitorëve.
-Nga Degët Doganore të merren masa të menjëhershme për nxjerrjen e Vendimeve për Rikuperimin me Forcë të Borxhit për rastet kur janë përmbushur kushtet dhe afatet dhe ky proces të monitorohet nëpërmjet evidencave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
Nga Degët Doganore të merren masa të menjëhershme për dërgimin e kërkesës në Gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, për rastet kur janë përmbushur kushtet dhe afatet dhe ky proces të monitorohet nëpërmjet evidencave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
Nga Degët Doganore të merren masa të menjëhershme për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, për rastet kur kanë dalë urdhër ekzekutimet dhe ky proces të monitorohet nëpërmjet evidencave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
Nga Degët Doganore të merren masa të menjëhershme në kompetencë të autoritetit doganor, për rastet e mësipërme dhe ky proces të monitorohet nëpërmjet evidencave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**Konkluzioni i auditimit**

-Nga auditimi i borxhit doganor është konstatuar se në fund të vitit 2024 rezulton një nivel i detyrimeve të papaguara doganore në shumën 48,588,510 mijë lekë, e përfaqësuar nga 4684 raste, me një rritje prej 994,940 mijë lekë ose 2.1% në krahasim me një vit më parë. Gjatë periudhës 1 Janar-31 Dhjetor 2024, detyrimet e papaguara të reja sipas vendimeve të vitit 2024, janë rritur me 334,003 mijë lekë ose 0.7% e totalit. **Pjesa tjetër e shtesës për vitin 2024 vjen nga shtesat e kamatëvonesave, duke marrë parasysh efektin e pakësimeve të borxhit nga vitet e kaluara si pasojë e pagesave të kryera në vitin 2024.** Në lidhje me pakësimin e detyrimeve të papaguara doganore përgjatë vitit 2024, shlyerja e detyrimit nga subjektet rezulton të jetë në shumën 403,742 mijë lekë ose 0.84% e totalit të detyrimeve të papaguara doganore. Nga shuma totale e pakësimeve si më sipër, shuma prej **292,052 mijë lekë** (ose sa **72%**) i përket pakësimeve të detyrimeve doganore për vendime administrative të marra gjatë vitit 2024, ndërsa pjesa tjetër në vlerën 111,710 mijë lekë i përket pagesave të kryera në vitin 2024 për llogari të detyrimeve doganore të mbartura nga viti 2011-2023. Kjo tregon që veprimet administrative të organeve doganore rezultojnë të jenë efektive përkundrejt detyrimeve të reja të konstatuara, por janë të papërfillshme në lidhje me detyrimet e mbartura nga vitet e kaluara. Evidentohet se raporti i detyrimeve të pakësuara mbi detyrimet e shtuara për vitin 2024 rezulton 28.8%, ndërsa për vitin 2023 rezultonte 40%. Pra kemi ulje të këtij raporti si rezultat i uljes së detyrimeve të arkëtuara në raport me detyrimet e shtuara gjatë vitit.
Nga auditimi konstatohet se detyrimet e papaguara doganore mbi 5 vjet nga momenti i lindjes së detyrimit janë në vlerën 44,048,161 mijë lekë ose në masën **90% mbi totalin e stokut të detyrimeve**. Duke qenë se më shumë se gjysma e detyrimit të trashëguar në vite është mbi 5 vjet, situata paraqitet **jo efektive mbi mënyrën e rikuperimit me forcë të detyrimeve të papaguara doganore nga ana e strukturave të doganës me pasojë rritjen e riskut të parashkrimit të mbledhjes së tyre.**
-Përsa i përket masave të marra për rikuperimin e detyrimeve doganore, nga auditimi janë konstatuar vonesa në ndjekjen e hapave proceduralë si dhe në disa raste mos marrje e masave që sigurojnë mbledhjen e detyrimeve doganore. Nga auditimi mbi evidencën e detyrimeve doganore të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Doganave, konstatohen të paktën 613 raste në shumën 13,976,212,926 lekë ose 28% e totalit të borxhit në vlerë (pa përfshirë muajin dhjetor 2024 dhe vlerat nën 1,500 lekë), për të cilat, nuk ka të shënuar në evidencën e borxhit të dhëna mbi marrjen

e Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, megjithëse referuar afateve dhe shumave të detyrimit, janë përmbushur kushtet ligjore për rikuperimin me forcë të këtyre borxheve doganore. Konstatohet se megjithëse kanë kaluar vite nga data e Vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, ende nuk është kryer kërkesa në gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, në të paktën 840 raste në shumën 2,470,270,806 lekë (pa përfshirë muajin dhjetor 2024 dhe vlerat nën 1,500 lekë). Nga ana e autoriteteve doganore mungon ndjekja e hapave të mëtejshëm procedurale për rikuperimin e mëtejshëm të borxhit doganor pas nxjerrjes dhe njoftimit të VRFB, në kundërshtim përcaktimet e bëra në pikën 1 të kapitullit VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit". Nga auditimi konstatohet se megjithëse nga gjykata janë lëshuar urdhrat e ekzekutimit, nga Degët Doganore ende nuk është vepruar për dërgimin e tyre në përmbarim apo masa të tjera në kompetencë të autoritetit doganor, kjo konstatohet në të paktën 105 raste në shumën 404,347,092 lekë, (pa përfshirë muajin dhjetor 2024 dhe vlerat nën 1,500 lekë). Nga auditimi mbi evidencën e përmbledhur të borxhit në fund të vitit 2024, konstatohen të paktën 765 raste në shumën 14,284,686,504 lekë, ku megjithëse urdhër ekzekutimet janë dërguar për ekzekutim zyrës së Përmbarimit Shtetëror/privat, në asnjë rast nuk janë marrë masa nga vetë autoriteti doganor për rikuperimin e detyrimeve të papaguara për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera sipas kërkesave të pikës 2.2.2 *"Bashkëpunimi me institucionet e tjera për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit"* të Kapitullit IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

Megjithëse kryerja e veprimeve procedurale të mësipërme është në përgjegjësi të degëve doganore, konstatohet se nga ana e DPD ka munguar monitorimi i duhur për shmangien e këtyre parregullsive.

-Nga Degët Doganore jo në çdo rast ka informacion për statusin aktual të çështjeve të dërguara në përmbarim, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin të vazhdueshëm me përmbaruesit gjyqësore. Nga auditimi i dosjeve të subjekteve debitore në degët doganore objekt auditimi, konstatohet se në asnjë rast nuk ka bashkëpunim ndërmjet degëve me strukturat e brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për sekuestrimin sipas dokumentacionit të kërkuar sipas pikës XV, gërma l), ll) të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 ku përcaktohet që *"Administrata doganore përdor mënyrën me efikase dhe më të sigurtë për mbledhjen e shumës së detyrimeve të papaguara, nga ana e debitorit...",* përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 22/1 prot., datë 17.01.2025, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 17.01.2025 deri më datë 25.04.2025, në subjektin Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Degët Doganore Berat, Fier, Lezhë dhe Tiranë, për periudhën e veprimtarisë së subjektit, nga data 01.01.2024 deri në 31.12.2024 u krye auditimi "Mbi ecurinë, performancën dhe efektivitetin e masave të marra në lidhje me borxhin doganor", nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R G, përgjegjës grupi.
2. A H, Auditues.
3. F D, Auditues.
4. I F, Auditues.

**Objektivat dhe qëllimi** i auditimit tematik në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Degët Doganore Berat, Fier, Lezhë dhe Tiranë është dhënia e konkluzionit dhe lëshimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime përgjatë periudhës 01.01.2024 deri në 31.12.2024 mbi bazën e nivelit të materialitetit dhe vlerësimit të risqeve, si dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI. Gjithashtu objektivat përfshijnë vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij; vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)[1]; dhe hartimin e Raportit të Auditimit dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve, të cilat mbështeten mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

**Identifikimi i çështjes.** Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degëve Doganore Berat, Fier, Lezhë dhe Tiranë dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për marrjen e masave për rikuperimin e detyrimeve doganore.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Raporti i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset.

**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.** Strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degëve Doganore Berat, Fier, Lezhë dhe Tiranë, janë përgjegjëse për marrjen e masave për rikuperimin e detyrimeve doganore në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm që përfshin aktet ligjore dhe nënligjore që referohen si kriteret e auditimit. Degët Doganore me anë të punonjësve të strukturës juridike/specialist të borxhit dhe Kryetarit të Degës marrin të gjitha masat për njoftimin e debitorëve, lajmërimin për ekzekutim vullnetar, nxjerrjen e Vendimit për rikuperimin me forcë, kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në Gjykatë, aplikimin e masave shtrënguese me anë të përmbarimit/ose vetë, etj. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave monitoron marrjen e masave nga ana e degëve doganore në bazë të evidencave periodike dhe siguron marrjen e masave për rikuperimin e degëve nëpërmjet mbështetjes së degëve me strukturat e brendshme në DPD si dhe me anë të bashkëpunimit me institucione të tjera.

**Përgjegjësitë e audituesve.** Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të

[1]Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet konkluzioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë sipas programit të auditimit.
Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.
Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Degët Doganore Berat, Fier, Lezhë dhe Tiranë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

**Kriteret e vlerësimit.**
-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
-Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";
-Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
-Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.03.2015;
-Ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",
-Ligji nr. 152-2013, "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar;
-Ligji nr.102, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
-Ligji nr. 44/2015, "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 61, datë 24.05.2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
-Ligji 92/2014, "Per Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", *i ndryshuar*
-Ligji 8116 dt 29.03.1996, "Kodi i Procedurës Civile", *i ndryshuar*
-Ligji 9874 dt.14.02.2008, "Për Ankandin Publik", *i ndryshuar*
-Ligji 10279 dt.20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative";
-Ligji 9900 dt.10.04.2008, "Për Rezervat Materiale të Shtetit".
-VKM nr. 651 datë 10.11.2017 "Për Dispozitat Zbatuese të KD";
-VKM nr. 612, datë 05.09.2012 "Për Dispozitat zbatuese të ligjit Për Akcizat", i ndryshuar;
-VKM nr. 355 datë 26.05.2022 "Për personelin e administratës doganore"
-Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar;
-Udhëzimin nr.9, datë 20.07.2018"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",
-Udhëzimi nr. 15 datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"
-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 9, datë 11.03.2019 "Mbi modalitetet e transferimit pranë Administratës Doganore të të dhënave për subjektet të cilat rezultojnë me detyrime të papaguar"
-Rregullore e Brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ KLSH-së", miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 197, datë 12.10.2022;
-Rregullore e brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me vendimin nr.07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së.

**-Standardet e auditimit.**
-ISSAI 100 "Parimet themelore të Auditimit të Sektorit Publik", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
-Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
-Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

**Metodat e auditimit.** Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me dosjen e borxhit specifik; dhe
- Pesha specifike që një zë detyrimesh doganore zë ndaj totalit të detyrimeve doganore të të tretë ndaj subjektit të audituar.

Pas vlerësimit të plotësisë së evidencave të detyrimeve doganore, zgjedhja u përqëndrua në zgjedhjen e kampioneve me peshën më të lartë ndaj totalit të borxhit doganor për dosjet e mbartura nga vitet e kaluara dhe kampioneve me peshën më të lartë ndaj borxhit të vitit të krijuar rishtazi gjatë 2024. Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit.

- *Kontrolli aritmetik*
- *Kontrolli me anë të dokumentacionit justifikues në dosje*
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese të dokumentacionit dhe raporteve*
- *Kontrolli i vlerësimeve*
- *Konfirmimi nga të tretët*
- *Kontrolli sipas një treguesi*
- *Intervista*
- *Raporte dhe Informacione*

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion

të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja[2].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.
Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose ne trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

**Dokumentimi i auditimit.** Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimet dhe Verifikimet e mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport Auditimi.

# III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

## III.1. Informacion i përgjithshëm

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, është një njësi funksionale, e përbërë nga 21 drejtori, që varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Ministria e Financave dhe ka në varësi të saj 18 Degë Doganore që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat kryejnë operacione të deklarimit dhe zhdoganimit. Misioni i Administratës Doganore Shqiptare është të ruajë interesat financiarë dhe ekonomikë të Shqipërisë, të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë dhe të partnerëve të biznesit duke u mbështetur në menaxhimin e riskut dhe kontrolle efikase dhe efektive të lehtësojë tregtinë duke implementuar metoda dhe teknologji moderne pune dhe të bashkëpunojë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me të gjithë aktorët përkatës.
Autoritet Doganore kanë si objektiva kryesore sigurimin e mbledhjes korrekte dhe të efektshme të detyrimeve dhe taksave nëpërmjet rritjes së efiçencës ne punë të stafit doganor dhe zbatimin korrekt të legjislacionit. Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 22/1 prot., datë 17.01.2025, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u ushtrua auditim në këtë drejtori dhe degët doganore lidhur me arkëtimin e detyrimeve doganore dhe masat e marra për rikuperimin e tyre.

[2] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm ∗ Risku i kontrollit ∗ Risku i Zbulimit

DPD drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili ka në varësi të tij katër Zëvendësdrejtorë të Përgjithshëm, të cilët sigurojnë mbështetjen në kryerjen e detyrës duke bashkërenduar punën. DPD ka funksionuar ende me rregulloren e miratuar me urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018 të Ministrit të Financave, "Rregullore e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e DPD dhe Degët Doganore", në të cilën trajtohen objekti dhe funksionet e punës për të gjithë strukturën përbërëse të DPD-së dhe DD, organizimi i strukturave, emërtimi, përbërja dhe detyrat e tyre, etj. edhe pse pas ristrukturimit të vitit 2022 me VKM nr.355 datë 26.05.2022 'Për disa ndryshime në vendimin nr.921 datë 29.12.2014" struktura ka pësuar ndryshime për një sërë pozicionesh dhe drejtorish.
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është një njësi e krijuar në mbështetje të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe ligjit nr. 90/2012, datë 27.09.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore". Realizimi i këtij auditimi është kryer në mbështetje të planit vjetor të vitit 2025, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Auditimi i këtij institucioni nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, lidhur me arkëtimin e detyrimeve doganore dhe efektshmërisë e masave të marra në minimizimin e tyre, si dhe funksionimit të strukturave përbërëse të saj, kanë një rëndësi specifike në hartimin dhe përmbajtjen e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit.
Përzgjedhja e subjekteve në auditim që përfshin DPD, DD Tiranë, DD Fier, DD Berat dhe DD Lezhë është kryer bazuar në peshën specifike më të lartë të këtyre degëve ndaj totalit të stokut të borxhit doganor sipas evidencave analtike, duke përjashtuar DD Durrës dhe DD Rinas të cilat janë audituar për borxhin me program auditimi më vete.

### III.2.1. Auditim mbi strukturat e përfshira në mbledhjen e detyrimeve doganore dhe bashkëpunimi me institucione të tjera.

Borxh doganor është detyrimi i një personi për të paguar shumën e detyrimit të importit ose shumën e detyrimit të eksportit, të cilat zbatohen për mallra të caktuara, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Detyrime te papaguara është shuma e borxhit doganor ose borxhit te akcizës, gjobat e aplikuara dhe kamate vonesat.
Në mbështetje të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Udhëzimit të DPD, nr.15, datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganor edhe të akcizës"*, mbi të cilën zhvillohet veprimtaria e konstatimit dhe arkëtimit të detyrimeve të papaguara doganore është konstatuar se veprimtaria kryesore mbi këtë proces kryhet nga Degët Doganore të cilat kanë autoritetin dhe kompetencën për marrjen e masave administrative me anë të Vendimeve për lindjen e detyrimeve doganore. Punonjësi i deleguar sipas strukturës organike pas konstatimit të shkeljes doganore/të akcizës, merr të gjitha masat për përgatitjen dhe plotësimin e dosjes së plotë të detyrimeve të papaguara sipas shkeljeve të konstatuara. Dosja e detyrimeve të papaguara pas konstatimit të shkeljes doganore/akcizës sipas Kapitullit III të udhëzimit të borxhit duhet të përmbajë:
- praktikën doganore/veprime me mallra akcize si dhe kopje të gjithë dokumentacionit tregtar shoqërues për të cilin është konstatuar shkelja.
- informacioni i detajuar ku tregohet saktë proceduara e ndjekur deri në përcaktimin e detyrimeve, i cila i dërgohet Degës Doganore kompetente nga struktura kontrolluese konstatuese.
- procesverbali i verifikimit të shkeljeve, sipas përcaktimeve në manualin udhëzues mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe akcizës dhe detyrimet e përllogaritura.
- në rastet kur shkelja administrative konstatohet dhe rekomandimet jepen nga struktura jo doganore (KLSH, Audit Ministrisë ..etj) atëherë Dega Doganore përpara daljes me vendim duhet

të mbajë një proces verbal në kuptim të KD dhe ligjit të akcizës. Ky proces verbal mbahet nga punonjësit e Degës Doganore të cilët vlerësojnë rekomandimet e lëna nga strukturat e mësipërme.

Në vijim, këto degë me anë të punonjësve të strukturës juridike/specialist të borxhit marrin të gjitha masat për njoftimin e debitorëve, lajmërimin për ekzekutim vullnetar, nxjerrjen e Vendimit për rikuperimin me forcë, kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në Gjykatë, aplikimin e masave shtrënguese me anë të përmbarimit/ose vetë, etj.

Vendimi për shpalljen debitor, kontabilizimi dhe njoftimi i tij.

Kryetari i Degës Doganore pasi shqyrton dosjen e përgatitur me të gjithë dokumentacionin e saj merr vendimin administrativ. Mbështetur në vendimin e shpalljes debitor Kryetari i Degës procedon si më poshtë:

a) Urdhëron kontabilizimin e detyrimeve të papaguara (borxh doganor/akcize, gjobat dhe kamatëvonesa të përllogaritura, nëse ka). Kontabilizimi bëhet nga financieri në përputhje me nenet 98,99 te KD dhe nenit 101 te ligjit për Akcizat.

b) Regjistrimi në bazë të të dhënave në databazën e shkeljeve doganore.

Ky vendim i njoftohet subjektit debitor me Njoftim Vendimi, i cili është akti me anë të të cilit Autoriteti Doganor i bën me dije shkelësit për shpalljen debitor nga ky autoritet. Njoftimi i vendimit kryhet nga Dega Doganore përkatëse nga punonjësi i deleguar dhe procedura e njoftimit të subjektit debitor bëhet sipas neneve 130-141 te KPC, në do rast me postë rekomande. Në raste të mos marrjes së konformimit për njoftim nga posta, procedohet me forma të tjera si njoftimi nëpërmjet afishimit publik. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore subjekti debitor konsiderohet i njoftuar.

Kontabilizimi bëhet në zëra të veçantë, një zë për shumën e borxhit doganore/akcize, një zë për shumën e gjobave, një zë për shumën e kamatvonesave. Kamatëvonesat llogariten mbi shumën e detyrimeve të importit ose të eksportit, me normën e aplikuar në ditën e parë të muajit në fjalë nga Banka e Shqipërisë për operacionet e saj kryesore të ri financimit të rritura me 2%.

Ekzekutimi me forcë

Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas KD/sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 280 të KD dhe nenin 103 të 1igjit "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të nenit 133/3 të Ligjit nr. 44, datë 30.4.2015 “KPA i Republikës se Shqipërisë" kalon në ekzekutimin forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/ akcizës (VRFB). Pas nxjerrjes së VRFB, Dega Doganore merr masat për njoftimin e këtij vendimi subjektit debitor. Procedura e njoftimit zbatohet në përputhje me procedurën e njoftimit të vendimit administrativ. Në momentin e njoftimit të VRFB debitorit, ky i fundit kthehet në Titull ekzekutiv.

Kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit

Dega Doganore dërgon Titullin ekzekutiv pranë gjykatës si kërkesë për nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit, menjëherë nga marrja dijeni mbi VRFB.

Ekzekutimi Urdhërit të Ekzekutimit

Dega Doganore i dërgon debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhëri i ekzekutimit, duke i caktuar për këtë një afat prej 10 ditësh.

Në zbatim të nenit 280 të KD dhe nenit 103 të ligjit "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", ekzekutimi i urdhërit të ekzekutimit mund të bëhet:

1) përmes Zyrave Përmbarimore; Në zbatim të Urdhërit Nr. 4321/4, date 18.7.2017 "Për miratimin e modelit të kontratës që lidhet midis shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit", Dega Doganore duhet ti kërkojë informacion me shkrim Zyrës Përmbarimore, lidhur me statusin aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, për të gjitha veprimet e kryera, informacion të cilin me pas ia përcjell DPD.
2) nga vetë autoritetet doganore, përmes strukturave të rikuperimit me forcë dhe Degëve Doganore, në bazë të dispozitave të ligjore në fuqi. Dega Doganore me qëllim ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit i drejtohet:
a) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me kërkesën për informacion për aktivitetin tregtar (magazinat, mallrat etj) të debitorit dhe bllokimin e aktivitetit të tij tregtar
b) Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me kërkesën për: informacion për të dhënat tregtare që disponon për shoqërinë debitore dhe bllokimin e çdo veprimi tregtar që ka lidhje me debitorin, pranë QKB.
c) Bankave për informacion për llogaritë bankare dhe llogaritë depozite të debitorit dhe bllokimin e sekuestrimin e menjëhershëm të vlerave monetare, të kredive, sendeve me vlerë
d)Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për identifikimin e pasurive të paluajtshme te debitorit dhe vendosjen në hipotekë të tyre në favor të administratës doganore.
e) Të gjitha Zyrave të Republikës së Shqipërisë, siç janë zyrat e regjistrimit të mjeteve motorike, mjeteve lundruese, të regjistrimit të aksioneve, etj.

<u>Vendosja e sekuestros për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit.</u>
Dega Doganore nxjerr Urdhërin për Vënien e Sekuestros Ekzekutive mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të tij në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimeve të papaguara. Urdhëri nxirret nga Kryetari i Degës Doganore që ka nxjerrë vendimin për rikuperimin forcërisht detyrimeve të papaguara. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontrabandës. Pas evidentimit të pasurive, Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontrabandës kryejnë realisht sekuestron ekzekutive mbi pasuritë e debitorit. Për këtë qëllim këto struktura pas evidentimit në vend të pasurisë që do të sekuestrohet mbajnë procesverbalin e sekuestros në vendin ku ndodhet pasuria e debitorit. Pasuritë, sendet, të hollat e evidentuara që i përkasin debitorit, për të cilat mbahet procesverbali i sekuestros konfiskohen ne favor te shtetit. Konfiskimi behet përmes nxjerrjes së Vendimit të Konfiskimit nga Dega Doganore që ka nxjerre urdhrin e sekuestros ekzekutive. Dega Doganore gjate procedurës se sekuestrimit mund te kërkojë mbështetje nga Departamenti Operativ Hetimor, Departamenti Administrativ, Departamenti Teknik dhe i Akcizës dhe Departamenti i Analizave dhe Aposteriorit.

E gjithë veprimtaria është pjesë e dosjes së debitorit e cila administrohet nga Dega Doganore. Këtë proces Dega Doganore e dokumenton edhe në evidencat periodike të cilat dërgohen muaj për muaj në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në Sektorin e Monitorimit të Borxhit dhe Ndërveprimit me Tatimet. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bazë të evidencave të dërguara nga degët harton përmbledhësen mujore të borxhit doganor. Sektori i Monitorimit të Borxhit dhe Ndërveprimit me Tatimet në DPD është pjesë e Drejtorisë së Statistikës, Analizës së të Ardhurave dhe Administrimit të Borxhit dhe funksionon sipas strukturës së miratuar me VKM nr. 355 datë 26.05.2022 “Për personelin e administratës doganore”, me një përgjegjës sektori dhe dy specialistë.
Për realizimin e procesit të mbledhjes së detyrimeve, subjekti i audituar bashkëpunon me institucione të tjera të përfshira në fazën e mbledhjes me forcë, që përfshijnë Drejtoritë Vendore

të ASHK, QKB, Bankat e nivelit të dytë, etj. Gjithashtu DPD ka marrëveshje bashkëpunimi me DPT për marrjen e masave specifike me qëllim bashkëveprimin për arkëtimin e detyrimeve doganore dhe tatimore sipas kërkesës së ndërsjelltë.

**I.1. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve**

Nga auditimi është konstatuar se në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka lidhur akt marrëveshje nr. 1435 datë 19.06.2018 me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Në marrëveshjen e bashkëpunimit me DPT, neni 3 "Shkëmbimi i informacionit", pika 5 shkronja a), përcaktohet *"Informacioni i shkëmbyer në kohë reale/periodikisht/në mënyrë elektronike nga DPD në DPT përfshin: ....iv) listën e tatimpaguesve debitorë në adminstratën doganore për të cilët është lëshuar urdhër ekzekutimi nga gjykata, me qëllim zbatimin e urdhrit nga administrata tatimore.".* Në vijim të nenit 6 "Mbledhja e detyrimeve të papaguara dhe të tjera", pika 1 përcakton se *"DPD, menjëherë sapo të marrë njoftimin për bllokimin e aktivitetit nga DPT, dërgon punonjësit e saj në Drejtorinë Rajonale Tatimore, ku është kryer bllokimi, në përputhje me pikën 5 a(iv) të nenit 3, të njihen me gjendjen reale dhe brenda 24 orësh fillon procedura e parashikuar në legjislacionin doganor për këtë qëllim"* dhe pikës 3 ku përcaktohet që *"Pala në përputhje me pikën 5a (iv) dhe pikën 5b (ii –iii) të nenit 3, respektivisht marrin masa për të mos lejuar regjistrimin e subjekteve debitore.*

Në pikën 7 të nenit 6 përcaktohet që *"Të gjitha degët doganore, për të gjithë subjektet të cilët kanë përmbushur kushtet për pezullimin e aktivitet ekonomik në tatime, menjëherë sapo të merret urdhri i ekzekutimit nga organet gjyqësore duhet të nisin me format elektronik kërkesën pranë sektorit të monitorimit të borxhit në DPD. Nga ana e tij, Sektori i Monitorimit të Borxhit në DPD menjëherë duhet të nisi me format elektronik pranë Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë në DPT, kërkesën për pezullimin e aktivitetit ekonomik të subjektit debitor. Çdo degë doganore, në çdo moment që i lind e drejta për lirimin e bllokimit të aktivitetit ekonomik në tatime, për debitorin ndaj të cilit më parë është marrë masa e bllokimit, dërgon me email kërkesën për lirimin e bllokimit pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit në DPD. Nga ana e tij Sektori i Monitorimit të Borxhit në DPD, pasi verifikon kërkesën e Degës Doganore dërgon me email në Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve kërkesën për lirimin nga pezullimi i aktivitetit ekonomik në tatime".*

Nga grupi i auditimit u kërkua informacion në sektorin e monitorimit të borxhit mbi korrespondencën me DPT për nisjen në format elektronik të kërkesës për bllokim për rastet e përzgjedhura për auditim për vitin 2024 në degët doganore për të cilat është nxjerrë Urdhëri i Ekzekutimit. Nga sektori i Monitorimit të Borxhit është referuar se *"Vetë Degët doganore dërgojnë herë pas here për subjektet debitor, kërkesë për informacion Degëve Rajonale të Tatimeve. Rajoni Tatimeve Qendër na bën me dije se kanë kërkuar informacion Degët doganore".*

Nga dokumentacioni i paraqitur në dosjet e borxhit të audituara në degë doganore, konstatohet se pjesë e dosjeve nuk kanë qenë dokumentacioni që provon kërkesën për marrjen e masave drejtuar tatimeve. Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se marrëveshja e bashkëpunimit me DPT nuk është zbatuar sipas parashikimeve për komunikimin e sektorit të monitorimit të borxhit, ku komunikimi bëhet i qendërzuar në mënyrë që të përputhet me nenin 1 "Qëllimi", me synim rritjen e performancës për mbledhjen e të ardhurave, nëpërmjet uljes së kohës së procedurave të shërbimit, kontrollit dhe kostove respektive. Këto problematika janë në kundërshtim me pikën 7 të nenit 6 marrëveshjes nr. 1435 datë 19.06.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se nuk ka programe pune të përbashkëta përsa i përket mbledhjes së detyrimeve të papaguara midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe

Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në kundërshtim me pikën 5 të nenit 6 të marrëveshjes së bashkëpunimit midis DPD-së dhe DPT-së së datës 19.06.2018, të protokolluar pranë DPD-së me nr.14355 prot datë 19.06.2018.

**I.2. Bashkëpunimi me zyrat përmbarimore**

DPD bashkëpunon me institucione të tjera në kuadër të ekzekutimit të Urdhrave të Ekzekutimit për mbledhje me forcë të borxhit, sipas kërkesave të Kreut IX *"Ekzekutimi i Urdhrit të Ekzekutimit",* të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës" , ku citohet se "Në zbatim të nenit 280 të Kodit Doganor dhe nenit 103 të ligjit 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", ekzekutimi i titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara (sekuestros konservative), mund të bëhet:*
*1. Përmes Zyrave Përmbarimore;*
*2. Nga vetë autoritetet doganore, përmes strukturave të rikuperimit me forcë dhe degëve doganore, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.*

Sipas pikës 1.3 të Kreut IX "Ekzekutimi i Urdhrit të Ekzekutimit", të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* konstatohet se nga Degët Doganore jo në çdo rast ka informacion për statusin aktual të çështjeve të dërguara në përmbarim, ku citohet *"Në zbatim të urdhrit nr. 4321/4 datë 18.07.2017 "Për miratimin e modelit të kontratës që lidhet midis shoqërisë përmbarimore/përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar, përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit", dega doganore ti kërkojë informacion me shkrim zyrës përmbarimore lidhur me statusin aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, për të gjitha veprimet e kryera, informacion të cilin më pas ja përcjell sektorit të monitorimit të borxhit në DPD.".* Janë konstatuar praktika të përzgjedhura për auditim në degë doganore për të cilat, gjatë vitit 2024, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin të vazhdueshëm me përmbaruesit gjyqësore, sipas përcaktimeve të pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës".* ku citohet *"..Dega Doganore ti kërkojë informacion me shkrim Zyrës Përmbarimore lidhur me statusin aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv për të gjitha veprimet e kryera, informacion të cilin më pas ia përcjell Sektorit të Monitorimit të Borxhit...."*.
Në dokumentacionin e paraqitur të dosjeve të borxhit konstatohet se përgjithësisht pjesë e dosjes janë vetëm kërkesa drejtuar përmbarimit dhe kontrata sipas rastit, por nuk ka dokumentacion që provon bashkëpunimin e mëtejshëm deri në ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit dhe nga ana e DPD ky proces nuk rezulton të jetë i monitoruar.

**I.3. Bashkëpunimi me strukturat e brendshme të DPD**

Bashkëpunimi ndërmjet Degës Doganore me strukturat e brendshme në DPD është përcaktuar, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të Kreut IX "Ekzekutimi i Urdhrit të Ekzekutimit", Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit, ku përcaktohet ndërmarrja e veprimeve të mëposhtme:
-pezullimi i autorizimit të regjimit doganor
-pezullimi i autorizimeve të akcizës
-prekjen e garancive të vendosura për qëllim të përfitimit të regjimit doganor apo autorizimeve të akcizës

-bllokimin në sistem të subjektit debitor, etj.
Në dosjet e audituara në Degë Doganore përgjithësisht nuk ka dokumentacion që vërteton zbatimin e masave të parashikuara më sipër. Komunikimi për marrjen e këtyre masave sipas shpjegimeve të subjektit të audituar kryhet me email duke mos patur gjurmë për kryerjen e tyre dhe në kundërshtim me përcaktimet e bëra në dokumentacionin që duhet të përmbajë dosja sipas pikës XV të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Nga subjekti i audituar janë paraqitur komente duke ju referuar email dhe shkresa të përcjella nga degët doganore.

**Momenti i prekjes së garancisë sipas udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018**
Ndër masat të cilat janë parashikuar për rikuperimin e detyrimeve doganore të lindura pas vendimmarrjes së autoriteteve doganore, është edhe prekja e garancive sipas parashikimeve të pikës 7 të kapitullit VI "Njoftimi i vendimit", të udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 ku përcaktohet që "*Dega Doganore njofton menjëherë vendimin dhe njoftimin e kryer për debitorin pranë strukturave përkatëse të DPD-së që menaxhojnë garancitë për qëllime të përfitimit të regjimeve doganore ose autorizimet e akcizës duke kërkuar prekjen e menjëhershme të saj sipas kushteve te autorizimit/regjimit. Në rastet kur malli nën regjimin doganor/pezullues i akcizës është i çliruar për konsum apo nuk gjendet (por është garantuar me garanci) atëherë preket garancia e depozituar për mbulimin e risqeve të mundshme të detyrimeve. Në rastin kur kjo garanci nuk është e mjaftueshme zbatohen paralelisht edhe masat e tjera të parashikuara në dispozitat ligjore në fuqi dhe pikat e mëposhtme. Sektori i kontrollit të pagesave dhe garancive pranë DPD-së do të sigurojë garantimin e pagesës së detyrimeve të pashlyera nëpërmjet kërkesës për prekjes së garancisë së debitorit në një nga bankat e nivelit të dytë apo shoqërive të sigurimit, garantuesve, dorëzanësve etj.".* Nga ana tjetër, në pikën 2.2.1."Ekzekutimi i detyrueshëm i urdhrit të ekzekutimit nga autoritetet doganore" të kapitullit IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit", të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 është përcaktuar e njëjta masë në një moment të mëvonshëm procedural të mbledhjes me forcë të borxhit ku citohet *"Menjëherë pas kalimit të afatit për ekzekutimin vullnetar të Urdhrit të Ekzekutimit.....Për këtë qëllim Dega Doganore kërkon nga DPD (Drejtoria e Financës, Drejtoria e Antikontrabandës, Departamenti Teknik dhe i Akcizës), kryerjen e procedurave si vijon: ...iii. prekjen e garancive të vendosura për qëllim të përfitimit të regjimit doganor apo autorizimeve të akcizës (nëse ka). Në rastet kur malli nën regjimin doganor/pezullues i akcizës është i çliruar për konsum apo nuk gjendet (por është garantuar me garanci) atëherë preket garancia e depozituar për mbulimin e risqeve të mundshme të detyrimeve...."*. Për sa më sipër konstatohet se procedurat e prekjes së garancisë janë parashikuar në dy momente kohore të ndryshëm procedurialë nga udhëzimi (në momentin e parë të daljes së vendimit dhe në momentin e mëvonshëm të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit) dhe drejt strukturave të ndryshme përgjegjëse në DPD për të njëjtën mase për rikuperimin e detyrimeve doganore.

**Momenti i bllokimit te veprimit në sistem**
Ndër masat të cilat janë parashikuar për rikuperimin e detyrimeve doganore të lindura pas vendimmarrjes së autoriteteve doganore është edhe bllokimi i veprimeve në sistem sipas përcaktimeve të pikës 2.6 të kapitullit VII "Ekzekutimi i vendimit i shpalljes debitor" të udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 ku citohet *"Dega Doganore dërgon pranë sektorit të Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave pranë DPD menjëherë të gjithë vendimet për zbatimin e masave shtrënguese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, qoftë në import, qoftë në export".* Nga ana tjetër, në pikën 2.2.1."Ekzekutimi i detyrueshëm i urdhrit të ekzekutimit nga autoritetet doganore" të kapitullit IX "Ekzekutimi i urdhrit të

ekzekutimit", të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 është përcaktuar e njëjta masë në një moment të mëvonshëm procedurial të mbledhjes me forcë të borxhit ku citohet *"Menjëherë pas kalimit të afatit për ekzekutimin vullnetar të Urdhrit të Ekzekutimit.....Për këtë qëllim Dega Doganore kërkon nga DPD (Drejtoria e Financës, Drejtoria e Antikontrabandës, Departamenti Teknik dhe i Akcizës), kryerjen e procedurave si vijon: ...iv) bllokimin në sistem të subjektit debitor".* Për sa më sipër konstatohet se procedurat e bllokimit në sistemin doganor janë parashikuar në dy momente kohore të ndryshëm procedurialë (në momentin e parë të njoftimit të vendimit të rikuperimit me forcë dhe në momentin e mëvonshëm të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit) nga udhëzimi dhe drejt strukturave të ndryshme përgjegjëse në DPD për të njëjtën mase për rikuperimin e detyrimeve doganore. Në konkluzion, konstatohet se cënohet efektiviteti i masave të ndërmarra për rikuperimin e borxhit nëpërmjet lejimit të bllokimit në sistem pas nxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit.

**Prekja e garancive të vendosura për qëllim të përfitimit të regjimit doganor apo autorizimeve të akcizës dhe ankimit administrativ**

**-Garancitë e ankimimit administrativ**

Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave përgjatë vitit 2024, sipas evidencës së vendosur në dispozicion grupit të auditimit ka vepruar në drejtim të garancive të paraqitura në 14 raste, në shumën 6,036,644 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | SUBJEKTI | Vendimi Degës | Dega Doganës | Lloji I veprimit | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr... Date… | | | |
| 1 | T | Nr 24; 24/05/2022 | Korçe | prekje garancie | 166,743 |
| 2 | Z | Nr.1053;1054;1055; 29/09/2023 | Durrës | prekje garancie | 1,345,116 |
| 3 | M | Nr.06; 08/01/2024 | Durrës | prekje garancie | 100,000 |
| 4 | T | Nr. 83; 26/04/2022 | Kapshtice | prekje garancie | 132,649 |
| 5 | C & | Nr 70; 30/08/2023 | Vlore | prekje garancie | 45,020 |
| 7 | D | Nr.846; 04/09/2023 | Tirane | çlirim garancie | 238,831 |
| 9 | E | Nr. 844; 28/09/2023 | Tirane | kalim mjete ne ruajtje | 1,161,221 |
| 10 | R | Nr.01; date 03/01/2024 | Tirane | kalim mjete ne ruajtje | 338,390 |
| 11 | R | Nr.02; date 03/01/2024 | Tirane | kalim mjete ne ruajtje | 338,097 |
| 12 | R | Nr.03; date 03/01/2024 | Tirane | kalim mjete ne ruajtje | 331,372 |
| 13 | R | Nr.04; date 03/01/2024 | Tirane | kalim mjete ne ruajtje | 370,849 |
| 14 | R | Nr.05; date 03/01/2024 | Tirane | kalim mjete ne ruajtje | 274,128 |
| 15 | R | Nr.06; date 03/01/2024 | Tirane | kalim mjete ne ruajtje | 274,128 |
| 16 | R | Nr.07; date 20/01/2024 | Kakavije | kalim mjete ne ruajtje | 920,100 |
| **Shuma** | | | | | **6,036,644** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Referuar tabelës së mësipërme dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, veprimet me garancitë përgjatë vitit 2024 janë kryer në formën e çlirimit të garancisë (për rastet kur ankimimi i subjektit është pranuar), është prekur (për rastet kur ankimi është rrëzuar) dhe është kaluar në llogarinë 466 "Mjete në ruajtje" (për rastet kur është rrëzuar ankimi nga Drejtori i Përgjithshëm i DPD, por çështja vazhdon në rrugë gjyqësore në gjykatat kompetente administrative). Nga auditimi, konstatohet se gjatë vitit 2024, janë prekur garancitë që lidhen me vendime administrative të viteve të mëparshme, pavarësisht se sipas dispozitave të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, prekja e garancisë duhet të kryhet në momentin e rrëzimit të ankimit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm.

Në fund të vitit 2024, sipas evidencave të përcjella nga Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave rezultojnë të depozituara 12 garanci me afat vlefshmërie përtej vitit 2024 në shumën 26,345,511 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | SUBJEKTI | Garancia | Data e vlefshmërisë | Garantuesi | Vendim nr date I DD | Dega Doganore | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | P | Nr.Prot 1707; 27/11/2019 | 25/05/2025 | BKT Tirane | 1069; 30/10/2019 | Durres | 14,918,200 |
| 2 | K | Nr 3153 Prot; 15/11/2019 | 30/06/2025 | OTP Bank | Nr.1050; 01/11/2019 | Durres | 4,292,493 |
| 3 | M | Nr 3036 Prot; 01/08/2022 | 30/06/2025 | ALPHA Bank | Nr.775; 20/06/2023 | Tirane | 38,034 |
| 4 | E | Nr.19630/3 Prot ; dt 23/01/2023 | 14/12/2026 | BKT Tirane | Nr 801, 802; 08/07/2022 | Tirane | 2,797,978 |
| 5 | T | Nr.167 Prot ; dt 28/04/2023 | 26/04/2026 | BKT Tirane | Nr 427; 29/03/2023 | Tirane | 446,626 |
| 6 | I | Nr.93 Prot ; dt 27/01/2025 | 23/01/2026 | BKT Durres | Nr 564; date 08/11/2024 | Tirane | 235,006 |
| 7 | E | Nr.285 Prot ; dt 15/11/2024 | 30/05/2025 | BKT Tirane | Nr 404; date 01/08/2024 | Tirane | 417,998 |
| 8 | E | Nr.64 Prot ; dt 05/03/2025 | 4/2/2027 | CREDINS Bank | Nr 591, date 29/11/2024 | Tirane | 203,066 |
| 9 | D | Nr.6 Prot ; dt 21/01/2025 | 20/07/2025 | CREDINS Bank | Nr 592, date 20/11/2024 | Tirane | 228,892 |
| 10 | D | Nr.7 Prot ; dt 21/01/2025 | 20/07/2025 | CREDINS Bank | Nr 593, date 20/11/2024 | Tirane | 225,485 |
| 11 | E | Nr 4927,Pr.60298; 19/11/2019, Nr. Pr 69585; 15/11/2024 | | CREDINS, Tirane | Nr. 1053; dt 01/11/2019 | Durres | 2,291,757 |
| 12 | V | Nr.174 Prot; dt 04/07/2024,ref 0109/BG/2024 | | Raiff Bank Dg Gjirok | Nr.46 ; date 10/06/2024 | Kakavije | 249,976 |
| **TOTALI** | | | | | | | **26,345,511** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Referuar të dhënave të mësipërme dhe shpjegimeve të dhëna të sektorit, konstatohet se 2 garanci janë të prekura përgjatë vitit 2025, dhe për 10 garancitë e tjera konstatohet se qëndrojnë në ruajtje nga DPD, duke qenë brenda afatit të vlefshmërisë (në pritje të përfundimit të procesit gjyqësor), megjithëse Udhëzimi nr.15, datë 03.12.2018, parashikon prekjen e tyre të menjëhershme pas rrëzimit të ankimimit nga Drejtori i Përgjithshëm i DPD-së dhe kalimi në llogaritë e thesarit. Gjithashtu për këto garanci në sistemin kontabël nuk ka asnjë informacion mbi gjendjen e tyre në fund të vitit ushtrimor, qoftë duke pasqyruar një të drejtë të mundshme për të arkëtuar, apo dhënien e informacioneve në shënimet shpjeguese sipas pasqyrave financiare. Procesi i depozitimit të garancive për paraqitjen e ankimimit administrativ nuk rezulton të jetë i rregulluar për qëllime të raportimit financiar, por vetëm procesi i çlirimit apo prekjes së garancisë, i cili rezulton të mos jetë pasqyruar në tepricat llogarive që reflektojnë prekjen e garancisë për rastet e vendimmarrjeve që janë shoqëruar me garanci për të cilat janë përmbushur kushtet për prekjen e tyre. Këto problematika nuk janë në përputhje me parashikimet e pikës 2.3 të kapitullit X *"Ankimi administrativ", ku përcaktohet "Në zbatim të pikës 5 të nenit 282 të Kodit Doganor në rast se Drejtori i Përgjithshëm i Doganave vendos rrëzimin e kërkesës ankimore Drejtoria Juridike i përcjellë origjinalin e garancisë së depozituar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit e cila bën kalimin e menjëhershëm të shumës së garancisë në llogarinë e DPD-së"* dhe pikës 3.3 të kapitullit X *"Ankimi administrativ"* ku përcaktohet e njëjta për detyrimet e akcizës *"Në zbatim të pikës 5 të të ligjit nr. 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar....,* të Udhëzimi nr.15, datë 03.12.2018.

**-Garancitë e regjimeve apo autorizimeve të akcizës.**

Në pikën 2.2.1 të Kreut IX "Ekzekutimi i Urdhrit të Ekzekutimit", Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara*

*doganore dhe të akcizës"* për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit, përcaktohet ndërmarrja e veprimeve të mëposhtme:
-pezullimi i autorizimit të regjimit doganor
-pezullimi i autorizimeve të akcizës
-prekjen e garancive të vendosura për qëllim të përfitimit të regjimit doganor apo autorizimeve të akcizës.
Nga auditimi konstatohet se Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave përgjatë vitit 2024 nuk ka kryer asnjë prekje të garancive të depozituara për qëllime të përfitimit të regjimit apo autorizimit të akcizës. Nga departamentet përkatëse nuk janë përcjellë në Sektorin e Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave asnjë kërkesë për prekjen e garancive.

**Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit ndërmjet degës dhe strukturave të specializuara në DPD**
Gjithashtu në pikën 2.3.11 të Kreut IX "Ekzekutimi i Urdhrit të Ekzekutimit", të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* është përcaktuar që Dega Doganore gjatë procedurës së sekuestrimit mund të kërkojë mbështetje nga Departamenti Operativ Hetimor, Departamenti Administrativ, Departamenti Teknik dhe i akcizës dhe Departamenti i Analizave dhe Aposteriorit.
Nga auditimi i dosjeve të subjektet debitore në degët doganore objekt auditimi, konstatohet se në asnjë rast nuk ka bashkëpunim ndërmjet degëve me strukturat e brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për sekuestrimin sipas dokumentacionit të kërkuar sipas pikës XV, gërma l), ll) të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Kjo ka ardhur në mungesë të marrjes së masave për sekuestro dhe mungesës së urdhrave të sekuestros sipas kërkesave të gërmës i) të kapitullit XV të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*
Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 ku përcaktohet që *"Administrata doganore përdor mënyrën me efikase dhe më të sigurtë për mbledhjen e shumës së detyrimeve të papaguara, nga ana e debitorit....* përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor ku citohet "*5. Ekzekutimi i titujve ekzekutivë të nxjerrë nga administrata doganore, të mbështetur me urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga autoritetet gjyqësore kompetente, bëhet menjëherë në bazë të dispozitave të parashikuara nga nenet 511 e në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile. Ekzekutimi mund të bëhet edhe nga strukturat e mbledhjes me forcë të detyrimit pranë administratës doganore. 6. Pas aplikimit të masave të parashikuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të këtij neni, autoritetet doganore procedojnë me konfiskimin, në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative.".*

**I.4. Bashkëpunimi me institucione të tjera**
Sipas kërkesave të udhëzimit në pikën 2.2.2 *"Bashkëpunimi me institucionet e tjera për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit"* të kapitullit IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, me qëllim ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit, Dega Doganore bashkëpunon me institucione të tjera ku përfshihen:
**-DPT** për bllokim aktiviteti tregtar
**-QKB** për bllokim veprimi tregtar që ka lidhje me debitorin

**-bankave të nivelit të dytë**, për bllokimin e sekuestrimin e menjëhershëm të vlerave monetare
**-zyrave të regjistrimit të pasurive të luajtshme** për vendosjen e sekuestros ndaj tyre.
**-zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme** për vendosjen në hipotekë në favor të administratës doganore.
Nga auditimi konstatohet se DPD ka marrëveshje bashkëpunimi vetëm me DPT, ndërkohë që me institucionet e tjera të mësipërme të parashikuara për rikuperimin e detyrimeve doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi, duke rezultuar gjithashtu në mungesë efektiviteti mbi këtë proces, ndërkohë që sipas pikës 3 të nenit 48 të Kodit Doganor është parashikuar që *"Me qëllim që të sigurohet zbatimi korrekt i legjislacionit doganor, autoritetet doganore bashkëpunojnë me organizma publikë ose privatë, shqiptarë ose të huaj. Mënyrat dhe format e bashkëpunimit e të shkëmbimit të informacionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij Kodi, në akte të tjera ligjore dhe nënligjore apo në marrëveshje bashkëpunimi.".*

Në konkluzion, nga auditimi konstatohen mangësi në dokumentimin e bashkëpunimit me institucione të tjera apo strukturat e brendshme të DPD me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore të papaguara sipas kërkesave të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

**III.2.2. Auditim mbi kontabilizimin e detyrimeve të subjekteve debitore për të ardhurat doganore, krijimi i detyrimeve të reja dhe stoku i borxhit doganor në fillim dhe në fund të vitit buxhetor.**

A. Kontabilizimi i detyrimeve në sistemin kontabël dhe raportimi në pasqyrat financiare
Procedurat për kryerjen e kontabilizimit të detyrimeve doganore janë përcaktuar në kapitullin V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës" ku përcaktohet "1.Mbështetur në vendimin e shpalljes debitor, Kryetari i Degës Doganore procedon si më poshtë: a) urdhëron kontabilizimin e detyrimeve të papaguara ... Ky kontabilizimin bëhet nga financieri pranë sektorit në Degën Doganore.... 2. Kontabilizimi i shumës së detyrimeve bëhet në zëra të veçantë: a)një zë për shumën e borxhit doganor (detyrimet e import/eksportit të papaguara) dhe apo detyrimeve të akcizës, b) një zë për shumën për shumën e penaliteteve, c) një zë për shumën e kamatvonesave.".* Nga auditimi konstatohet se deri në hartimin e këtij akt konstatimi nuk janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara me qëllim rakordimin e gjendjes së debitorëve në llogarinë 468 që i atribuohen vendimeve doganore për shpalljen debitor me evidencën përmbledhëse të stokut të borxhit në 31.12.2024 sipas Sektorit të Monitorimit të Borxhit. Nga auditimi me përzgjedhje për degët e përcaktuara në programin e auditimit është konstatuar diferencë në shumat e raportuara të borxhit ndërmjet financës dhe borxhit vetëm për Degën Doganore Tiranë. **Këto diferenca nuk rezultojnë të jenë monitoruar dhe shmangur diferencat në raportim nëpërmjet mbajtjes së një qëndrimi unifikues.**

Gjithashtu konstatohet se në të gjitha degët doganore, kontabilizimi i shumave kryhet në total për rast vendimi, pa e ndarë në detyrim, penalitet dhe kamatëvonesa, sipas përcaktimeve të mësipërme. Përsa i përket kamatvonesave, konstatohet se në disa raste në degët doganore Fier, Lezhë dhe Tiranë, llogaritja e tyre nuk është kryer nga momenti i lindjes së mos përmbushjes së detyrimit doganor për ato mos përmbushje të trajtuara sipas neneve 74-77 të Kodit Doganor, por është kryer nga data e njoftimit të vendimit, sipas përcaktimeve të pikës 4.2. b) ii) të kapitullit V

"Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Mos përllogaritja e saktë e këtyre kamatvonesave të evidentuara nga përzgjedhja e auditimit si dhe të tjera përtej zgjedhjes së auditimit në të gjitha degët doganore krijon kushtet për pasaktësinë e shumave të raportuara në evidencën e borxhit në fund të vitit 2024.
Nga auditimi mbi plotësinë e kontabilizimit të detyrimeve doganore në sistemin e kontabilitetit është konstatuar se në degët e audituara nuk ka vendime të pa kontabilizuara duke testuar vendimet e muajit dhjetor me përzgjedhje të cilët rezultuan të evidentuara saktë në llogarinë e debitorëve sipas kartelave analitike të llogarive.

B. Stoku i borxhit doganor në fillim dhe fund të vitit 2024 dhe shtesat e pakësimet përgjatë periudhës.

Bazuar në evidencën e vendosur në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD), në fund të vitit 2024 rezulton një nivel detyrimi i papaguar doganor gjithsej në shumën 48,588,510 mijë lekë, e përfaqësuar nga 4684 raste, të cilat analizohen si më poshtë:

| Viti | Raste | Totali | Shtesa/pakësime | Rritja/ulja % |
|---|---|---|---|---|
| 2018 | 4520 | 27,596,148 | 3,649,549 | |
| 2019 | 4364 | 41,972,864 | 14,376,716 | 34.25 |
| 2020 | 4708 | 45,053,939 | 3,081,075 | 6.84 |
| 2021 | 4688 | 45,711,587 | 657,648 | 1.44 |
| 2022 | 4858 | 46,690,911 | 979,324 | 2.1 |
| 2023 | 4495 | 47,593,570 | 902,659 | 1.9 |
| 2024 | 4680 | 48,588,510 | 994,940 | 2.10 |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Nga krahasimi i të dhënave të detyrimeve doganore të papaguara në krahasim me një vit më parë rezulton se borxhi doganor ka një rritje prej 994,940 mijë lekë ose 2.1%. Gjithashtu edhe në numër rastesh, sipas përmbledhëses së hartuar nga DPD, borxhi doganor rezulton në rritje nga 4495 raste në fund të vitit 2023, në 4680 raste në fund të vitit 2024, me një rritje prej 185 rastesh më shumë. Ne fund të vitit 2024 rezultojnë debitorë 3196 subjekte, me një rritje prej 185 subjektesh debitorë, nga 3011 subjekte debitorë që rezultojnë në fillim të vitit. Sipas evidencës totale analitike në nivel rasti të shkeljes doganore të vendosur në dispozicion nga DPD, konstatohet se në regjistrin e borxhit paraqiten 85 raste në të cilat vlera e detyrimit doganor është 0 lekë.

Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave rritja më e madhe e detyrimeve të papaguara doganore ka ndodhur në vitin 2019 me një rritje 34.25% krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje e konsiderueshme e detyrimeve të papaguara doganore në vitin 2019 ka ardhur si rezultat i transferimit të detyrimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), në zbatim të Udhëzimit të MFE-së nr. 9, datë 11.03.2019 *"Mbi modalitetet e transferimit pranë Administratës Doganore të të dhënave për subjektet e akcizës të cilat rezultojnë me detyrime të papaguara".* Rreth 29% të shumës së detyrimeve të papaguara ose 13,892,579 mijë lekë, të trashëguara deri me 31 Dhjetor 2024, janë detyrimet e papaguara të transferuara nga DPT në vitin 2019. Nga viti në vit vlera e detyrimeve të papaguara doganore ka ardhur në rritje, ku viti 2024 shënon vitin me detyrimet më të larta të raportuara.

Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave konstatohet se përbërja e detyrimeve doganore në nivel dege doganore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

| DEGA | Numër Rastesh | Detyrime Doganore | Penalitete | Kamate Vonesa | Total Borxhi |
|---|---|---|---|---|---|
| TIRANE | 1716 | 5,180,799,980 | 10,360,709,595 | 3,465,351,651 | **19,006,861,226** |
| RINAS | 15 | 2,588,060 | 6,010,323 | 723,820 | **9,322,203** |
| DURRES | 1015 | 1,513,908,863 | 4,957,260,250 | 1,492,687,458 | **7,963,856,571** |
| SHKODER | 151 | 83,827,895 | 303,673,310 | 116,817,945 | **504,319,150** |
| POGRADEC | 25 | 6,374,296 | 6,149,151 | 4,389,015 | **16,912,462** |
| KAKAVIJE | 302 | 145,235,892 | 160,454,164 | 138,872,324 | **444,562,380** |
| KORCE | 110 | 201,619,401 | 171,587,009 | 190,688,984 | **563,895,394** |
| KAPSHTICE | 122 | 40,517,170 | 92,259,847 | 17,929,999 | **150,707,016** |
| VLORE | 291 | 197,124,398 | 438,502,266 | 105,455,246 | **741,081,910** |
| FIER | 301 | 4,814,789,642 | 7,854,696,225 | 2,335,876,457 | **15,005,362,324** |
| SARANDE | 90 | 60,066,739 | 109,197,172 | 49,642,933 | **218,906,844** |
| ELBASAN | 93 | 43,099,787 | 238,640,608 | 91,259,569 | **372,999,964** |
| LEZHE | 98 | 470,504,272 | 933,399,627 | 544,632,742 | **1,948,536,641** |
| BERAT | 66 | 272,512,835 | 767,813,189 | 298,366,892 | **1,338,692,916** |
| KUKES | 97 | 35,685,667 | 35,813,208 | 28,405,193 | **99,904,068** |
| PESHKOPI | 23 | 18,638,219 | 64,939,024 | 40,248,713 | **123,825,956** |
| TRE URAT | 169 | 12,775,834 | 59,976,059 | 6,011,234 | **78,763,127** |
| **TOTALI** | **4684** | **13,100,068,950** | **26,561,081,027** | **8,927,360,175** | **48,588,510,153** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Peshën më të madhe specifike në borxhin doganor në raport me totalin konstatohet se e kanë Dega Doganore Tiranë 39%, Fier 31%%, Durrës 16.4%, Lezhë 4% dhe Berat 2.8%. Vlerë të konsiderueshme në përbërjen e detyrimeve doganore përbëjnë penalitetet me rreth 55% të cilat janë mbi vlerën e detyrimit kryesor që përbën 27% si dhe kamatëvonesat paraqiten në vlera përfaqësuese me rreth 18%.

Nga analiza e mëtejshme e përbërjes së borxhit nga këto degë doganore konstatohet se vjen kryesisht nga borxhi i krijuar nga tatimpaguesit subjekt i akcizës për detyrimeve të viteve të kaluara. Disa nga 3196 debitorët më të mëdhenj të trashëguar deri më 31 Dhjetor 2024, të cilët përbëjnë rreth 56% të shumës totale të detyrimeve të papaguara janë:

| Nr | Emri Subjektit | Detyrim Doganor | Penalitet | Kamate Vonesa | Shuma Totale |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A | 3,587,656,087 | 6,591,775,004 | 2,300,442,495 | **12,479,873,586** |
| 2 | D | 1,473,397,646 | 2,946,795,292 | 729,953,609 | **5,150,146,547** |
| 3 | B | | 1,768,359,980 | 92,838,899 | **1,861,198,879** |
| 4 | A | 390,215,111 | 780,430,222 | 441,907,637 | **1,612,552,970** |
| 5 | A | 195,510,257 | 977,551,285 | 287,085,111 | **1,460,146,653** |
| 6 | M | 222,572,360 | 667,717,080 | 348,342,625 | **1,238,632,065** |
| 7 | S | 121,369,352 | 606,846,760 | 145,029,010 | **873,245,122** |
| 8 | T | 242,755,600 | 485,511,200 | 120,266,465 | **848,533,265** |
| 9 | F | 123,475,979 | 617,379,895 | 15,452,895 | **756,308,769** |
| 10 | A | 192,162,000 | 389,324,000 | 163,473,641 | **744,959,641** |
| | **Totali** | **6,549,114,392** | **15,831,690,718** | **4,644,792,388** | **27,025,597,498** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Për këto debitorë konstatohet se mbarten nga viti në vit duke krijuar detyrime shtesë në formën e kamatvonesave, megjithëse janë ndërmarrrë kryesisht masat e ekzekutimit të detyrueshëm sipas evidencës mbi masat e marra për detyrimet doganore.

Sipas analizave të subjektit nga detyrimet e papaguara, të trashëguara deri më 31 Dhjetor 2024, rezultojnë:
-460 raste në shumën 355,161 mijë lekë janë detyrime të papaguara nga zhdoganimi i automjeteve.
-465 raste në shumën 30,134,842 mijë lekë ose 62.02% e detyrimeve totale janë detyrime nga mallrat e Akcizës (nga shkeljet në zbatim të Ligjit nr.61 dt 25.04.2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë");
-57 raste në shumën 551,029 mijë lekë janë detyrime nga TVSH-ja e shtyrë.

Raporti i shtesave dhe pakësimeve përgjatë vitit 2024 në raport me fillimin dhe fundin e vitit 2024 përsa i përket veprimtarisë së borxhit në baza mujore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Muaji | Borxhe te shtuara | | | Borxhe te pakësuara | | | % pakesime/shtesa |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr | Shuma | % ndaj Totali | Nr | Shuma | % ndaj Totali | |
| Janar 2024 | 260 | 120,404 | 8.6 | 221 | 32,728 | 8.1 | 27.2 |
| Shkurt 2024 | 223 | 27,082 | 1.9 | 231 | 34,317 | 8.5 | 126.7 |
| Mars 2024 | 193 | 63,245 | 4.5 | 226 | 30,206 | 7.5 | 47.8 |
| Prill 2024 | 172 | 54,078 | 3.9 | 215 | 44,527 | 11 | 82.3 |
| Maj 2024 | 300 | 110,353 | 7.9 | 185 | 24,085 | 6 | 21.8 |
| Qershor 2024 | 218 | 282,825 | 20.2 | 198 | 36,167 | 9 | 12.8 |
| Korrik 2024 | 294 | 75,411 | 5.4 | 308 | 50,776 | 12.6 | 67.3 |
| Gusht 2024 | 223 | 45,708 | 3.3 | 228 | 23,354 | 5.8 | 51.1 |
| Shtator 2024 | 224 | 25,343 | 1.8 | 196 | 46,884 | 11.6 | 185 |
| Tetor 2024 | 211 | 47,087 | 3.4 | 234 | 29,873 | 7.4 | 63.4 |
| Nëntor 2024 | 198 | 40,830 | 2.9 | 216 | 31,115 | 7.7 | 76.2 |
| Dhjetor 2024 | 295 | 506,316 | 36.2 | 168 | 19,710 | 4.9 | 3.9 |
| **Viti 2024** | **2,811** | **1,398,682** | **100** | **2,626** | **403,742** | **100** | 28.87 |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Të analizuara në nivel dege doganore, gjendja fillestare së bashku me shtesat e pakësimet e vitit dhe gjendjen e borxhit në 31.12.2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Dega doganore | Debitore fillestare | | Shtesat gjate vitit | | Pakesime gjate vitit | | Debitore përfundimtare | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *Raste* | *Vlere* | *Raste* | *Vlere* | *Raste* | *Vlere* | *Raste* | *Vlere* |
| TIRANE | 1,642 | 18,620,934,752 | 701 | 509,742,024 | 627 | 123,815,551 | 1,716 | 19,006,861,225 |
| RINAS | 15 | 9,322,203 | 44 | 12,437,491 | 44 | 12,437,491 | 15 | 9,322,203 |
| DURRES | 983 | 7,706,833,342 | 1,019 | 348,398,468 | 987 | 91,375,239 | 1,015 | 7,963,856,571 |
| SHKODER | 142 | 497,820,022 | 51 | 10,047,286 | 42 | 3,548,158 | 151 | 504,319,150 |
| POGRADEC | 25 | 56,861,035 | 50 | 10,363,073 | 50 | 50,311,646 | 25 | 16,912,462 |
| KAKAVIJE | 266 | 420,248,272 | 129 | 69,177,794 | 93 | 44,863,686 | 302 | 444,562,380 |
| KORCE | 113 | 518,333,521 | 27 | 48,805,439 | 30 | 3,243,567 | 110 | 563,895,393 |
| KAPSHTICE | 120 | 147,444,757 | 203 | 22,259,471 | 201 | 18,997,212 | 122 | 150,707,016 |
| VLORE | 287 | 738,179,477 | 174 | 18,674,208 | 170 | 15,771,775 | 291 | 741,081,910 |
| FIER | 281 | 14,755,644,285 | 117 | 262,483,279 | 97 | 12,765,240 | 301 | 15,005,362,324 |
| SARANDE | 85 | 215,494,968 | 39 | 6,296,459 | 34 | 2,884,583 | 90 | 218,906,844 |
| ELBASAN | 88 | 350,048,489 | 43 | 30,757,962 | 38 | 7,806,487 | 93 | 372,999,964 |
| LEZHE | 101 | 1,924,488,929 | 52 | 27,429,428 | 55 | 3,381,714 | 98 | 1,948,536,643 |
| BERAT | 70 | 1,331,716,126 | 17 | 8,686,909 | 21 | 1,710,119 | 66 | 1,338,692,916 |
| KUKES | 79 | 97,514,441 | 114 | 9,760,647 | 96 | 7,371,020 | 97 | 99,904,068 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| PESHKOPI | 27 | 124,132,589 | 26 | 2,313,484 | 30 | 2,620,117 | 23 | 123,825,956 |
| TRE URAT | 171 | 78,552,878 | 5 | 1,048,897 | 7 | 838,648 | 169 | 78,763,127 |
| **TOTALI** | **4,495** | **47,593,570,086** | **2,811** | **1,398,682,319** | **2,622** | **403,742,253** | **4,684** | **48,588,510,151** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Konstatohet se vazhdon të paraqitet një trend rritës i detyrimeve të papaguara. Rritja më e madhe në vlerë e debitorëve evidentohet në Degën Doganore Durrës në shumën 348,398 mijë lekë, Degën Doganore Tiranë në shumën 509,742 mijë lekë dhe Degën Doganore Fier në shumën 262,483 mijë lekë. Vetëm në Degën Doganore Pogradec evidentohet rënie në vlerën 50,311 mijë lekë të debitorëve si pasojë e arkëtimit të detyrimit të një subjekti në vlerë përfaqësuese ndaj totalit të borxhit të kësaj dege doganore. Në lidhje me pakësimin e detyrimeve të papaguara doganore përgjatë vitit 2024, shlyerja e detyrimit nga subjektet rezulton të jetë në shumën 403,742 mijë lekë ose 0.84% e totalit të detyrimeve të papaguara doganore, çka tregon një mungesë efektiviteti në rikuperimin e stokut të detyrimeve të krijuara gjatë viteve.
Evidentohet se raporti i detyrimeve të pakësuara mbi detyrimet e shtuara për vitin 2024 rezulton 28.8%, ndërsa për vitin 2023 rezultonte 40%. Pra kemi ulje të këtij raporti si rezultat i uljes së detyrimeve të arkëtuara në raport me detyrimet e shtuara gjatë vitit.

Gjatë periudhës 1 Janar-31 Dhjetor 2024, detyrimet e papaguara të reja sipas vendimeve të vitit 2024, janë rritur me **334,003 mijë lekë** si më poshtë:
**Borxhi doganor: 115,076 mijë lekë**
**Penalitete: 216,519 mijë lekë**
**Kamate vonesa: 2,408 mijë lekë**
Në këtë rritje peshën kryesore e kanë Dega Doganore Tiranë rreth **47%,** Durrës me **33**%, Elbasan rreth **7**%, Kakavijë **5%,** Fier **4%**, Shkodër, Pogradec, Kapshtica, dhe Vlora me rreth 4**%,** etj sipas tabelës së mëposhtme:

| Dega Doganore | Nr Vend | Detyrimi | Penaliteti | Interesi | SHUMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 01Tirane | 246 | 55,190,711 | 100,090,000 | 1,362,640 | 156,643,351 |
| 02Rinas | 1 | | 20,000 | | 20,000 |
| 03Durrës | 100 | 28,515,136 | 79,749,513 | 471,496 | 108,736,145 |
| 04Shkodër | 13 | 4,737,909 | 763,375 | - | 5,501,284 |
| 05Pogradec | 2 | | 2,488,926 | 10,993 | 2,499,919 |
| 06Kakavijë | 47 | 7,273,272 | 10,419,032 | 152,935 | 17,845,239 |
| 07Korçë | 2 | - | 158,355 | 1,578 | 159,933 |
| 08Kapshticë | 7 | 885,738 | 1,317,726 | 5,726 | 2,209,190 |
| 09Vlorë | 19 | 1,410,691 | 113,048 | 31,739 | 1,555,478 |
| 10Fier | 33 | 7,111,154 | 5,083,546 | 106,526 | 12,301,226 |
| 11Sarandë | 6 | 693,744 | 33,545 | 2,592 | 729,881 |
| 12Elbasan | 8 | 7,761,904 | 15,250,526 | 232,524 | 23,244,954 |
| 13Lezhë | 5 | 234,392 | 703,182 | 29,508 | 967,082 |
| 15Kukës | 21 | 1,261,097 | 328,152 | - | 1,589,249 |
| **Total** | **510** | **115,075,748** | **216,518,926** | **2,408,256** | **334,002,931** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*
Gjatë periudhës 1 Janar-31 Dhjetor 2024, detyrimet e papaguara, janë pakësuar **403,762 mijë lekë** si më poshtë:
Borxhi doganor: **223,410 mijë lekë**
Penalitete: **171,616 mijë lekë**
Kamate vonesa: **8,736 mijë lekë**

Nga shuma totale e pakësimeve si më sipër, shuma prej **292,052 mijë lekë** (ose sa **72%**) i përket pakësimeve të detyrimeve doganore për vendime administrative të marra gjatë vitit 2024, ndërsa

pjesa tjetër në vlerën 111,710 mijë lekë i përket pagesave të kryera në vitin 2024 për llogari të detyrimeve doganore të mbartura nga viti 2011-2023.

| Pagesat e kryera ne 2024 | Detyrimet | Penalitete | Interesa | Totali |
|---|---|---|---|---|
| Per llogari te 2024 | 163,473,338 | 128,537,221 | 41,373 | 292,052,352 |
| Per llogari te viteve te kaluara | 59,936,230 | 43,078,840 | 8,694,805 | 111,709,875 |
| **Totali** | **223,409,568** | **171,616,062** | **8,736,178** | **403,762,228** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Kjo tregon që veprimet administrative të organeve doganore rezultojnë të jenë efektive përkundrejt detyrimeve të reja të konstatuara, por janë të papërfillshme në lidhje me detyrimet e mbartura nga vitet e kaluara.

Pakësimet e borxhit përgjatë vitit 2024 paraqiten në nivel dege doganore sipas tabelës së mëposhtme:

| Dega Doganore | Nr Vend | Detyrimi | Penaliteti | Interesi | SHUMA |
|---|---|---|---|---|---|
| 01Tirane | 689 | 74,069,599 | 44,788,225 | 4,957,727 | 123,815,551 |
| 02Rinas | 43 | 5,686,572 | 6,750,919 | | 12,437,491 |
| 03Durrës | 1,056 | 42,310,438 | 48,328,379 | 736,421 | 91,375,238 |
| 04Shkodër | 46 | 2,056,122 | 1,491,355 | 681 | 3,548,158 |
| 05Pogradec | 56 | 44,104,573 | 6,199,664 | 7,409 | 50,311,646 |
| 06Kakavie | 164 | 19,986,912 | 25,458,688 | 61,136 | 45,507,155 |
| 07Korçë | 40 | 1,711,066 | 1,306,087 | 226,415 | 3,243,568 |
| 08Kapshticë | 195 | 14,436,233 | 3,649,958 | 267,551 | 18,353,742 |
| 09Vlorë | 192 | 6,704,598 | 9,029,498 | 37,679 | 15,771,775 |
| 10Fier | 114 | 1,086,100 | 9,595,642 | 2,083,501 | 12,765,243 |
| 11Sarandë | 44 | 587,863 | 2,296,720 | - | 2,884,583 |
| 12Elbasan | 42 | 2,878,204 | 4,632,519 | 295,764 | 7,806,487 |
| 13Lezhë | 56 | 2,211,086 | 1,161,105 | 9,524 | 3,381,715 |
| 14Berat | 22 | 790,866 | 917,202 | 2,053 | 1,710,122 |
| 15Kukës | 99 | 3,245,050 | 4,145,940 | - | 7,390,990 |
| 16Peshkopi | 31 | 1,544,286 | 1,002,661 | 37,670 | 2,584,617 |
| 17Tre Urat | 21 | - | 826,000 | 12,648 | 838,648 |
| Peshkopi | 1 | - | 35,500 | - | 35,500 |
| **Total** | **2,911** | **223,409,568** | **171,616,062** | **8,736,178** | **403,762,228** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Në pakësimin total peshën kryesore e kanë Dega Doganore Tiranë rreth **31%,** Durrës rreth **23%,** Pogradec rreth **12%**, Kakavijë rreth **11%,** Kapshticë rreth **4%,** Fier 3 % dhe Elbasan 2% etj.

### III.2.3. Lloji dhe përbërja e detyrimeve doganore sipas strukturave konstatuese dhe përllogaritja e kamatvonesave

Detyrimet doganore janë krijuar përgjatë viteve të ndryshme të mbartura dhe referuar evidencës përmbledhëse të vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave sipas vitit të vendimit, gjendja në 31.12.2024 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Viti i vendimit | Shuma për tu paguar | Përqindja ndaj totalit |
|---|---|---|
| 2002 | 21,423,888 | 0.04% |
| 2010 | 508,898,572 | 1.05% |
| 2011 | 1,548,207,818 | 3.19% |
| 2012 | 1,092,054,464 | 2.25% |
| 2013 | 5,744,778,861 | 11.82% |
| 2014 | 2,928,281,907 | 6.03% |
| 2015 | 9,218,107,824 | 18.97% |
| 2016 | 3,313,946,196 | 6.82% |
| 2017 | 1,171,384,267 | 2.41% |

| | | |
|---|---|---|
| 2018 | 3,955,054,393 | 8.14% |
| 2019 | 14,546,022,650 | 29.94% |
| 2020 | 3,043,095,886 | 6.26% |
| 2021 | 406,095,375 | 0.84% |
| 2022 | 227,047,860 | 0.47% |
| 2023 | 530,107,266 | 1.09% |
| 2024 | 334,002,925 | 0.69% |
| **Total** | **48,588,510,150** | **100.00%** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Peshën më të madhe specifike për vitet e krijimit të detyrimeve të papaguara doganore e ka viti 2019 në masën 29.94% dhe detyrimet e papaguara doganore të krijuara në vitin 2015 në masën 18.97%. Detyrimet e papaguara doganore krijuar përgjatë vitit ushtrimor 2024, paraqitet në shumën 334,002,925 mijë lekë ose 0.7% e totalit. **Pjesa tjetër e shtesës për vitin 2024 vjen nga shtesat nga kamatëvonesat, duke marrë parasysh efektin e pakësimeve të borxhit nga vitet e kaluara si pasojë e pagesave të kryera në vitin 2024.**
Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se detyrimet e papaguara doganore mbi 5 vjet nga momenti i lindjes së detyrimit janë në vlerën 44,048,161 mijë lekë ose në masën 90% mbi totalin e stokut të detyrimeve. Duke qenë se më shumë se gjysma e detyrimit të trashëguar në vite është mbi 5 vjet, situata paraqitet jo efektive mbi mënyrën e rikuperimit me forcë të detyrimeve të papaguara doganore nga ana e strukturave të doganës me pasojë rritjen e riskut të parashkrimit të mbledhjes së tyre.

Nga lista e debitorëve të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave konstatohet se fusha e strukturës konstatuese nuk është me vlera të paracaktuara për raportimin e saj të përmbledhur, referuar tabelës së mëposhtme:

| Struktura konstatuese | Shuma për tu paguar |
|---|---|
| Auditi | 339,825,281 |
| CROËN | 54,899,451 |
| CROËN | 167,904,701 |
| CROËN&AKCIZE | 3,686,252 |
| CROËN&D.DOGANORE | 9,484,440 |
| CROËN&DOH | 72,698,602 |
| D.DOGANORE | 12,511,367,442 |
| D.DOGANORE | 1,888,134 |
| D.DOGANORE REGJIMET | 2,273,986 |
| D.DOGANORE APOSTERIOR | 786,605 |
| D.DOGANORE EKSPORTE | 20,000 |
| D.DOGANORE KONTENIER | 150,000 |
| D.DOGANORE KONTROLLI I SIGURISE | 250,000 |
| D.DOGANORE Mbikëqyrja | 82,893,094 |
| D.DOGANORE Pika Hyrje-Dalje | 20,000 |
| D.DOGANORE PORTO ROMANO | 1,000,000 |
| D.DOGANORE REGJIMET | 134,759,466 |
| D.DOGANORE TRAGETE | 276,600 |
| D.DOGANORE ZYRA E KONTROLLIT | 180,000 |
| D.DOGANORE& D.P.D | 48,000 |
| D.DOGANORE&CROËN | 1,408,979 |
| D.DOGANORE&D.VLERES | 764,112 |
| D.DOGANORE&DOH | 1,864,841 |
| D.DOGANORE&KLSH | 694,028 |
| D.DOGANORE&POLICI | 274,443 |
| D.DOGANORE&SEKTORI I VLERSIMIT QENDROR | 119,489 |
| D.DOGANORE/DPD | 1,212,306 |
| D.DOGANORE/DPD/AKCIZE | 65,216,974 |
| D.DOGANORE/RLP | 3,239,945 |
| D.DOGANORE/RPA | 1,084,491 |
| D.DOGANORE/TARIFE | 43,312 |

| | |
|---|---|
| D.DOGANORE-AKCIZA | 7,813,049 |
| D.DOGANOREAPOSTERIOR | 311,883 |
| D.DOGANORE-AUDITI | 3,649,288 |
| D.K.P.ZH | 376,882,964 |
| D.K.P.ZH RPA | 603,704 |
| D.K.P.ZH&Dr Akcizës | 281,494,891 |
| D.K.P.ZH.DOH | 9,390,940 |
| D.K.P.ZH/DOH | 361,888,680 |
| D.K.P.ZH/DOH/D.DOGANORE | 12,550,337 |
| D.P.D | 807,393 |
| D.P.TATIME | 13,892,578,980 |
| D.P.V.D | 101,155 |
| DAB | 12,104,278 |
| Dep.Teknik | 1,024,157 |
| DOH | 10,554,724,044 |
| DOH | 710,271 |
| DOH Antikontrabande | 2,278,468 |
| DOH AUTO | 4,629,897 |
| DOH Dr.Akcizës | 79,004,558 |
| DOH e DARM DPD | 99,311 |
| DOH TRAGETE | 20,000 |
| DOH&D.DOGANORE | 47,540,829 |
| DOH/D.DOGANORE | 1,651,384,976 |
| DOH/GFI/DDD/AKCIZE | 86,319 |
| DPD | 8,462,849 |
| DPD KONTROLLI I SIGURISE | 60,000 |
| DPD/ GFI/ DDK | 1,343,860 |
| DPD/AUTO | 4,341,525 |
| Dr Akcizës | 88,790,082 |
| Dr.Akcizës | 4,843,874,339 |
| Dr.Akcizës&D.DOGANORE | 5,648,028 |
| Dr.Vlerës | 354,920 |
| DTO/DOH | 306,368 |
| DTO/DPD | 551,382 |
| DVQ | 35,018 |
| K.L.SH | 859,372,388 |
| K.L.SH | 12,098,610 |
| K.L.SH / DDK | 10,333,611 |
| K.L.SH&D.DOGANORE | 48,988 |
| K.L.SH&Dr.Akcizës | 146,159 |
| K.L.SH/D.DOGANORE | 7,862,181 |
| K.L.SH/Dr.Akcizës | 1,861,198,879 |
| Laboratori Doganor | 72,875,246 |
| M. Finances | 21,423,888 |
| ORIGJINA | 20,620,876 |
| RPA | 89,322 |
| SKAO | 6,656,285 |
| **TOTALI** | **48,588,510,150** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Nga auditimi konstatohet se të dhënat e mësipërme nuk janë në formatin e duhur dhe te standartizuar me qëllim përpunimin e informacionit dhe paraqitjes së tij drejt përdoruesve në kohën dhe formën e duhur për vendimmarrje. **Sipas strukturave konstatuese, borxhi i ri i krijuar për detyrimet doganore është** rritur me **334,003 mijë lekë dhe paraqitet si më poshtë:**

| Organi Konstatues | Numër rastesh | Shuma e detyrimeve | % Ndaj Totalit |
|---|---|---|---|
| **DOH** | **80** | **88,538** | **27%** |
| **KLSH** | **80** | **11,052** | **3%** |
| **Degët Doganore** | **305** | **116,627** | **35%** |
| **Auditi dhe te Tjera** | **40** | **102,361** | **31%** |
| **Depart. Akcizës** | **5** | **15,425** | **5%** |
| **Total** | **510** | **334,003** | **100%** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Ndërkohë që standartizimi i organit konstatues është kryer për vitin 2024, konstatohet të mos jetë kryer për rastet e mbartura nga vitet e kaluara.
Të analizuara sipas statusit të subjekteve të cilat rezultojnë me detyrime doganore në 31.12.2024, gjendja e debitorëve paraqitet:

| Emërtimi | Nr. Raste | Shuma e Detyrimit |
|---|---|---|
| Aktiv | 2366 | 28,763,472,364 |
| Aktiv NUK KA INFO | 4 | 148,223,781 |
| Aktiv&NUK KA INFO | 17 | 10,213,647 |
| Çregjistruar | 122 | 286,698,928 |
| Çregjistruar pa Likuidim | 15 | 35,019,689 |
| Falimentuar | 5 | 242,558,813 |
| Nipt I përgjithshëm | 200 | 159,058,823 |
| NUK KA IFORMACION | 711 | 2,653,292,170 |
| Pezulluar | 952 | 12,869,184,506 |
| Shoqëri ne Likuidim e Siper | 108 | 1,628,080,820 |
| Shoqëri në procedurë falimenti | 3 | 27,016,138 |
| SKA ID | 214 | 1,745,642,485 |
| Pa shënim | 48 | 20,047,986 |
| **Total** | **4765** | **48,588,510,150** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Nga auditimi konstatohet se për disa prej subjekteve në numër të konsiderueshëm nuk ka informacion ID, që krijon riskun e informacioneve të pasakta apo për ndjekjen në kohë reale të gjendjes së tyre, nëse janë aktiv apo jo. Paraqitja e informacionit përsa i përket statusit të debitorit evidentohet se ka dublikime dhe e bën përmbledhjen e tij në tabelë të papërpuneshme. Plotësimi i fushës nuk është me të dhëna unike të standardizuara në mënyrë që të analizohen të dhënat dhe të mbulohet vendimmarrja menaxheriale me informacion të saktë dhe të dobishëm për ndjekjen e borxhit doganor. E njëjta situatë paraqitet edhe për fushën "lloji i shkeljes".
Përsa i përket llogaritjes së kamatvonesave, nga auditimi konstatohet se ato zënë një peshë të konsiderueshme me rreth 18% mbi totalin e detyrimeve doganore të vitit 2024, duke qenë në rritje të vazhdueshme me rreth 1 miliard lekë në vit**. Kjo situatë shton borxhin doganor pa një kufi kohor të mirëpërcaktuar në kuadrin ligjor për përllogaritjen e tyre duke sjellë vështirësi shtesë në mbledhjen e tyre.** Gjithashtu konstatohet se në degët e përzgjedhura për auditim nuk është marrë asnjë masë për klasifikimin e borxhit si të pambledhshëm sipas përcaktimeve të nenit 116 "Shuarja" të Kodit Doganor dhe pikës 3 ç) të kapitullit XIV "Shuarja e detyrimeve doganore" të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

### III.2.4. Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

### III.2.4.1. Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

**Monitorimi dhe marrja e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave**
Nga auditimi mbi evidencën e detyrimeve doganore të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Doganave, konstatohet se është e përbërë nga lista analitike e debitorëve në formë regjistri për

masat e marra si dhe të dhëna të përgjithshme në nivel analize të borxhit. Nga përpunimi i të dhënave analitike të paraqitura në evidencë konstatohet se për detyrimet doganore deri në 31.12.2024, për 2678 raste në shumën 30,598,283,631 lekë janë të mbuluara me urdhër ekzekutimi të lëshuar nga gjykatat respektive. Pjesa tjetër prej **2087 (duke përfshirë edhe rastet me vlerë 0) raste në shumën 17,990,226,518 lekë** paraqitet pa shënim ose me shënimin "kthyer/refuzuar" në kolonën e urdhër ekzekutimit. Megjithëse janë prezantuar në evidencë si raste të pambuluara me urdhër ekzekutimi, nga auditimi janë konstatuar 4 raste në shumën 26,090,351 lekë në të cilat ka shënime në kolonat e evidencës për dërgimin e tyre në përmbarim. Këto raste janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

| Dega Doganore | Emri Subjektit | NIPT.i | Shuma për tu paguar | Nr Vendim | Dt Vendim | Nr Zyra e Përmbarimit | Dt Zyra e Përmbarimit | Emri Permb. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 01Tiranë | T | K | 1,223,615.86 | 373 | 5.31.2016 | 1401 | 1.31.2019 | 3H Zyra Permbarimit |
| 02Rinas | A | K | 1,289,884 | 7 | 27/01/2015 | 8 | 4/6/2015 | Shteteror |
| 06Kakavie | A | J | 20,452,915 | 85 | 7/3/2013 | 703 | 06.05.2015 | BLEK |
| 10Fier | C C | K | 3,123,937 | 35 | 12.3.2012 | 31.08.2015 | 31.08.2015 | ZYBER SHEHU |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Për këto raste, konstatohet mungesë e saktësisë e paraqitjes së të dhënave të evidencës së borxhit dhe mungesën e monitorimit të duhur nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**Detyrimet pa urdhër ekzekutimi**

Përsa i përket detyrimeve doganore të pambuluara me urdhër ekzekutimi, nga auditimi konstatohet se ato paraqiten në proces ankimimi/gjyqësor apo në procedurë tjetër të fazës së mbledhjes, sipas shënimeve në kolonën "proces gjyqësor" të evidencës së borxhit. Të paraqitura në vlerë për secilën fazë, këto raste paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Faza e rasteve pa urdher ekzekutimi | Shuma |
|---|---|
| Akt marrëveshje | 6,133,019 |
| Ankim administrativ dhe proces gjyqësor | 16,336,945,266 |
| Falimenti | 250,533,248 |
| Ne procedure mbledhje | 1,396,614,986 |
| **Totali** | **17,990,226,518** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Pjesa më e madhe e detyrimeve (të pambuluara me urdhër ekzekutimi) paraqiten të jenë në proces gjyqësor me rreth 16,336,945 mijë lekë, ndjekur nga raste të tjera në shumën 1,396,614 mijë lekë të cilat paraqiten në procedurë mbledhjeje.

Marrëveshjet e pagesës me këste janë lidhur me subjektet referuar shkresës nr. 22449/1 datë 29.09.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD "Në lidhje me shlyerjen e borxhit me këste" për një subjekt specifik duke u shprehur *"Sugjerojmë që kjo kërkesë të merret në konsideratë nga ana juaj duke lidhur aktmarrëveshje për shlyerjen me këste të penaliteteve dhe kamatvonesave. Aktmarrëveshja duhet të jetë me afat kohor jo më shumë se 1 vit kalendarik dhe të zbatohet me korrektësi nga palët."*. Nga auditimi konstatohet se akt marrëveshjet e evidentuara sipas tabelës përmbledhëse të borxhit doganor janë nënshkruar pa pasur një bazë ligjore mbi të cilën të jenë parashikuar kushtet, kriteret, modalitetet mbi të cilat aplikohen lehtësitë për shlyerjen e detyrimeve doganore, në një kohë që Kodi Doganor dhe Udhëzimi nr. 15 datë 03.12.2018 parashikon rikuperimin e menjëhershëm të detyrimeve, penaliteteve dhe kamatvonesave.

**Vendime për shpallje debitor të cilat janë të pa mbuluara me Vendim për rikuperimin me forcë të borxhit doganor**

-Nga rastet të cilat janë të pa mbuluara me urdhër ekzekutimi, konstatohen të paktën 613 raste në shumën **13,976,212,926 lekë ose 28% e totalit të borxhit në vlerë** (pa përfshirë muajin dhjetor 2024 dhe vlerat nën 1,500 lekë), për të cilat, nuk ka të shënuar në evidencën e borxhit të dhëna mbi marrjen e Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, megjithëse referuar afateve dhe shumave të detyrimit, janë përmbushur kushtet ligjore për rikuperimin me forcë të këtyre borxheve doganore dhe nuk ka informacion të rifreskuar për situatën faktike të gjendjes së këtyre debitorëve, por vetëm shënimin në proces gjyqësor. Këto raste paraqiten sipas aneksit nr.1. Të analizuara në nivel dege doganore, përmbledhja e rasteve dhe shumave paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Dega Doganore | Shuma | Raste |
|---|---|---|
| 01Tiranë | 13,610,151,291 | 318 |
| 02Rinas | 848,664 | 2 |
| 03Durrës | 10,885,448 | 6 |
| 04Shkodër | 2,924,406 | 6 |
| 05Pogradec | 2,499,919 | 2 |
| 06Kakavie | 25,560,499 | 59 |
| 07Korçë | 109,930 | 1 |
| 08Kapshticë | 1,676,968 | 3 |
| 09Vlorë | 15,616,792 | 45 |
| 10Fier | 48,152,976 | 53 |
| 11Sarandë | 1,557,679 | 10 |
| 12Elbasan | 213,814,212 | 16 |
| 13Lezhë | 16,088,430 | 34 |
| 14Berat | 2,322 | 1 |
| 15Kukës | 2,638,458 | 31 |
| 17Tre Urat | 23,684,933 | 26 |
| **Total** | **13,976,212,926** | **613** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Problematikat më të mëdha konstatohen **në Degën Doganore Tiranë e cila përbën 99% të rasteve**.

Ky konstatim rezulton si pasojë e ekzistencës së shumave në kolonën e detyrimit dhe penaliteteve të detyrimit doganor sipas rastit dhe mungesës së marrjes së VRFB sipas përcaktimeve të pikës 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* ku citohet *"Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 282 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës. Ky vendim....."*. Megjithëse kryerja e veprimeve proceduriale të mësipërme është në përgjegjëse të degëve doganore, konstatohet se nga ana e DPD ka munguar monitorimi i duhur për shmangien e këtyre parregullsive.

-Nga ana tjetër, për rastet për të cilat është nxjerrë VRFB, konstatohet se megjithëse kanë kaluar vite nga data e Vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, ende nuk është kryer kërkesa në gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. **Kjo konstatohet në të paktën 840 raste në shumën 2,470,270,806 lekë** (pa përfshirë muajin dhjetor 2024 dhe vlerat nën 1,500 lekë), të cilat të grupuara në nivel dege doganore paraqiten:

| Dega Doganore | Shuma | Raste |
|---|---|---|
| 01Tiranë | 583,632,977 | 644 |
| 02Rinas | 54,442 | 1 |
| 03Durrës | 3,312,772 | 5 |
| 04Shkodër | 5,823,325 | 8 |
| 06Kakavie | 17,362,287 | 25 |
| 07Korçë | 1,677,013 | 2 |
| 08Kapshticë | 133,126 | 1 |
| 09Vlorë | 12,065 | 3 |
| 10Fier | 1,769,775,620 | 41 |
| 11Sarandë | 15,137,096 | 16 |
| 12Elbasan | 26,313,006 | 11 |
| 13Lezhë | 16,537,916 | 18 |
| 14Berat | 479,097 | 3 |
| 15Kukës | 680,475 | 7 |
| 17Tre Urat | 29,339,589 | 55 |
| **Total** | **2,470,270,806** | **840** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Këto raste paraqiten sipas aneksit nr.2.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e autoriteteve doganore mungon ndjekja e hapave të mëtejshëm procedurialë për rikuperimin e mëtejshëm të borxhit doganor pas nxjerrjes dhe njoftimit të VRFB, në kundërshtim përcaktimet e bëra në pikën 1 të kapitullit VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit" ku citohet *"Menjëherë mbas marrjes dijeni të vendimit për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, pra pas kthimit në titull ekzekutiv, specialisti – jurist/specialist borxhi i sektorit/zyrës së administratës dhe shërbimit në degën doganore dërgon në gjykatë kërkesën për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit".* Megjithëse kryerja e veprimeve proceduriale të mësipërme është në përgjegjësi të degëve doganore, konstatohet se nga ana e DPD ka munguar monitorimi i duhur për shmangien e këtyre parregullsive.

-Nga auditimi konstatohet se megjithëse nga gjykata janë lëshuar urdhrat e ekzekutimit, nga Degët Doganore ende nuk është vepruar për dërgimin e tyre në përmbarim apo masa të tjera në kompetencë të autoritetit doganor, kjo konstatohet në të paktën **105 raste në shumën 404,347,092 lekë,** (pa përfshirë muajin dhjetor 2024 dhe vlerat nën 1,500 lekë). Këto veprime konstatohet se janë në kundërshtim me Kapitullin IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Këto raste paraqiten sipas aneksit nr.3. Megjithëse kryerja e veprimeve proceduriale të mësipërme është në përgjegjësi të degëve doganore, konstatohet se nga ana e DPD ka munguar monitorimi i duhur për shmangien e këtyre parregullsive.

| Dega Doganore | Shuma | Raste |
|---|---|---|
| 01Tiranë | 155,153,839 | 29 |
| 03Durrës | 1,684,126 | 6 |
| 04Shkodër | 1,489,040 | 1 |
| 06Kakavie | 24,264,003 | 17 |
| 07Korçë | 11,608,686 | 2 |
| 09Vlorë | 25,768,329 | 24 |

| | | |
|---|---|---|
| 10Fier | 148,804,920 | 19 |
| 11Sarandë | 35,061,003 | 2 |
| 12Elbasan | 306,717 | 2 |
| 15Kukës | 33,300 | 1 |
| 17Tre Urat | 173,128 | 2 |
| **Total** | **404,347,092** | **105** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

-Nga auditimi mbi evidencën e përmbledhur të borxhit në fund të vitit 2024, konstatohen të paktën 765 raste në shumën 14,284,686,504 lekë, ku megjithëse urdhër ekzekutimet janë dërguar për ekzekutim zyrës së Përmbarimit Shtetëror/privat, në asnjë rast nuk janë marrë masa nga vetë autoriteti doganor për rikuperimin e detyrimeve të papaguara për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera sipas kërkesave të pikës 2.2.2 *"Bashkëpunimi me institucionet e tjera për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit"* të Kapitullit IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Këto raste paraqiten sipas aneksit nr.4 dhe paraqiten në nivel dege doganore sipas tabelës së mëposhtme:

| Dega Doganore | Shuma | Raste |
|---|---|---|
| 01Tiranë | 3,171,954,864 | 359 |
| 02Rinas | 4,037,050 | 4 |
| 03Durrës | 79,751,583 | 7 |
| 04Shkodër | 63,908,515 | 2 |
| 05Pogradec | 38,278 | 1 |
| 06Kakavie | 30,297,134 | 34 |
| 07Korçë | 274,990 | 4 |
| 09Vlorë | 37,491,725 | 92 |
| 10Fier | 10,512,343,051 | 131 |
| 11Sarandë | 112,952,640 | 36 |
| 12Elbasan | 74,186,619 | 22 |
| 13Lezhë | 176,812,188 | 30 |
| 15Kukës | 11,147,757 | 15 |
| 17Tre Urat | 9,490,109 | 28 |
| **Total** | **14,284,686,504** | **765** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD*

Megjithëse kryerja e veprimeve proceduriale të mësipërme është në përgjegjësi të degëve doganore, konstatohet se nga ana e DPD ka munguar monitorimi i duhur për shmangien e këtyre parregullsive.

Gjithashtu për të gjitha rastet e audituara në degë doganore përgjatë vitit 2024 ka rezultuar se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor në kundërshtim me pikën 2.3. *"Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor"* të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës".*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 ku përcaktohet që *"Administrata doganore përdor mënyrën me efikase dhe më të sigurtë për mbledhjen e shumës së detyrimeve të papaguara, nga ana e*

*debitorit....* përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor ku përcaktohet*"1. Kur shuma e detyrimeve të importit ose eksportit që duhen paguar nuk është shlyer brenda afateve të përcaktuara në këtë Kod: a) autoritetet doganore përdorin të gjitha mjetet ligjore për të siguruar pagesën e shumës së borxhit; b) përveç shumës së detyrimeve të importit ose eksportit ngarkohen edhe kamatëvonesat. 2. Autoritetet doganore, kur lind një borxh, me qëllim që të sigurojnë pagimin e këtij borxhi, mund të marrin masat e mëposhtme: a) sekuestrimin e vlerave monetare, të kredive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumenteve, me anë të të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në një bankë, që i përkasin debitorit ose garantuesit/garantuesve; b) sekuestrimin e mallrave, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, që i përkasin debitorit ose garantuesit /gantuesve, i cili/të cilët ka/kanë detyrime kundrejt debitorit. 3. Autoritetet doganore, përveç ushtrimit të kompetencave të tyre, sipas këtij Kodi, mund t'u kërkojnë autoriteteve kompetente edhe marrjen e masave të tjera specifike, si pezullimi i veprimtarive ekonomike të debitorit ose të veprimtarive të tjera prodhuese, për ushtrimin e të cilave debitori është regjistruar pranë këtyre autoriteteve. 4. Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit bëhen tituj ekzekutivë menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit. 5. Ekzekutimi i titujve ekzekutivë të nxjerrë nga administrata doganore, të mbështetur me urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga autoritetet gjyqësore kompetente, bëhet menjëherë në bazë të dispozitave të parashikuara nga nenet 511 e në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile. Ekzekutimi mund të bëhet edhe nga strukturat e mbledhjes me forcë të detyrimit pranë administratës doganore. 6. Pas aplikimit të masave të parashikuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të këtij neni, autoritetet doganore procedojnë me konfiskimin, në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative.".*

### III.2.4.2. Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për Degën Doganore Tiranë.

Zyra e borxhit doganor në Degën Doganore Tiranë (DDT) funksionon sipas strukturës së miratuar me VKM nr. 355 datë 26.05.2022 '*Për personelin e administratës doganore'*, në të cilën evidentohen dy pozicione pune për specialist borxhi. Nga auditimi u konstatua se zyra ka funksionuar me vetëm një punonjës dhe një pozicion ka vijuar të mbetet vakant, **vakancë kjo e cila sikurse evidentohet ne vijim ka cënuar mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin në përmbushjen e detyrave të zyrës së borxhit, si pasojë e ngarkesës dhe numrit të madh të subjekteve nën mbikëqyrje të Degës Doganore.**

Auditimi mbi menaxhimin e Borxhit Doganor (BD), u fokusua në evidentimin e gjendjes së detyrimeve të subjekteve debitorë, krijimin e detyrimeve, gjendjen në fillim dhe në fund, kontabilizimin e tyre, strukturën e detyrimeve, llojshmëria, pesha specifike në total, masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor etj.

Bazuar në evidencën e vendosur në dispozicion nga Zyra e Borxhit, rezulton se gjendja e borxhit doganor më 01.01.2024 paraqitet me 1,642 raste, 1,252 subjekte debitorë në vlerën 18,620,934,751 lekë dhe gjendja e borxhit më datë 31.12.2024 paraqitet në 1,716 raste, për 1,129 subjekte në shumën 19,006,861,228 lekë. Pra gjatë vitit 2024, borxhi doganor është ulur në numër me 123 subjekte debitorë dhe është rritur në numër rastesh me 74 në krahasim me numrin në fillim të vitit, ndërsa në vlerë është shtuar me 385,926,477 lekë ose me 2.07%.

Gjendja fillestare e borxhit doganor së bashku me shtesat dhe pakësimet gjatë vitit 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Dega doganore | Debitore fillestare | | Shtesat gjate vitit | | Pakesime gjate vitit | | Debitore përfundimtare | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | raste | shuma | raste | shuma | raste | shuma | raste | shuma |
| **TIRANE** | 1,642 | 18,620,934,752 | 701 | 509,742,024 | 627 | 123,815,551 | 1,716 | 19,006,861,225 |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Tiranë*

Sipas informacionit te vendosur ne dispozicion nga Dega Doganore Tirane dhe evidencat analitike të kësaj dege doganore dhe DPD, shtesat nga vendimet e marra në vitin 2024 janë në shumën 246,845,973 lekë, ndërkohë që pjesa tjetër e shtesave rezulton se vjen nga përllogaritja e kamatvonesave nga detyrimet e mbartura nga vitet e kaluara dhe ato të krijuara rishtazi. Pakësimet e borxhit për vitin 2024 janë në shumën 123,815,551 lekë, nga të cilat 91,520,954 lekë janë arkëtuar për llogari të vendimeve të vitit 2024 dhe diferenca për llogari të vendimeve të viteve të kaluara.

Shtesat nga kamatëvonesat e shtuara të cilat bëjnë pjesë në shtesat gjatë vitit paraqiten në shumën 262,874,556 lekë. Të ndara në llogaritje 6 mujore të cilat janë kryer gjatë vitit ato paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Periudha e llogaritjes | Shuma |
|---|---|
| gjashtëmujori I dyte | 128,365,127 |
| gjashtëmujori I pare | 134,509,429 |
| **totali I kamatvonesave** | **262,874,556** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Lezhë*

Nga auditimi konstatohet se llogaritja e interesave mbi detyrimet është kryer në baza 6-mujore me dy fletë llogaritje mbi detyrimet ndërkohë që referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* llogaritja e interesave duhet të kryhet mbi baza mujore duke qenë se sipas pikës 5 të kapitullit V të udhëzimit citohet që *"Specialisti – Jurist/Specialist borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në degën doganore raporton në DPD (Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave) çdo muaj mbi gjendjen e detyrimeve të papaguara".* Për rrjedhojë, evidencat mujore të paraqitura nga Dega e Doganës Tiranë nuk janë të sakta përsa i përket shumës së kamatvonesave të paraqitura me pasojë edhe në shumën totale të borxhit doganor, me përjashtim të muajit Dhjetor kur janë reflektuar në shtesë të gjashtëmujorit të dytë.
Nga auditimi në lidhje me kontabilizimin e shumave të borxhit doganor, konstatohet se sipas kartelës së llogarisë 468 "Debitorë", regjistrimi i analitik i detyrimit, penaliteti apo kamatvonesave nuk kryhet i ndarë për subjektin sipas vendimit dhe përcaktimeve të pikës 2, kapitulli V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" ku citohet "Kontabilizimi i shumës së detyrimeve bëhet në zëra të veçantë: a)një zë për shumën e borxhit doganor (detyrimet e import/eksportit të papaguara) dhe apo detyrimeve të akcizës, b) një zë për shumën për shumën e penaliteteve, c) një zë për shumën e kamatvonesave.

-Në fund të vitit 2024, diferenca e debitorëve midis zyrës së financës dhe zyrës së borxhit është në vlerën prej **36,851,485** lekësh (19,043,712,712.5 lekë gjendja e debitorëve në 31.12.2024 raportuar nga zyra e financës dhe 19,006,861,228 lekë raportuar gjendja nga zyra e borxhit). Kjo diferencë prej **36,851,485** lekësh është justifikuar sipas sqarimeve se "*Në fund të vitit nga të ardhurat e*

*arkëtuara nga gjobat, marrim konfirmim me shkresë nga Drejtoria Juridike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Zyra Juridike pranë Degës së Doganës Tiranë nëse subjektet që kanë paguar për gjobat për vitin aktual raportues janë në procese ankimimi apo jo. Në vijim të sa më sipër është bërë kalimi nga llogaria ekonomike 7115210 e gjobave, te llogaria ekonomike 4662100 e mjeteve ne ruajtje. Kjo sepse në rast se çështjet që janë në ankimim apo në procese gjyqësore humben nga Dega e Doganës Tiranë, jemi të detyruar t'i kthejmë shumën e paguar subjekteve përkatëse, dhe kjo mund të bëhet në vitet e mëpasshme vetëm nga llogaria e mjeteve në ruajtje 4662100, si e vetmja llogari që mbartet nga viti në vit. Zyra e Financës mban përnjëherësh dhe llogarinë 468 si e drejtë për të arkëtuar mjetet monetare (llogari aktivi) dhe llogarinë 4662100 si detyrim për t'i kthyer mjetet monetare subjekteve përkatëse n.q.s. finalizimi i proçesit gjyqësor është në favor të subjekteve (pra llogari detyrimi). Ndërkohë zyra e borxhit e heq si debitor në momentin që subjekti paguan, qoftë kjo në llogarinë ekonomike 7115210 (llogari gjobe), qoftë në llogarinë ekonomike 4662100 (llogari mjete në ruajtje).".* Këto sqarime janë raportuar me shkresën nr. 2028/2 datë 12.03.2025 të Degës Doganore Tiranë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave duke referuar edhe raste të lënies së gjobave si garanci nga subjektet për arsye ankimimi gjatë viteve 2021, 2022, 2023 dhe 2024 si dhe disa detyrime të cilat për shkak të natyrës së detyrimeve zyra e borxhit nuk i ka në evidencat e saj, zakonisht për shkak të pagesave më tepër. Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se gjendja e debitorëve në 31.12.2024 i raportuar nga financa në shumën 19,043,712,712.5 lekë sipas llogarisë 468 të marrë nga programi kompjuterik i kontabilitetit, është rezultat i tepricës debitore në shumën 19,070,469,796.69 lekë me tepricën kreditore në shumën 26,757,094.1 lekë. Nga auditimi konstatohet se në 31.12.2024 ekzistojnë 68 raste në sistemin kontabël me tepricë kreditore të llogarisë 468 në shumën 26,757,094.1 lekë, të cilat përfaqësojnë pagesa të kryera më tepër se detyrimi duke humbur konceptin e të drejtës për të arkëtuar nga Dega Doganore Tiranë drejt këtyre subjekteve pasi përfaqësojnë një detyrim, dhe jo një të drejtë. Përsa më sipër, konstatohet se kontabilizimi dhe raportimi i debitorëve paraqiten me diferenca për shkak të trajtimit jo të saktë të arkëtimeve më tepër dhe diferencave në trajtim për penalitetet e garantuara të cilat trajtohen ndryshe nga borxhi dhe ndryshe nga financa, duke mos patur një rregullim të brendshëm dhe unifikim qëndrimi.

Nga auditimi me zgjedhje i vendimeve të muajit dhjetor 2024, rezulton se ato janë të kontabilizuara në sistemin e kontabilitetit Alpha në llogarinë 468. Pjesa më e madhe e vendimeve të marra në vitin 2024 janë paguar brenda vitit, ndërkohë që janë krijuar detyrime për 246 vendime të papaguara në shumën 156,643,347 lekë, duke përfshirë pjesën e kamatvonesave të vitit.
Borxhi doganor në 31.12.2024 sipas evidencës analitike në nivel rasti të borxhit, referuar autoritetit konstatues paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| **Autoriteti konstatues** | **Shuma** |
|---|---|
| Akciza | 165,468,581.84 |
| Audit DPD | 271,499,823.20 |
| Croën | 53,173,501.92 |
| Hetimi | 344,415,595.87 |
| KLSH | 87,971,113.27 |
| TATIMET | 13,037,312,212.14 |
| Dega doganore dhe te tjera | 2,302,004,306.29 |
| DOH | 2,745,016,093.02 |
| **Totali** | **19,006,861,227.55** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Lezhë*

Sikurse evidentohet në të dhënat e tabelës së mësipërme, pjesa më e madhe e borxhit doganor në Degën Doganore Tiranë përbëhet nga borxhi i mbartur nga tatimet si pasojë e transferimit të kryer për subjektet debitorë në fushën e akcizës.
Auditimi i masave të marra nga Dega Doganore Tiranë për rikuperimin e borxhit doganor është kryer bazuar në evidencën e paraqitur mbi stokun e borxhit si dhe dokumentacionin e dosjeve të përzgjedhura për auditim. Dosjet e përzgjedhura për auditim përfshijnë:
**-15 dosjet e përzgjedhura me vlerën më të lartë për vitin 2024 në shumën 115,970 mijë lekë që përbëjnë të stokut të borxhit 74% në 31.12.2024:**

| Subjekti | NIPT | Numër Vendimi | Date Vendim | Detyrimi doganor |
|---|---|---|---|---|
| A | L | 35 | 1/31/2024 | 74,410,531 |
| I | L | 497 | 10/4/2024 | 13,880,694 |
| K | L | 146 | 3/29/2024 | 7,827,399 |
| 4 | L | 42 | 1/31/2024 | 2,525,212 |
| R | M | 707 | 12/22/2024 | 2,310,078 |
| I | M | 140 | 3/29/2024 | 2,185,542 |
| V | H | 712 | 12/26/2024 | 2,152,392 |
| B | K | 597 | 11/27/2024 | 1,545,069 |
| A | B | 705 | 12/20/2024 | 1,540,160 |
| J | 1 | 721 | 12/30/2024 | 1,447,672 |
| K | M | 126 | 3/26/2024 | 1,361,823 |
| N | L | 149 | 3/29/2024 | 1,319,317 |
| D | M | 478 | 9/16/2024 | 1,257,418 |
| D | M | 674 | 12/18/2024 | 1,253,928 |
| 4 | L | 43 | 1/31/2024 | 953,545 |
| **Totali** | | | | **115,970,781** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Lezhë*

**-10 dosjet e përzgjedhura me vlerën më të lartë nga vitet e mëparshme që përbëjnë 15,258 milion lekë detyrimi ose 80% të stokut të borxhit në 31.12.2024.**

| Subjekti | NIPT | Numër Vendimi | Date Vendim | Detyrimi doganor |
|---|---|---|---|---|
| AR | J | 11981 | 8/28/2019 | 12,569,564,988 |
| S | L | 11842/1 | 12/29/2014 | 876,279,356 |
| K | K | 300 | 6/2/2017 | 437,462,837 |
| C | L | 217 | 2/16/2015 | 359,053,471 |
| E | K | 11981 | 8/28/2019 | 339,547,042 |
| S | L | 4470/2 | 6/7/2014 | 172,083,111 |
| V | K | 1186 | 12/23/2019 | 135,144,763 |
| B | L5 | 477 | 8/12/2017 | 125,320,736 |
| T | L | 11981 | 8/28/2019 | 125,151,040 |
| A | K | 13280 | 12/31/2014 | 117,938,091 |
| **Totali** | | | | **15,257,545,437** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Lezhë*

## A. Auditim mbi evidencën e borxhit doganor në Degën e Doganës Tiranë

-Nga rastet e raportuara në evidencë, rezulton se Dega Doganore Tiranë ka në proces gjyqësor 103 raste me vlerë 14,083,792,994 lekë, për të cilat rezulton se nuk janë reflektuar në tabelën përmbledhëse të borxhit, hapat procedurialë të ndjekur të ankimit sipas llojit përkatës, pasi nuk

është likuiduar detyrimi doganor si dhe nuk janë garantuar gjobat parashikuar nga neni 281-282 i Kodit Doganor. Kjo pasi ne kolonën e pagesave të evidencës së borxhit shuma e paguar paraqitet 0 lekë për secilin rast, ndërkohë që në kolonën e vendim gjyqësor paraqitet me shënim përkatës "proces gjyqësor". Gjithashtu konstatohet të mos jenë respektuar kërkesat e kapitullit X "Ankimi administrativ" të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* nga vetë autoriteti për rikuperimin e detyrimeve doganore. Këto raste janë dërguar me email të datës 19.03.2025 për të cilën janë paraqitur argumente nga specialistja e borxhit se janë debitorë në proces gjyqësor që kanë kërkuar pavlefshmëri absolute pranë Gjykatës së shkallës së parë Tiranë.

-Nga zyra Juridike me qëllim uljen e borxhit doganor, deri në fund të vitit 2024 kanë dalë 1290 VRFB me vlerë 5,347,885,639 lekë, Nga auditimi janë konstatuar të paktën 236 raste në shumën 13,604,529,544 lekë për të cilat nuk ka të shënuar në evidencën e borxhit të dhëna mbi marrjen e Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, megjithëse referuar afateve dhe shumave të detyrimit, janë përmbushur kushtet ligjore për rikuperimin me forcë të këtyre borxheve doganore. Mos ndjekja e hapave proceduriale të detyrueshëm për rikuperimin e detyrimeve doganore të papaguara është në kundërshtim me pikën 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* ku citohet *"Kur debitori nuk ekzekuton vullentarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 282 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës. Ky vendim....."*. Këto raste janë dërguar me email të datës 19.03.2025. Për këto raste, referuar të dhënave të paraqitura në evidencë, në disa prej tyre referohet se janë në proces gjyqësor pa specifikuar statusin dhe në 4 raste prej tyre referohen se janë lidhur akt marrëveshje sipas shënimit. Nga auditimi konstatohet mungesë e bazës ligjore që parashikon lidhjen e marrëveshjeve me këste për pagesën e detyrimit dhe duhet të ishin marrë masat për rikuperimin me forcë në mënyrë të menjëhershme të borxhit doganor sipas përcaktimeve të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

-Nga auditimi konstatohet se janë dërguar kërkesa për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit në gjykatë për 622 raste me vlerë 4,625,412,375 lekë, **ndërsa për 1094 raste me vlerë 14,381,448,853 lekë nuk është dërguar kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në gjykatë**, nga të cilat për një pjesë as nuk është nxjerrë VRFB. Ndër rastet për të cilat është nxjerrë VRFB, konstatohet se për 647 raste në shumën 593,483,363 lekë nuk janë marrë masat për dërgimin e tyre në gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Këto raste janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në duke qenë në pikën 1 të kapitullit VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* ku citohet *"Menjëherë mbas marrjes dijeni të vendimit për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, pra pas kthimit në titull ekzekutiv, specialisti – jurist/specialist borxhi i sektorit/zyrës së administratës*

*dhe shërbimit në degën doganore dërgon në gjykatë kërkesën për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit".* Këto raste janë dërguar me email të datës 19.03.2025.

-Nga ana e Gjykatës janë lëshuar Urdhër Ekzekutimi për 494 raste me vlerë 4,381,026,020 lekë, Nga auditimi konstatohet se megjithëse nga DD Tiranë është dërguar kërkesa në Gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, nga gjykata nuk është lëshuar urdhri i ekzekutimit. Sipas evidencës analitike të borxhit doganor, kjo konstatohet në 134 raste në shumën 373,363,170 lekë. Për këto raste nuk ka informacion në lidhje me arsyen e mos lëshimit të urdhrit të ekzekutimit apo refuzimin/kërkesën për plotësim nga gjykata megjithëse ka kaluar kohë e konsiderueshme nga data e kërkesës për disa prej tyre në vlera të mëdha të borxhit doganor të përfshirë në objektin e ekzekutimit të detyrueshëm. Konstatohet se nuk janë dokumentuar hapat procedurialë të ndjekura nga autoriteti doganor dhe nuk janë paraqitur sipas kërkesave të pikës 4 dhe 5 të kapitullit VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*. Këto raste janë dërguar me email të datës 19.03.2025

-Nga auditimi konstatohet se megjithëse nga gjykata janë lëshuar urdhrat e ekzekutimit, nga Dega Doganore Tiranë nuk është vepruar për dërgimin e tyre në përmbarim apo masa të tjera në kompetencë të autoritetit doganor, konstatuar në 45 raste në shumën 165,100,918 lekë. Këto veprime konstatohet se janë në kundërshtim me Kapitullin IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Këto raste janë dërguar me email të datës 19.03.2025.

-Janë dërguar për ekzekutim zyrës së Përmbarimit Shtetëror/privat 450 raste me vlerë 4,217,148,718 lekë sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e borxhit doganor. Për këto raste, konstatohet se në asnjë rast nuk janë marrë masa nga vetë autoriteti doganor drejtuar QKB apo DPSHTRR për bllokim veprimeve në sistem apo pasuritë e paluajtshme. Kjo referuar mosplotësimit të asnjë rekordi në evidencën e borxhit për gjendjen përfundimtarë në vitin 2024. Përsa i përket masave drejtuar ish-ZRVPP apo ASHK për pasuritë e paluajtshme si dhe bllokimin e llogarive bankare konstatohet se është kryer në 170 prej rasteve të mësipërme të cilat janë dërguar edhe në përmbarues me vlerë borxhi doganor në 31.12.2024 në shumën 3,153,651,369 lekë. Për pjesën tjetër rezulton të mos jetë marrë asnjë masë me iniciativë nga vetë autoriteti doganor duke u mjaftuar vetëm me ndjekjen me shoqëri përmbarimore. Këto veprime konstatohet se janë në kundërshtim me Kapitullin IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

**B. Auditimi i dosjeve të përzgjedhura për vitin 2024**

**<u>-Subjekti "A" Shoqëri Anonime Teknike, Degë e Shoqërisë së Huaj, me NUIS LC.</u>**

**a**-Vendimi nr.35, datë 31.01.2024 i DD Tiranë. Sipas këtij vendimi DDT pasi shqyrtoi Raportin përfundimtar mbi programin e kontrollit n.20311/1prot, datë 15.11.2023 (nr11017prot., datë 29.12.2023 DDTiranë) të Drejtorisë së Kontrollit pas Zhdoganimit/Aposterior, në lidhje me Autorizimet për Regjimin e Lejimit të Përkohshëm ndër të tjera ka vendosur:
Subjekti "A" Shoqëri Anonime Teknike me NUIS LC të paguajë detyrimin doganor të munguar në shumën 24,437,011 lekë.
Subjekti "A" Shoqëri Anonime Teknike me NUIS LC paralizohet në shumën 48,874,022 lekë.

**b-**Lajmërim marrje, Posta Shqiptare sha, vulosur nga zyra pranuese e lajmërimit datë 09.02.2024;
**c-**Vendimi nr.40, datë 02.04.2024 "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor";
**d**-Lajmërim marrje datë 25.04.2024 i Vendimit nr.40, datë 02.04.2024 "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor";
**e.**Kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit nr.4131prot., datë 23.05.2024 për vendimin nr.40, datë 02.04.2024 të DDT, drejtuar GJASHP Tiranë;
f-Vendim nr regjistri themeltar 3070, datë 24.07.2024 i GJASHPTiranë për pranimin e kërkesës dhe lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për aktin administrativ, Vendimin nr.40, datë 02.04.2024 "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor /akcizë" të DDTiranë;
g.Lajmërim për ekzekutim vullnetar të Urdhërit të Ekzekutimit, Shkresa nr.7649 prot., datë 26.10.2024 drejtuar subjektit;
h. Kërkesë për ekzekutimin e detyrueshëm të Urdhërit Ekzekutiv të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë drejtuar Shoqërisë Përmbarimore Gjyqësore Private "J" SHPK Shkresa nr.10121prot., datë 18.12.2024;
i. Kontrate shërbimi nr.10121/1prot., datë 26.12.2024 midis kreditorit DPD, Dega Doganore Tirane dhe Përmbaruesit Gjyqësor Privat Shoqëria Përmbarimore "J" SHPK Shpk me NUIS L2v, Përmbarues Gjyqësor privat M H.
*Konstatohen vonesa në kryerjen e njoftimeve dhe nxjerrjes se vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit mangësi në dokumentacion veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, konkretisht*:*
-Nuk ka dokumentacion që të justifikoje vonesën prej 52 ditësh të nxjerrjes së VRFB nr.40, datë 02.04.2024 i cili është nxjerrë 52 ditë pas njoftimit (datë 09.02.2024) të vendimit nr.35, datë 31.01.2024.
-Nuk justifikohet vonesa prej 23 ditësh e njoftimit (me datë 25.04.2024) të VRFB nr 40, datë 02.04.2024.
-Kërkesa për lëshim urdhëri të ekzekutimit ka datë 23.05.2024 pra një muaj vonesë pas njoftimit të VRFB i cili ka datë 25.04.2024.
-Vendimi i GJASHP për pranimin e kërkesës dhe lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të VRFB nr.40 ka datë 24.07.2024 ndërsa lajmërimi për ekzekutim vullnetar ka datë 26.10.2024 tre muaj vonesë. Veprime në kundërshtim me pikat VI "Njoftimi i vendimit" dhe pikën VII "Ekzekutimi i vendimit të shpalljes debitor" të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2028 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të Akcizës" të DPD-së.

**-Operatori ekonomik "4" SHPK me NUIS LT**
**a.**Vendimi nr.42, datë 31.01.2024 I DDT
Sipas këtij vendimi DDT, pasi u njoh me proces verbalin për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore nr.10615/1prot., datë 18.12.2023 të Kontrollin Aposterior DDT në lidhje me deklaratat doganore të importit IMP4 Nr.R11051 datë 12.11.2021, R113779 datë 20.11.2021, R116525 datë 27.11.2021, R119717 datë 06.12.2021, bazuar në nenin 273 të KD deklaruesit ju nis për dijeni proces verbali me shkresën nr.10615/2prot, datë 20.12.2023 i cili u kthye nga shërbimi postar me shënime larguar DDT ju drejtua Bashkisë Tiranë me shkresën nr.126prot., datë 05.01.2024 kërkesë për shpallje publike e cila u konfirmua nga bashkia me shkresën nr. 1703/1prot., datë 17.01.2024 ( këto shkresa nuk janë pjesë e dosjes ) ka vendosur:
Operatori ekonomik "4" SHPK me NUIS LT të paguajë detyrimin doganor në shumën 1,236,334lekë;

Të dënojë me gjobë operatorin në shumën 1,236,334 lekë sa 1 fish I detyrimit doganor të munguar.
**b.** Vendimi nr.43, datë 31.01.2024 I DDT
Sipas këtij vendimi DDT bazuar në nenin 273 të KD deklaruesit ju nis për dijeni proces verbal me shkresën nr.9868/3 prot., datë 30.11.2023 në lidhje me deklaratën doganore të importit IMP4 R7703, datë 31.01.2022, e cila u kthye nga shërbimi postar me shënimin larguar, DDT ju drejtua Bashkisë Tiranë me shkresën nr.126 prot., datë 05.01.2024 "Kërkesë për shpallje publike" e cila u konfirmua nga Bashkia Tiranë me shkresën nr.1703/1prot., datë 17.01.2024 (këto shkresa nuk janë pjesë e dosjes ) ka vendosur:
Operatori ekonomik "4" SHPK me NUIS LT të paguajë detyrimin doganor në shumën 466,852 lekë;
Të dënojë me gjobë operatorin në shumën 466,852 lekë sa 1 fish I detyrimit doganor të munguar.
**c.** Lajmërim marrje datë 14.02.2024 kthyer me shënimin larguar, për vendimet nr.42 dhe 43, datë 31.01.2024 të DDT;
**d.** Vendim nr.69, datë 06.08.2024 "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës" , drejtuar operatorit;
**e.**Vendim nr.70, datë 06.08.2024 "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës", drejtuar subjektit.
**f.**Lajmërim postar datë 12.09.2024 kthyer me shënimin larguar për vendimet nr.69 dhe nr.70, datë 06.08.2024 të DDT;
**g.**Kërkesë për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit për vendimet nr.69 dhe nr.70, datë 06.08.2024 të DDT drejtuar GJASHPTiranë me nr.280/2 prot., datë 12.01.2025 .

*Konstatohen mangësi ne kryerjen e procedura te njoftimeve te vendimeve të shpalljes debitor dhe vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor në kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",, konkretisht:*
-Nuk është respektuar afati 10 ditor i kryerjes se njoftimit të vendimit.
- Njoftimi i vendimit nr.149, datë 29.03.2024 të DDT ka datë 19.04.2024 ka shënimin (larguar) konstatohet se nuk është vepruar sipas kërkesave të neneve 276 të KD , të neneve 130-141/a të KPrCivile, nuk janë kryer format e tjera të njoftimit afishimi në QKB, pranë çdo dege doganore, në vende publike si në Bashki, njësi administrative, gazetë e pushtetit vendor, internet dhe se VRFB nr.69 dhe nr.70 është nxjerrë në datë 06.08.2024 në mënyrë të pajustifikuar pas afro 4 muajsh vonesë pas njoftimit të vendimit të shpalljes debitor.
Veprime në kundërshtim me pikën VI Njoftimi I vendimit, nënpikat 2 dhe 3 të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*
-Kërkesa për lëshimin e Urdhërit të ekzekutimit është në datë 12.01.2025 ose 4 muaj me vonesë të pajustifikuar nga njoftimi i VRFB. Veprime në kundërshtim me pikën VIII "Nxjerrja e Urdhërit të Ekzekutimit", pikën "VI Njoftimi i vendimit", nënpikat 2 dhe 3 të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*
-Sipas vendimit subjektit i ka lindur detyrim në shumën 1,236,334 lekë nga kontrolli aposterior, konkretisht të deklaratës R11051 datë 12.11.2021, R113779 datë 20.11.2021, R116525 datë 27.11.2021 dhe R119717 datë 06.12.2021 dhe detyrim në shumën 466,852 nga kontrolli aposterior, konkretisht të deklaratës R7703 datë 31.01.2022. Nga auditimi konstatohet se për këtë detyrim nuk janë llogaritur kamatëvonesa, ndërkohë që kamatëvonesat duhet të ishin llogaritur që

në momentin e lindjes së detyrimit fillestar sipas përcaktimeve të shkronjës b), pika 4.2, kapitulli V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" *"*ii) *Afati kur fillon zbatimi i kamatëvonesës"* në të cilën citohet që *"...Kur një borxh lind sipas nenit 74 ose 77 të Kodit Doganor apo kur njoftimi i borxhit doganor vjen në vijim të një kontrolli, pas çlirimit, norma e kamatvonesave zbatohet mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit duke filluar nga data në të cilën lind borxhi doganor deri në datën e njoftimit të tij.....* dhe *iv)Për rastet e lindjes së detyrimit së borxhit të akcizës për operacionet e parregullta momentit i zbatimit të kamatëvonesës do të jetë momenti në të cilin konstatohet lindja e detyrimit të akcizës që i korrespondon momentit kur është vërtetuar se produktet e akcizës janë prodhuar, importuar, blerë, transportuar, përdorur ose konsumuar në mënyrë të parregullt ose janë hedhur në konsum në mënyrë të parregullt si dhe janë dërguar ose përdorur nga përdorues i përjashtuar për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në autorizim."*[3]. Për rrjedhojë kamatëvonesa nuk është llogaritur dhe pasqyruar saktë në evidencën e borxhit doganor, në kundërshtim me udhëzimin nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës".* Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**-Operatori ekonomik "K" SHPK me NUIS MM**

**a.**Vendim Nr. 125, datë 26.03.2024

Sipas këtij vendimi DDT pasi mori në shqyrtim materialin shkresor nr.1686 prot., datë 29.01.2024 të dërguar nga DOH Informacion për marrje vendimi, proces verbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative nr. 810 prot., datë 30.01.2024 për verifikimin e kundërvajtjes administrative lidhur me deklaratën IMP4 R29323, datë 03.04.2021; dhe DDT ka kryer njoftimin në rrugë postare me shkresën nr. 810/1prot, datë 01.02.2024 e cila është kthyer nga shërbimi postar, prandaj u kërkua me shkresën nr.1408 prot., datë 16.02.2024 "Kërkesë për shpallje publike" e cila u krye dhe u konfirmua me shkresën nr. 766/3 prot., datë 21.02.2024, (këto shkresa nuk janë pjesë e dosjes) bazuar në nenin 273 të KD vendosi:

Operatori ekonomik "K" shpk me NUIS MM të paguajë detyrimin doganor të munguar në shumën 143,742 lekë.

Operatori ekonomik "K" shpk me NUIS MM penalizohet me gjobë në shumën 143,742 lekë.

**b.**Vendim Nr. 126, datë 26.03.2024, sipas këtij vendimi DDT pasi mori në shqyrtim materialin shkresor nr.1686 prot., datë 29.01.2024 dërguar nga DOH "Informacion për marrje vendimi" proces verbalin për kundërvajtje administrative me nr.810 prot., datë 30.01.2024 lidhur me deklaratën doganore IMP4 R39146, datë 01.05.2021 dhe ka kryer njoftimin në rrugë postare me shkresën nr.810/1prot., datë 01.02.2024 e cila është kthyer nga shërbimi postar. Prandaj u kërkua me shkresën nr.1408 prot., datë 16.02.2024 "Kërkesë për shpallje publike" e cila u krye dhe konfirmua me shkresën nr,7663 prot., datë 21.02.2024, (këto shkresa nuk janë pjesë e dosjes), bazuar në nenin 273 të KD vendosi:

Operatori ekonomik "K" shpk me NUIS MM të paguajë detyrimin doganor të munguar në shumën 337,521 .

Operatori ekonomik "K" shpk me NUIS MM penalizohet me gjobë në shumën 1,012,563 lekë.

**c.**Lajmërim postar datë 19.04.2024 i vendimeve nr 125 dhe 126 datë 26.03.2024 të DDT;

d.Vendimi nr.44, datë 29.05.2024 i DDT Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës

[3] Efekti i kamatvonesave te munguara ne llogaritje sipas KLSH eshte jo material ne shumën 239,557 lekë

d.Lajmërim postar datë 01.06.2024 (i vendimit nr. 44, datë 29.05.2024) me shënimi objekt i pakërkuar
e. kërkesë për shpallje publike të akteve administrative, vendimet e rikuperimit me forcë të borxhit doganor, drejtuar Bashkisë Tiranë nr.1110 prot., datë 10.02.2025
Konstatohen vonesa në kryerjen e njoftim vendimeve dhe procedurave të njoftimit.
*Mangësi në dokumentacionin në dosje në kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:
-Nuk është respektuar afati 10 ditor I kryerjes se njoftimit të vendimit.
-VRFB është 40 ditë më vonë se njoftimi i vendimit, vonesë e pajustifikuar
-njoftimi i VRFB nr.44, datë 29.05.2024 ka datë 01.06.2024 ndërsa kërkesa për shpallje publike e tij ka datë 10.02.2025 pra 8 muaj e dhjetë ditë vonesë e pajustifikuar në kundërshtim me pikat VI "Njoftimi i vendimit" dhe pikën VII "Ekzekutimi i vendimit të shpalljes debitor" të Udhëzimit *nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:
-Sipas vendimit subjektit i ka lindur detyrim në shumën 337,521 lekë nga kontrolli aposterior, konkretisht të deklaratës R39146 datë 01.05.2021. Nga auditimi konstatohet se për këtë detyrim nuk janë llogaritur kamatëvonesa, ndërkohë që kamatvonesat duhet të ishin llogaritur që në momentin e lindjes së detyrimit fillestar sipas përcaktimeve të shkronjës b), pika 4.2, kapitulli V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" "ii) *Afati kur fillon zbatimi i kamatëvonesës"* në të cilën citohet që *"...Kur një borxh lind sipas nenit 74 ose 77 të Kodit Doganor apo kur njoftimi i borxhit doganor vjen në vijim të një kontrolli, pas çlirimit, norma e kamatvonesave zbatohet mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit duke filluar nga data në të cilën lind borxhi doganor deri në datën e njoftimit të tij.....* dhe *iv)Për rastet e lindjes së detyrimit së borxhit të akcizës për operacionet e parregullta momentit i zbatimit të kamatëvonesës do të jetë momenti në të cilin konstatohet lindja e detyrimit të akcizës që i korrespondon momentit kur është vërtetuar se produktet e akcizës janë prodhuar, importuar, blerë, transportuar, përdorur ose konsumuar në mënyrë të parregullt ose janë hedhur në konsum në mënyrë të parregullt si dhe janë dërguar ose përdorur nga përdorues i përjashtuar për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në autorizim."*[4]. Për rrjedhojë kamatëvonesa nuk është llogaritur dhe pasqyruar saktë në evidencën e borxhit doganor, në kundërshtim me udhëzimin nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës".* Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**- Operatori Ekonomik "I" SHPK me NUIS MH**

a.Vendimi nr.140, datë 29.03.2024 I DDT, sipas këtij vendimi DDT pasi u njoh me proces verbalin e kundërvajtjes administrative me nr.1236 prot., datë 12.02.2024 të doganierit të Zyrës së Regjimeve doganore pranë DDT për plotësimin e kushteve për mallrat nën Reagimin e Përpunimit Aktiv me Autorizimin AL20230503/20491/1 lëshuar nga DPD ku ka rezultuar se operatori ekonomik nuk është paraqitur për ti dhënë destinacion sasisë mallit prej 12.343 kg dhe vlerë 33,665 Euro . Operatori ekonomik është njoftuar me shërbim postar me shkresën nr.1236/1prot. E cila u kthye dhe pastaj është njoftuar me shpallje publike konfirmuar nga Bashkia Tiranë me shkresën

[4] Efekti i kamatvonesave te munguara ne llogaritje sipas KLSH eshte jo material ne shumën 53,229 lekë

nr.11948/1prot., datë 25.03.2024 ME NR.1236/2prot., datë 28.03.2024 në DDT (këto shkresa nuk janë pjesë e dosjes) ka vendosur ;
Të paguhet detyrimi doganor i munguar në shumën 720,409 lekë.
Të dënojë me gjobë operatorin ekonomik në shumën 1,440,819 lekë.
b. Lajmërimi postar i operatorit datë 19.04.2024 (për vendimin nr140,datë 29.03.2024), kthyer me shënimin -i panjohur
c. Vendimi nr.74, datë 11.09.2024 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës i DDT drejtuar operatorit;
d.Lajmërim postar datë 18.09.2024 për vendimin 74, datë 11.09.2024 i kthyer me shënimin i panjohur.
e. Kërkesë për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit (për vendimin 74, datë 11.09.2024) nr.280/3prot., datë 12.01.2025 drejtuar Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Tiranë- kjo kërkesë nuk ka vulën e regjistrimit në Gjykatë.
*Konstatohen mangësi në afate dhe kryerjen e procedurave doganore të njoftimeve, në mos kryerjen e veprimeve proceduriale të lajmërimit pas shënimeve " i panjohur"., në dosje nuk janë njoftimet me anë të shpalljes publike dhe konfirmimet e tyre dosje në kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:
-Nuk është respektuar afati 10 ditor i kryerjes se njoftimit të vendimit.
- Njoftimi i vendimit nr.140, datë 29.03.2024 të DDT ka datë 19.04.2024 ka shënimi ( i panjohur) konstatohet se nuk është vepruar sipas kërkesave të neneve 276 të KD , të neneve 130-141/a të KPrCivile, nuk janë kryer format e tjera të njoftimit afishimi në QKB, pranë çdo dege doganore, në vende publike si në Bashki, njësi administrative, gazetë e pushtetit vendor, internet dhe se VRFB është nxjerrë në datë 11.09.2024 në mënyrë të pajustifikuar pas afro 5 muajsh vonesë pas njoftimit të vendimit të shpalljes debitor, veprime në kundërshtim me pikën.VI "Njoftimi i vendimit", nënpikat 2 dhe 3 të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018.
-Kërkesa për lëshimin e Urdhërit të ekzekutimit është në datë 12.01.2025 ose 4 muaj me vonesë të pajustifikuar nga njoftimi i VRFB. Veprime në kundërshtim me pikën VIII.Nxjerrja e Urdhërit të Ekzekutimit të veprime në kundërshtim me pikën.VI "Njoftimi i vendimit", nënpikat 2 dhe 3 të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018.

**- Operatori Ekonomik "K" SHPK me NUIS LA**

**a.**Vendimi nr.146, datë 29.03.2024
Sipas këtij vendimi DDT pasi shqyrtoi materialin bashkëngjitur proces verbalit me nr.7588 prot., datë 04.09.2024 nga Zyra e Mbikëqyrjes doganore e DDT për Autorizimin nr.20210217/22545/1 datë 17.02.2021 të Regjimit të Përpunimit Aktiv për mos dhënien destinacion mallrave me vlerë 80,185 Euro, ka vendosur subjekti "K" SHPK me NUIS LA të paguajë detyrimin në shumën 1,940,477 lekë, subjekti "K" SHPK me NUIS LA penalizohet në shumën 5,821,431 lekë.
b. Lajmërimi postar i operatorit datë 19.04.2024 (për vendimin nr146,datë 29.03.2024), kthyer me shënimin - i panjohur
c. Vendimi nr.73, datë 11.09.2024 I DDT "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës"
d.Lajmërim postar datë 18.09.2024 për vendimin 73, datë 11.09.2024 i kthyer me shënimin larguar.
e. Kërkesë për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit (për vendimin 73, datë 11.09.2024) nr.280/4prot., datë 12.01.2025 drejtuar Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Tiranë.- kjo kërkesë nuk ka vulën e regjistrimit në Gjykatë.

*Konstatohen mangësi në kryerjen e procedurave për rikuperimin e borxhit, në dosje nuk janë njoftimet me anë të shpalljes publike dhe konfirmimet e tyre si për vendimin e shpalljes debitor subjektin dhe për VRFB të DDT, në kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:
-Nuk është respektuar afati 10 ditor i kryerjes se njoftimit të vendimit.
- Njoftimi i vendimit nr.146, datë 29.03.2024 të DDT ka datë 19.04.2024 ka shënimi ( i panjohur) konstatohet :
-se nuk është vepruar sipas kërkesave të neneve 276 të KD, të neneve 130-141/a të KPrCivile, nuk janë kryer format e tjera të njoftimit afishimi në QKB, pranë çdo dege doganore, në vende publike si në Bashki, njësi administrative, gazetë e pushtetit vendor, internet dhe se VRFB është nxjerrë në datë 11.09.2024 në mënyrë të pajustifikuar pas afro 5 muajsh vonesë pas njoftimit të vendimit të shpalljes debitor veprime në kundërshtim me pikën VI "Njoftimi i vendimit", nënpikat 2 dhe 3 të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018.
-Kërkesa për lëshimin e Urdhërit të ekzekutimit është në datë 12.01.2025 ose 4 muaj me vonesë të pajustifikuar nga njoftimi i VRFB, veprime në kundërshtim me pikën VIII "Nxjerrja e Urdhërit të Ekzekutimit" veprime në kundërshtim me pikën VI "Njoftimi i vendimit", nënpikat 2 dhe 3 të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018.

**- Operatori Ekonomik "N" SHPK me NUIS LG**
**a.**Vendimi nr.149, datë 29.03.2024 i DDT
Sipas këtij vendimi në shqyrtim të proces verbalit nr.7829/2prot., datë 13.11.2023 nga Zyra e Mbikëqyrjes doganore në DDT për Autorizimin e RPA nr.20200203/31115/1, 20210406/22899/1 dhe 20220412/8938/1 subjekti është larguar pa dhënë destinacion mallrave të vendosura nën regjim (materialet bashkëngjitur dhe proces verbali nuk ndodhen në dosje) DDT ka vendosur
Subjekti të paguajë detyrimin në shumën 434,880 lekë
Subjekti penalizohet në shumën 869,760 lekë.
**b.** Lajmërimi postar i operatorit datë 19.04.2024 (për vendimin nr. 149,datë 29.03.2024), kthyer me shënimin -adresë e pamjaftueshme.
c. Vendimi nr.75, datë 11.09.2024 I DDT "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës"
d.Lajmërim postar datë 16.09.2024 për vendimin 75, datë 11.09.2024 i kthyer me shënimin adresë e pamjaftueshme.
e. kërkesë për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit (për vendimin 75, datë 11.09.2024) nr.280/5prot., datë 12.01.2025 drejtuar Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Tiranë.- kjo kërkesë nuk ka vulën e regjistrimit në Gjykatë.
*Konstatohet vonesa në kryerjen e njoftim vendimit të vendimit të shpalljes debitor; mos kryerje të procedurave të tjera të njoftimit, vonesa në kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit (nuk është e protokolluar në Gjykatë). Në dosje nuk janë njoftimet me anë të shpalljes publike dhe konfirmimet e tyre si për vendimin si për VRFB, mangësi ne dokumentacion, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:
-Nuk është respektuar afati 10 ditor i kryerjes se njoftimit të vendimit.
- Njoftimi i vendimit nr.149, datë 29.03.2024 të DDT ka datë 19.04.2024 ka shënimin (adresë e pamjaftueshme) konstatohet se nuk është vepruar sipas kërkesave të neneve 276 të KD , të neneve 130-141/a të KPrCivile, nuk janë kryer format e tjera të njoftimit afishimi në QKB, pranë çdo dege doganore, në vende publike si në Bashki, njësi administrative, gazetë e pushtetit vendor, internet

dhe se VRFB është nxjerrë në datë 11.09.2024 në mënyrë të pajustifikuar pas afro 5 muajsh vonesë pas njoftimit të vendimit të shpalljes debitor, veprime në kundërshtim me pikën VI "Njoftimi i vendimit", nënpikat 2 dhe 3 të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2028.
-Kërkesa për lëshimin e Urdhërit të ekzekutimit është në datë 12.01.2025 ose 4 muaj me vonesë të pajustifikuar nga njoftimi i VRFB, veprime në kundërshtim me pikën VIII "Nxjerrja e Urdhërit të Ekzekutimit", veprime në kundërshtim me pikën.VI Njoftimi i vendimit, nënpikat 2 dhe 3 të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018.

**- Operatori Ekonomik "I" SHPK me NUIS LL**

a.Vendimi nr.497, datë 04.10.2024 i DDT, sipas këtij vendimi DDT mbështetur në proces verbalin nr.4885prot., datë 27.08.2024 të Zyrës së Regjimeve në DDT për mallrat nën Regjimin e Përpunimit Aktiv Autorizim 20220627/11951/1 dhe 20230630/2231/1 lëshuar nga DPD për mos dhënien destinacion të tyre. Operatori është njoftuar me shërbimin postar me shkresën nr.4885/2prot., datë 28.08.2024 , është njoftuar me shpallje publike konfirmuar nga Bashkia Tiranë me shkresën nr. 34543/1prot., datë 26.09.2024 , ka vendosur të paguhet detyrimi doganor I munguar në shumën 4,626,897 lekë dhe të dënojë me gjobë operatorin ekonomik në shumën 9,253,795 lekë.
b. Lajmërimi postar i operatorit datë 08.11.2024 ( për vendimin nr.497,datë 04.10.2024), kthyer me shënimin -ka ndryshuar adresë.
c. Kërkese për shpallje publike të akteve administrative drejtuar Bashkisë Tiranë nr.141 prot., datë 08.01.2025.(në listë edhe ky vendim).
d.Vendimi nr.3, datë 14.02.2025 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës
*Konstatohet vonesë në njoftimin e vendimit për shpallje debitor , vonesë në kryerjen e procedurave të tjera të njoftimit të vendimit, mungon konfirmimi I Bashkisë për kryerjen e shpalljes publike. Vonese në nxjerrjen e njoftimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:
-Nuk është respektuar afati 10 ditor i kryerjes se njoftimit të vendimit.
- Njoftimi i vendimit nr.497, datë 04.10.2024 të DDT ka datë 08.11.2024 ka shënimin (ka ndryshuar adresë) konstatohet se nuk është vepruar sipas kërkesave të neneve 276 të KD , të neneve 130-141/a të KPrCivile, nuk janë kryer format e tjera të njoftimit afishimi në QKB, pranë çdo dege doganore, në vende publike si në Bashki, njësi administrative, gazetë e pushtetit vendor, internet dhe se kërkesa për shpallje publike në Bashki është me datë 08.01.2025 pra dy muaj vonesë e pajustifikuar, veprime në kundërshtim me pikën.VI Njoftimi i vendimit, nënpikat 2 dhe 3 të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018.

**-Operatori Ekonomik "B" SHPK me NUIS KF**

a.Vendimi nr.597, datë 27.11.2024 i DDT, sipas këtij vendimit DDT pasi shqyrtoi proces verbalin nr.3030/1prot., datë 14.10.2024 nga sektori i regjimeve në DDT për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv plotësimit të detyrimeve të Autorizimeve nr.12426/1 datë 12.07.2022; nr.22827/1, datë 24.07.2023 dhe RLP nr.22687. datë 14.07.2023 rezultoi se subjekti nuk kryente më aktivitet në këto ambiente dhe ishte larguar pa njoftuar autoritetet doganore, ka vendosur subjekti të paguajë detyrimin doganor në shumën 515,023 lekë dhe të dënojë me gjobë subjektin në shumën 1,030,046 lekë.
b. Lajmërimi postar i operatorit datë 18.12.2024 ( për vendimin nr.597,datë 27.11.2024), kthyer me shënimin – larguar.

c. Kërkesë për shpallje publike të akteve administrative (vendimi nr.597, datë 27.11.2024) drejtuar Bashkisë Tiranë me nr.141 prot., datë 08.01.2025.
d. Vendim nr.2, datë 13.02.2025 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës
*Konstatohen vonesa në njoftimin e vendimit për shpalljen debitor subjektit, vonesa në kërkesën për shpallje debitor drejtuar Bashkisë Tiranë mos dokumentimi i konfirmimit të shpalljes, mos kryerje e procedurave të tjera të njoftimit., mungesë dokumentacioni në dosje para marrjes së vendimit veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:
-Nuk është respektuar afati 10 ditor i kryerjes se njoftimit të vendimit.
- Njoftimi i vendimit nr.597, datë 27.11.2024 të DDT ka datë 18.12.2024 ka shënimin (larguar) konstatohet se nuk është vepruar sipas kërkesave të neneve 276 të KD , të neneve 130-141/a të KPrCivile, nuk janë kryer format e tjera të njoftimit afishimi në QKB, pranë çdo dege doganore, në vende publike si në Bashki, njësi administrative, gazetë e pushtetit vendor, internet dhe se kërkesa për shpallje publike në Bashki është me datë 08.01.2024, gjithsej 20 ditë vonesë e pajustifikuar, veprime në kundërshtim me pikën.VI Njoftimi i vendimit, nënpikat 2 dhe 3 të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018.

-**<u>Operatori Ekonomik "D" SHPK me NUIS ME</u>**
a.Vendimi nr.478, datë 16.09.2024 i DDT, sipas këtij vendimi mbështetur në proces verbalin për verifikimin e kundërvajtje administrative nr.5387/1prot., datë 29.07.2024 mbajtur nga Kontrolli Aposterior në DDT në lidhje me deklaratën IMP4 R83683, datë 11.08.2023, vendosi operatori ekonomik të paguajë detyrimin doganor në shumën 313,442 lekë dhe të dënojë me gjobë në shumën 940,326 lekë.
b. Lajmërimi postar i vendimit nr.478, datë 16.09.2024 vulosur me datë 04.10.2024 , dorëzuar në datë 07.10.2024 dhe nga shpërndarësi posta 1057 Tiranë datë 08.10.2024.
c. Vendimi nr. 77, datë 06.11.2024 për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës
d.Lajmërim postar datë 07.11.2024 i vendimit nr.77 datë 06.11.2024.
*Konstatohen vonesa në kryerjen e njoftimit të vendimit të shpallje debitor subjektin, në nxjerrjen e vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, mangësi në dokumentacionin në dosje, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:
-Nuk është respektuar afati 10 ditor i kryerjes se njoftimit të vendimit.
- Njoftimi i vendimit nr.478, datë 16.09.2024 të DDT ka datë 04.10.2024 konstatohet se vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit ka datë 06.11.2024 vonesë të pajustifikuar, nuk ka dokumentacion për procedura të tjera, veprime në kundërshtim me pikën VI :Njoftimi i vendimit:, nënpikat 2 dhe 3 të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018.
-Sipas vendimit subjektit i ka lindur detyrim në shumën 313,442 lekë nga kontrolli aposterior, konkretisht të deklaratës R83683 datë 11.08.2023. Nga auditimi konstatohet se për këtë detyrim nuk janë llogaritur kamatëvonesa, ndërkohë që kamatvonesat duhet të ishin llogaritur që në momentin e lindjes së detyrimit fillestar sipas përcaktimeve të shkronjës b), pika 4.2, kapitulli V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" *"*ii) *Afati kur fillon zbatimi i kamatëvonesës"* në të cilën citohet që *"...Kur një borxh lind sipas nenit 74 ose 77 të Kodit Doganor apo kur njoftimi i borxhit doganor vjen në vijim të një kontrolli, pas çlirimit, norma e kamatvonesave zbatohet mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit duke filluar nga data në të cilën lind borxhi doganor deri në datën e njoftimit të tij.....* dhe *iv)Për rastet e lindjes së detyrimit së borxhit të akcizës për operacionet e parregullta momentit i zbatimit të kamatëvonesës*

*do të jetë momenti në të cilin konstatohet lindja e detyrimit të akcizës që i korrespondon momentit kur është vërtetuar se produktet e akcizës janë prodhuar, importuar, blerë, transportuar, përdorur ose konsumuar në mënyrë të parregullt ose janë hedhur në konsum në mënyrë të parregullt si dhe janë dërguar ose përdorur nga përdorues i përjashtuar për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në autorizim."*[5]. Për rrjedhojë kamatëvonesa nuk është llogaritur dhe pasqyruar saktë në evidencën e borxhit doganor, në kundërshtim me udhëzimin nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës".* Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**-<u>Operatori Ekonomik "D" SHPK me NUIS ME</u>**

a.Vendimi nr.674, datë 18.12.2024 i DDT sipas këtij vendimi mbështetur në proces verbalin për verifikimin e kundërvajtje administrative nr.8394 prot., datë 18.10.2024 mbajtur nga Drejtoria e Hetimit, DOH në DPD në lidhje me deklaratën IMP4 R83683, datë 11.08.2023 , DDT vendosi operatori ekonomik të paguajë detyrimin doganor në shumën 313,482 lekë dhe të dënojë me gjobë sa tre fishi i detyrimit doganor të munguar në shumën 940,446 lekë.

b.Lajmërimi postar i vendimit nr.674, datë 18.12.2024 vulosur me datë 22.01.2024 , dorëzuar në datë 24.01.2024 dhe nga shpërndarësi posta 1057 Tiranë datë 25.01.2024 me shënimin refuzuar.

c.Kërkesë nr.1556/2 prot., datë 25.02.2025 për shpallje publike të akteve administrative (vendimi nr.674, datë 18.12.2024) drejtuar Bashkisë Tiranë.

*Konstatohen vonesa në kryerjen e njoftimit të vendimit të shpallje debitor subjektin, në nxjerrjen e vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, mangësi në dokumentacionin në dosje, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:

- Vonesa në njoftim vendimin e shpalljes debitor.
- Vonesa në kërkesën për shpallje publike të akteve administrative

Mangësi në dosjen detyrimeve të papaguara.

*Konstatohen vonesa në kryerjen e njoftimit të vendimit të shpalljes debitor subjektin, mangësi në dokumentacionin në dosjen e detyrimeve të papaguara, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.15 Për rikuperimin e borxhit doganor.*

-Sipas vendimit subjektit i ka lindur detyrim në shumën 313,482 lekë nga kontrolli aposterior, konkretisht të deklaratës R83683 datë 11.08.2023. Nga auditimi konstatohet se për këtë detyrim nuk janë llogaritur kamatëvonesa, ndërkohë që kamatvonesat duhet të ishin llogaritur që në momentin e lindjes së detyrimit fillestar sipas përcaktimeve të shkronjës b), pika 4.2, kapitulli V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" *"*ii) *Afati kur fillon zbatimi i kamatëvonesës"* në të cilën citohet që *"...Kur një borxh lind sipas nenit 74 ose 77 të Kodit Doganor apo kur njoftimi i borxhit doganor vjen në vijim të një kontrolli, pas çlirimit, norma e kamatvonesave zbatohet mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit duke filluar nga data në të cilën lind borxhi doganor deri në datën e njoftimit të tij.....* dhe *iv)Për rastet e lindjes së detyrimit së borxhit të akcizës për operacionet e parregullta momentit i zbatimit të kamatëvonesës do të jetë momenti në të cilin konstatohet lindja e detyrimit të akcizës që i korrespondon momentit kur është vërtetuar se produktet e akcizës janë prodhuar, importuar, blerë, transportuar, përdorur ose konsumuar në mënyrë të parregullt ose janë hedhur në konsum në mënyrë të parregullt si dhe janë dërguar ose përdorur nga përdorues i përjashtuar për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara*

[5] Efekti i kamatvonesave te munguara ne llogaritje sipas KLSH eshte jo material ne shumën 31,282 lekë

*në autorizim."*[6]. Për rrjedhojë kamatëvonesa nuk është llogaritur dhe pasqyruar saktë në evidencën e borxhit doganor, në kundërshtim me udhëzimin nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës".* Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**-Operatori Ekonomik "R" SHPK me NUIS MH**

**a.**Vendimi nr.707, datë 22.12.2024 i DDT sipas këtij vendimi në shqyrtim të proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative nr.5238/1 prot., datë 2410.2024 nga Zyra e Regjimeve Doganore pranë DDT për mos plotësimin e kushteve për mallrat nën Regjimin e Përpunimit Aktiv me Autorizim 10234/1, datë 26.04.2022 (dokumentacioni i praktikës së shkeljes para daljes së vendimit nuk ndodhet në dosje) DDT ka vendosur të paguhet detyrimi doganor i munguar në shumën 770,026 lekë dhe të dënojë me gjobë operatorin ekonomik në shumën 1,540,052 lekë.

**b.**Lajmërimi postar i operatorit datë 22.01.2025 (për vendimin nr. 707 datë 22.12.2024), shpërndarësi 1057 Tiranë datë 23.01.2025.

c. Vendimi nr.1, datë 13.02.2025 i DDT "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës"

d.Lajmërim postar datë 19.02.2025 për vendimin nr.1, datë 13.02.2025.

e.Kërkesë për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit (për vendimin nr.1, datë 13.02.2025) me nr.1657 prot., datë 28.02.2025 drejtuar Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Tiranë, kjo kërkesë nuk ka vulën e regjistrimit në Gjykatë.

*Konstatohet vonesa në kryerjen e njoftim vendimit të vendimit të shpalljes debitor; kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, nuk është e protokolluar në Gjykatë, mangësi ne dokumentacion, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:

-Nuk është respektuar afati 10 ditor i kryerjes se njoftimit të vendimit.

- kërkesa për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit (për vendimin nr.1, datë 13.02.2025 të DDT) nuk është bërë menjëherë pas njoftimit të VRFB të DDT, veprim më kundërshtim me Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018, pika VIII/1*."Menjëherë pas marrjes dijeni të vendimit për zbatimin e masave garantuese dh/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, pra pas kthimit në Titull Ekzekutiv, specialist-Jurist/Specialist Borxhi I Sektorit/Zyrës së Administratës dhe Shërbimit në Degën Doganore dërgon në Gjykatë kërkesën për nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit".*

- nuk është në dosje dokumentacioni që ka shërbyer për nxjerrjen e vendimit të shpalljes debitor, veprime në kundërshtim me nenin 273,276 të Kodit Doganor dhe Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018.

**-Subjekti V person fizik me ID HO**

**a.**Vendimi nr.712, datë 26.12.2024 i DDT, sipas këtij vendimi në shqyrtim të shkresës nr. 1294. Prot., informacion për marrje vendimi e materialeve shkresore protokolluar në DDT me nr.638 prot., të DOH , DDT ka vendosur të paguhet detyrimi doganor i munguar në shumën 538,098 lekë dhe të dënohet me gjobë në shumën 1,614,294 lekë.

**b.**Lajmërimi postar datë 15.02.2025 (për vendimin nr.712, datë 26.12.2024).

c.Vendimi nr.4, datë 26.02.2025 i DDT "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës"

*Konstatohet mungesa të dokumentacionit përpara marrjes së vendimit pjesë e praktikës së shkeljes doganore, vonesa në kryerjen e njoftim vendimit të vendimit të shpalljes debitor veprime në*

[6] Efekti i kamatvonesave te munguara ne llogaritje sipas KLSH eshte jo material ne shumën 31,279 lekë

*kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:
- Nuk është respektuar afati kohor i bërjes së njoftim vendimit. Lajmërimi postar datë 15.02.2025 (për vendimin nr.712,datë 26.12.2024).
-nuk ka dokumentacion për kryerjen e mënyrave të tjera te njoftimit veprime në kundërshtim me nenin 48/4 të Kodit Doganor Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve, sipas të cilit: *"Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor".*
*Konstatohet mungesa të dokumentacionit përpara marrjes së vendimit pjesë e praktikës së shkeljes doganore. vonesa në kryerjen e njoftim vendimit të vendimit të shpalljes debitor, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.15 Për rikuperimin e borxhit doganor.*

**-Subjekti J person fizik me ID 1**
**a.**Vendimi nr.721, datë 30.12.2024 i DDT sipas këtij vendimi në shqyrtim të shkresës nr.1296 Prot., informacion për marrje vendimi e materialeve shkresore protokolluar në DDT me nr.640prot., të DOH, DDT ka vendosur të paguaj detyrimin doganor i munguar në shumën 361,918 lekë dhe të dënohet me gjobë në shumën 1,085,754 lekë.
b. Kërkesë nr.15562 prot., datë 25.02.2025 për shpallje publike të akteve administrative (vendimi nr.721, datë 30.12.2024) drejtuar Bashkisë Tiranë.
*Konstatohet mungesa të dokumentacionit përpara marrjes së vendimit pjesë e praktikës së shkeljes doganore dhe njoftim vendimit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:
- në dosje nuk ka njoftim vendimi postar, dega doganore nuk ka dokumentacion për kryerjen e mënyrave te tjera te njoftimit veprime në kundërshtim me nenin 48/4 të Kodit Doganor "Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve", sipas të cilit: *"Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor".*
*Konstatohet mungesa të dokumentacionit përpara marrjes së vendimit pjesë e praktikës së shkeljes doganore dhe njoftim vendimit, veprime në kundërshtim me nenin 48 të Kodit Doganor dhe Udhëzimin nr.15 Për rikuperimin e borxhit doganor.*

**- Subjekti A person fizik me ID B4**
**a.**Vendimi nr.705, datë 20.12.2024 i DDT sipas këtij vendimi në shqyrtim të shkresës nr. 10206Prot., informacion për marrje vendimi e materialeve shkresor protokolluar në DDT me nr.3599Prot., të DOH , DDT ka vendosur të paguaj detyrimin doganor i munguar në shumën 385,040 lekë dhe të dënohet me gjobë në shumën 1,155,120 lekë.
**b.**Lajmërimi postar datë 15.02.2025 (për vendimin nr.712,datë 26.12.2024) shënimi larguar, datë 19.02.2025.
c. Kërkese nr. 1556/1 prot, datë 25.02.2025 për shpalljen publike të akteve administrative (vendimit nr.705, datë 20.12.20240 drejtuar Bashkisë Malësi e Madhe
d.kërkesë nr. 1556/2 prot, datë 25.02.2025 për shpalljen publike të akteve administrative (vendimit nr.705, datë 20.12.20240 drejtuar Bashkisë Tiranë.
*Konstatohet mungesa të dokumentacionit përpara marrjes së vendimit pjesë e praktikës së shkeljes doganore vonesa në kryerjen e njoftim vendimit të vendimit të shpalljes debitor, veprime në*

*kundërshtim me Udhëzimin nr.15* datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* konkretisht:
-mos respektim i afatit të njoftimit të vendimit. Lajmërimi postar datë 15.02.2025 (për vendimin nr.712,datë 26.12.2024) shënimi larguar, datë 19.02.2025.
-Në dosje nuk ka dokumentacion për kryerjen e mënyrave te tjera te njoftimit, veprime në kundërshtim me nenin 48/4 të Kodit Doganor "Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve", sipas të cilit: *"Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor".*
*Konstatohet mungesa të dokumentacionit përpara marrjes së vendimit pjesë e praktikës së shkeljes doganore vonesa në kryerjen e njoftim vendimit të vendimit të shpalljes debitor dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.15 Për rikuperimin e borxhit doganor.*

Nga auditimi konstatohet se në të gjitha rastet nuk ka dokumentacion për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara të bëra nga vetë autoritete doganore përmes strukturave te rikuperimit me forcë. Veprime në kundërshtim me pikën IX/2 "Ekzekutimi i Urdhërit të Ekzekutimit" dhe pikën XI "Të përgjithshme", të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2028. Në të gjitha rastet mungon dokumentacioni që duhet të përmbajë Dosja e Detyrimeve të Papaguara konkretisht: praktika doganore për të cilën është konstatuar shkelja, raporti, informacioni i detajuar nga struktura kontrolluese/konstatuese ku tregohet saktë procedura e ndjekur deri në përcaktimin e detyrimeve të papaguara dhe proces verbali i verifikimit të shkeljeve. Këto janë veprime në kundërshtim me pikën III "Dosja e Detyrimeve të Papaguara" pas konstatimit të shkeljes doganore/akcizës, të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të Akcizës" të DPD-së.

**C. Auditimi i dosjeve të borxhit të cilat përfaqësojnë peshën më të madhe ndaj totalit të borxhit doganor në Degën Doganore Tiranë.**

**-Subjekti "K" me NIPT KA.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 300 Prot. 5086/1 datë 02.06.2017, në shumën 97,748,426 lekë dhe 293,245,278 lekë penalitet për shkelje në fushën e akcizës. Në dosje gjendet dokumentacioni paraprak për marrje vendimi që përfshin deklaratën doganore, shkresë përcjellëse për RPA të KLSH datë 20.09.2016, procesverbal nr.803 datë 21.01.2016 i kontrollit aposterior i DDT dhe procesverbal për verifikimin e kundravajtjes administrative kopje.
Mbi këtë Vendim disponohet në dosje në kopje, ankimi administrativ i shoqërisë me nr. 5715 datë 09.06.2017 drejtuar DPD me objekt konstatim i pavlefshmërisë absolute si vendim i marrë haptazi në kundërshtim me ligjin, në 1 fletë.
Nga auditimi mbi këtë rast të detyrimit doganor konstatohet se nuk është marrë asnjë masë për rikuperimin me forcë nga autoriteti doganor duke qenë në kundërshtim me Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* dhe parashikimet e bëra në Kodin Doganor. Kjo ka sjellë kushtet për akumulimin e kamatvonesave vit pas vit në shtesë të detyrimit dhe megjithëse kanë kaluar gati 8 vjet nga vendimmarrja e DDT, asnjë masë nuk rezulton të jetë iniciuar me qëllim vazhdimin e procedurave për arkëtimin e borxhit. Gjithashtu nuk rezulton të jenë pezulluar garancitë nga mos marrja e vendimit të rikuperimit me forcë.

**-Subjekti "S" me NIPT LD.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 587 Prot. 11842/1 datë 29.12.2014, në shumën 121,369,352 lekë dhe 606,846,760 lekë penalitet për shkelje në fushën e kontrabandës. Në dosje gjendet edhe praktika që përfshin informacion për marrje vendimi për shkeljen doganore. Me Vendim nr. 197 datë 15.04.2015 të Degës Doganore Tiranë është vendosur rikuperimi me forcë i borxhit doganor/akcizës, duke përfshirë në këtë akt marrjen e masave shtrënguese.
Kërkesa e Degës Doganore Tiranë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është kryer me shkresë nr. 5662 datë 25.05.2015.
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendim nr. 1255 datë 12.10.2015 ka miratuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.
Me kërkesë nr.3669 datë 07.04.2016 është kërkuar Zyrës përmbarimore gjyqësore "K." shpk ekzekutimi i urdhrit ekzekutiv të Gjykatës nr.1255 datë 12.10.2015. Kjo kërkesë është kryer në tejkalim të afateve nga nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit. Në vijim, nga përmbaruesi me Vendim Refuzimi nr. 665, nr.8686 prot datë 08.08.2018, shoqëria përmbarimore ka vendosur refuzimin e kryerjes së veprimeve pasi kërkesa e DDT ka mangësi dhe megjithëse është lënë afat kohor për plotësimin ato nuk janë plotësuar. Nga auditimi konstatohet se ky refuzim është kryer pas 2 vjetësh nga kërkesa për ekzekutim, që tregon mos ndjekjen e duhur dhe në mënyrë periodike nga DDT dhe mos marrje informacioni mbi situatën e veprimeve përmbarimore. Nga DDT me shkresë nr. 15707 datë 27.12.2018 është kërkuar shoqërisë përmbarimore gjyqësore 3 shpk ekzekutimi i urdhrit ekzekutiv nr. 1255 datë 12.10.2015.
Veprimet e autoritetit doganor për rikuperimin me forcë të borxhit sipas shkresave që disponohen në dosje përfshijnë:
-Kthim përgjigje nga ZRVPP Tiranë mbi kërkesën nr. 13553 datë 29.12.2016 për informacion mbi pasuritë e debitorit nga kjo zyre, duke referuar se nuk ka pasuri dhe kërkuar dërgimin e të dhënave më të plota.
Gjithashtu në dosje gjendet edhe kallëzim penal me nr.1269 datë 30.01.2019 drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për administratorin dhe aksionerin e subjektit S dhe shkresa nr. 4250 datë 21.03.2019 e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për mos fillimin e procedimit penal.
-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin me përmbaruesit gjyqësore pas nënshkrimit të kontratës së shërbimit, sipas përcaktimeve t pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15. Nuk ka dokumentacion provues për përmbushjen e detyrimeve të kreditorit sipas kontratës tip me përmbaruesin ku në nenin 4 "Detyrimet e kreditorit", pika 7 përcaktohet *"Kreditori merr përsipër detyrimet e mëposhtme: ...Të nënshkruajë procesverbalet që dokumentojnë veprimet përmbarimore nga shoqëria përmbarimore të cilat pasqyrojnë realitetin dhe janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi duke pasur të drejtë të shënojë në të dhe vërejtjet/kundërshtimet që ai ka".*
Gjithashtu, përzgjedhja e përmbaruesit nuk rezulton të jetë e dokumentuar.

Në dosje nuk gjendet dokumentacion justifikues për masat e marra nga vetë autoriteti doganor për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, sipas përcaktimeve të pikës XV të Udhëzimit 15.
Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit të Ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".
Nuk ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.

Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Në kundërshtim me pikë 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës"*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**-Subjekti "S" me NIPT LD.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. Prot. 4470/2 datë 07.06.2014, në shumën 23,049,834 lekë dhe 115,249,170 lekë penalitet për shkelje në fushën e kontrabandës. Në dosje gjendet edhe praktika që përfshin informacion për marrje vendimi për shkeljen doganore me nr. 4470 datë 19.05.2014. Me Vendim nr. 52 datë 24.03.2015 të Degës Doganore Tiranë është vendosur rikuperimi me forcë i borxhit doganor/akcizës, duke përfshirë në këtë akt marrjen e masave shtrënguese.
Kërkesa e Degës Doganore Tiranë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është kryer me shkresë nr. 9975 datë 27.09.2016.
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendim nr. 2018 datë 26.10.2016 ka miratuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.
Me kërkesë nr.894 datë 28.01.2017 është kërkuar Zyrës përmbarimore gjyqësore B ekzekutimi i urdhrit ekzekutiv të Gjykatës, për të cilën është lidhur kontratë shërbimi në datë 03.02.2017. Në dosje disponohet lajmërim për ekzekutim vullnetar nga përmbaruesi drejtuar subjektit me nr.177 datë 06.02.2017.
Veprimet e autoritetit doganor për rikuperimin me forcë të borxhit sipas shkresave që disponohen në dosje përfshijnë:
-shkresa nr.9602 datë 09.09.2015 drejtuar QKR Tiranë për shpallje publike të VRFB dhe shkresa nr. 7242 datë 28.07.2014.
-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin me përmbaruesit gjyqësore pas nënshkrimit të kontratës së shërbimit, sipas përcaktimeve të pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15 ku citohet *"..Dega Doganore ti kërkojë informacion me shkrim Zyrës Përmbarimore lidhur me statusin aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv për të gjitha veprimet e kryera, informacion të cilin më pas ia përcjell Sektorit të Monitorimit të Borxhit....* Nuk ka dokumentacion provues për përmbushjen e detyrimeve të kreditorit sipas kontratës tip me përmbaruesin ku në nenin 4 "Detyrimet e kreditorit", pika 7 përcaktohet *"Kreditori merr përsipër detyrimet e mëposhtme: ...Të nënshkruajë procesverbalet që dokumentojnë veprimet përmbarimore nga shoqëria përmbarimore të cilat pasqyrojnë realitetin dhe janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi duke pasur të drejtë të shënojë në të dhe vërejtjet/kundërshtimet që ai ka".*
Gjithashtu, përzgjedhja e përmbaruesit nuk rezulton të jetë e dokumentuar.

Në dosje nuk gjendet dokumentacion justifikues për masat e marra nga vetë autoriteti doganor për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, sipas përcaktimeve të pikës XV të Udhëzimit 15.
Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit të Ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".
Nuk ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Në kundërshtim me pikë 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës".*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**-Subjekti "V" me NIPT KT.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 1186, nr. Prot. 13567/3 datë 23.12.2019, në shumën 61,992,368 lekë dhe 61,992,368 lekë penalitet si pasojë e mos përmbushjes së kushteve dhe afateve të autorizimit të RPA për mallrat.
Me Vendim nr. 3 datë 06.02.2020 të Degës Doganore Tiranë është vendosur rikuperimi me forcë i borxhit doganor/akcizës, duke përfshirë në këtë akt marrjen e masave shtrënguese për vendimet nr.1183, 1184, 1185, 1186 dhe 1187 kundrejt operatorit ekonomik që kanë krijuar detyrime.
Kërkesa e Degës Doganore Tiranë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është kryer me shkresë nr. 5844 datë 06.07.2020.
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendim nr. 621 datë 13.07.2020 ka miratuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.
Me shkresë nr. 2925/13 datë 02.04.2021 drejtuar subjektit është lajmëruar për ekzekutim vullnetar të urdhrit të ekzekutimit.
Me kërkesë nr.3484 datë 0.04.2021 është kërkuar Zyrës përmbarimore gjyqësore 3 shpk ekzekutimi i urdhrit ekzekutiv të Gjykatës. Në dosje gjendet edhe kontratë shërbimi datë 23.04.2021 me Zyrën e Përmbarimit Privat 3 shpk si dhe kërkesat e zyrës përmbarimore drejtuar QKB me nr. 854/3 datë 19.05.2021 dhe njoftimi për deklarim drejtuar kompanisë me nr.854/2 datë 19.05.2021.
Nga auditim i dosjes dhe dokumentacionit të paraqitur konstatohet se ka vonesa në ndjekjen e hapave proceduriale për rikuperimin me forcë të borxhit doganor sipas udhëzimit nr. 15.

-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin me përmbaruesit gjyqësore pas nënshkrimit të kontratës së shërbimit, sipas përcaktimeve të pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15. Nuk ka dokumentacion provues për përmbushjen e detyrimeve të

kreditorit sipas kontratës tip me përmbaruesin ku në nenin 4 "Detyrimet e kreditorit", pika 7 përcaktohet *"Kreditori merr përsipër detyrimet e mëposhtme: ...Të nënshkruajë procesverbalet që dokumentojnë veprimet përmbarimore nga shoqëria përmbarimore të cilat pasqyrojnë realitetin dhe janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi duke pasur të drejtë të shënojë në të dhe vërejtjet/kundërshtimet që ai ka".*
Gjithashtu, përzgjedhja e përmbaruesit nuk rezulton të jetë e dokumentuar.

Në dosje nuk gjendet dokumentacion justifikues për masat e marra nga vetë autoriteti doganor për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, sipas përcaktimeve të pikës XV të Udhëzimit 15.
Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit të Ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".
Nuk ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Në kundërshtim me pikë 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës"*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

-**Subjekti "C" me NIPT LM.** Detyrimi për këtë vendim ka lindur në bazë të Vendimit nr. 217, nr. Prot. 840/1 datë 16.02.2015, në shumën 49,885,055 lekë dhe 229,425,275 lekë penalitet si pasojë e shkeljes kontrabandë. Ky vendim është marrë në vijim të procesverbalit nr. 000837 datë 2301.2015 të DOH për konstatimin e kundravajtjes.
Me Vendim nr. 310 datë 31.10.2015 të Degës Doganore Tiranë është vendosur rikuperimi me forcë i borxhit doganor/akcizës, duke përfshirë në këtë akt marrjen e masave shtrënguese.
Kërkesa e Degës Doganore Tiranë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është kryer me shkresë nr. 191 datë 09.01.2016.
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendim nr. 167 datë 01.02.2017 ka miratuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, i cili nuk është pjesë e dosjes së borxhit.
Me shkresë nr. 4892 datë 22.05.2017 drejtuar shoqërisë përmbarimore B është kërkuar vënia në ekzekutim e urdhrit të ekzekutimit nr. 167 datë 01.02.2017, për të cilën është lidhur kontratë shërbimi nr. 4892/1 datë 20.06.2017.
Në dosje gjenden dokumentacioni për veprimet e përmbaruesit si më poshtë:
-lajmërim për ekzekutim vullnetar datë 29.06.2017;
-Vendim nr13194 datë 13.12.2017 për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm

-Urdhër për vënien e sekuestros konservative nr. 1396 datë 13.12.2017 drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe Urdhër për vënien e sekuestros konservative nr. 1395 datë 13.12.2017 drejtuar DRSHTRR Tiranë.
Që nga veprimet e fundit të përmbaruesit në Dhjetor 2017, në dosje nuk gjendet informacion/ korespondecë me përmbaruesin për situatën aktuale të procesit të rikuperimit të këtyre detyrimeve, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15. Nuk ka dokumentacion provues për përmbushjen e detyrimeve të kreditorit sipas kontratës tip me përmbaruesin ku në nenin 4 "Detyrimet e kreditorit", pika 7 përcaktohet *"Kreditori merr përsipër detyrimet e mëposhtme: ...Të nënshkruajë procesverbalet që dokumentojnë veprimet përmbarimore nga shoqëria përmbarimore të cilat pasqyrojnë realitetin dhe janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi duke pasur të drejtë të shënojë në të dhe vërejtjet/kundërshtimet që ai ka".*
Gjithashtu, përzgjedhja e përmbaruesit nuk rezulton të jetë e dokumentuar.

-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se ka vonesa dhe mangësi në ndjekjen e hapave proceduriale sipas udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, konkretisht:

Në dosje nuk gjendet dokumentacion justifikues për masat e marra nga vetë autoriteti doganor për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, sipas përcaktimeve të pikës XV të Udhëzimit 15.
Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit të Ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".
Nuk ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Në kundërshtim me pikë 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës"*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**-Subjekti "B" me NIPT LL.** Detyrimi për këtë vendim ka lindur në bazë të Vendimit nr. 477, nr. Prot. 5317/1 datë 12.08.2017, në shumën 36,802,450 lekë dhe 73,604,900 lekë penalitet si pasojë e mos përmbushjes së kushteve dhe afateve të autorizimit të RPA për mallrat. Ky vendim është marrë në vijim të procesverbalit nr. 5317 datë 01.06.2017 të Degës Doganore Tiranë për konstatimin e kundravajtjes, pjesë e dosjes së borxhit së bashku me autorizim për RPA, urdhër kontrolli nr.4775 datë 17.05.2017, procesverbal kontrolli, shkresë nr. 4775/1 datë 31.05.2017 të DDT.

Me Vendim nr. 295 datë 22.11.2018 të Degës Doganore Tiranë është vendosur rikuperimi me forcë i borxhit doganor/akcizës, duke përfshirë në këtë akt marrjen e masave shtrënguese për vendimet nr.471, 474 dhe 477 kundrejt operatorit ekonomik që kanë krijuar detyrime.
Kërkesa e Degës Doganore Tiranë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është kryer me shkresë nr. 591 datë 15.01.2019.
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendim nr. 64 datë 22.01.2019 ka miratuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.
Me shkresë nr. 2774 datë 27.02.2019 drejtuar subjektit është lajmëruar për ekzekutim vullnetar të urdhrit të ekzekutimit.
Në dosje gjendet kontrata e shërbimit me datë 27.05.2019 me shoqërinë përmbarimore "B". Në baze të kësaj kontratë, në dosje gjendet Vendim nr. 9226 datë 27.06.2019 "Për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm" i shoqërisë përmbarimore dhe Vendim nr. 5242 datë 19.06.2020, prot DDT "Për pezullimin e ekzekutimit" i shoqërisë përmbarimore si pasojë e mos pasjes së aseteve për ekzekutim të detyrueshëm.
Në vijim me shkresë nr. 7703 datë 28.08.2020 DDT ka bërë kërkesë për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit të gjykatës drejtuar shoqërisë përmbarimorë private I.
-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin me përmbaruesit gjyqësore pas nënshkrimit të kontratës së shërbimit, sipas përcaktimeve të pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15. Nuk ka dokumentacion provues për përmbushjen e detyrimeve të kreditorit sipas kontratës tip me përmbaruesin ku në nenin 4 "Detyrimet e kreditorit", pika 7 përcaktohet *"Kreditori merr përsipër detyrimet e mëposhtme: ...Të nënshkruajë procesverbalet që dokumentojnë veprimet përmbarimore nga shoqëria përmbarimore të cilat pasqyrojnë realitetin dhe janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi duke pasur të drejtë të shënojë në të dhe vërejtjet/kundërshtimet që ai ka".*
Gjithashtu, përzgjedhja e përmbaruesit nuk rezulton të jetë e dokumentuar.

Në dosje nuk gjendet dokumentacion justifikues për masat e marra nga vetë autoriteti doganor për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, sipas përcaktimeve të pikës XV të Udhëzimit 15.
Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit të Ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".
Nuk ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Në kundërshtim me pikë 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzekutive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës"*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit

përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**-Subjekti "E" me NIPT KC.** Kjo dosje është transferuar sipas shkresës nr. 18683 datë 16.04.2019, të DRTM drejtuar DPT. Ky transferim është kryer në vijim të Udhëzimit nr.9, datë 11.03.2019 të Ministrit të MFE-së, *"Mbi modalitetet e transferimit pranë administratës doganore të të dhënave për subjektet e akcizës të cilët rezultojnë me detyrime të papaguara dhe Urdhër nr.21004, datë 16.08.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD-së".* Sipas pikës 9 të Udhëzimit nr.9, datë 11.03.2019 të Ministrit të MFE-së ku citohet *"Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në varësi të adresës ku subjekti debitor ka selinë, urdhëron degët doganore përkatëse për marrjen në evidencë dhe kontabilizimin e borxhit të akcizës, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave deri në mbledhjen dhe shuarjen e këtij borxhi."* është parashikuar kontabilizimi dhe në vijim ndjekja e të gjitha procedurave për rikuperimin e detyrimeve të papaguara.
Dosja e transferuar nga DPT në DPD e në vijim në DDT sipas kartelave shoqëruese të praktikës përmban 101 fletë me nr. Sekretimi 982-1082 dhe në përmbajtje të saj ndodhen dokumentacioni sipas formularit të transferimit të të dhënave të tatimpaguesve lidhur me detyrimet e papaguara të akcizës sipas pjesëve përbërëse:
1.DRT nga bëhet transferimi
2.Informacioni mbi tatimpaguesin
3.Informacion për detyrimet e tatimpaguesit
4.Dosja e subjektit (sipas procesverbalit të inventarit të dosjes me 4 dokumente të emërtuara dhe shënimin etj ne mbështetje të njoftim vlerësimit, faqe 983 e protokolluar)
Në vijim të transferimit të mësipërm dhe akteve ligjore mbi të cilën është kryer ky transferim, nga ana e DDT me shkresën nr. 11981/5 datë 06.09.2019 është njoftuar subjekti *"për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, pasi në të kundërt administrata doganore do të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për rikuperimin me forcë të detyrimin doganore.*
Nga Dega Doganore Tiranë, përveç njoftimit të subjektit për ekzekutim vullnetar, nuk është marrë asnjë masë në vijim për të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për rikuperimin me forcë të detyrimin doganore, në kundërshtim me pikën 9 të Udhëzimit nr.9, datë 11.03.2019 të Ministrit të MFE-së ku citohet *"Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në varësi të adresës ku subjekti debitor ka selinë, urdhëron degët doganore përkatëse për marrjen në evidencë dhe kontabilizimin e borxhit të akcizës, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave deri në mbledhjen dhe shuarjen e këtij borxhi."* dhe përcaktimet e bëra në udhëzimin nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

**-Subjekti "T" me NIPT LI**. Kjo dosje është transferuar sipas shkresës nr. 18683 datë 16.04.2019, të DRTM drejtuar DPT. Ky transferim është kryer në vijim të Udhëzimit nr.9, datë 11.03.2019 të Ministrit të MFE-së, *"Mbi modalitetet e transferimit pranë administratës doganore të të dhënave për subjektet e akcizës të cilët rezultojnë me detyrime të papaguara dhe Urdhër nr.21004, datë 16.08.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD-së".* Sipas pikës 9 të Udhëzimit nr.9, datë 11.03.2019 të Ministrit të MFE-së ku citohet *"Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në varësi të adresës ku subjekti debitor ka selinë, urdhëron degët doganore përkatëse për marrjen në evidencë dhe kontabilizimin e borxhit të akcizës, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave deri në mbledhjen dhe shuarjen e këtij borxhi."* është parashikuar kontabilizimi dhe në vijim ndjekja e të gjitha procedurave për rikuperimin e detyrimeve të papaguara.

Dosja e transferuar nga DPT në DPD e në vijim në DDT sipas kartelave shoqëruese të praktikës përmban 80 fletë me nr. Sekretimi 1229-1308 dhe në përmbajtje të saj ndodhen dokumentacioni sipas formularit të transferimit të të dhënave të tatimpaguesve lidhur me detyrimet e papaguara të akcizës sipas pjesëve përbërëse:
1.DRT nga bëhet transferimi
2.Informacioni mbi tatimpaguesin
3.Informacion për detyrimet e tatimpaguesit
4.Dosja e subjektit (sipas procesverbalit të inventarit të dosjes me 1 dokument të emërtuar)
Në vijim të transferimit të mësipërm dhe akteve ligjore mbi të cilën është kryer ky transferim, nga ana e DDT me shkresën nr. 11981/3 datë 06.09.2019 është njoftuar subjekti *"për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, pasi në të kundërt administrata doganore do të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për rikuperimin me forcë të detyrimit doganor".* Nga tatimpaguesi me shkresë nr. 12746 datë 19.09.2019 drejtuar DDT ndër të tjera, është kthyer përgjigje për shkresën nr. 11981/3 datë 06.09.2019. Në dosje disponohet edhe shkresë Sekretarit të Përgjithshëm të MFE drejtuar DDT ndër të tjera ku kërkon informacion për ankesë të paraqitur në MFE nga tatimpaguesi dhe kërkesë për vendosje në dijeni për hapat që janë ndërmarrë dhe do ndërmerren për këtë çështje. DDT me shkresën nr. 12666/1 datë 18.10.2019 ka kthyer përgjigje MFE dhe për dijeni DPD ku ka informuar mbi kërkesën për saktësim drejtuar DPT me shkresë nr. 13113 datë 30.09.2019 nëse shoqëria vazhdon të jetë debitore. Në përgjigje të kësaj shkrese, DRT Tiranë me shkresë nr.26967 datë 28.10.2019 drejtuar ndër të tjera DPD ka sqaruar se akti njoftim vlerësimi nr. 64750/6 datë 22.11.2012 është në fuqi dhe ndodhet në proces gjyqësor, e cila i është komunikuar DDT nga DPD me shkresën nr. 14969 datë 12.11.2019.
Nga auditimi mbi dokumentacionin e paraqitur në këtë dosje, konstatohet se nga Dega Doganore Tiranë, përveç njoftimit të subjektit për ekzekutim vullnetar, nuk është marrë asnjë masë në vijim për të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për rikuperimin me forcë të detyrimin doganor, në kundërshtim me pikën 9 të Udhëzimit nr.9, datë 11.03.2019 të Ministrit të MFE-së ku citohet *"Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në varësi të adresës ku subjekti debitor ka selinë, urdhëron degët doganore përkatëse për marrjen në evidencë dhe kontabilizimin e borxhit të akcizës, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave deri në mbledhjen dhe shuarjen e këtij borxhi."* dhe përcaktimet e bëra në udhëzimin nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

**-Subjekti "A" me NIPT LD**. Kjo dosje është transferuar sipas shkresës nr. 18683 datë 16.04.2019, të DRTM drejtuar DPT. Ky transferim është kryer në vijim të Udhëzimit nr.9, datë 11.03.2019 të Ministrit të MFE-së, *"Mbi modalitetet e transferimit pranë administratës doganore të të dhënave për subjektet e akcizës të cilët rezultojnë me detyrime të papaguara dhe Urdhër nr.21004, datë 16.08.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD-së".* Sipas pikës 9 të Udhëzimit nr.9, datë 11.03.2019 të Ministrit të MFE-së ku citohet *"Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në varësi të adresës ku subjekti debitor ka selinë, urdhëron degët doganore përkatëse për marrjen në evidencë dhe kontabilizimin e borxhit të akcizës, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave deri në mbledhjen dhe shuarjen e këtij borxhi."* është parashikuar kontabilizimi dhe në vijim ndjekja e të gjitha procedurave për rikuperimin e detyrimeve të papaguara.
Dosja e transferuar nga DPT në DPD e në vijim në DDT sipas kartelave shoqëruese të praktikës përmban 127 fletë me nr. Sekretimi 1102-1228 dhe në përmbajtje të saj ndodhen dokumentacioni sipas formularit të transferimit të të dhënave të tatimpaguesve lidhur me detyrimet e papaguara të akcizës sipas pjesëve përbërëse:

1.DRT nga bëhet transferimi
2.Informacioni mbi tatimpaguesin
3.Informacion për detyrimet e tatimpaguesit
4.Dosja e subjektit (sipas procesverbalit të inventarit të dosjes me 77 dokumente të emërtuara)
Në vijim të transferimit të mësipërm dhe akteve ligjore mbi të cilën është kryer ky transferim, nga ana e DDT me shkresën nr. 11981/4 datë 06.09.2019 është njoftuar subjekti *"për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, pasi në të kundërt administrata doganore do të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për rikuperimin me forcë të detyrimin doganore".* Për shkak të mos marrjes dijeni, për këtë njoftim DDT i është drejtuar me shkresë nr. 5561 datë 29.06.2020 Bashkisë Tiranë për shpallje publike, për të cilën është kthyer përgjigje nga Bashkia Tiranë me shkresën nr. 21607/1 datë 07.07.2020 sipas së cilës është kryer afishimi i shpalljes.
Nga auditimi mbi dokumentacionin e paraqitur në këtë dosje, konstatohet se nga Dega Doganore Tiranë, përveç njoftimit të subjektit për ekzekutim vullnetar, nuk është marrë asnjë masë në vijim për të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për rikuperimin me forcë të detyrimin doganore, në kundërshtim me pikën 9 të Udhëzimit nr.9, datë 11.03.2019 të Ministrit të MFE-së ku citohet *"Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në varësi të adresës ku subjekti debitor ka selinë, urdhëron degët doganore përkatëse për marrjen në evidencë dhe kontabilizimin e borxhit të akcizës, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave deri në mbledhjen dhe shuarjen e këtij borxhi."* dhe përcaktimet e bëra në udhëzimin nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

**-Subjekti A me NIPT KD.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.13280 datë 13.12.2014, nr.13281 datë 13.12.2014, nr.13282 datë 13.12.2014, të Degës Doganore Tiranë në shumën 27,645,141 lekë dhe gjobë në shumën 138,225,705 lekë. Në dosje ndodhen:
Vendimet nr.13280 datë 13.12.2014, nr.13281 datë 13.12.2014, nr.13282 datë 13.12.2014. Kopje e lajmërim marrje të vendimeve.
Vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit Doganor/akcizës me nr.11752/57 prot datë 31.10.2015.

**Konkluzioni**

Nga auditimi konstatohet se Dega e Doganës Tiranë në lidhje me këtë subjekt nuk ka marrë masa të mëtejshme proceduriale për vjeljen e detyrimeve doganore të papaguara, pasi nga ana e sektorit të borxhit nuk është vijuar me kërkesën drejtuar Gjykatës Adminstrative të Shkallës së Parë Tiranë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit (kthimin në titull ekzekutiv VRFB nr.11752/57 prot datë 31.10.2015), ky veprim ka pamundësuar ecurinë e ndjekjes së mëtejshme të procedurave të rikuperimit me forcë të detyrimeve doganor. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 280 të ligjin nr.102/2014 **"Kodin Doganor"** dhe Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës" Kapitulli VII "Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor".

Nga subjekti i audituar, Dega e Doganës Tiranë me shkresën nr. 22/14 prot. KLSH datë 07.07.2025 janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit ku janë parashtruar pretendime shtesë mbi ato të paraqitura për akt konstatimet me përmbajtje si më poshtë:
-në lidhje me kontabilizimin e ndarë, ... bëhet jo vetëm për të qënë në përputhje me udhëzimin në fuqi, por dhe për anën praktike, për të ndjekur ecurinë e debitorit. Dhe me këtë nënkuptoj që duke qënë se detyrimi doganor është e ardhur parësore, vjelja e tij bëhet me amendim në llogarinë parapaguese të subjektit në systemin Asycuda Ëorld (llogaria që ka subjekti pranë Drejtorisë së

Përgjithshme të Doganave në të cilën kryen zhdoganime), ndërsa të ardhurat nga gjoba dhe kamatvonesat janë të ardhura dytësore të cilat vijnë me thesar dhe rakordohen çdo muaj nga zyra e financës. Dhe patjetër që për të bërë ndjekjen e situatës së debitorit është dhe praktikisht e detyrueshme të bëhen kontabilizime të ndara, per detyrimin, gjobën dhe kamatvonesën.
-për diferencën ndërmjet zyrës së borxhit dhe financës, ….. Nga vetë mënyra si raporton borxhi (në excel) dhe financa sipas parimeve të kontabilitetit, pa marrë ne konsideratë faktorë të tjerë, është e pamundur që zyra e financës dhe e borxhit të kenë një shifër të njëjtë të vlerës së debitorëve.
-për diferencën për shakk të tepricës kreditore, …. kjo nuk është e vertetë sepse nëse do ishte kështu zyra e financës do raportonte një 468 më të ulët sesa zyra e borxhit. Një llogari aktivi (siç është llogaria 468) e cila ka nje tepricë normale debitore kur rezulton me tepricë kreditore funksion si një llogari detyrimi. Dy janë opsionet, ose ta kesh kreditore ose të mbyllësh gjendjen kreditore dhe ta kalosh te një llogari detyrimi 467 "Kreditorë të ndryshëm". Praktikisht më e lehtë dhe menaxhuese është të mbash një llogari duke dhënë patjetër informacione në shënimet shpjeguese. Sa i përket vlerës së lartë me teprice kreditore të cilën e keni konstatuar, nje kartelë e emërtuar "Pa Nipt" mban peshën me të lartë të tepricës kreditore e cila është e paidentifikueshme aktualisht nga zyra e Financës duke qënë se nuk ka asnjë origjinë të kësaj vlere.

**-Nga zyra e borxhit:**

- Sqarojmë se për 148 raste me vlerë 13,892,867,031 lekë (si në evidencë), që rezultojnë në proçes gjyqësor, zyra e borxhit nuk ka vijuar me dërgimin e kërkesave për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit ndaj debitorëve derisa të ketë një vendim të formës së prerë. Nisja e procedurës së përmbarimit për një akt që më pas mund të shpallet i pavlefshëm, mund të cojë në problematika financiare për administratën doganore në formën e kthimeve me interesa. … Kjo e mbështetur edhe në faktin se gjykata administrative në përputhje me praktikën e saj gjyqësore kërkon domosdoshmërisht një vërtetim zyrtar që tregon nëse subjekti debitor është apo jo në proces gjyqësor lidhur me detyrimin përkatës. Në mungesë të këtij vërtetimi, gjykata refuzon të shqyrtojë kërkesën dhe nuk lëshon urdhrin e ekzekutimit. Bazur në këtë praktikë të konsoliduar nga vetë gjykata, zyra e borxhit është e detyruar që në raste të tilla të pezullojë përkohësisht përgatitjen e kërkesës për urdhër ekzekutimi.

-Ju bejmë me dije se nga ana jonë është tentuar disa herë për të regjistruar urdhërat e ekzekutimit në ekstraktin e subjekteve në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më qëllim bllokimin e veprimeve tregtare. Megjithatë pavarësisht përpjekjeve për regjistrim proçesi nuk ka mundur të përfundojë me sukses për shkak të problemeve tëknike të sistemit elektronik të QKB-së. Pamundësia për të regjistruar urdhrat në QKB është dokumentuar në dosje përmes mesazhit zyrtar të sistemit elektronik, i cili evidenton qarte problemin.

-…. theksojmë faktin se pergjigjet e bankave te nivelit të dytë apo ish ZRVPP-ja, kanë qënë negative (nuk ka pasuri debitori, gjendja e llogarise është me debi apo nuk ka llogari kz subject, etj,). Ndërkohë që çështja është në përmbarim, mund të shihet si ndërhyrje e panevojshme në një proçes tashmë të deleguar ligjërisht, shpenzim I panevojshëm kohe nga ana jonë, që mund të përqëndrohet në ndjekjen e rasteve të tjera, jo të deleguara ende në përmbarim.

-… Pra, vonesa nuk ka ardhur si pasojë e mosveprimit të specislistit por si rezultat i ndjekjes së procedurave ligjore alternartive të njoftimit, të cilat kërkojnë kohë shtesë.

-… Për vetë faktin që aktualisht janë mbi 1900 dosje të borxhit, mbajtja fizike e të gjitha praktikave të plota në Zyrën e Borxhit është e pamundur për shkak të mungesës së hapësirës fizike dhe të ngarkesës së lartë të punës. Kjo do të kërkonte trajtimin e Zyrës së Borxhit si njësi arkivore, gjë që bie në kundërshtim me funksionin e saj parësor dhe do të ndikonte negativisht në efikasitetin e ndjekjes së procedurave të vjeljes.

- Lidhur me auditimin e dosjeve të borxhit të cilat përfaqësojnë peshën më të madhe ndaj totalit të borxhit doganor në Degën Doganore Tiranë, konkretisht: subjekti K shpallur debitor me vendimin e degës Doganore Tiranë nr. 300 Prot. 5086/1 datë 02.06.2017, sqaroj se ky subjekt rezulton në proçes gjyqësor. Dega Doganore nuk ka vijuar me rikuperimin me forcë të borxhit duke qënë se subjekti ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ/Vendimit Nr.300 Prot., date 02.06.2017. ….. Zyra e borxhit ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, astete të tjera, sipas pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, bashkëldhur dokumentacioni përkatës.
Sjellim në vëmendje se këto institucione si Bankat e nivelit të dytë, ish ZVRPPT, Transporti, etj kanë kthyer përgjigje (si në shkresat bashkëlidhur) se shoqëritë me detyrime të papaguara si më sipër, nuk kanë gjendje kreditore ne llogari, nuk figurojnë me pasuri, etj. Pra nuk ka pasur ndonje rezultat pozitiv për debitorët e sipër shënuar, edhe pse kanë kaluar 10 vjeçarin si dosje me urdhër ekzekutimi.
- Lidhur me dosjet e transferuara sipas shkresës nr. 18683 daë 16.04.2019, të DRTM drejtuar DPT, nga DPT në DPD e në vjim në DDT, ju sqarojmë se Dega Doganore Tiranë ka marrë masat për ndjekjen e proceduarave per rikuperimin e borxhit. .. Subjekti "E" me NIPT KC, Subjekti "T" me NIPT LI, Subjekti "A" me NIPT LD (që zënë përqindjen më të lartë të borxhit doganor), u informuam se jane në proçese të hapura gjyqësore dhe për këtë arsye Dega Doganore Tiranë, është në pritje të vendimit përfundimtar gjyqësor. Sa i përket subjektit A NIPT KD, ku nga ana juaj konstatohet se Dega e Doganës Tiranë në lidhje me këtë subjekt nuk ka marrë masa të mëtejshme proceduriale për vjeljen e detyrimeve doganore të papaguara, ju informojme se për këtë subjekt janë kthyer disa herë përgjigje shkresave te gjykatës, DPD-së etj, në lidhje me gjendjen debitore, për arsye se ky subjekt ka qënë në proçes falimenti. Dega Doganore Tiranë, ka nisur kërkesën për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit, e cila nuk ka rezultuar me nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit. Bashkëlidhur do të gjeni shkresën e DPD nr. 15973/1, dt. 30/06/2016, nr. 15973/2, dt. 07/07/2016, nr. 12456/1, dt. 09/06/2017, manadat pagesat me deklaratat e amenduara të datës 30/08/2017.
Përfundimisht, në themel nuk ka neglizhencë, nuk ka patur shpërdorime, keqinterpretime apo anashkalim të zbatimit të ligjit. Kjo është rrjedhojë e stafit të pa mjaftueshem të nevojshëm dhe të domosdoshëm që ka qënë i pa plotësuar sipas organikës prej vitesh.

**Qëndrimi i grupit të auditimit**: *Në lidhje me observacionet për kontabilizimin e ndarë në excel për detyrimin, gjobat dhe kamatvonesat pranojmë observacionin ndërkohë që për kontabilizimin në sistemin alpha të ndarë, sqarojmë se është një cështje që i përket rregullimit të brendshëm DPD-DD nëse parashikimet e udhëzimit në lidhje me kontabilizimin e ndarë do të kryhen edhe në këtë sistem të ndara apo sintetike. Në lidhje me diferencat, sqarojmë se nuk është objekt konstatimi në vetvete diferenca borxh-financë, por shkaqet që kanë sjellë këto diferenca, ndër të cilat edhe kontabilizimi jo i drejtë i pagesave më tepër nga debitorët i reflektuar në tepricë kreditore të llgoarive të debitorëve, që në gjykimin e KLSH duhet të reflektohet në llogarinë e mjeteve në ruajtje 466 në vijim sikurse citoni edhe ju. Për këto arsye merret në konsideratë pjesërisht observacioni.*
*Në lidhje me observacionin e pjesës së borxhit, konstatojmë se ato janë përgjithësisht të njejta me ato të paraqitura në fazën e akt konstatimeve për të cilat janë dhënë shpejgimet përkatëse. Për pretendimet shtesë dhe dokumentacionin shoqërues të përcjellë sqarojmë se merret në konsideratë shkresa e kërkimit të informacionit të nr. 305 atë 23.04.2024 drejtuar shoqërive përmbarimore për informacion për të cilat një pjesë kanë përcjellë informacion. Për cështjet e ekzkutimit gjatë kohës që cështja është në gjykim i mbetemi të njejtit qendrim ligjor të mëparshëm. Për masat e marra nga vetë autoriteti doganor, vlerësojmë se duhet të merren pavarësisht pretendimit për kohën e*

*konsumuar nga ana juaj dhe ndjekjes së cështjes në përmbarim dhe duhet të ndiqet në kohën e duhur. Për komunikimin me ASHK apo QKB sqarojmë se shkresat i përkasin viteve të kaluara ndërkohë që shumë veprime kryhen automatikisht në system me aplikim dhe duhet të reflektohen në rekomandimin që kemi përcjellë për komunikim të qendërzuar të DPD me këto institucione në kuadër të bashkëpunimit insitutcional. Për rastet e vonesave, nuk ka argumenta për marrjen në konsideratë të observacionit refeuar konstatimeve që kanë marrë në konsideratë edhe përiudhën e shpalljes. Për subjektet me vlerën më të lartë, sqarojmë se qënia në proces gjyqësor nuk pezullon ekzkeutimin e vendimit dhe pjesë e dokumentacionit shoqërues nuk janë të gjitha masat për subjektet e konstatuara në aktin përkatës, por një pjesë e cila nuk është reflektuar as në evidencën përkatëse dhe dosjen e borxhit. Për subjektet e transferuara nga tatimet sqarojmë se duhet të ndiqet procedura normale e ekzekutimit pavarësisht mundësisë për arkëtim dhe këto janë veprime që duhet të ishin ndërmarrë në kohë e duhur pasi në tërësi për të gjithë kosntatimet, kalimi i kohës pamundëson ekzekutimin e detyrimeve si pasojë e veprimeve të palëve debitore. Për këto arsye observacioni merret në konsideratë pjesërisht.*

### III.2.4.3. Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për Degën Doganore Fier

Zyra e borxhit doganor në Degën Doganore Fier funksionon sipas strukturës së miratuar me VKM nr.355 datë 26.05.2022 '*Për personelin e administratës doganore'*, në të cilën evidentohen një pozicion pune jurist/specialist borxhi.

Auditimi mbi menaxhimin e Borxhit Doganor (BD), u fokusua në evidentimin e gjendjes së detyrimeve të subjekteve debitorë, krijimin e detyrimeve, gjendjen në fillim dhe në fund, kontabilizimin e tyre, strukturën e detyrimeve, llojshmëria, pesha specifike në total, masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor etj.

Bazuar në evidencën e vendosur në dispozicion nga Dega e Doganës Fier, rezulton se gjendja e borxhit doganor më 31.12.2024 paraqitet me 297 raste për 161 subjekte debitorë në vlerën 15,005,362,324 lekë, dhe gjendja e borxhit më datë 01.01.2024 paraqitet me 281 raste, për 151 subjekte debitorë në vlerën 14,755,644,285 lekë. Pra gjatë vitit ushtrimor 2024, borxhi doganor është ulur me 16 raste në krahasim me numrin në fillim të vitit, është rritur me 10 subjekte debitorë në numër ndërsa në vlerë është shtuar me 249,718,039 lekë ose me 1.7%.

-Nga auditimi mbi evidencën e vendosur në dispozicion nga Dega Doganore Fier për gjendjen e detyrimeve doganore të papaguara në fund të vitit 2024, rezulton se gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime doganore (borxh i ri), i cili paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Dega Doganore | Nr.Raste 01.01.2024 | Shuma në 01.01.2024 | Nr. Raste Shtesa 2024 | Shuma e shtesave në 2024 | Nr. Raste Pakësime 2024 | Shuma e pakësimeve në 2024 | Nr. Raste 31.12.2024 | Shuma në 31.12.2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **FIER** | **281** | **14,755,644,285** | **117** | **262,483,279** | **97** | **12,765,240** | **297** | **15,005,362,324** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Fier*

Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga Dega Doganore Fier dhe evidencat analitike të kësaj dege doganore dhe DPD, shtesat nga vendimet e marra në vitin 2024 janë në shumën 17,420,926 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 5,226,226 lekë për vendime të vitit 2024. Pakësimet e borxhit për vitin 2024 janë në shumën 12,765,240 lekë, nga të cilat 5,226,226 lekë për llogari të vitit 2024 dhe diferenca në shumën 7,603,850 lekë për llogari të detyrimeve doganore të viteve të

kaluara. Shtesa nga kamatëvonesat e llogaritura për 6 mujorin e parë janë në shumën 123,553,965 lekë, ndërsa shtesat nga kamatëvonesat e llogaritura për 6 mujorin e dytë janë në shumën 121,508,094 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

| Periudha e llogaritjes | Shuma |
|---|---|
| gjashtëmujori I dyte | 123,553,965 |
| gjashtëmujori I pare | 121,508,094 |
| **totali I kamatvonesave** | **245,062,059** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Fier*

Konstatohet se shtesa e borxhit për vitin 2024 shkaktohet në masën 93% nga shtesa e kamatëvonesave për detyrimet doganore të pa mbledhura të viteve të mëparshme.

Nga auditimi konstatohet se llogaritja e interesave mbi detyrimet është kryer në baza 6-mujore me dy fletë llogaritje mbi detyrimet ndërkohë që referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* llogaritja e interesave duhet të kryhet mbi baza mujore duke qenë se sipas pikës 5 të kapitullit V të udhëzimit citohet që *"Specialisti – Jurist/Specialist borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në degën doganore raporton në DPD (Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave) çdo muaj mbi gjendjen e detyrimeve të papaguara".* Për rrjedhojë, evidencat mujore të paraqitura nga Dega e Doganës Fier nuk janë të sakta përsa i përket shumës së kamatvonesave të paraqitura me pasojë edhe në shumën totale të borxhit doganor, me përjashtim të muajit Dhjetor kur janë reflektuar në shtesë të gjashtëmujorit të dytë.

Nga auditimi në lidhje me kontabilizimin e shumave të borxhit doganor, konstatohet se sipas kartelës së llogarisë 468 "Debitorë", regjistrimi analitik i detyrimit, penaliteti apo kamatvonesave nuk kryhet i ndarë për subjektin sipas vendimit dhe përcaktimeve të pikës 2, kapitulli V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" ku citohet "Kontabilizimi i shumës së detyrimeve bëhet në zëra të veçantë: a)një zë për shumën e borxhit doganor (detyrimet e import/eksportit të papaguara) dhe apo detyrimeve të akcizës, b) një zë për shumën për shumën e penaliteteve, c) një zë për shumën e kamatvonesave.

Shtesa e borxhit nga vendimet e vitit 2024.

Nga auditimi me zgjedhje i vendimeve të muajit dhjetor 2024, rezulton se ato janë të kontabilizuara në sistemin e kontabilitetit Alpha në llogarinë 468. Pjesa më e madhe e vendimeve të marra në vitin 2024 janë paguar brenda vitit, ndërkohë që janë krijuar detyrime për 29 vendime të papaguara në shumën **12,195 mijë** lekë, pa përfshirë pjesën e kamatvonesave të vitit.

-Borxhi doganor në 31.12.2024 sipas evidencës analitike në nivel rasti të borxhit, referuar autoritetit konstatues paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Struktura Konstatuese | Vlera e detyrimit |
|---|---|
| Auditi | 2,604,014 |
| D.Doganore | 8,396,373,743 |
| D.K.P.Zh&Dr Akcizës | 275,512,059 |
| D.K.P.Zh/DOH | 1,650,040 |
| D.P.D | 3,463,113 |
| D.P.Tatime | 5,551,244 |
| DOH | 442,119,542 |
| DOH/D.Doganore | 18,714,527 |
| Dr.Akcizës | 3,603,533,701 |

| | |
|---|---|
| Dr.Vlerës | 68,802 |
| K.L.Sh | 393,280,635 |
| K.L.Sh/Dr.Akcizës | 1,861,198,879 |
| Laboratori Doganor | 669,054 |
| Origjina | 533,649 |
| RPA | 89,322 |
| **Totali** | **15,005,362,324** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Fier*

Sikurse evidentohet në të dhënat e tabelës së mësipërme, pjesa më e madhe e borxhit doganor në Degën Doganore Fier përbëhet nga borxhi i konstatuar nga dega doganore dhe nga drejtoria e akcizës. Borxhi në masën 90 % të totalit të detyrimeve, i mbartur nga vitet e kaluara, konstatohet se vjen nga 5 subjekte të cilat kanë zhvilluar veprimtarinë në fushën e akcizës sipas tabelës së mëposhtme:

| **Subjekti** | **Shuma** |
|---|---|
| D | 5,896,617,424 |
| I | 2,577,951,640 |
| B | 1,861,198,879 |
| A | 2,337,079,771 |
| T | 854,662,844 |
| **Totali** | **13,527,510,558** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Fier*

Auditimi i masave të marra nga Dega Doganore Fier për rikuperimin e borxhit doganor është kryer bazuar në evidencën e paraqitur mbi stokun e borxhit si dhe dokumentacionin e dosjeve të përzgjedhura për auditim. Nga grupi i auditimit u përzgjodhën për verifikim 20 vendime (dosje) në total për detyrime të papaguara në vlerën 11,329,590 mijë lekë, të cilët përfaqësojnë 76 % të vlerës së borxhit doganor në Degën Doganore Fier, të cilat do trajtohen rast pas rasti të ndara në 10 vendime të viteve të kaluara (2011-2023) me vlerë 11,318,324 mijë lekë dhe 10 vendime të vitit 2024 në vlerën 11,266 mijë lekë, pasqyruar në tabelat si më poshtë:

Tabela nr. Rastet debitore të periudhës 2011-2023 të degës doganës Fier.

| **Debitori** | **NIPT** | **Shuma e detyrimit** | **N. Vendim** | **Date Vendimi** |
|---|---|---|---|---|
| D | LC | 5,187,349,838 | 189 | 17/06/2015 |
| B | KL | 1,861,198,879 | 133/1 | 12/01/2016 |
| A | JD | 1,465,083,287 | 69 | 22/07/2013 |
| T | KP | 854,662,844 | 183 | 06/04/2015 |
| A | LS | 440,874,859 | 72 | 19/05/2016 |
| DE | LC | 417,966,521 | 236 | 09/10/2015 |
| I | LI | 353,757,480 | 24 | 07/02/2018 |
| I | LI | 247,564,451 | 15 | 07/02/2018 |
| D | LC | 245,796,554 | 301 | 21/12/2018 |
| A | JD | 244,068,580 | 83 | 26/08/2013 |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Fier*

Tabela nr. Rastet debitore të periudhës 2024 të degës doganës Fier.

| **Debitori** | **NIPT** | **Shuma e detyrimit** | **N. Vendim** | **Date Vendimi** |
|---|---|---|---|---|
| D | LI | 4,902,123 | **89** | 25/10/2024 |
| K | KU | 1,505,872 | **106** | 12/10/2024 |
| R | LC | 1,179,399 | **60** | 16/08/2024 |
| K | LA | 851,878 | **40** | 07/08/2024 |
| K | LA | 812,551 | **41** | 07/04/2024 |
| N | LA | 626,165 | **78** | 17/09/2024 |
| E | KL | 492,446 | **105** | 12/05/2024 |
| G | MM | 317,728 | **74** | 09/06/2024 |
| T | LK | 299,125 | **94** | 18/11/2024 |
| P | H | 279,375 | **112** | 26/12/2024 |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Fier*

**A. Auditim mbi evidencën e borxhit doganor në Degën e Doganës Fier**

Nga auditimi mbi evidencën e vendosur në dispozicion nga Dega Doganore Fier për gjendjen e detyrimeve doganore të papaguara në fund të vitit 2024 paraqiten 297 raste në vlerën 15,005,362 mijë lekë, të ndara në 4,813,118 mijë lekë detyrim, 7,855,307 mijë lekë gjoba dhe 2,336,937 mijë lekë interesa.

Nga rastet e cituara rezulton se Dega Doganore Fier ka në proces gjyqësor 32 raste me vlerë 9,745,032 mijë lekë të cilët rezultojnë se nuk kanë ndjekur procedurën administrative të ankimit pasi nuk është likuiduar detyrimi doganor si dhe nuk janë garantuar gjobat parashikuar nga neni 281-282 i Kodit Doganor i cili ka parashikuar se: *Kundër vendimit të autoriteteve doganore kompetente, shkelësi mund t'i paraqesë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave një kërkesë ankimore të arsyetuar, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Për të paraqitur ankesën, ankimuesi duhet të paguajë shumën e përgjithshme të detyrimeve të importit ose eksportit, sipas përkufizimeve të këtij titulli, si dhe të garantojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e sanksioneve të aplikuara për shkeljen, objekt konflikti. Ankimuesi duhet të bashkëshoqërojë ankimin me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e tij.*

- Nga zyra Juridike me qëllim uljen e borxhit doganor, deri në fund të vitit 2024 kanë dalë 236 VRFB me vlerë 14,954,790 mijë lekë, **ndërsa për 61 raste të tjera me vlerë 50,572 mijë lekë nuk janë nxjerrë VRFB**,
- Nga ana e këtij sektori janë dërguar kërkesa për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit në gjykatë për 186 raste me vlerë 13,174,537 mijë lekë, **ndërsa për 111 raste me vlerë 1,830,825 mijë lekë nuk janë dërguar kërkesa lëshimin e urdhërit të Ekzekutimit në gjykatë**.
- Nga ana e Gjykatës janë lëshuar Urdhër Ekzekutimi për 161 raste me vlerë 12,662,719 mijë lekë, **ndërsa për 136 raste në vlerën 2,342,644 mijë lekë vlerë borxhi doganor rezulton të mos këtë lëshim urdhër ekzekutimi nga Gjykata**,
- Nga ana e zyrës Juridike janë dërguar për ekzekutim zyrës së Përmbarimit Shtetëror/privat 136 raste me vlerë 12,480,820 lekë.

- Nga auditimi janë konstatuar të paktën 61 raste në shumën 50,572,167 lekë për të cilat nuk ka të shënuar në evidencën e borxhit të dhëna mbi marrjen e Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, megjithëse referuar afateve dhe shumave të detyrimit, janë përmbushur kushtet ligjore për rikuperimin me forcë të këtyre borxheve doganore. Mos ndjekja e hapave proceduriale të detyrueshëm për rikuperimin e detyrimeve doganore të papaguara është në kundërshtim me pikën 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* ku citohet *"Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 282 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës. Ky vendim".* Këto raste janë dërguar në email të datës 16.04.2025 drejtuar juristit/specialist borxhi ne DD Fier.

-Nga auditimi konstatohet se **për 111 raste me vlerë 1,830,825,096 lekë nuk është dërguar kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në gjykatë**, nga të cilat për një pjesë as nuk është nxjerrë VRFB. Ndërsa rastet për të cilat është nxjerrë VRFB, konstatohet se për 50 raste në shumën 1,780,252,929 lekë nuk janë marrë masat për dërgimin e tyre në gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Këto raste janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në duke qenë në pikën 1 të kapitullit VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* ku citohet *"Menjëherë mbas marrjes dijeni të vendimit për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, pra pas kthimit në titull ekzekutiv, specialisti – jurist/specialist borxhi i sektorit/zyrës së administratës dhe shërbimit në degën doganore dërgon në gjykatë kërkesën për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit".* Këto raste janë dërguar në email të datës 16.04.2025 drejtuar juristit/specialist borxhi ne DD Fier.

-Nga auditimi konstatohet se megjithëse nga DD Fier është dërguar kërkesa në Gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, por nga gjykata nuk ka vendim për pranimin e kërkesës për lëshimin urdhri i ekzekutimit. Sipas evidencës analitike të borxhit doganor, kjo konstatohet në 25 raste në shumën 511,818,706 lekë. Për këto raste nuk ka informacion në lidhje me arsyen e mos lëshimit të urdhrit të ekzekutimit apo refuzimin/kërkesën për plotësim nga gjykata megjithëse ka kaluar kohë e konsiderueshme nga data e kërkesës për disa prej tyre në vlera të mëdha të borxhit doganor të përfshirë në objektin e ekzekutimit të detyrueshëm. Konstatohet se nuk janë dokumentuar hapat procedurialë të ndjekura nga autoriteti doganor dhe nuk janë paraqitur sipas kërkesave të pikës 4 dhe 5 të kapitullit VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* ku citohet *"Dega Doganore është përgjegjëse për dërgimin sipas ligjit të akteve të mësipërme në Gjykatë dhe nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit. Në të gjitha rastet, kërkesa për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit, Urdhri i Ekzekutimit i nxjerrë nga Gjykata si dhe çdo akt tjetër i gjykatës bëhen pjesë e dosjes së debitorit.".*

-Nga auditimi konstatohet se megjithëse ka urdhër ekzekutimi të lëshuar nga Gjykata, nga zyra Juridike nuk janë dërguar pranë zyrës së Përmbarimit Shtetëror/Privat 28 raste me vlerë 185,290 mijë lekë. Këto veprime konstatohet se janë në kundërshtim me Kapitullin IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* pasqyruar sipas tabelës së më poshtë:

**Tabela "Rastet të cilat nuk janë dërguar pranë zyrës së Përmbarimit Shtetëror/Privat"**

| Subjekti | Nuis | Shuma E Borxhit | Vendim | | Urdher Ekzekutimi | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nr | Dt | Nr | Dt |
| C | KC | 979,066 | 95 | 24/10/11 | 2941 | 23/04/2012 |
| A | KT | 80,686 | 11 | 28/01/2013 | 81 | 30/6/2014 |
| I | LT | 227,714 | 25 | 25/03/2013 | 76 | 07/01/2014 |
| V | KD | 58,759 | 40 | 29/04/2013 | 74 | 07/01/2014 |
| E | LH | 1,214,059 | 42 | 29/04/2013 | 79 | 30/6/2014 |
| N | AA | 312,400 | 57 | 13/05/2013 | 73 | 30/6/2014 |
| H | LA | 369,030 | 65 | 07/08/2013 | 82 | 07/01/2014 |
| M | Pezulluar | 4,863,475 | 79 | 26/08/2013 | 78 | 07/01/2014 |
| N | JC | 22,941 | 46 | 02/02/2015 | 216 | 26.04.2016 |
| S | JP | 1,380,056 | 230 | 09/07/2015 | 75 | 13/03/2017 |
| S | JP | 167,879 | 231 | 09/07/2015 | 75 | 13/03/2017 |
| S | JP | 948,970 | 232 | 09/07/2015 | 75 | 13/03/2017 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| M | JC | 52,909 | 276 | 18/12/2015 | 430 | 09/05/2016 |
| B | FA | 121,532 | 38 | 23/02/2016 | 547 | 26/11/2016 |
| T | KP | 25,865,347 | 122 | 20/10/2016 | 90 | 21/03/2017 |
| F | LM | 7,128,902 | 199 | 22/10/2018 | 357 | 30.07.2020 |
| T | GB | 49,978 | 282 | 17/12/2018 | 88 | 20.05.2020 |
| L | ID | 18,774 | 283 | 17/12/2018 | 392/57 | 18.02.2022 |
| P | LE | 49,949 | 289 | 17/12/2018 | 393 | 30.12.2021 |
| A | JD | 35,971,492 | AM 20 | 24/07/2014 | 157 | 21/03/2016 |
| A | JD | 65,343,187 | AM 21 | 24/07/2014 | 157 | 21/03/2016 |
| A | JD | 14,506,638 | AM 22 | 24/07/2014 | 157 | 21/03/2016 |
| V | LC | 2,237,998 | 86 | 04/12/2019 | 722 | 09.11.2020 |
| S | HK | 200,000 | 147 | 28/10/2019 | 363 | 24.07.2020 |
| T | LA | 1,238,259 | 154 | 26/11/2019 | 10 | 23/01/2020 |
| T | LA | 12,869,950 | 52 | 03/06/2021 | 109 | 08.03.2022 |
| T | LA | 6,524,700 | 55 | 03/06/2021 | 106 | 08.03.2022 |
| T | KK | 2,485,715 | 150 | 06.08.2021 | 129 | 12.04.2022 |

Të dhënat: DDF, Punoi: KLSH

-Nga auditimi konstatohen raste për të cilat Dega e Doganës Fier nuk ka dijeni për borxhin se në cilën zyrë përmbarimore është duke u ndjekur detyrimi doganor i papaguar, duke mos pasur informacion dhe duke mos marrë masa për arkëtimin e detyrimeve doganore. Lista e rasteve për të cilat në evidencën e detyrimeve doganore të papaguara nuk ka informacion në lidhje me zyrën përmbarimore që është duke u ndjekur dhe që konfirmohen edhe nga kërkesat për informacion nga KLSH drejtuar Doganës Fier paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela Vendimet që janë dërguar pranë Zyrës Përmbarimore Shtetërore/Privat pa informacion.

| Subjekti | NIPT | Shuma e borxhit | Vendimi | | Zyra e Përmbarimit | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nt | Date | Nr | Date | Emri |
| P | J8Ë | 2,655,720 | 118 | 30/11/11 | 973/prot | po | ---------- |
| K | JË | 112,039 | 4 | 5/2/2016 | | PO | ---------- |
| K | JË | 158,416 | 5 | 5/2/2016 | | PO | ---------- |
| I | LI | 1,789,250 | 184 | 14/12/2017 | 271 | 16.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 473,625 | 1 | 03/01/2018 | 108 | 09.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 2,262,928 | 39 | 05/01/2018 | 103 | 09.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 227,171,169 | 14 | 07/02/2018 | 109 | 09.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 247,564,451 | 15 | 07/02/2018 | 110 | 09.01.2020 | ---------- |
| v | LI | 220,582,619 | 16 | 07/02/2018 | 111 | 09.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 228,185,712 | 17 | 07/02/2018 | 112 | 09.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 236,229,751 | 18 | 07/02/2018 | 113 | 09.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 132,975,225 | 19 | 07/02/2018 | 113 | 09.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 227,256,825 | 20 | 07/02/2018 | 113 | 09.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 200,809,571 | 21 | 07/02/2018 | 113 | 09.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 66,500,594 | 22 | 07/02/2018 | 113 | 09.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 225,381,343 | 23 | 07/02/2018 | 113 | 09.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 353,757,480 | 24 | 07/02/2018 | 114 | 09.01.2020 | ---------- |
| T | LN | 19,931,462 | 40 | 19/03/2018 | 134 | 09.01.2020 | ---------- |
| I | LI | 206,832,172 | 45/1 | 04/05/2018 | 132 | 09.01.2020 | ---------- |
| P | LK | 92,567 | 32 | 15/03/2019 | 4545 | 08.10.2020 | ---------- |
| V | LC | 50,000 | 47 | 18/03/2019 | 4548 | 08.10.2020 | ---------- |
| P | LK | 50,000 | 128 | 31/07/2019 | 4544 | 08.10.2020 | ---------- |
| P | LK | 578,436 | 142 | 1/10/2019 | 4547 | 08.10.2020 | ---------- |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Fier*

Këto raste si dhe të tjera janë konfirmuar edhe në shkresën nr. 2804 datë 12.08.2024 me lëndë "Relacioni nr.5" drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave duke cituar *"....ekzistojnë të hedhur Urdhrat e Ekzekutimit lëshuar nga Gjykatat, por nuk janë të hedhura në cilën zyrë përmbarimore janë adresuar për ekzekutimin e detyrueshëm. Gjithashtu në dosjet personale të këtyre vendimmarrjeve nuk gjenden as origjinal dhe as fotokopje të këtyre Urdhrave Ekzekutiv.*

*...Gjithashtu në tabelën e borxhit të Degës Doganore Fier janë të hedhura ndër vite kërkesat drejtuar Gjykatës Administrative për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit. Ende sot Degës Doganore Fier nuk i kanë ardhur Urdhrat e Ekzekutimit të kërkuar apo refuzim i kërkesave në numër total 23 kërkesa. Megjithëse Dega Doganore Fier ka dërguar me shkresën .2905/1 datë 18.08.2023 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, kjo gjykatë e ka lënë pa përgjigje kërkesën tonë."*

- Nga auditimi rezulton se vetë Dega Doganore Fier me qëllim uljen e borxhit doganor, për asnjë rast nuk ka ndjekur masat shtrënguese në vijim, si bllokim të llogarive bankare, vendosja e mase sigurimit ne ZRPP, vendosja e mase sigurimit në DPSHTRR dhe bllokimin i veprimeve në QKB, për rastet e pajisura me urdhër ekzekutimi, me përjashtim të një rasti në të cilën janë marrë pjesërisht masa, veprime të cilat janë në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.
- Nga auditimi rezulton se nga ana e zyrës Juridike nuk ka informacion shkresor në lidhje me masat e marra nga zyra e Përmbarimit Shtetëror/Privat për rikuperimin e borxhit doganor gjatë vitit 2024.

**B. Auditimi i dosjeve të përzgjedhura për vitin 2024.**

**1. Subjekti D me NUIS LI.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.89 datë 25.10.2024 të Degës Doganore Fier në shumën 1,627,193 lekë dhe gjobë në shumën 3,254,386 lekë. Në dosje dokumentet që ndodhen janë, Program Pune nr.3035 prot datë 06.09.2024, shkresa nr.3035/1 prot., informacion mbi kontrollin e kryer, shkresa nr.3193 prot datë 19.09.2024 marrja e masave dhe fillimi procedurës administrative, shkresa nr.3292 prot datë 30.09.2024 njoftim i proces-verbalit për verifikimin e kundërvajtës administrative, fillimin e procedurave administrative, Autorizimi për përdorimin e Regjimit të Përpunimit Aktiv nr.9103/1 datë 23.03.2022, Vendimi nr.89 protokolluar me nr.3666 prot datë 25.10.2024 për shpalljen debitor të subjektit D. B. me Nuis LI. Shkresa nr.3666/1 prot datë 25.10.2024 mbi njoftimin e vendimit të shpallur për subjektin, vendimi nr.3666/2 prot datë 23.12.2024 për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore për subjektin D me Nuis LI, shkresa nr.3666/3 prot datë 23.12.2024 mbi njoftimin e vendimit për rikuperimin me forcë të detyrime doganore, kërkesa për Lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit nr.206 prot datë 14.01.2025 drejtuar Gjykatës Adminsitrative të Shkallës së Parë Lushnje.

**Konkluzioni:**

Nga auditimi konstatohet se në dosjen e subjektit sipas Vendimit nr.89 datë 25.10.2024 nuk ka gjurmë të mos marrjes dijeni për njoftimin e vendimit nga subjekti sipas shënimeve mbi kthimin apo refuzimin e marrjes dijeni. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15 ku citohet *"Njoftim Vendimi hartohet në tre kopje, të cilat pasi është firmosur ose pas ardhjes së letrës rekomande, administrohen si më poshtë:*
*-një kopje e kundër firmosur/zarfin me Njoftim Vendimi e mban debitori*
*-dy kopjet e tjera të kundërfimosura /ose kopje të letrës rekomande i mban përfaqësuesi i administratës doganore, nga të cilat:*
*-një kopje i bashkëlidhet dosjes së debitorit*
*-një kopje (e treta) do të shërbejë për t'u dërguar në gjykatë për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit"*
Gjithashtu konstatohet se njoftimi i vendimit është kryer në 25.10.2024, ndërkohë që VRFB është nxjerrë me datë 20.12.2024 jashtë afatit ligjore të përcaktuar pas njoftimit të vendimit parashikuar nga neni 282 pika 1 i Kodit Doganor, duke kaluar me 24 ditë afatin e përcaktuar.
Gjithashtu nga auditimi konstatohet të mos jenë respektuar përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.15 Kapitullin VI Njoftimit i Vendimit, VII Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor dhe VIII Nxjerrja e Urdhërit të Ekzekutimit.

**Kapitullin VI Njoftimi i Vendimit,** në pikën 4, 6 dhe 7 ka përcaktuar se:
**Pika 4.** *"Një kopje e Njoftim vendimit së bashku me shpalljen debitor i vihet në dispozicion Sektorit të Mbikëqyrjes Doganore, për të vijuar me amendimin e deklaratës doganore në rastet kur gjendja në llogarinë parapagesë mbulon detyrimin doganor"*
**Pika 6.** *"Nëse: a) subjekti debitor ka gjendje kreditore në llogarinë parapagesë, e cila mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendim/et për shpalljen debitor, specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore apo Përgjegjësi i Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore (c1): - prek llogarinë, duke amenduar deklaratën/at respektive, - njofton me email Subjektin debitor apo agjentin e tij dhe specialistin * Juristit/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në degën doganore për veprimin e kryer b) gjendja e llogarisë nuk mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendimi për shpalljen debitor lajmërohet elektronikisht subjekti debitor/deklaruesi nga specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes doganore apo përgjegjësi i Zyrës së mbikëqyrjes doganore (C1), për të bërë pagesat përkatëse dhe shtuar në llogarinë parapagesë* dhe
**VII Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor** në pikën 2.1 dhe 2.6 të kapitullit VII përcaktohet se: *"Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 282 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës.* Pika 2.6 përcakton se Dega Doganore dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të ardhurave, pranë DPD menjëherë të gjithë vendimet për zbatimin e masave garantuese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, qoftë në import qoftë në export, veprim i cili nuk është kryer nga Dega Doganore Fier.
Gjithashtu konstatohet se VRFB është njoftuar me shkresën nr.3666/2 prot datë 23.12.2024, ndërkohë që kërkesa për lëshimin e udhërit të ekzekutimit është kryer në 14.01.2025 pra 22 ditë më vonë ndërkohë që udhëzimi nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"* në pikën 1 të kapitullit **VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit"** citohet se *"Menjëherë mbas marrjes dijeni të vendimit për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, pra pas kthimit në titull ekzekutiv, specialisti – jurist/specialist borxhi i sektorit/zyrës së administratës dhe shërbimit në degën doganore dërgon në gjykatë kërkesën për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit".*

**2. Subjekti "K." shpk me NIPT KU.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr. 106 datë 10.12.2024 të Degës Doganore Fier në shumën 752,936 lekë dhe gjobë në shumën 752,936 lekë në vijim të procesverbalit nr. 3869 datë 11.11.2024 pas konstatimit të mos përputhjes së kodit tarifor për deklaratën R1779 datë 08.03.2022. Ky vendim është njoftuar me shkresën nr. 4030/2 datë 10.12.2024, në të njëjtën ditë me daljen e vendimit. Subjekti ka marrë dijeni mbi vendimin në datë 12.12.2024 sipas LM. VRFB është marrë me nr.336 datë 21.01.2025. njoftuar me shkresën nr. 336/1 datë 21.01.2025.

**Konkluzioni:**

Nga auditimi konstatohet se subjekti ka marrë dijeni mbi vendimin në datë 12.12.2024 sipas LM, ndërkohë VRFB është marrë me nr.336 datë 21.01.2025. njoftuar me shkresën nr. 336/1 datë 21.01.2025, në tejkalim të afatit 10 ditor nga marrja dijeni mbi vendimin, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.1 dhe 2.6 të kapitullit VII ku citohet *"Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 282 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës.* Pika 2.6 përcakton se Dega Doganore dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të ardhurave, pranë DPD menjëherë të gjithë vendimet për zbatimin e masave garantuese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, qoftë në import qoftë në export, veprim i cili nuk është kryer nga Dega Doganore Fier.

-Sipas vendimit subjektit i ka lindur detyrim në shumën 752,936 lekë nga kontrolli aposterior për klasifikim tarifor të gabuar, konkretisht të deklaratës R1779 datë 08.03.2022. Nga auditimi konstatohet se për këtë detyrim nuk janë llogaritur kamatëvonesa, ndërkohë që kamatëvonesat duhet të ishin llogaritur që në momentin e lindjes së detyrimit fillestar sipas përcaktimeve të shkronjës b), pika 4.2, kapitulli V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" *"*ii) *Afati kur fillon zbatimi i kamatëvonesës"* në të cilën citohet që *"...Kur një borxh lind sipas nenit 74 ose 77 të Kodit Doganor apo kur njoftimi i borxhit doganor vjen në vijim të një kontrolli, pas çlirimit, norma e kamatvonesave zbatohet mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit duke filluar nga data në të cilën lind borxhi doganor deri në datën e njoftimit të tij.....* dhe *iv)Për rastet e lindjes së detyrimit së borxhit të akcizës për operacionet e parregullta momenti i zbatimit të kamatëvonesës do të jetë momenti në të cilin konstatohet lindja e detyrimit të akcizës që i korrespondon momentit kur është vërtetuar se produktet e akcizës janë prodhuar, importuar, blerë, transportuar, përdorur ose konsumuar në mënyrë të parregullt ose janë hedhur në konsum në mënyrë të parregullt si dhe janë dërguar ose përdorur nga përdorues i përjashtuar për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në autorizim."*[7]. Për rrjedhojë kamatëvonesa nuk është llogaritur dhe pasqyruar saktë në evidencën e borxhit doganor, në kundërshtim me udhëzimin nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës".* Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**3. Subjekti R me NUIS LC.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.60 datë 16.08.2024 të Degës Doganore Fier në shumën 1,106,124 lekë dhe gjobë në shumën 50,000 lekë. Në dosje dokumentet që ndodhen janë: Shkresa njoftim vendimi nr.2830/1 prot., datë 16.08.2024. Vendimi nr.60 për operatorin e sipërcituar, dërguar me shkresën nr.2830 prot., datë 16.08.2024. Shkresa nr.2830/2 prot., datë 22.08.2024 kërkesë për shpallje publike të aktit administrative drejtuar Bashkisë Fier. Shkresa nr.4316/1 prot., datë 19.12.2024 njoftim vendimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore/zbatimi masave shtrënguese. Shkresa nr.4316 prot., datë 19.12.2024

[7] Efekti i kamatvonesave te munguara ne llogaritje sipas KLSH eshte jo material ne shumën 79,215 lekë

vendimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore që janë marrë ndaj subjektit debitor "R" me Nuis LC

**Konkluzioni:**

Nga auditimi konstatohet se në dosjen e subjektit sipas Vendimit nr.60 datë 16.08.2024 nuk ka gjurmë të mos marrjes dijeni për njoftimin e vendimit nga subjekti sipas shënimeve mbi kthimin apo refuzimin e marrjes dijeni. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15.

Gjithashtu konstatohet se njoftimi i vendimit është kryer në 16.08.2024, ndërkohë që kërkesa për shpallje publike është kryer me shkresën nr.2830/2 prot., datë 22.08.2024, me një diferencë prej 8 ditësh, që nuk justifikojnë periudhën e gjatë të mos marrjes së konfirmimit për njoftim. Gjithashtu, sipas përmbajtjes së VRFB, citohet "shpallja e akteve u kryer në stendën publike të Bashkisë Fier në datë 27.08.2024", ndërkohë që VRFB është kryer 110 ditë pas kësaj shpallje, duke qenë në kundërshtim me pikën 3 të udhëzimit nr.15 ku citohet *"Në rastet e mos marrjes së konfirmimit për njoftim procedohet me format e tjera të njoftimit si më poshtë: .. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore subjekti konsiderohet i njoftuar".*

Nga auditimi konstatohet të mos jenë respektuar përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.15 Kapitullin VI Njoftimit i Vendimit, VII Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor dhe VIII Nxjerrja e Urdhërit të Ekzekutimit.

**Kapitullin VI Njoftimit i Vendimit,** në pikën 4, 6 dhe 7 ka përcaktuar se:

**Pika 4.** *"Një kopje e Njoftim vendimit së bashku me shpalljen debitor i vihet në dispozicion Sektorit të Mbikëqyrjes Doganore, për të vijuar me amendimin e deklaratës doganore në rastet kur gjendja në llogarinë parapaguese mbulon detyrimin doganor"*

**Pika 6.** "Nëse: a) subjekti debitor ka gjendje kreditore në llogarinë parapaguese, e cila mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendim/et për shpalljen debitor, specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore apo Përgjegjësi i Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore (c1): - prek llogarinë, duke amenduar deklaratën/at respektive, - njofton me email Subjektin debitor apo agjentin e tij dhe specialistin * Jurisit/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në degën doganore për veprimin e kryer b) gjendja e llogarisë nuk mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendimi për shpalljen debitor lajmërohet elektronikisht subjekti debitor/deklaruesi nga specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes doganore apo përgjegjësi i Zyrës së mbikëqyrjes doganore (C1), për të bërë pagesat përkatëse dhe shtuar në llogarinë parapaguese dhe

**Kapitullit VII Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor** në pikën 2.1 dhe 2.6 të kapitullit VII përcaktohet se: *"Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 282 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës.* Pika 2.6 përcakton se Dega Doganore dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të ardhurave, pranë DPD menjëherë të gjithë vendimet për zbatimin e masave garantuese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, qoftë në import qoftë në export, veprim i cili nuk është kryer nga Dega Doganore Fier.

Gjithashtu, konstatohet se VRFB është njoftuar me shkresën nr.4316 prot., datë 19.12.2024, ndërkohë që për këtë rast nuk kemi kërkesë për lëshimin e udhërit të ekzekutimit drejtuar gjykatës, veprim i cili është në kundërshtim me udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës",* **Kapitullin VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit"** pikën 1 ku citohet se: *"Menjëherë mbas marrjes dijeni të vendimit për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, pra pas kthimit në titull ekzekutiv, specialisti – jurist/specialist borxhi i sektorit/zyrës së administratës dhe shërbimit në degën doganore dërgon në gjykatë kërkesën për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit".*
Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**4. Subjekti K me NIPT LA.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.40 datë 08.07.2024 të Degës Doganore Fier në shumën 782,128.9 lekë dhe gjobë në shumën 50,000 lekë. Në dosje ndodhet Njoftim Vendimi subjektit me shkresën nr.1288/1 prot., datë 08.07.2024, në të njëjtën ditë me Vendimin. Ky vendim është marrë në vijim të shkresës nr.1517 prot., datë 08.05.2024 për marrje masash mbi zbatimin e udhëzimit nr.4 datë 28.03.2019 "Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Pasiv", procesverbal 0022788 nr.1597/2 prot., datë 31.05.2024 dhe shkresën njoftim procesverbali nr.1597/3 prot., datë 03.06.2024. Me shkresë nr.2459 prot., datë 24.07.2024 nga Dega Doganës Fier është bërë ri-kërkesë për shpallje publike të aktit administrativ drejtuar Bashkisë Fier. Në vijim të kërkesës së dytë për shpallje nga ana e Degës Doganore Fier është marrë vendimi nr.3522 prot., datë 30.09.2024 për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore.
Me shkresë nr.4305 prot., datë 18.12.2024, Dega Doganore Fier i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje për lëshimin e urdhrit ekzekutimit.

**Konkluzioni**
Nga auditimi konstatohet se në dosjen e subjektit sipas vendimit nr.40 datë 08.07.2024 nuk ka gjurmë të mos marrjes dijeni për njoftimin e vendimit nga subjekti sipas shënimeve mbi kthimin apo refuzimin e marrjes dijeni. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15.
Nga auditimi është konstatuar se njoftimi i vendimit është kryer në 08.07.2024, ndërkohë që kërkesa për shpallje publike është kryer me shkresën nr.2459 prot., datë 24.07.2024, me një diferencë prej 16 ditësh, që nuk justifikojnë periudhën e gjatë të mos marrjes së konfirmimit për njoftim.
Gjithashtu nga auditimi konstatohet të mos jenë respektuar përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.15 Kapitullin VI "Njoftimit i Vendimit", pasi në këtë rast nuk kemi korrespondencë siç parashikohet në **Kapitullin VI Njoftimit i Vendimit,** në pikën 4, 6 dhe 7 ku është e përcaktuar se:
**Pika 4.** *"Një kopje e Njoftim vendimit së bashku me shpalljen debitor i vihet në dispozicion Sektorit të Mbikëqyrjes Doganore, për të vijuar me amendimin e deklaratës doganore në rastet kur gjendja në llogarinë parapaguese mbulon detyrimin doganor".*
**Pika 6.** "Nëse: a) subjekti debitor ka gjendje kreditore në llogarinë parapaguese, e cila mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendim/et për shpalljen debitor, specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore apo Përgjegjësi i Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore (c1): - prek llogarinë,

duke amenduar deklaratën/at respektive, - njofton me email Subjektin debitor apo agjentin e tij dhe specialistin Jurisit/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në degën doganore për veprimin e kryer b) gjendja e llogarisë nuk mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendimi për shpalljen debitor lajmërohet elektronikisht subjekti debitor/deklaruesi nga specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes doganore apo përgjegjësi i Zyrës së mbikëqyrjes doganore (C1), për të bërë pagesat përkatëse dhe shtuar në llogarinë parapaguese dhe

-Nga auditimi konstatohet se "shpallja e akteve është kryer në stendën publike të Bashkisë Fier në datë 29.07.2024", ndërkohë që VRFB është kryer 60 ditë pas kësaj shpallje, veprim i cili është në kundërshtim me pikën 3 të udhëzimit nr.15 ku citohet *"Në rastet e mos marrjes së konfirmimit për njoftim procedohet me format e tjera të njoftimit si më poshtë: Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore subjekti konsiderohet i njoftuar".* Gjithashtu këto veprime janë në kundërshtim edhe me kapitullin **VII Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor** pikën 2.1 dhe 2.6. Pika 2.6 përcakton se Dega Doganore dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të ardhurave, pranë DPD menjëherë të gjithë vendimet për zbatimin e masave garantuese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, qoftë në import qoftë në export, veprim i cili nuk është kryer nga Dega Doganore Fier.

-Në këtë rast VRFB është njoftuar me shkresën nr. 3522/1 datë 30.09.2024, ndërkohë që kërkesa për lëshimin e udhërit të ekzekutimit është kryer në 18.12.2024 pra 69 ditë jashtë afatit ligjor të përcaktuar, veprimi cili është në kundërshtim me udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"* në pikën 1 të kapitullit **VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit".**

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**5. Subjekti K me NIPT LA.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.41 port., datë 04.07.2024 të Degës Doganore Fier në shumën 743,770 lekë dhe gjobë në shumën 50,000 lekë. Ky vendim është njoftuar me shkresën nr. 2229/1 prot., datë 04.07.2024, në të njëjtën ditë me daljen e vendimit, por nuk disponohet në dosje kopja e lajmërimit postar. Gjithashtu në dosje ndodhen kërkesë për shpallje publike të aktit administrative drejtuar Bashkisë Fier me nr. 2320 datë 11.07.2024. Shpallja e akteve është kryer në stendën publike të Bashkisë Fier në datë 15.07.2024", ndërkohë që VRFB është marrë me datë 15.09.2024 njoftuar me shkresën me nr.3156 prot., datë 15.09.2024.

**Konkluzioni:**

Nga auditimi konstatohet se në dosjen e subjektit nuk ka gjurmë të mos marrjes dijeni për njoftimin e vendimit nga subjekti sipas shënimeve mbi kthimin apo refuzimin e marrjes dijeni. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet të mos jenë respektuar përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.15 Kapitullin VI "Njoftimit i Vendimit", pasi në këtë rast nuk kemi korrespondencë siç parashikohet në **Kapitullin VI Njoftimit i Vendimit,** në pikën 4, 6 dhe 7 ku është e përcaktuar se:

**Pika 4.** *"Një kopje e Njoftim vendimit së bashku me shpalljen debitor i vihet në dispozicion Sektorit të Mbikëqyrjes Doganore, për të vijuar me amendimin e deklaratës doganore në rastet kur gjendja në llogarinë parapaguese mbulon detyrimin doganor".*

**Pika 6.** "Nëse: a) subjekti debitor ka gjendje kreditore në llogarinë parapaguese, e cila mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendim/et për shpalljen debitor, specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore apo Përgjegjësi i Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore (c1): - prek llogarinë, duke amenduar deklaratën/at respektive, - njofton me email Subjektin debitor apo agjentin e tij dhe specialistin Jurisit/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në degën doganore për veprimin e kryer b) gjendja e llogarisë nuk mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendimi për shpalljen debitor lajmërohet elektronikisht subjekti debitor/deklaruesi nga specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes doganore apo përgjegjësi i Zyrës së mbikëqyrjes doganore (C1), për të bërë pagesat përkatëse dhe shtuar në llogarinë parapaguese dhe

-Nga auditimi konstatohet se "shpallja e akteve është kryer në stendën publike të Bashkisë Fier në datë 15.07.2024", ndërkohë që VRFB është marrë me datë 15.09.2024 njoftuar me shkresën me nr.3156 prot., datë 15.09.2024 kryer 60 ditë pas kësaj shpallje, veprim i cili është në kundërshtim me pikën 3 të udhëzimit nr.15 ku citohet *"Në rastet e mos marrjes së konfirmimit për njoftim procedohet me format e tjera të njoftimit si më poshtë: Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore subjekti konsiderohet i njoftuar".* Gjithashtu këto veprime janë në kundërshtim edhe me kapitullin **VII Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor** pikën 2.1 dhe 2.6.. Pika 2.6 përcakton se Dega Doganore dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të ardhurave, pranë DPD menjëherë të gjithë vendimet për zbatimin e masave garantuese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, qoftë në import qoftë në export, veprim i cili nuk është kryer nga Dega Doganore Fier.

Njoftimi i VRFB është kryer me shkresën nr.3156/1 datë 15.09.2024, në të njëjtën datë me VRFB dhe në vijim me shkresë nr. 3156/2 datë 20.09.2024 është kërkuar drejt Bashkisë Fier shpallja publike e akti administrativ me argumentin se lajmërimet nëpërmjet shërbimit postar nuk kanë rezultuar të suksesshme, përsëritur me shkresë nr.3382 prot., datë 07.10.2024.

Në këtë rast VRFB është njoftuar me shkresën nr.3522/1 prot., datë 30.09.2024, ndërkohë që kërkesa për lëshimin e udhërit të ekzekutimit drejtuar gjykatës është kryer në datë 19.12.2024, 59 ditë jashtë afatit ligjor të përcaktuar, veprimi cili është në kundërshtim me udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"* në pikën 1 të kapitullit **VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit".** Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**6. Subjekti N me NIPT LA.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr. 78 datë 17.09.2024 të Degës Doganore Fier në shumën 566,626 lekë dhe gjobë në shumën 50,000 lekë. Ky vendim është njoftuar me shkresën nr.2271/4 prot., datë 17.09.2024, në të njëjtën ditë me daljen e vendimit, por nuk disponohet në dosje kopja e lajmërimit postar. Vendimi është marrë në vijim të shkresës nr.1470 prot., datë 26.04.2024 me lëndë marrje masash, shkresës nr. 1470/1 prot., datë 10.05.2024 "Kërkesë për shpallje publike proces verbali drejtuar Bashkisë Roskovec", shkresës nr.1470/2 prot., datë 27.06.2024 "Kërkesë për shpallje publike proces verbali drejtuar Bashkisë Roskovec", konfirmim për afishim shpallje nga Bashkia Roskovec me nr.3480/1 prot., datë 21.05.2024, procesverbal nr. 0022796 me nr. 1470/4 datë 08.07.2024 dhe njoftim procesverbali nr.2271 prot., datë 09.07.2024. Konstatohet se procesverbali pjesë e dosjes është pas shkresave për kërkesa për shpallje publike, pasi nga Dega Doganore Fier është ndryshuar procesverbali fillestar i shkeljes doganore duke korrigjuar vlerën e penalitetit.

Me shkresë nr.4326 prot., datë 19.12.2024 Dega e Doganës Fier ka marrë Vendim për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore. Sipas përmbajtjes së VRFB, citohet *"shpallja e akteve u kryer në stendën publike të Bashkisë Fier në datë 24.09.2024"* (duke cituar kërkesën nr.2272/4 prot., datë 20.09.2024 drejtuar Bashkisë Fier e cila nuk është pjesë e dosjes së detyrimit doganor), ndërkohë që *VRFB* është nxjerrë në 19.12.2024. Njoftimi i VFRB është kryer me shkresë nr. 4326/1 prot., datë 19.12.2024, në të njëjtën ditë me daljen e vendimit. Për këtë njoftim, është bërë kërkesë me nr.4326/2 prot., datë 24.12.2024 drejtuar Bashkisë Fier për shpallje publike të aktit administrativ duke cituar faktin se njoftimet postare kanë rezultuar të pasuksesshme.

**Konkluzioni:**

Nga auditimi konstatohet se në dosjen e subjektit nuk ka gjurmë të mos marrjes dijeni për njoftimin e vendimit nga subjekti sipas shënimeve mbi kthimin apo refuzimin e marrjes dijeni. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet të mos jenë respektuar përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.15 Kapitullin VI "Njoftimit i Vendimit", pasi në këtë rast nuk kemi korrespondencë siç parashikohet në **Kapitullin VI Njoftimit i Vendimit,** në pikën 4, 6 dhe 7 ku është e përcaktuar se:

**Pika 4.** *"Një kopje e Njoftim vendimit së bashku me shpalljen debitor i vihet në dispozicion Sektorit të Mbikëqyrjes Doganore, për të vijuar me amendimin e deklaratës doganore në rastet kur gjendja në llogarinë parapaguese mbulon detyrimin doganor"*.

**Pika 6.** "Nëse: a) subjekti debitor ka gjendje kreditore në llogarinë parapaguese, e cila mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendim/et për shpalljen debitor, specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore apo Përgjegjësi i Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore (c1): - prek llogarinë, duke amenduar deklaratën/at respektive, - njofton me email Subjektin debitor apo agjentin e tij dhe specialistin Jurisit/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në degën doganore për veprimin e kryer b) gjendja e llogarisë nuk mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendimi për shpalljen debitor lajmërohet elektronikisht subjekti debitor/deklaruesi nga specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes doganore apo përgjegjësi i Zyrës së mbikëqyrjes doganore (C1), për të bërë pagesat përkatëse dhe shtuar në llogarinë parapaguese..

-Nga auditimi konstatohet se "shpallja e akteve është kryer në stendën publike të Bashkisë Fier në datë 24.09.2024", ndërkohë që VRFB është marrë me datë 19.12.2024 njoftuar me shkresën me nr.4326/1 prot., datë 19.12.2024 kryer në të njëjtën ditë me daljen e vendimit. Për këtë njoftim, është bërë kërkesa me nr.4326/2 prot., datë 24.12.2024 drejtuar Bashkisë Fier për shpallje publike të aktit administrativ duke cituar faktin se njoftimet postare kanë rezultuar të pasuksesshme. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 3 të udhëzimit nr.15 ku citohet *"Në rastet e mos marrjes së konfirmimit për njoftim procedohet me format e tjera të njoftimit si më poshtë: Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore subjekti konsiderohet i njoftuar".* Gjithashtu këto veprime janë në kundërshtim edhe me kapitullin **VII Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor** pikën 2.1 dhe 2.6 ku përcaktohen se:*"Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 282 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës*. Pika 2.6 përcakton se Dega

Doganore dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të ardhurave, pranë DPD menjëherë të gjithë vendimet për zbatimin e masave garantuese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, qoftë në import qoftë në export, veprim i cili nuk është kryer nga Dega Doganore Fier.
Nga auditimi në këtë rast konstatohet se pas shpalljes publike të kërkuar se nga ana e Degës Doganore Fier nuk është proceduar me depozitimin në gjykatë të kërkesës për lëshimin e urdhërit, veprimi i cili është në kundërshtim me udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"* në pikën 1 të kapitullit **VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit"**.
Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**7. Subjekti E S me NUIS KL.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.105 datë 05.12.2024 të Degës Doganore Fier në shumën 246,223 lekë dhe gjobë në shumën 246,223 lekë. Në dosje dokumentat që ndodhen janë: shkresa nr.2625 prot datë 06.08.2024 mbi njoftimin e raportit përfundimtar të KLSH-së. Shkresa nr.2625/4 prot datë 14.11.2024 njoftim i proces-verbalit të kundravatjes administrative. Vendimi nr.105 datë 05.12.2024 për shpalljen debitor në vlerën 492,446 lekë, si dhe shkresa nr.4165/1 prot datë 05.12.2024 njoftim vendimi për shpalljen debitor të subjektit E Sj me NUIS KL. Vendimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore nr.337 prot datë 21.01.2025. **Kërkesa për bllokimin e veprimeve në sistem nr.366 prot datë 24.01.2025**.

**Konkluzioni:**
Nga auditimi konstatohet se në dosjen e subjektit sipas vendimit nr.105 datë 05.12.2024 nuk ka gjurmë të mos marrjes dijeni për njoftimin e vendimit nga subjekti sipas shënimeve mbi kthimin apo refuzimin e marrjes dijeni. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15. Gjithashtu nga auditimi konstatohet të mos jenë respektuar përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.15 Kapitullin VI "Njoftimit i Vendimit", pasi në këtë rast nuk kemi korrespondencë siç parashikohet në **Kapitullin VI Njoftimit i Vendimit,** në pikën 4, 6 dhe 7 ku është e përcaktuar se:
**Pika 4.** *"Një kopje e Njoftim vendimit së bashku me shpalljen debitor i vihet në dispozicion Sektorit të Mbikëqyrjes Doganore, për të vijuar me amendimin e deklaratës doganore në rastet kur gjendja në llogarinë parapaguese mbulon detyrimin doganor"*.
**Pika 6.** "Nëse: a) subjekti debitor ka gjendje kreditore në llogarinë parapaguese, e cila mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendim/et për shpalljen debitor, specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore apo Përgjegjësi i Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore (c1): - prek llogarinë, duke amenduar deklaratën/at respektive, - njofton me email Subjektin debitor apo agjentin e tij dhe specialistin Jurisit/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në degën doganore për veprimin e kryer b) gjendja e llogarisë nuk mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendimi për shpalljen debitor lajmërohet elektronikisht subjekti debitor/deklaruesi nga specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes doganore apo përgjegjësi i Zyrës së mbikëqyrjes doganore (C1), për të bërë pagesat përkatëse dhe shtuar në llogarinë parapaguese..
-Nga auditimi konstatohet se me shkresë nr.337 prot datë 21.01.2025 Dega e Doganës Fier ka marrë Vendim për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore. Sipas përmbajtjes së VRFB, citohet *"provohet se subjekti ka marrë dijeni për vendimin me LM nr.4165 kod bar RR310726113*

*AA datë 11.12.2024*), ndërkohë që *VRFB* është nxjerrë në 21.01.2025 me diferencë kohore prej 31 ditësh. Këto veprime janë në kundërshtim me kapitullin **VII Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor**, pikën 2.1 dhe 2.6 të kapitullit VII ku citohet *"Kur debitori nuk ekzekuton vullentarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 282 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës.* Nga auditimi në këtë rast konstatohet se pas shpalljes publike të kërkuar, nga ana e Degës Doganore Fier nuk është proceduar me depozitimin në gjykatë të kërkesës për lëshimin e urdhërit, veprimi i cili është në kundërshtim me udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"* në pikën 1 të kapitullit **VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit".**

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**8. Subjekti G me Nuis MM.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.74 datë 06.09.2024 të Degës Doganore Fier në shumën 263,296 lekë dhe gjobë në shumën 50,000 lekë. Në dosje dokumentat që ndodhen janë: njoftim Vendimi subjektit me shkresën nr. 2351/5 prot datë 06.09.2024, në të njëjtën ditë me shkresën nr. 2351/4 prot datë 06.09.2024 është dërguar edhe Vendimin i sipërcituar. Shkresa nr.3151/6 prot., datë 19.09.2024 kërkesë për shpallje publike të aktit administrative drejtuar Bashkisë Fier. Shkresa nr.2351/7 prot., datë 20.12.2024 Vendimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore/zbatimi masave shtrënguese. Shkresa nr.2351/8 prot., datë 20.12.2024 njoftim vendimi për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore që janë marrë ndaj subjektit debitor "G" me Nuis MM. Shkresa nr.4411 prot datë 30.12.2024 kërkesë për shpallje publike të aktit administrative.

**Konkluzioni:**

Nga auditimi konstatohet se në dosjen e subjektit sipas vendimit nr.74 datë 06.09.2024 nuk ka gjurmë të mos marrjes dijeni për njoftimin e vendimit nga subjekti sipas shënimeve mbi kthimin apo refuzimin e marrjes dijeni. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet të mos jenë respektuar përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.15 Kapitullin VI "Njoftimit i Vendimit", pasi në këtë rast nuk kemi korrespondencë siç parashikohet në **Kapitullin VI Njoftimit i Vendimit,** në pikën 4, 6 dhe 7 ku është e përcaktuar se:

**Pika 4.** *"Një kopje e Njoftim vendimit së bashku me shpalljen debitor i vihet në dispozicion Sektorit të Mbikëqyrjes Doganore, për të vijuar me amendimin e deklaratës doganore në rastet kur gjendja në llogarinë parapaguese mbulon detyrimin doganor"*.

**Pika 6.** "Nëse: a) subjekti debitor ka gjendje kreditore në llogarinë parapaguese, e cila mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendim/et për shpalljen debitor, specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore apo Përgjegjësi i Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore (c1): - prek llogarinë, duke amenduar deklaratën/at respektive, - njofton me email Subjektin debitor apo agjentin e tij dhe specialistin Jurisit/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në

degën doganore për veprimin e kryer b) gjendja e llogarisë nuk mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendimi për shpalljen debitor lajmërohet elektronikisht subjekti debitor/deklaruesi nga specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes doganore apo përgjegjësi i Zyrës së mbikëqyrjes doganore (C1), për të bërë pagesat përkatëse dhe shtuar në llogarinë parapaguese..
-Nga auditimi është konstatuar se njoftimi i vendimit është kryer me shpallje publike, me shkresën nr.3151/6 datë 19.09.2024, pasi nga verifikimi i dosjes rezulton se subjekti nuk është njoftuar nga dega e Doganës Fier me shërbimin postar për vendimmarrjen e kryer. Gjithashtu, sipas përmbajtjes së VRFB, citohet "shpallja e akteve u kryer në stendën publike të Bashkisë Fier në datë 23.09.2024", ndërkohë që VRFB është kryer 81 ditë pas kësaj shpallje, duke qenë në kundërshtim me pikën 3 të udhëzimit nr.15 ku citohet *"Në rastet e mos marrjes së konfirmimit për njoftim procedohet me format e tjera të njoftimit si më poshtë:* ***..... Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore subjekti konsiderohet i njoftuar"***. Në kundërshtim edhe me kapitullin **VII Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor** pikën 2.1 dhe 2.6. Pika 2.6 përcakton se Dega Doganore dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të ardhurave, pranë DPD menjëherë të gjithë vendimet për zbatimin e masave garantuese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, qoftë në import qoftë në export, veprim i cili nuk është kryer nga Dega Doganore Fier.
Nga auditimi në këtë rast konstatohet se pas shpalljes publike të kërkuar se nga ana e Degës Doganore Fier nuk është proceduar me depozitimin në gjykatë të kërkesës për lëshimin e urdhërit, veprimi cili është në kundërshtim me udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"* në pikën 1 të kapitullit **VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit".**
Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**9. Subjekti T me NUIS LK.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.94 datë 18.11.2024 të Degës Doganore Fier në shumën 296,629 lekë dhe gjobë në shumën 0 lekë. Në dosje dokumentat që ndodhen janë: njoftim vendimi subjekteve me shkresën nr.2549/5 prot., datë 18.11.2024. Shkresa nr.2549/4 prot., datë 18.11.2024 vendimi nr.94 për operatorin e sipërcituar. Shkresa nr.2549/3 prot., datë 12.11.2024 me lëndë informacion për vendimmarrjen. Shkresa nr.2549 prot., datë 01.08.2024 njoftim akt vlerësimi i Raportit përfundimtar të KLSH-së. Shkresa nr.2549/1 prot., datë 02.09.2024 kërkesë për shpallje publike të aktit administrative drejtuar Bashkisë Lushnje. Shkresa nr.2549/6 prot., datë 10.12.2024 kërkesë për shpallje publike të aktit administrative drejtuar Bashkisë Lushnje. Shkresa nr.10116 prot., datë 27.12.2024 Bashkisë Lushnje, kthim përgjigje shkresës nr.2549/6 prot datë 10.12.2024.

Nga auditimi konstatohet se në dosjen e subjektit sipas vendimit nr.94 datë 18.11.2024 nuk ka gjurmë të mos marrjes dijeni për njoftimin e vendimit nga subjekti sipas shënimeve mbi kthimin apo refuzimin e marrjes dijeni. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15.
Gjithashtu nga auditimi konstatohet të mos jenë respektuar përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.15 Kapitullin VI "Njoftimit i Vendimit", pasi në këtë rast nuk kemi korespondecë siç parashikohet në **Kapitullin VI Njoftimit i Vendimit,** në pikën 4, 6 dhe 7 ku është e përcaktuar se:

**Pika 4.** *"Një kopje e Njoftim vendimit së bashku me shpalljen debitor i vihet në dispozicion Sektorit të Mbikëqyrjes Doganore, për të vijuar me amendimin e deklaratës doganore në rastet kur gjendja në llogarinë parapaguese mbulon detyrimin doganor"*.

**Pika 6.** "Nëse: a) subjekti debitor ka gjendje kreditore në llogarinë parapaguese, e cila mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendim/et për shpalljen debitor, specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore apo Përgjegjësi i Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore (c1): - prek llogarinë, duke amenduar deklaratën/at respektive, - njofton me email Subjektin debitor apo agjentin e tij dhe specialistin Jurisit/Specialist Borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në degën doganore për veprimin e kryer b) gjendja e llogarisë nuk mbulon detyrimet që rrjedhin nga Vendimi për shpalljen debitor lajmërohet elektronikisht subjekti debitor/deklaruesi nga specialisti (C1) pranë Sektorit të Zyrës së Mbikëqyrjes doganore apo përgjegjësi i Zyrës së mbikëqyrjes doganore (C1), për të bërë pagesat përkatëse dhe shtuar në llogarinë parapaguese..

-Nga auditimi është konstatuar se njoftimi i vendimit është kryer me shpallje publike, me shkresën nr.2549/6 prot., datë 10.12.2024, pasi nga verifikimi i dosjes rezulton se subjekti nuk është njoftuar nga dega e Doganës Fier me shërbimin postar për vendimmarrjen e kryer, ndërkohë që për këtë rast konstatohet se nga ana e Degës Doganore Fier nuk është nxjerrë VRFB veprim i cili është në kundërshtim me Kodin Doganor si dhe në kundërshtim me udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës me pikën 2.1 dhe 2.6 të kapitullit VII. Pika 2.6 përcakton se Dega Doganore dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të ardhurave, pranë DPD menjëherë të gjithë vendimet për zbatimin e masave garantuese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, qoftë në import, qoftë në export, veprim i cili nuk është kryer nga Dega Doganore Fier.

Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**10. Subjekti P me NUIS KH.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.112 datë 26.12.2024 të Degës Doganore Fier në shumën 279,375 lekë dhe gjobë në shumën 0 lekë. Në dosje dokumentat që ndodhen, njoftim vendimi subjekteve me shkresën nr.4404/1 prot., datë 26.12.2024. Shkresa nr.4404 prot., datë 26.12.2024, vendimi nr.112 për operatorin e sipërcituar shpallur debitor. Shkresa nr.4404/2 prot., datë 08.01.2025 kërkesë për shpallje publike të aktit administrative drejtuar Bashkisë Divjak.

**Konkluzioni:**

Nga auditimi konstatohet se në dosjen e subjektit sipas vendimit nr.112 datë 26.12.2024 nuk ka gjurmë të mos marrjes dijeni për njoftimin e vendimit nga subjekti sipas shënimeve mbi kthimin apo refuzimin e marrjes dijeni. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15.

Nga auditimi është konstatuar se njoftimi i vendimit është kryer me shpallje publike, me shkresën nr.4404/2 prot., datë 08.01.2025, pasi nga verifikimi i dosjes rezulton se subjekti nuk është njoftuar nga dega e Doganës Fier me shërbimin postar për vendimmarrjen e kryer, ndërkohë që për këtë rast konstatohet se nga ana e Degës Doganore Fier nuk është nxjerrë VRFB brenda 31.12.2024, Pika 2.6 përcakton se Dega Doganore dërgon pranë Sektorit të Monitorimit të Borxhit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të ardhurave, pranë DPD menjëherë të gjithë vendimet

për zbatimin e masave garantuese duke kërkuar bllokimin e menjëhershëm të veprimeve në sistem, qoftë në import, qoftë në export, veprim i cili nuk është kryer nga Dega Doganore Fier.
Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore të parashikuara nga Kodi Doganor dhe Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës.

**C. Auditimi i dosjeve të borxhit të cilat përfaqësojnë peshën më të madhe ndaj totalit të borxhit doganor në Degën Doganore Fier.**

**1. Subjekti D Sha me NUIS LC.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.189 datë 17.06.2015 të Degës Doganore Fier në shumën 5,187,349,838 lekë. Diferenca ndërmjet tabelës dhe vendimit është kamatëvonesat e llogaritura deri me 31.12.2024. Në dosje dokumentat që ndodhen janë:
- Vendimi nr. 189 datë 17.06.2015 me nr.1410 prot datë 17.06.2015.
- Njoftim Vendimi dërguar me shkresën nr.1410/1 prot datë 17.06.2015.
- Proces-verbal i kontrollit fizik nr.1410/2 prot datë 17.06.2015.
- Proces-verbal për verifikimin e kundravajtjeve administrative nr.1410/3 prot datë 17.06.2015.
- Shkresa nr.1422/3 prot datë 18.06.2015 korrigjim i proces-verbalit nr.001406 datë 17.05.2015 bashkëngjitur ndodhen proces-verbali nr.1401 prot datë 16.06.2015 dhe proces-verbali nr.1401/1 prot datë 16.06.2015.

**Konkluzioni**
Nga auditimi konstatohet se Dega e Doganës Fier në lidhje me këtë subjekt nuk ka marrë masa të mëtejshme proceduriale për vjeljen e detyrimeve doganore të papaguara, pasi nga ana e sektorit të borxhit nuk është nxjerrë VRFB për të vijuar me masat shtrënguese, ky veprim ka pamundësuar ecurinë e ndjekjes së mëtejshme të procedurave të rikuperimit me forcë të detyrimeve doganor (pavarësisht se në evidencën e borxhit fushat e VRFB, urdhrit të ekzekutimit dhe përmbaruesit janë të plotësuar për këtë rast duke krijuar mospërputhje me dokumentacionin në dosjen e borxhit). Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 280 të ligjin nr.102/2014 **"Kodin Doganor"** dhe Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës" Kapitulli VII "Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor".

**2. Subjekti D Sha me NUIS LC.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.236 datë 11.09.2015 të Degës Doganore Fier në shumën 417,966,521 lekë. Diferenca ndërmjet tabelës dhe vendimit është kamatëvonesat e llogaritura deri me 31.12.2024. Në dosje dokumentat që ndodhen janë:
- Vendimit nr.236 datë 11.09.2015 me nr.2600 prot datë 11.09.2015.
- Njoftim Vendimi dërguar me shkresën nr.2600/1 prot datë 11.09.2015.
- Proces-verbal i kontrollit fizik nr.2566 prot datë 10.09.2015.
- Proces-verbal për verifikimin e kundravajtjeve administrative nr.2566/1 prot datë 10.09.2015.
- Proces-verbal për verifikimin e kundravajtjeve administrative nr.2566/2 prot datë 10.09.2015.
- Proces-verbal për verifikimin e kundravajtjeve administrative nr.2566/3 prot datë 10.09.2015.
- Proces-verbal për verifikimin e kundravajtjeve administrative nr.2566/4 prot datë 10.09.2015.
- Shkresa nr.2690 prot datë 08.07.2015 raport kontrolli.

**Konkluzioni**

Nga auditimi konstatohet se Dega e Doganës Fier në lidhje me këtë subjekt nuk ka marrë masa të mëtejshme proceduriale për vjeljen e detyrimeve doganore të papaguara, pasi nga ana e sektorit të borxhit nuk është nxjerrë VRFB për të vijuar me masat shtrënguese, ky veprim ka pamundësuar ecurinë e ndjekjes së mëtejshme të procedurave të rikuperimit me forcë të detyrimeve doganor (pavarësisht se në evidencën e borxhit fushat e VRFB, urdhrit të ekzekutimit dhe përmbaruesit janë të plotësuar për këtë rast duke krijuar mospërputhje me dokumentacionin në dosjen e borxhit). Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 280 të ligjin nr.102/2014 **"Kodin Doganor"** dhe Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës" Kapitulli VII "Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor".

**3. Subjekti D Sha me NUIS LC.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.301 datë 21.12.2018 të Degës Doganore Fier në shumën 245,796,554 lekë. Diferenca ndërmjet tabelës dhe vendimit është kamatëvonesat e llogaritura deri me 31.12.2024. Në dosje dokumentat që ndodhen janë:

- Vendimit nr.301 datë 21.12.2018 protokolluar me nr.4697/2 prot datë 21.12.2018.
- Shkresa njoftimi vendimit nr.2136/1 prot datë 12.04.2019.
- Vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit Doganor dërguar me shkresën me nr.2136 prot datë 12.04.2019.
- Proces-verbal i kontrollit fizik nr.1221 prot datë 19.04.2018. Proces-verbal për verifikimin e kundravajtjeve administrative nr.serie 005451i cili nuk është i protokolluar datë 17.04.2018.

**Konkluzioni**

Nga auditimi konstatohet se Dega e Doganës Fier, sektorit borxhit për të vijuar me masat shtrënguese ka nxjerrë VRFB, por pas kësaj, nuk janë ndërmarrë hapat e tjerë për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore të papaguara. Këto veprime janë në shkelje të nenit 280 të Ligjit nr. 102/2014, 'Kodi Doganor', dhe të Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018, 'Për evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës', në Kapitullin VII, që ka të bëjë me 'Ekzekutimin e Vendimit të Shpalljes Debitor'.

**4. Subjekti B LTD me NUIS KL.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.133/1 datë 12.01.2016 të Degës Doganore Fier në shumën 1,861,198,879 lekë. Diferenca ndërmjet tabelës dhe vendimit është kamatëvonesat e llogaritura deri me 31.12.2024. Në dosje dokumentat që ndodhen janë:

- Vendimi nr.133/1 datë 17.06.2016 protokolluar me nr.4809 prot datë 01.12.2016.
- Njoftim Vendimi dërguar me shkresën nr.4809/1 prot datë 01.12.2016.
- Vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit doganor që shoqëria B me NUIS KL ka ndaj Degës Doganore Fier nr.F-4809 datë 28.09.2017.
- Njoftimi vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, dërguar me shkresën nr.3994/1 prot datë 28.09.2017.
- Kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit nr.2314 prot datë 30.06.2023 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
- Vendimi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë nr.44 datë 26.07.2023 për pranimin e kërkesës, lëshimin urdhërit të ekzekutimit për aktin administrativ nr.F-4809 nr.3994 prot datë 28.09.2017.
- Kërkesa drejtuar zyrës përmbarimore nr.1480 prot datë drejtuar Zyrës Përmbarimore të Përmbaruesit Gjyqësor Privat Adriana Gjoka.

- Kërkesa për informacion dërguar zyrës përmbarimore nr.2681 prot datë 26.07.2023.
- Kërkesa për bashkëpunim drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Shtetëror Tiranë me nr.1530 prot datë 02.05.2023.
- Kopje të Kërkesë-Padisë të paraqitur nga subjekti B me NUIS KL me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv të Degës Doganore Fier nr.F-4809 datë 28.09.2017 dhe marrjen e masës së pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv të Degës Doganore Fier nr.F-4809 datë 28.09.2017.
- Vendimi nr.ska datë 11.04.2024 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje i cili vendosi pranimin e kërkesës së palës paditëse, marrjen e masës së pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv të Degës Doganore Fier nr.F-4809 datë 28.09.2017.
- Ankimi i veçantë nr.1807 prot datë 31.05.2024 kundër vendimit pa numër, datë 11.04.2024.

**<u>Konkluzioni</u>**

Nga auditimi konstatohet se nga ana e sektorit të borxhit doganor në Degën Doganore Fier përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit ë Ekzekutimit. Në lidhje me këtë subjekt nuk është shfrytëzuar mundësinë për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor deri në datën e vendimit të 11.04.2024, datë të cilën Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje vendosi pranimin e kërkesës së palës paditëse, *marrjen e masës së pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv të Degës Doganore Fier nr.F-4809 datë 28.09.2017*. Gjithashtu konstatohet një vonesë e pajustifikuar e kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës Administrativet të Shkallës së Parë Vlorë. Në dosje nuk gjendet dokumentacion justifikues për masat e marra nga vetë autoriteti doganor për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, sipas përcaktimeve të pikës XV të Udhëzimit 15 ku përcaktohet *"Në përfundim të gjithë procedurës për evidentimin, kontabilizimin, njoftimin, vjeljen dhe shuarjen e borxhit, dosja e borxhit doganor/borxhit të akcizës dhe e detyrimeve që duhen paguar duhet të përmbajë dokumentat e mëposhtme: l)akte të bankave, të zyrave të regjistrimit të pasurisë së luajtshme, të zyrës së Regjistrimit të pasurive të patundshme të vendosur si garanci apo si subjekt sekuestrimi.*

Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit të Ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".

Nuk ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.

Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.

Në kundërshtim me pikë 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës"*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit

Doganor. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 280 të ligjit nr.102/2014 **"Kodin Doganor"** dhe Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës" Kapitulli VII "Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor".

**5. Subjekti I me NUIS LI.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.24 datë 07.02.2018 të Degës Doganore Fier në shumën 353,757,480 lekë. Diferenca ndërmjet tabelës dhe vendimit janë kamatëvonesat e llogaritura deri me 31.12.2024. Në dosje dokumentat që ndodhen janë,

- Vendimi nr.24, datë 07.02.2018, protokolluar me nr.447 prot, ku në përfundim është vendosur detyrimi në shumën 272,761,077 lekë, për subjektin ''I'' me NIPT LI si dhe operatori ekonomik është penalizuar në shumën 450,000 lekë, në vendimin me nr.1 i datës 03.01.2018.
- Njoftim vendimi nr.24, datë 07.02.2018, për subjektin ''I' me NIPT LI, i cili është shpallur debitor për detyrimin e akcizës në shumën 272,761,077 lekë.
- Shkresa kthim përgjigje nga subjekti 'I' drejtuar Degës Doganore Fier, në lidhje me përfundimin e përdorimit të rafinerisë nga ky subjekt, si dhe kalimin e administrimit të asetit tek banka Credins.
- Proces Verbal Kontrolli Fizik i subjektit ''I''.
- Njoftimi Lajmërim Marrje nga posta.
- Vendim me nr.F-04 prot, datë 19.05.2018, për rikuperimin me forcë të borxhit doganor që shoqëria ''IRTC'' ka ndaj Degës Doganore Fier me nr.447/2 prot datë 19.05.2018.
- Njoftimi i vendimit me nr.F-04, datë 19.05.2018, me nr.447/2 prot., datë 19.05.2018.
- Kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, nr.extra.prot datë 29.01.2019 nga Dega Doganës Fier.
- Vendimi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me nr.375 Akti datë 11.06.2019 për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit.
- Kërkesa nr.114 prot datë 09.01.2020 për ekzekutimin në mënyrë të detyrueshme të urdhërit të ekzekutimit nr.375 datë 11.06.2019, lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Vlorë.
- Shkresa me nr.18/01460/tbo-002 prot për vënien e sekuestros conservative mbi llogaritë e debitorit. Përgjigje shkresës nr.2848 prot datë 01.02.2018, nga A Bank për DD Fier se subjekti 'I' nuk ka llogari pranë kësaj banke.
- Kërkesa me nr.5643 prot, lidhur me ekzekutimin e vendimit për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës Administrative te Shkalles se Pare, Vlore drejtuar përmbaruesit gjyqësor G.
- Shkresa me nr.328 prot., dërgim informacioni nga DD Fier mbi bashkëpunimin me Shërbimin Përmbarimor, me qëllim rikuperimin forcërisht të borxhit të akcizës drejtuar DPD.
- Vendimi për transferimin e çështjes përmbarimore nr.669/1 prot datë 21.01.2020.

**<u>Konkluzioni</u>**

Nga auditimi konstatohet se nga ana e sektorit të borxhit doganor në Degën Doganore Fier në lidhje me këtë subjekt nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit ë Ekzekutimit. Gjithashtu konstatohet një vonesë e pajustifikuar e kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës Administrativet të Shkallës së

Parë Vlorë veprim i cili është në kundërshtim me nenin 280 të ligjit nr.102/2014 **"Kodin Doganor"** dhe Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës" Kapitulli VII "Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor".

-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin me përmbaruesit gjyqësore pas nënshkrimit të kontratës së shërbimit, sipas përcaktimeve të pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15 ku citohet *". Dega Doganore ti kërkojë informacion me shkrim Zyrës Përmbarimore lidhur me statusin aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv për të gjitha veprimet e kryera, informacion të cilin më pas ia përcjell Sektorit të Monitorimit të Borxhit....* Nuk ka dokumentacion provues për përmbushjen e detyrimeve të kreditorit sipas kontratës tip me përmbaruesin ku në nenin 4 "Detyrimet e kreditorit", pika 7 përcaktohet *"Kreditori merr përsipër detyrimet e mëposhtme: ...Të nënshkruajë procesverbalet që dokumentojnë veprimet përmbarimore nga shoqëria përmbarimore të cilat pasqyrojnë realitetin dhe janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi duke pasur të drejtë të shënojë në të dhe vërejtjet/kundërshtimet që ai ka".*
Gjithashtu, përzgjedhja e përmbaruesit nuk rezulton të jetë e dokumentuar.

Në dosje nuk gjendet dokumentacion justifikues për masat e marra nga vetë autoriteti doganor për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, sipas përcaktimeve të pikës XV të Udhëzimit 15.
Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit të Ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".
Nuk ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Në kundërshtim me pikë 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës"*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**6. Subjekti T me NUIS KP.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.183 datë 04.06.2015 të Degës Doganore Fier në shumën 854,662,844 lekë. Diferenca ndërmjet tabelës dhe vendimit është kamatëvonesat e llogaritura deri me 31.12.2024.
- Vendimi Nr.183, datë 04.06.2015, së bashku me procesverbalet ku sipas Programit të Kontrollit nr.1231 prot, datë 01.06.2015, ka pasur kundravajtje administrative ku është pasqyruar shkelja doganore, një diference prej 4.855.112 litra mangut, krahasuar me gjendjen në sistemin Asycuda.

Për këtë kundravajtje u vendos të paguhet detyrimi i akcizës në shumën 242,755,600 lekë dhe të dënohet me gjobë 485,511,200 lekë. Në total 728.266.800 lekë.
- Njoftimi i këtij vendimi gjendet në zarfin e dërguar.
- Vendimi Nr.F-1262/1 date 24.12.2015 protokolluar me nr.4514, për rikuperimin me forcë të borxhit doganor që shoqëria "T" me NIPT KP ka ndaj DD Fier.
- Njoftimi i vendimit Nr.F-1262/1, datë 24.12.2015 të rikuperimit me forcë, protokolluar me Nr.4514/1 prot datë 24.12.2015.
- Kërkesa për shpallje publike të vendimit për rikuperim me force të borxhit doganor nr.246 prot., datë 15.01.2016.
- Kërkesa për Lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit nr.763 prot, datë 16.02.2016, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për detyrimet e papaguara në shumën 728.266.800 lekë.
- Vendim nr.98 Akti, datë 29.02.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlore, për pranimin e kërkesës, Lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit.
- Praktika e Përmbarimit/Kontratë shërbimi, datë 11.04.2016.
- Kërkesa për ekzekutimin të detyrueshëm të Urdhrave të Ekzekutimit, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.1626 prot., datë 14.04.2016 drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme.
- Lajmërim për ekzekutim vullnetar brenda 10 ditëve nga data e marrjes dijeni të shkresës nr.458 prot., datë 12.04.2016.
- Kërkesa për vendosjen e masës së sekuestros ekzekutive, drejtuar bankave të nivelit të dytë nr.1627 prot., datë 14.04.2016 nga DDF.
- Urdhër për Vënie Sekuestro, drejtuar Qendrës Kombëtare të Regjistrimit Tirane Nr.458Prot, date 10.05.2016 nga DDF.
- Urdhër Sekuestro Institucioneve të ndryshme, me nr.458 prot, datë 10.05.2016.
- Kërkesë për Ekzekutim të Urdhërit Ekzekutiv nr.98, datë 29.02.2016, protokolluar me nr.1584/2 prot, datë 12.04.2016, drejtuar Përmbarueses Gjyqësore Private Znj. G.
- Kontratë Shërbimi datë 11.04.2016 për Ekzekutim të Urdhërit Ekzekutiv nr.98, datë 29.02.2016.
- Shkresa kthim përgjigje nga banka "U", nr.14630/1 prot., datë 20.04.2016 ku citohet se subjektet "T", "D" dhe ''D" nuk kanë llogari në Union Bank.
- Shkresa kthim përgjigje nga ZVRPP, nr.2939/1 prot., datë 13.05.2016., ku subjekti "T" nuk figuron të këtë pasuri të regjistruar pranë ZVRPP. Regjistrimet para vitit 1997 nuk disponohen.
- Shkresa kthim përgjigje nga Credins Bank, nr.20246 prot., 21.04.2016., ku subjekti "T" dhe "D" janë klient kredie.
- Ekstrakt Historik i regjistrit tregtar për subjektin Shoqëri Aksionere "T" datë 18.06.2021.

**<u>Konkluzioni</u>**

Nga auditimi konstatohet se nga ana e sektorit të borxhit doganor në Degën Doganore Fier në lidhje me këtë subjekt nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit ë Ekzekutimit. Nga ana e këtij sektori nuk janë marrë të gjitha masat shtrënguese, por janë mjaftuar vetëm më dërgimin e çështjes për ndjekje nga zyra përmbarimore.
-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin me përmbaruesit gjyqësore pas nënshkrimit të kontratës së shërbimit, sipas përcaktimeve të pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15 ku citohet *"..Dega Doganore ti kërkojë informacion me shkrim Zyrës Përmbarimore lidhur me statusin aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv për të gjitha veprimet e kryera, informacion të cilin më pas ia përcjell Sektorit të Monitorimit të Borxhit....* Nuk

ka dokumentacion provues për përmbushjen e detyrimeve të kreditorit sipas kontratës tip me përmbaruesin ku në nenin 4 "Detyrimet e kreditorit", pika 7 përcaktohet *"Kreditori merr përsipër detyrimet e mëposhtme: ...Të nënshkruajë procesverbalet që dokumentojnë veprimet përmbarimore nga shoqëria përmbarimore të cilat pasqyrojnë realitetin dhe janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi duke pasur të drejtë të shënojë në të dhe vërejtjet/kundërshtimet që ai ka".*
Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 280 të ligjin nr.102/2014 **"Kodin Doganor"** dhe Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës" Kapitulli VII "Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor".

**7. Subjekti A me NUIS JD.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.69 datë 22.07.2013 të Degës Doganore Fier në shumën 1,465,083,287 lekë. Diferenca ndërmjet tabelës dhe vendimit është kamatëvonesat e llogaritura deri me 31.12.2024. Në dosje dokumentat që ndodhen:
- Vendim nr.69, date 22.07.2013, protokolluar me nr.1144/3 prot datë 22.07.2013, ndaj subjektit 'A' sha me NIPT JT.

**Konkluzioni**
Nga auditimi konstatohet se Dega e Doganës Fier në lidhje me këtë subjekt nuk ka marrë masa të mëtejshme proceduriale për vjeljen e detyrimeve doganore të papaguara, pasi nga ana e sektorit të borxhit nuk është nxjerrë VRFB për të vijuar me masat shtrënguese, ky veprim ka pamundësuar ecurinë e ndjekjes së mëtejshme të procedurave të rikuperimit me forcë të detyrimeve doganor (pavarësisht se në evidencë gjendet e plotësuar vetëm fusha e VFRB). Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 280 të ligjin nr.102/2014 **"Kodin Doganor"** dhe Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës" Kapitulli VII "Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor".

**8. Subjekti A me NUIS JD.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.83 datë 26.08.2013 të Degës Doganore Fier në shumën 244,068,580 lekë. Diferenca ndërmjet tabelës dhe vendimit është kamatëvonesat e llogaritura deri me 31.12.2024. Në dosje dokumentat që ndodhen:
- Vendim nr.83, date 26.08.2013, protokolluar me nr.1867/3 prot, datë 03.09.2013 ndaj subjektit 'A' sha me NIPT JT.
- Shkresa njoftim vendimi nr.1867/3 prot, datë 03.09.2013. Shkresa njoftim vendimi për rikuperimin me forcë të borxhit doganor për vendimin nr.83, date 26.08.2013.
- Vendimi i Gjykatës Administrative te Apelit me Nr.55, Date 06.11.2014 për ndryshimin e vendimit nr.1256 datë 16.06.2014, Rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë.

**Konkluzioni**
Nga auditimi konstatohet se Dega e Doganës Fier në lidhje me këtë subjekt nuk ka marrë masa të mëtejshme proceduriale për vjeljen e detyrimeve doganore të papaguara, pasi nga ana e sektorit të borxhit nuk është vijuar me kërkesën drejtuar Gjykatës Adminstrative të Shkallës së Parë Tiranë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit (kthimin në titull ekzekutiv VRFB nr.83 prot datë 26.08.2013), ky veprim ka pamundësuar ecurinë e ndjekjes së mëtejshme të procedurave të rikuperimit me forcë të detyrimeve doganor. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 280 të ligjin nr.102/2014 **"Kodin Doganor"** dhe Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara Doganore dhe të Akcizës" Kapitulli VII "Ekzekutimi i Vendimit i Shpalljes Debitor".

**9. Subjekti I me NUIS LI.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.24 datë 07.02.2018 të Degës Doganore Fier në shumën 353,757,480 lekë. Diferenca ndërmjet tabelës dhe vendimit është kamatëvonesat e llogaritura deri me 31.12.2024.
Në lidhje me auditimin e kësaj dosje rezulton se subjekti i audituar nuk ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit dokumentacionin në lidhje me vendimmarrjen si dhe masat e marra më qëllim vjeljen e detyrimeve doganore me pretendimin e dërguar me emailin e datës 28.03.2025 nga Z. I G dërguar grupit të auditimit ku pretendon se: "*Dosja nuk ndodhen në D.D.Fier. Ju me pa të drejtë bëni objekt auditit vendimet e viteve 2013-2018 sa më lartë, që del jashtë periudhës së auditimit të programit Tuaj (01/01/2024-31/12/2024). Dega Doganore Fier për këto vendimmarrje të këtyre viteve nuk ka kryer procedura administrative ndaj subjekteve pasi do ndodhej në shkelje të nenit 263 të ligjit 102/2014".*

**10. Subjekti A me NUIS LS.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.72 datë 19.05.2016 të Degës Doganore Fier në shumën 440,874,859 lekë. Diferenca ndërmjet tabelës dhe vendimit është kamatëvonesat e llogaritura deri me 31.12.2024.
Në lidhje me auditimin e kësaj dosje rezulton se subjekti i audituar nuk ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit dokumentacionin në lidhje me vendimmarrjen si dhe masat e marra më qëllim vjeljen e detyrimeve doganore me pretendimin e dërguar me emailin e datës 28.03.2025 nga Z. I G dërguar grupit të auditimit ku pretendon se: "*Dosja nuk ndodhen në D.D.Fier. Ju me pa të drejtë bëni objekt auditit vendimet e viteve 2013-2018 sa më lartë, që del jashtë periudhës së auditimit të programit Tuaj (01/01/2024-31/12/2024). Dega Doganore Fier për këto vendimmarrje të këtyre viteve nuk ka kryer procedura administrative ndaj subjekteve pasi do ndodhej në shkelje të nenit 263 të ligjit 102/2014".*

### III.2.4.4. Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për Degën Doganore Lezhë.

Zyra e borxhit doganor në Degën Doganore Lezhë funksionon sipas strukturës së miratuar me VKM nr. 355 datë 26.05.2022 '*Për personelin e administratës doganore'*, në të cilën evidentohen një pozicion pune jurist/specialist borxhi i plotësuar.
Auditimi mbi menaxhimin e Borxhit Doganor (BD), u fokusua në evidentimin e gjendjes së detyrimeve të subjekteve debitorë, krijimin e detyrimeve, gjendjen në fillim dhe në fund, kontabilizimin e tyre, strukturën e detyrimeve, llojshmëria, pesha specifike në total, masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor etj.
Bazuar në evidencën e vendosur në dispozicion nga Dega e Doganës Lezhë, rezulton se gjendja e borxhit doganor më 31.12.2024 paraqitet me 98 raste për 71 subjekte debitorë në vlerën 1,948,536,641 lekë, dhe gjendja e borxhit më datë 01.01.2024 paraqitet me 101 raste, për 75 subjekte debitorë në vlerën 1,924,488,929 lekë. Pra gjatë vitit ushtrimor 2024, borxhi doganor është ulur me 3 raste në krahasim me numrin në fillim të vitit, subjekte debitorë në numër janë ulur me 4, ndërsa në vlerë është shtuar me 24,047,712 lekë ose me 1.25%.
Gjendja fillestare e borxhit doganor së bashku me shtesat dhe pakësimet gjatë vitit 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Dega doganore | Debitore fillestare | | Shtesat gjate vitit | | Pakesime gjate vitit | | Debitore përfundimtare | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *Raste* | *Vlere* | *Raste* | *Vlere* | *Raste* | *Vlere* | *Raste* | *Vlere* |
| **LEZHE** | 101 | 1,924,488,929 | 52 | 27,429,428 | 55 | 3,381,714 | 98 | 1,948,536,643 |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Lezhë*

Shtesa e borxhit nga kamatëvonesat

Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga Dega Doganore Lezhë, për vitin 2024 kamatëvonesat e shtuara të cilat bëjnë pjesë në shtesat gjatë vitit paraqiten në shumën 23,935,118 lekë, të cilat janë llogaritur muaj për muaj që përfshin fletëllogaritjen dhe rakordimin me borxhin. Të ndara në llogaritje 6 mujore të cilat janë kryer gjatë vitit ato paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Periudha e llogaritjes | Shuma |
|---|---|
| gjashtëmujori i dyte | 12,153,895 |
| gjashtëmujori i pare | 11,781,223 |
| **totali i kamatvonesave** | **23,935,118** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Lezhë*

Nga auditimi konstatohet se llogaritja e interesave mbi detyrimet megjithëse është kryer në baza mujore, nuk është reflektuar në evidencat mujore të dërguara në DPD. Referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* llogaritja e interesave duhet të kryhet mbi baza mujore duke qenë se sipas pikës 5 të kapitullit V të udhëzimit citohet që *"Specialisti – Jurist/Specialist borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në degën doganore raporton në DPD (Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave) çdo muaj mbi gjendjen e detyrimeve të papaguara".* Për rrjedhojë, evidencat mujore të paraqitura nga Dega e Doganës Lezhë nuk janë të sakta përsa i përket shumës së kamatvonesave të paraqitura me pasojë edhe në shumën totale të borxhit doganor, me përjashtim të muajit Dhjetor kur janë reflektuar në shumën e duhur.

Nga auditimi në lidhje me kontabilizimin e shumave të borxhit doganor, konstatohet se sipas kartelës së llogarisë 468 "Debitorë", regjistrimi i analitik i detyrimit, penaliteti apo kamatvonesave nuk kryhet i ndarë për subjektin sipas vendimit dhe përcaktimeve të pikës 2, kapitulli V *"Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi"* ku citohet *"Kontabilizimi i shumës së detyrimeve bëhet në zëra të veçantë: a)një zë për shumën e borxhit doganor (detyrimet e import/eksportit të papaguara) dhe apo detyrimeve të akcizës, b) një zë për shumën për shumën e penaliteteve, c) një zë për shumën e kamatvonesave.".*

Shtesa e borxhit nga vendimet e vitit 2024

Gjatë vitit 2024, sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Dega Doganore Lezhë, rezulton se kanë dalë 53 vendime të cilat kanë krijuar detyrime përgjatë vitit në shumën 3,514,304 lekë. Nga auditimi me zgjedhje i vendimeve të muajit dhjetor 2024, rezulton se ato janë të kontabilizuara në sistemin e kontabilitetit Alpha në llogarinë 468. Pjesa më e madhe e vendimeve të marra në vitin 2024 janë paguar brenda vitit, ndërkohë që janë krijuar detyrime për 4 vendime të papaguara në shumën 937,576 lekë, pa përfshirë pjesën e kamatvonesave të vitit.

Borxhi doganor në 31.12.2024 sipas evidencës analitike në nivel rasti të borxhit, referuar autoritetit konstatues paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Struktura konstatuese | Vlera e detyrimit |
|---|---|
| Hetimi | 51,521,819.2 |
| Auditimi I brendshëm DPD | 2,054,269.7 |
| D. Akcizës | 79,230,098.7 |

| | |
|---|---|
| D.Dog. | 82,171,997.5 |
| Dega e Doganes | 30,348,426.2 |
| Dep.Akc e D.Dog | 1,450,288.7 |
| DOH | 15,854,960.4 |
| DOH e DARM DPD | 99,310.8 |
| DOH, D.Dog | 1,632,388,905.1 |
| Dr.Akcizes/Dog Lezhe | 326,515.1 |
| Drejt Kontr, Pas Zhdog | 111,496.7 |
| Hetimi | 948,465.6 |
| Klsh | 3,665,855.1 |
| KPZH/DOH | 48,364,232.4 |
| **Totali** | **1,948,536,641.2** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Lezhë*

Sikurse evidentohet në të dhënat e tabelës së mësipërme, pjesa më e madhe e borxhit doganor në Degën Doganore Lezhë përbëhet nga borxhi i konstatuar nga DOH për subjektet që kanë ushtruar veprimtarinë në fushën e akcizës.

Auditimi i masave të marra nga Dega Doganore Lezhë për rikuperimin e borxhit doganor është kryer bazuar në evidencën e paraqitur mbi stokun e borxhit si dhe dokumentacionin e dosjeve të përzgjedhura për auditim. Dosjet e përzgjedhura për auditim përfshijnë:

**-5 dosjet e përzgjedhura për të cilat është krijuar borxh në fund të vitit 2024:**

| Emri Subjektit | Detyrimi Doganor | Penalitete | Interesa | Shuma totale | Shuma e paguar | Shuma për tu paguar | Nr Vendim | Dt Vendim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| J, D | 86,396 | 259,194 | 4,016 | 349,606 | | 349,606 | 3 | 05.02.2024 |
| N,A,A | 69,265 | 207,795 | 3,218 | 280,278 | | 280,278 | 5 | 05.02.2024 |
| E, A | 46,333 | 138,999 | 2,153 | 187,485 | | 187,485 | 6 | 05.02.2024 |
| I M | 32,398 | 97,194 | 1,505 | 131,097 | | 131,097 | 4 | 05.02.2024 |
| C A | 1,324,743 | | 18,616 | 1,343,359 | 1,324,743 | 18,616 | 25 | 02.07.2024 |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Lezhë*

**-10 dosjet e përzgjedhura nga vitet e mëparshme që përbëjnë 1,844,188 mijë lekë detyrimi ose 95% të stokut të borxhit në 31.12.2024.**

| Emri Subjektit | NIPT-i | Vendim nr. date | | Detyrimi | Penalitete | Interesa | Shuma per tu paguar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | KM | 50 | 4/10/2013 | 390,215,111 | 780,430,222 | 461,743,572 | 1,632,388,905 |
| Xh | KV | 3 | 24/01/2013 | 9,135,000 | 45,675,000 | 23,160,270 | 77,970,270 |
| A | JD | 49 | 16/09/2013 | 8,420,657 | 25,261,971 | 12,784,240 | 46,466,868 |
| A | JD | 48 | 16/08/2013 | 6,916,075 | 20,748,225 | 10,688,655 | 38,352,955 |
| Sh | KP | 74 | 15/11/2018 | 16,809,532 | | 3,874,061 | 20,683,593 |
| Ar | JD | 8 | 4/6/2013 | 2,189,290 | 4,378,580 | 2,775,325 | 9,343,195 |
| B | LF | 15 | 12/3/2019 | 3,846,242 | 3,846,242 | 841,418 | 8,533,902 |
| Gj | KE | 40 | 29/05/2017 | | 5,978,988 | 457,620 | 6,436,608 |
| Gj | KE | 39 | 29/05/2017 | | 2,379,694 | 182,137 | 2,561,831 |
| G | KT | 38 | 30/5/2018 | 439,116 | 878,232 | 132,941 | 1,450,289 |
| **TOTALI** | | | | **437,971,023** | **889,577,154** | **516,640,238** | **1,844,188,415** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Lezhë*

**A. Auditim mbi evidencën e borxhit doganor në Degën e Doganës Lezhë**

<u>Raste me shënim në proces gjyqësor pa paguar detyrimin.</u>

-Nga rastet e raportuara në evidencë, rezulton se Dega Doganore Lezhë ka në proces gjyqësor 4 raste me vlerë 93,985,831 lekë ose 4.82% e borxhit, të cilët rezultojnë se nuk kanë ndjekur

procedurën administrative të ankimit pasi nuk është likuiduar detyrimi doganor si dhe nuk janë garantuar gjobat parashikuar nga neni 281-282 i Kodit Doganor i cili ka parashikuar se: *Kundër vendimit të autoriteteve doganore kompetente, shkelësi mund t'i paraqesë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave një kërkesë ankimore të arsyetuar, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Për të paraqitur ankesën, ankimuesi duhet të paguajë shumën e përgjithshme të detyrimeve të importit ose eksportit, sipas përkufizimeve të këtij titulli, si dhe të garantojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e sanksioneve të aplikuara për shkeljen, objekt konflikti. Ankimuesi duhet të bashkëshoqërojë ankimin me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e tij.* Kjo pasi ne kolonën e pagesave të evidencës së borxhit shuma e paguar paraqitet 0 lekë për secilin rast, ndërkohë që në kolonën e vendim gjyqësor paraqitet me shënim përkatës. Gjithashtu konstatohet të mos jenë respektuar kërkesat e kapitullit X "Ankimi administrativ" të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*. Këto raste janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

| Subjekti | NIPT | Detyrim | Penalitet | Kamatëvonesa | Borxh total | Paguar | Borxh 31.12.2024 | Proces gjyqësor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | JD | 8,420,657 | 25,261,971 | 12,784,240 | 46,466,868 | | 46,466,868 | Proces - gjyqësor |
| A | JD | 6,916,075 | 20,748,225 | 10,688,655 | 38,352,955 | | 38,352,955 | Proces - gjyqësor |
| Gj | KE | | 5,978,988 | 457,620 | 6,436,608 | | 6,436,608 | Proces - gjyqesor |
| Sh | KH | 2,053,099 | | 676,301 | 2,729,400 | | 2,729,400 | Proces - gjyqesor |
| **TOTALI** | | | | | | | **93,985,831** | |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Lezhë*

Raste për të cilat nuk është nxjerrë VRFB

-Me qëllim uljen e borxhit doganor, deri në fund të vitit 2024 kanë dalë 62 VRFB me vlerë 1,932,388,710 lekë. Nga auditimi janë konstatuar të paktën 36 raste në shumën 16,147,931 lekë ose 1% e totalit, për të cilat nuk ka të shënuar në evidencën e borxhit të dhëna mbi marrjen e Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, megjithëse referuar afateve dhe shumave të detyrimit, janë përmbushur kushtet ligjore për rikuperimin me forcë të këtyre borxheve doganore. Mos ndjekja e hapave proceduriale të detyrueshëm për rikuperimin e detyrimeve doganore të papaguara është në kundërshtim me pikën 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Këto raste janë përcjellë me email të datës 22.04.2025.

Raste për të cilat është nxjerrë VRFB por nuk është kryer kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit

-Nga auditimi konstatohet se janë dërguar kërkesa për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit në gjykatë për 43 raste me vlerë 1,915,673,379 lekë, **ndërsa për pjesën tjetër nuk është dërguar kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në gjykatë**, nga të cilat për një pjesë as nuk është nxjerrë VRFB. Ndër rastet për të cilat është nxjerrë VRFB, konstatohet se për 16 raste në shumën 15,457,701 lekë ose 1% e totalit, nuk janë marrë masat për dërgimin e tyre në gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit (përveç 2 rasteve me shënim në evidence por pa shënim në kolonën urdhër ekzekutimi). Këto raste janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1 të kapitullit VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* ku citohet *"Menjëherë mbas marrjes dijeni të vendimit për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, pra pas kthimit në titull ekzekutiv, specialisti – jurist/specialist borxhi i sektorit/zyrës së administratës dhe shërbimit në degën doganore dërgon*

*në gjykatë kërkesën për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit".* Rastet për të cilat është konstatuar mos dërgimi në gjykate për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

| Emri Subjektit | Shuma per tu paguar | Vendim | | Vendimi RFB | | Derguar Gjykate | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| R, I | 5,512,577 | **47** | **7/6/2016** | **1954** | **24/10/2016** | | |
| G S | 4,423,333 | **49** | **7/6/2016** | 1982 | 27/10/2016 | | |
| K | 1,842,229 | **171** | **9/12/2015** | 1953 | 24/10/2017 | | |
| G | 1,450,289 | **38** | **30/5/2018** | 2090 | **19/12/2018** | | |
| L | 1,098,318 | **48** | **7/6/2016** | 1955 | 24/10/2016 | | |
| Un | 907,844 | **44** | **8/9/2014** | 1 | **05.04.2018** | | |
| B | 326,515 | **39** | **14.09.2021** | **2** | **24.01.2023** | | |
| K | 276,584 | **168** | **25/11/2015** | **1951** | **24/10/2016** | | |
| V | 215,842 | **15** | **4/30/2011** | **1946** | **24/10/2016** | | |
| E | 126,416 | **75** | **17/10/2017** | **438** | **15/3/2018** | | |
| T | 101,475 | **22** | **11/10/2011** | **1946** | **24/10/2016** | | |
| S | 68,840 | **3** | **6/2/2012** | **1945** | **24/10/206** | | |
| Sh | 50,000 | **6** | **27.02.2021** | **3** | **24.01.2023** | | |
| K | 46,053 | **170** | **9/12/2015** | 1952 | 24/10/2016 | | |
| K | 41,944 | **25** | **16/02/2015** | **1467** | **7/9/2015** | | |
| S | 20,000 | **59** | **22.11.2021** | **1** | **24.01.2023** | | |
| L | 18,440 | **58** | **29/04/2015** | **1958** | **27/10/2016** | | |
| G | 11,218 | **11** | **22/01/2015** | **1981** | **27/10/2016** | | |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Lezhë*

-Nga ana e Gjykatës janë lëshuar Urdhër Ekzekutimi për 33 raste me vlerë 1,894,020,916 lekë, Nga rastet për të cilat është dërguar kërkesa në Gjykatë, konstatohen 10 raste të cilat kanë përshkrimin në evidencë "kthyer nga gjykata", në shumën 21,652,463 lekë ose 1% e totalit, për të cilat nuk është marrë asnjë masë e mëtejshme për kthimin e tyre në urdhër ekzekutimi. Për këto raste nuk ka informacion në lidhje me arsyen e mos lëshimit të urdhrit të ekzekutimit apo refuzimin/kërkesën për plotësim nga gjykata megjithëse ka kaluar kohë e konsiderueshme nga data e kërkesës për disa prej tyre në vlera të mëdha të borxhit doganor të përfshirë në objektin e ekzekutimit të detyrueshëm. Konstatohet se nuk janë dokumentuar hapat proceduriale të ndjekura nga autoriteti doganor dhe nuk janë paraqitur sipas kërkesave të pikës 4 dhe 5 të kapitullit VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Këto raste janë paraqitur sipas tabelës së mëposhtme:

| Emri Subjektit | Shuma për tu paguar | Vendim | | Vendimi RFB | | Derguar Gjykate | | Urdher Ekzekutimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gj | 6,436,608 | **40** | **29/05/2017** | **439** | **15/3/2018** | 1,838 | 05.11.2018 | kthyer nga gjykata |
| B | 6,326,320 | **11** | **22/02/2017** | **443** | **15/3/2018** | 1,845 | 05.11.2018 | kthyer nga Gjykata |
| S | 4,820,733 | **64** | **26/09/2016** | **446** | **15/3/2018** | 1,839 | 05.11.2018 | kthyer nga Gjykata |
| Gj | 2,561,831 | **39** | **29/05/2017** | **439** | **15/3/2018** | 1,837 | 05.11.2018 | kthyer nga gjykata |
| B | 880,918 | **12** | **22/02/2017** | **443** | **15/3/2018** | 1,844 | 05.11.2018 | kthyer nga Gjykata |
| I | 156,302 | **37** | **11/5/2016** | **2191** | **23/11/2016** | | | kthyer nga gjykata |
| I | 154,294 | **10** | **22/02/2017** | **445** | **15/3/2018** | 1,842 | 05.11.2018 | kthyer nga Gjykata |
| B | 151,668 | **69** | **17/10/2017** | **435** | **15/3/2018** | 1,840 | 05.11.2018 | kthyer nga Gjykata |
| V | 100,840 | **82** | **4/5/2015** | **2060** | **05.11.2015** | 2258 | 04.12.2015 | kthyer nga gjykata |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | 62,950 | **71** | **17/10/2017** | | | | | kthyer nga Gjykata |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Lezhë*

-Nga auditimi mbi të dhënat e paraqitura në evidencën analitike të borxhit, konstatohet se, për të gjitha rastet për të cilat ka urdhër ekzekutimi nga gjykata, Dega Doganore Lezhë ka dërguar për ekzekutim të detyrueshëm në zyrat përmbarimore përkatëse.

-Megjithatë konstatohet se nuk janë marrë masa nga vetë autoritetit doganor, pasi nuk janë të përshkruara në evidencë shënimet mbi bllokimet në bankat e nivelit të dytë, DPT, ASHK, DPSHTRR, etj, jo në përputhje me Kapitullin IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Kjo konstatohet në 30 raste në shumën 176,812,188 lekë ose 9% e totalit. Për asnjë rast nuk ka ndjekur masat shtrënguese në vijim, si bllokim të llogarive bankare, vendosja e mase sigurimit ne ZRPP, vendosja e mase sigurimit ne DPSHTRR dhe bllokimin i veprimeve në QKB, për rastet e pajisura me urdhër ekzekutimi duke konkluduar për veprime të cilat janë në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**B. Auditimi i dosjeve të përzgjedhura për vitin 2024**

- **Subjekti J.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr. 3 datë 05.02.2024 të Degës Doganore Lezhë në shumën 86,398 lekë dhe gjobë në shumën 259,194 lekë. Në dosje ndodhet Njoftim Vendimi subjektit me shkresën nr. 1258/5 datë 05/02/2024 dhe 1258/4 datë 05/02/2024, në të njëjtën ditë me vendimin, por nuk disponohet në dosje kopja e lajmërimit postar. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15.
Gjithashtu në dosje ndodhen kërkesë për shpallje publike të aktit administrative drejtuar Prefektit të Qarkut Lezhë me nr. 1258/6 datë 31.12.2024 dhe kërkesë drejtuar Bashkisë Mirditë me nr. 125/7 datë 31.12.2024. Për këto shkresa nga Prefekti i Qarkut Lezhë me nr. 1258/8 datë 30.01.2025 dhe nga Bashkia Mirditë me shkresë nr. 1258/9 datë 06/02/2025 është kthyer përgjigje për afishimin e shpalljes së aktit administrative. Në dosje administrohet gjithashtu edhe njoftimi i procesverbalit të shkeljes doganore me nr. 1258/2 datë 27/12/2023 (me dërgesë postare datë 30.12.2023) dhe 1258/1 datë 277/12/2023 2023 (me dërgesë postare datë 29.12.2023). Në dosje gjendjet dokumentacioni mbi shkeljen doganore që përfshin informacion nr. 22119 datë 07.12.2023 për marrje vendimi nga DOH drejtuar DD Lezhë bashkëlidhur fotokopje të dokumentacionit si procesverbal nr. 0001441 datë 04.12.2023, raporte, shkresa, etj (12 dokumente).
Nga auditimi mbi këtë detyrim doganor konstatohet se nuk janë marrë masat për njoftimin e vendimit në kohë sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës",* pasi është kryer mbi 10 muaj vonesë. Gjithashtu, konstatohet se nuk është marrë në vijimësi asnjë masë proceduriale për ekzekutimin e këtij detyrimi, vendim për rikuperimin me forcë të borxhit doganor sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"* pikën 2.1 dhe 2.6 të kapitullit VII.

**-Subjekti N.** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr. 5 datë 05.02.2024 të Degës Doganore Lezhë në shumën 69,265 lekë dhe gjobë në shumën 207,795 lekë. Në dosje ndodhet

Njoftim Vendimi subjekteve me shkresën nr. 1260/5 datë 05/02/2024, 1260/6 datë 05/02/2024 dhe 1260/7 datë 05/02/2024 në të njëjtën ditë me vendimin, por nuk disponohet në dosje kopja e lajmërimit postar, përveç subjektit A me barkod në datë 06/02/2024 me pullë shënimi kthehet për adresë të pasaktë. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15.
Në dosje gjendet dokumentacioni mbi shkeljen doganore që përfshin informacion nr. 22124 datë 07.12.2023 për marrje vendimi nga DOH drejtuar DD Lezhë bashkëlidhur fotokopje të dokumentacionit si procesverbal nr. 0001443 datë 05.12.2023, raporte, shkresa, etj (15 dokumente).
Procesverbalet e shkeljes doganore janë njoftuar me shkresat nr. 1260/1 datë 27.12.2023 subjekti N, shkresën nr. 1260/2 datë 27.12.2023 subjektit A dhe shkresën nr. 1260/3 datë 27.12.2023 subjektit A.
Në dosje ndodhen edhe kërkesat për shpallje publike të aktit administrative drejtuar Bashkisë Tiranë me nr. 1260/8 datë 31.12.2024 për dy subjekte, drejtuar Prefektit të Qarkut Tiranë me nr. 1260/9 datë 31.12.2024, drejtuar Prefektit të Qarkut Kukës me nr. 1260/10 datë 31.12.2024 për subjektin N dhe drejtuar Bashkisë Has me nr. 1260/11 datë 31.12.2024 drejtuar N. Për këto kërkesa janë dërguar nga institucionet e mësipërme konfirmimet e Bashkisë Tiranë me nr. 1260/14 datë 07/02/2025, Prefekti i Qarkut Tiranë me nr. 1260/13 datë 31.01.2025 dhe Prefekti i Qarkut Kukës me nr. 126/12 datë 31.01.2025.
Nga auditimi mbi këtë detyrim doganor konstatohet se nuk janë marrë masat për njoftimin e vendimit në kohë sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës",* pasi është kryer mbi 10 muaj vonesë. Gjithashtu, konstatohet se nuk është marrë në vijimësi asnjë masë proceduriale për ekzekutimin e këtij detyrimi, vendim për rikuperimin me forcë të borxhit doganor sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"* pikën 2.1 dhe 2.6 të kapitullit VII.

-**Subjekti "E".** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr. 6 datë 05.02.2024 të Degës Doganore Lezhë në shumën 46,333 lekë dhe gjobë në shumën 138,999 lekë. Në dosje ndodhet Njoftim Vendimi subjekteve me shkresën nr. 1280/3 datë 05/02/2024, subjektit E person fizik me NIPT L18326502G, në të njëjtën ditë me vendimin, por nuk disponohet në dosje kopja e lajmërimit postar. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15.
Në dosje gjendet dokumentacioni mbi shkeljen doganore që përfshin informacion nr. 22610 datë 13.12.2023 për marrje vendimi nga DOH drejtuar DD Lezhë bashkëlidhur fotokopje të dokumentacionit si procesverbal nr. 0001444 datë 06.12.2023, raporte, shkresa, etj (9 dokumente).
Procesverbalet e shkeljes doganore janë njoftuar me shkresën nr. 1280/1 datë 27.12.2023 drejtuar subjektit E person fizik i shoqëruar me lajmërimin postar datë 27.12.2023.
Nga auditimi mbi këtë detyrim doganor konstatohet se nuk janë marrë masat për njoftimin e vendimit në kohë sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës".* Gjithashtu, konstatohet se nuk është marrë në vijimësi asnjë masë proceduriale për ekzekutimin e këtij detyrimi, vendim për rikuperimin me forcë të borxhit doganor sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"* pikën 2.1 dhe 2.6 të kapitullit VII.

**-Subjekti "I".** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr. 4 datë 05.02.2024 të Degës Doganore Lezhë në shumën 32,398 lekë dhe gjobë në shumën 97,194 lekë. Në dosje ndodhet Njoftim Vendimi subjektit me shkresën nr. 1259/3 datë 05/02/2024, subjektit I në të njëjtën ditë me vendimin, por nuk disponohet në dosje kopja e lajmërimit postar. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15.
Në dosje gjendjet dokumentacioni mbi shkeljen doganore që përfshin informacion nr. 22120 datë 07.12.2023 për marrje vendimi nga DOH drejtuar DD Lezhë bashkëlidhur fotokopje të dokumentacionit si procesverbal nr. 0001442 datë 04.12.2023, raporte, shkresa, etj (11 dokumente).
Procesverbalet i shkeljes doganore është njoftuar me shkresën nr. 1259/1 datë 27.12.2023 drejtuar subjektit I i shoqëruar me lajmërimin postar datë 27.12.2023.
Në dosje ndodhen edhe kërkesat për shpallje publike të aktit administrativ drejtuar Bashkisë Tiranë me nr. 1259/5 datë 31.12.2024 dhe drejtuar Prefektit të Qarkut Tiranë me nr. 1259/4 datë 31.12.2024. Për këto kërkesa janë dërguar nga institucionet e mësipërme konfirmimet e Bashkisë Tiranë me nr. 3880/1 datë 31.01.2025 dhe Prefekti i Qarkut Tiranë me nr. 135/3 datë 28.01.2025
Nga auditimi mbi këtë detyrim doganor konstatohet se nuk janë marrë masat për njoftimin e vendimit në kohë sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës",* pasi është kryer mbi 10 muaj vonesë. Gjithashtu, konstatohet se nuk është marrë në vijimësi asnjë masë proceduriale për ekzekutimin e këtij detyrimi, vendim për rikuperimin me forcë të borxhit doganor sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"* pikën 2.1 dhe 2.6 të kapitullit VII.

**-Subjekti "C".** Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr. 25 datë 02.07.2024 të Degës Doganore Lezhë në shumën 1,324,743 lekë sipas rekomandimit nga KLSH. Në dosje ndodhet Njoftim Vendimi subjektit me shkresën nr. 1167/38 datë 02.07.2024 në të njëjtën ditë me vendimin, por nuk disponohet në dosje kopja e lajmërimit postar. Në dosje gjendjet shkresa nr. 1167/23 datë 22.04.2024 për dërgimin e formularit të rivlerësimit sipas rekomandimit të KLSH-së dhe shkresa nr 1167/15 datë 22.04.2024 "Formular rivlerësimi".
Nga auditimi konstatohet se nuk është mbajtur procesverbal sipas pikës 3 të kapitullit III të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*. Gjithashtu nuk është respektuar afati kohor i nxjerrjes së vendimit nga momenti i marrjes dijeni nga dega doganore kompetente në rast të mbajtjes së procesverbalit nga struktura të tjera kontrolluese, sipas kërkesave të shkronjës b), pika 3 e kapitullit IV të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës".*
Sipas vendimit nr. 25 datë 02.07.2024 subjektit i ka lindur detyrim në shumën 1,324,743 lekë për rivlerësimin të deklaratave doganore të mëparshme. Ky detyrim është shlyer në datë 11.10.2024 nëpërmjet llogarisë parapagues në Asycuda sipas kartelës analitike të llogarisë nga programi Alpha Web. Nga auditimi konstatohet se për këtë detyrim janë llogaritur kamatëvonesa nga data e vendimit deri në shlyerjen e tij në shumën 18,616 lekë, ndërkohë që kamatëvonesat duhet të ishin llogaritur që në momentin e lindjes së detyrimit fillestar sipas përcaktimeve të shkronjës b), pika 4.2, kapitulli V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" *"*ii) *Afati kur fillon zbatimi i kamatëvonesës"* në të cilën citohet që *"...Kur një borxh lind sipas nenit 74 ose 77 të Kodit*

*Doganor apo kur njoftimi i borxhit doganor vjen në vijim të një kontrolli, pas çlirimit, norma e kamatvonesave zbatohet mbi shumën e detyrimit të importit ose eksportit duke filluar nga data në të cilën lind borxhi doganor deri në datën e njoftimit të tij.....* dhe *iv)Për rastet e lindjes së detyrimit së borxhit të akcizës për operacionet e parregullta momentit i zbatimit të kamatëvonesës do të jetë momenti në të cilin konstatohet lindja e detyrimit të akcizës që i korrespondon momentit kur është vërtetuar se produktet e akcizës janë prodhuar, importuar, blerë, transportuar, përdorur ose konsumuar në mënyrë të parregullt ose janë hedhur në konsum në mënyrë të parregullt si dhe janë dërguar ose përdorur nga përdorues i përjashtuar për qëllime të tjera nga ato të përcaktuara në autorizim."*[8]. Për rrjedhojë shuma prej 131,843 lekë, nuk është llogaritur dhe pasqyruar saktë në evidencën e borxhit doganor. Këto konstatime janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës".*

**C. Auditimi i dosjeve të borxhit të subjekteve të cilat përfaqësojnë peshën më të madhe ndaj totalit të borxhit doganor në Degën Doganore Lezhë**

**-Subjekti "A" me NIPT KM.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 50 datë 04.10.2013, në shumën 390,215,111 lekë dhe 780,430,222 lekë penalitet për shkelje në fushën e kontrabandës. Në dosje gjendet edhe praktika që përfshin procesverbal për shkeljen doganore me nr. 1424 datë 04.10.2013. Me Vendim nr. 1094/6 datë 11.11.2013 të Degës Doganore Lezhë është vendosur rikuperimi me forcë i borxhit doganor/akcizës, duke përfshirë në këtë akt marrjen e masave shtrënguese.
Kërkesa e Degës Doganore Lezhë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës është kryer me shkresë nr. 1094/10 datë 26.11.2013.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me Vendim nr. 349 datë 12.12.2013 ka miratuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.
Me kërkesë nr. 1094/19 datë 24.01.2014 është kërkuar Zyrës përmbarimore Lezhë vënia në ekzekutim të detyrueshëm i urdhrit ekzekutiv të Gjykatës. Në dosje gjendet dokumentacioni për veprimet e përmbaruesit me përmbajtje si më poshtë:
-Shkresa nr. 1848 datë 05.11.2018 "Vendim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm"
-Urdhër nr. 3283 datë 29.10.2018 "Për vënien e sekuestros konservative" drejtuar bankave të nivelit të dytë, ZVRPP, DRT dhe DSHTRR.

Veprimet e autoritetit doganor për rikuperimin me forcë të borxhit sipas shkresave që disponohen në dosje përfshijnë:
-Shkresa nr.1094/14 datë 27.12.2013 drejtuar ZQRPP për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit për pasuritë e paluajtshme, për të cilën ZQRPP me shkresë nr. 290/1 datë 04.01.2014 i është drejtuar ZVRPP për kompetencë dhe veprim të menjëhershëm.
-Shkresa nr. 1094/14 datë 27.12.2013 drejtuar ZVRPP Lezhë për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit për pasuritë e paluajtshme, për të cilat është kthyer përgjigje me shkresat nr. 1094/22 datë 31.01.2014 të ZVRPP Has se nuk ka pasuri të regjistruar dhe nr. 1094/23 datë 31.01.2014 të ZVRPP Mirditë se nuk ka pasuri të regjistruar.
-Shkresa nr. 1094/15 datë 27.12.2013 drejtuar bankave të nivelit të dytë për vendosje sekuestro ekzekutive mbi llogaritë bankare.
-Shkresa nr.1094/20 datë 27.01.2014 drejtuar QKR për bllokimin e aktivitetit tregtar të subjektit.

[8] *Efekti i kamatvonesave te munguara ne llogaritje sipas KLSH eshte jo material ne shumën 131,843 lekë*

-Shkresa nr. 1094 datë 15.01.2014 e DPD drejtuar DPT për bllokimin e subjektit debitor.

-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin të vazhdueshëm me përmbaruesit gjyqësore, sipas përcaktimeve të pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës".* ku citohet *"..Dega Doganore ti kërkojë informacion me shkrim Zyrës Përmbarimore lidhur me statusin aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv për të gjitha veprimet e kryera, informacion të cilin më pas ia përcjell Sektorit të Monitorimit të Borxhit....*

-Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*.
Në kundërshtim me pikën 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës".*

**-Subjekti "Xh" me NIPT KV.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 3 datë 24.01.2013, në shumën 9,135,000 lekë dhe 45,675,000 lekë penalitet si pasojë e kundravajtjes adminsitrative në fushën e akcizës. Pjesë e dosjes për vendimmarrje është edhe informacion për marrje vendimi nr. 298 datë 09.01.2012 dhe procesverbalet verifikim bllokimi datë 20.12.2012 dhe 07.01.2013.
Me Vendim nr. 750 datë 29.05.2014 të Degës Doganore Lezhë është vendosur rikuperimi me forcë i borxhit doganor/akcizës, duke përfshirë në këtë akt marrjen e masave shtrënguese.
Kërkesa e Degës Doganore Lezhë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës është kryer me shkresë nr. 884 datë 20.06.2014.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me Vendim nr. 266 datë 23.07.2014 ka miratuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.
Në dosje nuk gjendet kërkesa drejtuar Zyrës Përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrit të ekzekutimit, por vetëm dokumentacioni që provon veprimet e ndërmarra nga përmbaruesi me përmbajtje si më poshtë:
-Shkresa nr. 7 datë 08.01.2015 "Vendim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm" e Zyrës Përmbarimore Kurbin.
-Urdhër nr. 710 datë 16.03.2015 "Për vënien e sekuestros konservative" drejtuar bankave të nivelit të dytë, ZVRPP, DRT dhe DSHTRR.

-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin të vazhdueshëm me përmbaruesit gjyqësore, sipas përcaktimeve të pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15.
Në dosje nuk gjendet dokumentacion justifikues për masat e marra nga vetë autoriteti doganor për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, sipas përcaktimeve të pikës XV të Udhëzimit 15 datë

03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*.
Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit të Ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".
Nuk ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*.
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*.
Në kundërshtim me pikë 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sekuestros Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës"*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**Subjekti "A" me NIPT JD.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 8 datë 04.06.2013, në shumën 2,189,290 lekë dhe 4,378,580 lekë penalitet si pasojë e kundravajtjes adminsitrative në fushën e akcizës.
Me Vendim nr. 657/7 datë 21.10.2013 të Degës Doganore Lezhë është vendosur rikuperimi me forcë i borxhit doganor/akcizës, duke përfshirë në këtë akt marrjen e masave shtrënguese.
Kërkesa e Degës Doganore Lezhë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës është kryer me shkresë nr. 657/9 datë 04.11.2013.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me Vendim nr. 330 datë 18.11.2013 ka miratuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.
Me kërkesë nr. 794 datë 10.05.2018 është kërkuar Zyrës përmbarimore Lezhë vënia në ekzekutim të detyrueshëm i urdhrit ekzekutiv të Gjykatës. Në dosje nuk gjendet dokumentacioni për veprimet e përmbaruesit.
Veprimet e autoritetit doganor për rikuperimin me forcë të borxhit sipas shkresave që disponohen në dosje përfshijnë:
-Shkresa nr. 1034/11 datë 15.01.2014 drejtuar ZQRPP për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit për pasuritë e paluajtshme.
-Shkresa nr. 1034/12 datë 15.01.2014 drejtuar bankave të nivelit të dytë për vendosje sekuestro ekzekutive mbi llogaritë bankare.

Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se nuk janë marrë masat e plota nga vetë autoriteti doganor për mbledhjen e borxhit si dhe kërkesa drejtuar përmbarimit është kryer pas 4 vitesh nga nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit.
-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin me përmbaruesit gjyqësore, sipas përcaktimeve të pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*.
Në dosje nuk gjendet dokumentacion i plotë justifikues për masat e marra nga vetë autoriteti doganor për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, sipas përcaktimeve të pikës XV të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*.
Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit të Ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".
Nuk ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15.
Në kundërshtim me pikën 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës".*
Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**Subjekti "A" me NIPT JD.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 48 datë 16.08.2013, në shumën 6,916,075 lekë dhe 20,748,225 lekë penalitet si pasojë e kundravajtjes adminsitrative në fushën e akcizës.
Me Vendim nr. 921/4 datë 21.10.2013 të Degës Doganore Lezhë është vendosur rikuperimi me forcë i borxhit doganor/akcizës, duke përfshirë në këtë akt marrjen e masave shtrënguese.
Kërkesa e Degës Doganore Lezhë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës është kryer me shkresë nr. 921/6 datë 04.11.2013.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me Vendim nr. 329 datë 15.11.2013 ka miratuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.
Me kërkesë nr. 793 datë 10.05.2018 është kërkuar Zyrës përmbarimore Lezhë vënia në ekzekutim të detyrueshëm i urdhrit ekzekutiv të Gjykatës. Në dosje nuk gjendet dokumentacioni për veprimet e përmbaruesit, me përjashtim të shkresës nr. 1535 datë 13.09.2018 "Vendim për transferimin e

çështjes përmbarimore" drejtuar Degës Doganore Lezhë, ku është urdhëruar transferimi i çështjes përmbarimore pranë zyrës përmbarimore Tiranë.

Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se nuk janë marrë masat e plota nga vetë autoriteti doganor për mbledhjen e borxhit si dhe kërkesa drejtuar përmbarimit është kryer pas 4 vitesh nga nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit dhe nuk është ndjekur në vijimësi për statusin e çështjes.
-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin me përmbaruesit gjyqësore, sipas përcaktimeve të pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15.
Në dosje nuk gjendet dokumentacion justifikues për masat e marra nga vetë autoriteti doganor për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, sipas përcaktimeve të pikës XV të Udhëzimit 15.
Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit të Ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".
Nuk ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*.
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*.
Në kundërshtim me pikë 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës".*
Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**Subjekti "A" me NIPT JD.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 49 datë 16.09.2013, në shumën 8,420,657 lekë dhe 25,261,971 lekë penalitet si pasojë e kundravajtjes adminsitrative në fushën e akcizës.
Me Vendim nr. 1034/7 datë 21.10.2013 të Degës Doganore Lezhë (e cila nuk gjendet në dosje, por vetëm njoftimi i VRFB) është vendosur rikuperimi me forcë i borxhit doganor/akcizës, duke përfshirë në këtë akt marrjen e masave shtrënguese.
Kërkesa e Degës Doganore Lezhë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës është kryer me shkresë nr. 1034/9 datë 04.11.2013.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me Vendim nr. 328 datë 18.11.2013 ka miratuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.
Me kërkesë nr. 795 datë 10.05.2018 është kërkuar Zyrës përmbarimore Lezhë vënia në ekzekutim të detyrueshëm i urdhrit ekzekutiv të Gjykatës. Në dosje nuk gjendet dokumentacioni për veprimet e përmbaruesit, me përjashtim të shkresës nr. 1534 datë 13.09.2018 "Vendim për transferimin e

çështjes përmbarimore" drejtuar Degës Doganore Lezhë, ku është urdhëruar transferimi i çështjes përmbarimore pranë zyrë përmbarimore Tiranë.
-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin me përmbaruesit gjyqësore, sipas përcaktimeve të pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15.
Në dosje nuk gjendet dokumentacion justifikues për masat e marra nga vetë autoriteti doganor për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, sipas përcaktimeve të pikës XV të Udhëzimit 15.
Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit të Ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".
Nuk ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*.
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*.
Në kundërshtim me pikën 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës".*
Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**Subjekti "G" me NIPT KT.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 38 datë 30.05.2018, në shumën 439,166 lekë dhe 878,232 lekë penalitet si pasojë e kundravajtjes adminsitrative në fushën e akcizës. Pjesë e dosjes është edhe informacioni nr. 1469/2 datë 08.05.2018 për marrje vendimit i Departamentit të Akcizës në DPD dhe procesverbali nr. 0011350 datë 02.05.2018.
Me Vendim nr. 2080 datë 19.12.2018 të Degës Doganore Lezhë është vendosur rikuperimi me forcë i borxhit doganor/akcizës, duke përfshirë në këtë akt marrjen e masave shtrënguese.
Në dosje gjendet edhe shkresa nr. 870/4 datë 05.07.2018 e DPD drejtuar subjektit dhe për dijeni Degës Doganore Lezhë për saktësim dokumentacioni në lidhje me ankimin e ushtruar në DPD.
Nga auditimi mbi këtë detyrim doganor konstatohet se megjithëse kanë kaluar mbi 4 vite nga vendimmarrja për borxhin, nuk janë ndjekur hapat proceduriale dhe nuk janë respektuar afatet për garantimin e rikuperimit të detyrimit doganor, duke qenë se ende nuk është kryer kërkesa në gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*.

**Subjekti "Gj" me NIPT KE.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 39 datë 29.05.2017, në shumën 2,379,694 lekë penalitet si pasojë e kundravajtjes adminsitrative në fushën e akcizës, në vijim të vendimit nr. 13 datë 22.02.2017. Pjesë e dosjes është edhe procesverbali nr. 009961 datë 27.05.2017.
Me Vendim nr. 440 datë 15.03.2018 të Degës Doganore Lezhë është vendosur rikuperimi me forcë i borxhit doganor/akcizës, duke përfshirë në këtë akt marrjen e masave shtrënguese.
Kërkesa e Degës Doganore Lezhë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit drejtuar Gjykatës është kryer me shkresë nr. 1838 datë 05.11.2018.
Në dosje nuk ka dokumentacion për vijimin e mëtejshëm të procedurës për rikuperimin me forcë për këtë rast, ndërkohë që në evidencën e borxhit ka të shënuar "kthyer nga gjykata", pa dokumentacion shpjegues. Nga auditimi konstatohet se nuk janë marrë masa sipas parashikimeve të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore/akcizës që prej vitit 2018.

**Subjekti "Gj" me NIPT KE.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 40 datë 29.05.2017, në shumën 5,978,988 lekë penalitet si pasojë e kundravajtjes adminsitrative në fushën e akcizës, në vijim të vendimit nr. 24 datë 03.04.2017. Pjesë e dosjes është edhe procesverbali nr. 009963 datë 27.05.2017.
Sipas kërkesës "Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit", me nr.1837 datë 05.11.2018 drejtuar GjASHP Shkodër, është cituar se Dega Doganore Lezhë ka nxjerrë Vendimin nr. 439 datë 15.08.2018 "Për rikuperimin me forcë të borxhit".
Në dosje nuk ka dokumentacion për vijim e mëtejshëm të procedurës për rikuperimin me forcë për këtë rast, ndërkohë që në evidencën e borxhit ka të shënuar "kthyer nga gjykata", pa dokumentacion shpjegues. Nga auditimi konstatohet se nuk janë marrë masa sipas parashikimeve të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore/akcizës që prej vitit 2018.

**Subjekti "Sh" me NIPT KP.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 74 datë 15.11.2018, në shumën 16,809,532 lekë si pasojë e rivlerësimit nga aposteriori i Degës Doganore Lezhë, sipas procesverbalit nr. 0010047 datë 30.12.2018.
Sipas vendimit të Gjykatës Adminsitrative të Shkallës së Parë Shkodër nr. 314 dat 29.09.2021, marrë për objektin e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit mbi Vendimin e Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor nr. 2091 datë 19.12.2018, në vijim të kërkesës datë 19.07.2021 (e cila nuk është pjesë e dosjes) është vendosur pranimi i kërkesës dhe lëshimi i urdhrit të ekzekutimit.
Gjithashtu në dosje gjendet Vendim nr. 1054 datë 07.03.2019 i GJASHP Shkodër ku është vendosur refuzimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë.

Në dosje nuk gjendet dokumentacioni për veprimet e përmbaruesit, kërkesa e drejtuar përmbaruesit për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, me përjashtim të shkresës nr. 1033/3 datë 13.05.2022 "Vendim për transferimin e çështjes përmbarimore" drejtuar Degës Doganore Lezhë, ku është urdhëruar transferimi i çështjes përmbarimore pranë zyrë përmbarimore Tiranë dhe shkresa nr. 359 datë 11.04.2023 "Lajmërim për ekzekutim vullnetar" e Zyrës Përmbarimore Tiranë.

-Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin me përmbaruesit gjyqësore, sipas përcaktimeve të pikës 1.3, kapitulli IX i Udhëzimit nr.15.
Në dosje nuk gjendet dokumentacion justifikues për masat e marra nga vetë autoriteti doganor për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, sipas përcaktimeve të pikës XV të Udhëzimit 15.
Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15, pika 2 "Ekzekutimi i urdhrit të Ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".
Nuk ka korrespondencë me institucionet e tjera për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera, në kundërshtim me pikën 2.2.2 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*.
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës"*.
Në kundërshtim me pikë 2.3. "Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor", konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet që *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës".*
Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**Subjekti "B" me NIPT LF.** Detyrimi për këtë rast ka lindur në bazë të Vendimit nr. 15 datë 12.03.2019, në shumën 3,846,242 lekë dhe 3,846,242 lekë penalitet si pasojë e rivlerësimit nga aposteriori i Degës Doganore Lezhë.
Në Degën Doganore Lezhë nuk disponohet dosje e plotë për detyrimin sipas këtij vendimi që përfshin edhe praktikën për nxjerrjen e tij.
Nga auditimi konstatohet se nuk janë marrë masat për rikuperimin me forcë të këtij borxhi doganor të lindur nga vitet e kaluara, pasi nuk është nxjerrë vendimi për rikuperimin me forcë dhe në vijim kërkesa në gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Nga auditimi konstatohet se nuk janë marrë masa sipas parashikimeve të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore/akcizës që prej vitit 2018.

Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimit, me shkresë nr. 22/13 datë 03.07.2025 nga Dega Doganore Lezhë janë përcjellë observacionet e mëposhtme:
**Pretendimi i subjektit:**
-Janë zbatuar VRFB për rastet e 2024.
-për subjektin C, detyrimi ka lindur si pasojë e deklaratës import 4 bazuar në enent 65-70 të Kodit Doganor dhe kemi të bëjmë me rivlerësim e jo shmangie të nenit 74 pika 1.

-për subjetin xh me shkresën rn.1259 datë 10.09.2024 i DD i është drejtuar ZP për vënien në ekzekutim të udhrit.
-Për pjesën tjetër të subjekeve i referohet veprimeve të ndërmarra për zbatimin e konstatimeve të KLSH.
-Për kontabilizimin janë pasqyruar artijut kontabël të konstatimin dhe arkëtimit të të drejtave dhe fakti që për arsye të ndjekjes së borxhit nga fiannca mbahet i specifikuar në excel ku është i gjithë informacioni për vendimin doganor.
***Qëndrim i grupit të auditimit:*** *Sqarojmë se veprimet për zbatimin e konstatimeve janë objekt i zbatimit të rekomandimeve dhe vlerësojmë iniciativën për përmirësimine e situatës. Për momentin e llogaritjes së kamatvonesave i qendrojmë të njejtit konstatim sikurse referohet në bazën ligjore të gjetjes dhe argumentimit përkatës nga ana jonë në udhëizmin e borxhit dhe Kodit Doganor. Për pjesën e kontabilizimit të ndarë pranojmë observacionin për pasqyrimin në excel të të dhënave megjithatë kontabilizimi në sistemin alpha është një cështje që duhet rregulluar nga DPD në lidhje me përputhshmërinë me udhëzimin të këtyre veprimeve. Për këto arsye observacioni merret në konsideratë pjesërisht.*

### III.2.4.5. Masat e marra për mbledhjen e detyrimeve doganore të papaguara në nivel dege doganore dhe aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për Degën Doganore Berat.

Zyra e borxhit doganor në Degën Doganore Berat funksionon sipas strukturës së miratuar me VKM nr. 355 datë 26.05.2022 '*Për personelin e administratës doganore'*, në të cilën evidentohen një pozicion pune jurist/specialist borxhi.

Auditimi mbi menaxhimin e Borxhit Doganor (BD), u fokusua në evidentimin e gjendjes së detyrimeve të subjekteve debitorë, krijimin e detyrimeve, gjendjen në fillim dhe në fund, kontabilizimin e tyre, strukturën e detyrimeve, llojshmëria, pesha specifike në total, masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor etj.

Bazuar në evidencën e vendosur në dispozicion nga Dega e Doganës |Berat, rezulton se gjendja e borxhit doganor më 31.12.2024 paraqitet me 66 raste për 54 subjekte debitorë në vlerën 1,338,692,916 lekë, dhe gjendja e borxhit më datë 01.01.2024 paraqitet me 70 raste, për 57 subjekte debitorë në vlerën 1,331,716,126 lekë. Pra gjatë vitit ushtrimor 2024, borxhi doganor është ulur me 4 raste në krahasim me numrin në fillim të vitit, si dhe është ulur me 3 subjekte debitorë në numër ndërsa në vlerë është shtuar me 6,976,790 lekë ose me 0.52%. Gjendja e detyrimeve në 31.12.2024 sipas strukturave konstatuese për detyrimet doganore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Struktura Konstatuese | Vlera e detyrimit |
|---|---|
| Auditi | 7,185,822 |
| D.DOGANORE | 75,142,526 |
| D.DOGANORE-AKCIZA | 2,322 |
| D.DOGANORE-AUDITI | 2,639,802 |
| D.K.P.ZH | 3,625,685 |
| D.K.P.ZH/DOH | 18,156,059 |
| D.P.TATIME | 746,956,828 |
| D.P.V.D | 36 |
| DAB | 12,104,278 |
| DOH | 17,700,688 |
| Dr.Akcizës | 442,369,152 |

| | |
|---|---|
| K.L.SH | 12,809,717 |
| **Totali** | **1,338,692,916** |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Berat*

-Nga auditimi mbi evidencën e vendosur në dispozicion nga Dega Doganore Berat për gjendjen e detyrimeve doganore të papaguara në fund të vitit 2024, rezulton se gjatë vitit 2024 nuk është krijuar asnjë borxh i ri, por shtesa e borxhit ka ardhur vetëm nga kamatëvonesat shtesë mbi borxhin e mbartur nga vitet e kaluara. Teprica fillestare e borxhit e analizuar me shtesat dhe pakësimet gjatë vitit së bashku me gjendjen përfundimtare në 31.12.2024 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Dega Doganore | Nr.Raste 01.01.2024 | Shuma në 01.01.2024 | Nr. Raste Shtesa 2024 | Shuma e shtesave në 2024 | Nr. Raste Pakësime 2024 | Shuma e pakësimeve në 2024 | Nr. Raste 31.12.2024 | Shuma në 31.12.2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 70 | 1,331,716,126 | 17 | 8,686,909 | 21 | 1,710,119 | 66 | 1,338,692,916 |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Berat*

Shtesat e vitit në shumën 8,687 mijë lekë konstatohet se kanë ardhur në rreth 7,630 mijë lekë nga rritja e kamatvonesave dhe në shumën 1,052 mijë lekë nga vendime të marra gjatë vitit 2024. Për këto vendime të marra gjatë vitit 2024, janë kryer menjëherë pagesat gjatë vitit duke mos krijuar borxh të ri doganor si rezultat i veprimtarisë së vitit 2024. Pakësimet e borxhit në shumën 1,710 mijë lekë kanë shkuar për vendimet e vitit 2024 në shumën 1,051 lekë dhe pjesa tjetër prej 658 mijë lekë ka shkuar për shlyerjen e vendimeve të viteve të kaluara, qofte kjo shlyerje pjesore apo përfundimtare për heqje nga regjistri i borxhit.

Nga auditimi në lidhje me kontabilizimin e shumave të borxhit doganor, konstatohet se sipas kartelës së llogarisë 468 "Debitorë", regjistrimi i analitik i detyrimit, penalitetit apo kamatvonesave nuk kryhet i ndarë për subjektin sipas vendimit dhe përcaktimeve të pikës 2, kapitulli V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" ku citohet *"Kontabilizimi i shumës së detyrimeve bëhet në zëra të veçantë: a)një zë për shumën e borxhit doganor (detyrimet e import/eksportit të papaguara) dhe apo detyrimeve të akcizës, b) një zë për shumën për shumën e penaliteteve, c) një zë për shumën e kamatvonesave."*

**A. Auditim mbi evidencën e borxhit doganor në Degën e Doganës Berat**

Nga rastet e cituara rezulton se Dega Doganore Berat ka në proces gjyqësor 5 raste me vlerë 25,123 mijë lekë të cilët rezultojnë se nuk kanë ndjekur procedurën administrative të ankimit pasi nuk është likuiduar detyrimi doganor si dhe nuk janë garantuar gjobat parashikuar nga neni 281-282 i Kodit Doganor i cili ka parashikuar se: *Kundër vendimit të autoriteteve doganore kompetente, shkelësi mund t'i paraqesë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave një kërkesë ankimore të arsyetuar, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit. Për të paraqitur ankesën, ankimuesi duhet të paguajë shumën e përgjithshme të detyrimeve të importit ose eksportit, sipas përkufizimeve të këtij titulli, si dhe të garantojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e sanksioneve të aplikuara për shkeljen, objekt konflikti. Ankimuesi duhet të bashkëshoqërojë ankimin me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e tij.*

Nga zyra Juridike me qëllim uljen e borxhit doganor, deri në fund të vitit 2024 kanë dalë 64 VRFB me vlerë 1,338,690 mijë lekë, **ndërsa për 2 raste të tjera nuk janë nxjerrë VRFB (nga të cilat njëra është paguar vullnetarisht në shumën 2 mijë lekë dhe rasti tjetër është jo material në vlerën 36 lekë)**, janë dërguar kërkesa për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit në gjykatë për 61 raste me vlerë 1,338,211 mijë lekë, **ndërsa për 4 raste me vlerë 481 mijë lekë nuk janë dërguar kërkesa lëshimin e urdhërit të Ekzekutimit në gjykatë (nga të cilat njëra është paguar vullnetarisht)**, nga ana e Gjykatës janë lëshuar Urdhër Ekzekutimi për 55 raste me vlerë 1,301,804 mijë lekë, **ndërsa për 10 raste në vlerën 36,888 mijë lekë vlerë borxhi doganor rezulton të mos këtë lëshim urdhër ekzekutimi nga Gjykata**, janë dërguar për ekzekutim zyrës së Përmbarimit Shtetëror 55 raste me vlerë 1,301,804 mijë lekë.

-Konstatohet se nuk janë dokumentuar hapat proceduriale të ndjekura nga autoriteti doganor dhe nuk janë paraqitur sipas kërkesave të pikës 4 dhe 5 të kapitullit VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* ku citohet *"Dega Doganore është përgjegjëse për dërgimin sipas ligjit të akteve të mësipërme në Gjykatë dhe nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit. Në të gjitha rastet, kërkesa për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit, Urdhri i Ekzekutimit i nxjerrë nga Gjykata si dhe çdo akt tjetër i gjykatës bëhen pjesë e dosjes së debitorit."*. Nga auditimi mbi evidencën e borxhit të Degës Doganore Berat konstatohet se përgjithësisht janë ndjekur hapat proceduriale për rikuperimin e borxhit doganor, nga nxjerrja e vendimit, deri në lëshimin e urdhrit ekzekutiv nga Gjykata kompetente, me problematika në afate. Megjithatë, konstatohet se për vitin 2024, në 10 raste, megjithëse kanë kaluar mbi një vit nga data e vendimit për shpalljen debitor, ende nuk është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit nga Gjykata kompetente. Kjo ka ndodhur për 6 raste, kur nga Dega Doganore është dërguar në gjykatë kërkesa për titull ekzekutiv dhe ende nuk ka një përgjigje nga ana e Gjykatave në tejkalim të afateve. Në 4 raste të tjera, megjithëse është nxjerrë VRFB, nuk është kërkuar në Gjykatë lëshimi i urdhrit të ekzekutimit menjëherë. Këto raste paraqiten si më poshtë:

| NIPT | Subjekti | Nr. Vendimi | Date | Dërguar ne gjykatë | Data | Shuma e papaguar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| KT | M | 8 | 10.11.23 | 2528 | 20.12.23 | 31,392,182 |
| LU | T | 42 | 10.05.22 | 1268 | 07.07.22 | 2,433,816 |
| JA | L | 51 | 01.07.22 | 1900 | 14.10.22 | 1,928,947 |
| KP | I | 38 | 29.04.22 | | | 342,589 |
| LA | V | 5 | 16.02.22 | 2643 | 24.12.24 | 299,205 |
| KT | M | 33 | 19.04.22 | 7895 | 27.05.22 | 200,000 |
| MA | N | 7 | 04.11.23 | 2560 | 21.12.23 | 153,045 |
| KD | B | 6 | 05.02.18 | | | 128,548 |
| KD | B | 5 | 05.02.18 | | | 7,960 |
| KM | K | 20 | 04.12.23 | | | 2,322 |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Berat*

Këto raste janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në duke qenë në pikën 1 të kapitullit VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* ku citohet *"Menjëherë mbas marrjes dijeni të vendimit për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, pra pas kthimit në titull ekzekutiv, specialisti – jurist/specialist borxhi i sektorit/zyrës së administratës dhe shërbimit në degën doganore dërgon në gjykatë kërkesën për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit".*

## B. Auditimi i dosjeve të përzgjedhura

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën për auditim 8 vendime (dosje) në total për detyrime të papaguara në vlerën 1,232,441 mijë lekë, të cilët përfaqësojnë 92 % të vlerës së borxhit doganor në Degën Doganore Berat, të cilat trajtohen rast pas rasti.
Raste të reja që i takojnë detyrimeve të papaguara në 31.12.2024 si pasojë e vendimeve administrative të vitit 2024 nuk ka pasur dhe nuk janë paraqitur në evidencën e borxhit. Për rrjedhojë, janë kërkuar dosjet e subjekteve më përfaqësuese të dy viteve të fundit 2022-2023 dhe dosjet e subjekteve me peshën më të madhe në raport me totalin e borxhit doganor në këtë Degë Doganore. Kjo zgjedhje paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Emri Subjektit | Viti | Detyrimi doganor | Penalitete | Interesa | Shuma totale | Shuma e paguar | Shuma për tu paguar | Vendim | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Nr. | Dt. |
| M | 2022 | 11,975,216 | 11,995,216 | 830,278 | 24,800,710 | | 24,800,710 | 52 | 06.07.22 |
| N | 2023 | 148,545 | | 4,500 | 153,045 | | 153,045 | 7 | 04.11.23 |
| M | 2023 | 10,359,318 | 20,718,636 | 314,228 | 31,392,182 | | 31,392,182 | 8 | 10.11.23 |
| K | 2023 | 2,322 | 11,610 | | 13,932 | 11,610 | 2,322 | 20 | 04.12.23 |
| A | 2011 | 192,162,000 | 389,324,000 | 165,267,153 | 746,753,153 | | 746,753,153 | 1611 | 23.08.19 |
| E | 2014 | 47,379,648 | 188,906,944 | *59,112,927* | 295,399,519 | 44,751,317 | 250,648,202 | 8 | 18/01/14 |
| E | 2013 | 25,489,160 | 76,967,480 | 43,883,206 | 146,339,846 | | 146,339,846 | 20 | 14.02.13 |
| B | 2014 | 8,707,546 | 25,092,518 | 7,259,251 | 41,059,315 | 8,707,546 | 32,351,769 | 156 | 12/2/14 |

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Degës Doganore Berat*

Janë kërkuar dosjet e rasteve të përzgjedhura për auditim për detyrimet e pa paguara dhe auditimi i detajuar për secilën dosje paraqitet:

### 1.Subjekti "M" me NIPT "KT".

Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas **Vendimit nr. 52 datë 06.07.2022** të Degës Doganore Berat në shumën 11,975,216 lekë dhe gjobë në shumën 11,995,216 lekë. Ky vendim është njoftuar me shkresën nr.1264/2 datë 06.07.2022, në të njëjtën ditë me daljen e vendimit për të cilën është marrë dijeni në 14.07.2022 sipas lajmërimit postar.
- Vendimi është marrë në vijim të procesverbalit nr. 00068851 me nr. 433/5 datë 11.05.2022 dhe procedurës për kryerjen e kontrollit dhe hartimin e raportit përfundimtar të Kontrolli, brenda afatit 60 ditor për marrjen e tij.
- Dega e Doganës Berat ka marrë Vendimin nr.15 datë 12.08.2022 për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, e cila është njoftuar me shkresën 1529/1 datë 15.08.2022, duke mos e nxjerrë VRFB brenda afatit të parashikuar në pikën 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, ku citohet *"Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 280 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të Ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës. Ky vendim bëhet pjesë e dosjes së detyrimeve të papaguara".*

- Njoftimi i VFRB-së është kryer me shkresën nr.1529/1 datë 15.08.2022 për të cilën është marrë dijeni sipas lajmërimit postar datë 29.08.2022, ndërkohë që kërkesa për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit me nr.1529/2 datë 06.09.2022, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është kryer jo në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, pika 1 e kapitullit VIII *"Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit"*, ku citohet se: *"Menjëherë mbas marrjes dijeni të vendimit për zbatimin e masave garantuese dhe/ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara, pra pas kthimit në titull ekzekutiv, specialisti – jurist/specialist borxhi i sektorit/zyrës së administratës dhe shërbimit në degën doganore dërgon në gjykatë kërkesën për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit".*
- Gjykata ka lëshuar Urdhër Ekzekutimin nr.365, datë 19.09.2022, dhe në vijim është bërë kërkesë me nr.2239 datë 05.12.2022, drejtuar Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Berat për ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrit të ekzekutimit, pas kërkesës me nr.1529/4 datë 21.11.2022, *"Lajmërim për ekzekutim vullnetar"* drejtuar subjektit, në kundërshtim me pikën 1.1 të kapitullit IX ku citohet se *"..menjëherë me nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit dërgon pranë Shërbimit Përmbarimor kërkesën për ekzekutimin e këtij urdhëri të ekzekutimit.".*

-Gjithashtu për këtë detyrim doganor janë marrë masa edhe nga Dega e Doganës Berat për ekzekutimin e detyrueshëm që përfshijnë:
-Kërkesë nr. 2237 datë 05.12.2022 drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë, Pro Credit me nr.2385 datë 19.12.2022;
-Kërkesë nr. 2233 datë 05.12.2022 drejtuar ZRVPP, vendosjen e sekuestros dhe kthim përgjigje nr. 4636/1 datë 14.12.2022;
-Kërkesë nr. 2236 datë 05.12.2022 drejtuar QKB, "Kërkesë për pezullim NIPT-i";
-email sipas evidencës në datë 05.12.2022 drejtuar DPT.

-Në vijim me shkresën nr.23884, datë 18.11.2024, nga Dega e Doganës Berat është kërkuar informacion Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Berat mbi situatën aktuale të ekzekutimit të titujve ekzekutivë, për të cilën nuk ka asnjë kthim përgjigje.

-Nga auditimi konstatohet se Urdhri i Ekzekutimit lëshuar nga Gjykata është në muajin Shtator, ndërkohë që dërgimi në përmbarim ka ndodhur në muajin Nëntor dhe njoftimi i bankave është kryer në muajin Dhjetor duke mos marrë në kohë masa të menjëhershme për rikuperimin me forcë të borxhit nga vetë autoriteti doganore për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit.

Në dosje nuk ka dokumentacion që provon bashkëpunimin me strukturat e DPD-së për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit sipas kërkesave të pikës 2.2.1, kapitulli IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*
Në dosje nuk gjendet dokumentacion që provon nxjerrjen e urdhrit të sekuestros ekzekutive për vendosjen e saj sipas kërkesave të pikës 2.3 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, nëpërmjet bashkëpunimit me Drejtoritë e tjera në DPD.

**2. Subjekti M me NIPT KT.**

Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas **Vendimit nr. 8 datë 10.11.2023** të Degës Doganore Berat në shumën 10,359,318 lekë dhe gjobë në shumën 20,718,636 lekë. Ky vendim është njoftuar me shkresën nr. 2109/4 datë 10.11.2023, në të njëjtën ditë me daljen e vendimit për të cilën është marrë dijeni në 15.11.2023 sipas lajmërimit postar.
Vendimi është marrë në vijim të procesverbalit nr. 0006785 me nr. 2109 datë 26.10.2023 dhe procedurës për kryerjen e kontrollit dhe hartimin e raportit përfundimtar të Kontrolli, brenda afatit 60 ditor për marrjen e tij.

-Dega e Doganës Berat ka marrë Vendimin nr.2 datë 14.12.2023, për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, e cila është njoftuar me shkresën 2109/6 datë 14.12.2023, marrë dijeni në 18.12.2023, duke mos e nxjerrë VRFB brenda afatit të parashikuar në pikën 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, ku citohet *"Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 282 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës.*

-Njoftimi i VFRB-së, është kryer me shkresën nr.2109/6 datë 14.12.2023, marrë dijeni në 18.12.2023, ndërkohë që kërkesa për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit me nr.2528 datë 20.12.2023 drejtuar Gjykatës Adminsitrative të Shkallës së Parë Lushnje.

***Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se*** ende nuk është lëshuar urdhri i ekzekutimit në vijim të kërkesës për lëshimin drejtuar Gjykatës, megjithëse kanë kaluar mbi një vit, duke mos pasur kushtet për të vazhduar me masat e mëtejshme për ekzekutimin e detyrueshëm, në kundërshtim me Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

**3. Subjekti "N." shpk me NIPT MA.**

Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.7 datë 10.11.2023, të Degës Doganore Berat në shumën 148,545 lekë. Ky vendim është njoftuar me shkresën nr. 2211/3 datë 11.11.2023. Vendimi është marrë në vijim të procesverbalit nr. 1990 datë 09.10.2023 njoftuar në po të njëjtën datë.

-Me shkresë nr. 2211/4 datë 14.12.2023, marrë dijeni 21.12.2023, Dega e Doganës Berat ka marrë Vendimin nr.1 datë 14.12.2023 për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore. Nga auditimi konstatohet se VRFB është marrë përtej afatit të parashikuar në Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, pika 2.1 e kapitullit VII ku citohet se:*"Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 282 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të ligjit nr.44*

*datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës.*

Njoftimi i VRFB është kryer me shkresën nr. 2211/4 datë 14.12.2023, marrë dijeni 21.12.2023, dhe në vijim me shkresë nr. 2560 datë 21.12.2023 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje është kërkuar lëshimi i urdhrit të ekzekutimit, menjëherë sipas parashikimeve të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*.

Nga auditimi mbi këtë dosje konstatohet se ende nuk është lëshuar urdhri i ekzekutimit në vijim të kërkesës për lëshimin drejtuar Gjykatës, megjithëse kanë kaluar mbi një vit, duke mos pasur kushtet për të vazhduar me masat e mëtejshme për ekzekutimin e detyrueshëm.

**4. Subjekti "K." shpk me NIPT KM.**

Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.20 datë 04.12.2023 të Degës Doganore Berat në shumën 2,322 lekë dhe penalitet në shumën 11,610 lekë. Ky vendim është njoftuar me shkresën nr. 22148/6 datë 04.12.2023, marrë dijeni në datën 08.12.2023. Vendimi është marrë në vijim të procesverbalit nr. 0002390 nr. 2248 datë 15.12.2023.
-VRFB është kryer me vendim nr. datë 08.01.2024 ndërkohë që njoftimi mbi vendimin e shpalljes debitor është kryer në datë 08.12.2023, në kundërshtim me pikën 2.1 të kapitullit VII ku citohet *"Kur debitori nuk ekzekuton vullnetarisht detyrimet e papaguara, duke filluar nga e nesërmja që debitori ka marrë dijeni mbi njoftimin/vendimin për shpalljen debitor, pas mbarimit të afatit 10 ditor për vendimet e trajtuara sipas Kodit Doganor ose sipas Ligjit për Akcizën, dega doganore bazuar në nenet 282 të Kodit Doganor dhe nenin 103 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" në zbatim të nenit 133/3 të ligjit nr.44 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë kalon në ekzekutim forcërisht përmes nxjerrjes së vendimit administrativ për zbatimin e masave garantuese dhe /ose rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara doganore/akcizës".*
Njoftimi i VRFB është kryer me shkresën nr.2248/8 datë 08.01.2024 marrë dijeni në 10.01.2024 dhe në dosje nuk ka kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit në kundërshtim me Udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*

**C. Vendime për shpallje debitor për dosjet me peshë më të madhe ndaj totalit të borxhit doganor në Degën Doganore Berat.**

**1. Subjekti "B" me NIPT "LA"**

Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.156 prot., datë 02.12.2014 të Degës Doganore Berat në shumën 8,707,546 lekë dhe penalitet në shumën 25,092,518 lekë.
Ky vendim është njoftuar me shkresën nr.1606/1 datë 02.12.2014, marrë dijeni në datën 05.12.2014 dhe ankimuar në DPD sipas shkresës nr.09 datë 05.01.2015.

-Me shkresën nr.467 datë 30.04.2015, Dega e Doganës Berat ka marrë Vendimin nr.23 datë 30.04.2015 për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore.
-Kërkesa për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit është kryer me shkresën nr.581 datë 08.05.2019, drejtuar Gjykatës Adminsitrative të Shkallës së Parë Vlorë, pra *me 4 vjet vonesë*.
Vendimi për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, është me nr.392 datë 06.06.2019. Lajmërimi për ekzekutim vullnetar është kryer me shkresën nr. 920 datë 12.09.2019.

-Kërkesa për ekzekutimin e detyrueshëm të Urdhrit të Ekzekutimit është kryer me shkresën nr. 941 datë 18.09.2019, drejtuar Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Berat. Shkresa nr.436 datë 06.03.2020 e Zyrës Përmbarimore Lushnje, informon se janë në pritje të përgjigjeve drejtuar institucioneve. Me shkresë nr. 216 datë 01.06.2021 është komunikuar Vendimi i zyrës së përmbarimit Lushnje për transferimin e çështjes në zyrën përmbarimore Berat.
Nga Dega e Doganës Berat, janë marrë masat e mëposhtme:
-Shkresa nr.1095 datë 06.11.2019, drejtuar QKB për pezullim NIPT;
-Shkresa nr.1096 datë 06.11.2019, drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë për vendosjen e masës së sekuestros ekzekutive mbi llogaritë e subjekteve debitore;
-Shkresa nr.1097 datë 06.11.2019, drejtuar ZRVPP Berat për ekzekutimin e detyrueshëm të Urdhrit të Ekzekutimit me anë të vendosjes së sekuestros në hipotekë.
Gjithashtu nga Dega e Doganës Berat me shkresë nr. 2384 datë 18.11.2024 "Kërkesë për informacion" drejtuar Zyrës Përmbarimore Gjyqësore Berat është kërkuar informacion për situatën aktuale të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

***Konkluzion***
Gjithashtu konstatohet se nuk është shfrytëzuar mundësia për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për zbatimin e masave garantuese nga vetë autoriteti doganor përmes strukturave të rikuperimit me forcë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi sipas përcaktimit të Kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, pika 2 *"Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor".*
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*.
Në kundërshtim me pikën 2.3. *"Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor"*, konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet se *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës"*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* ku përcaktohet se *"Administrata doganore përdor mënyrën me efikase dhe më të sigurtë për mbledhjen e shumës së detyrimeve të papaguara, nga ana e debitorit..."* përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin

nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor *"1. Kur shuma e detyrimeve të importit ose eksportit që duhen paguar nuk është shlyer brenda afateve të përcaktuara në këtë Kod: a) autoritetet doganore përdorin të gjitha mjetet ligjore për të siguruar pagesën e shumës së borxhit; b) përveç shumës së detyrimeve të importit ose eksportit ngarkohen edhe kamatëvonesat. 2. Autoritetet doganore, kur lind një borxh, me qëllim që të sigurojnë pagimin e këtij borxhi, mund të marrin masat e mëposhtme: a) sekuestrimin e vlerave monetare, të kredive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumenteve, me anë të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në një bankë, që i përkasin debitorit ose garantuesit/garantuesve; b) sekuestrimin e mallrave, të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, që i përkasin debitorit ose garantuesit /gantuesve, i cili/të cilët ka/kanë detyrime kundrejt debitorit. 3. Autoritetet doganore, përveç ushtrimit të kompetencave të tyre, sipas këtij Kodi, mund t'u kërkojnë autoriteteve kompetente edhe marrjen e masave të tjera specifike, si pezullimi i veprimtarive ekonomike të debitorit ose të veprimtarive të tjera prodhuese, për ushtrimin e të cilave debitori është regjistruar pranë këtyre autoriteteve. 4. Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit bëhen tituj ekzekutivë menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit. 5. Ekzekutimi i titujve ekzekutivë të nxjerrë nga administrata doganore, të mbështetur me urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga autoritetet gjyqësore kompetente, bëhet menjëherë në bazë të dispozitave të parashikuara nga nenet 511 e në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile. Ekzekutimi mund të bëhet edhe nga strukturat e mbledhjes me forcë të detyrimit pranë administratës doganore. 6. Pas aplikimit të masave të parashikuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të këtij neni, autoritetet doganore procedojnë me konfiskimin, në përputhje me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative."*

**2. Subjekti "A" me NIPT "KD"**

Kjo dosje është transferuar sipas shkresës nr. 1069/3 datë 12.04.2019, *"Transferim i të dhënave për subjektet e akcizës të cilat rezultojnë me detyrime të papaguara"* të Degës Doganore Berat drejtuar DPT.
Ky transferim është kryer në vijim të Udhëzimit nr. 9, datë 11.03.2019 të Ministrit të MFE-së, *"Mbi modalitetet e transferimit pranë administratës doganore të të dhënave për subjektet e akcizës të cilët rezultojnë me detyrime të papaguara dhe Urdhër nr.21009, datë 16.08.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD-së".*
Me Vendimin nr.296, datë 18.03.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë është rrëzuar kërkesa e DRT-së Berat për fillimin e procedurës së falimentit.
Me marrjen e dosjes nga DPD është kryer lajmërim për ekzekutim vullnetar, njoftim për shpallje të lajmërimit dhe në vijim VRFB nr. 17 dat 28.10.2019, njoftuar me shkresën nr. 1054/1 datë 28.10.2019, për të cilën është kryer kërkesë për shpallje publike Bashkisë Çorovodë. Kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit është kryer me nr.1122 datë 12.11.2019, drejtuar Gjykatës Lushnje dhe Gjykata me Vendimin nr.625 datë 27.11.2019, ka lëshuar Urdhrin e Ekzekutimit.
Me shkresë nr.1199, datë 19.12.2019, është kërkuar ekzekutimi i detyrueshëm i Urdhrit të ekzekutimit drejtuar Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Berat.
Në dosje administrohen kërkesat e bëra nga Dega e Doganës Berat si më poshtë:
-Shkresë nr.315, datë 10.02.2020 drejtuar ASHK Berat;
-Shkresë nr.317, datë 10.02.2020 për pezullim NIPT-i drejtuar QKB-së;
-Shkresë nr.318, datë 10.02.2020 drejtuar DPSHTRR-së;

-Shkresë nr.481, datë 04.03.2020 drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë.
Gjithashtu nga Dega e Doganës Berat me shkresë nr. 2384 datë 18.11.2024 "Kërkesë për informacion" drejtuar Zyrës Përmbarimore Gjyqësore Berat është kërkuar informacion për situatën aktuale të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

***Konkluzion***
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*.
Në kundërshtim me pikë 2.3. *"Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor"*, konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet se *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës"*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**3. Subjekti "E" sha me NIPT "LK"**
Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.20 prot. 1606, datë 14.02.2013 të Degës Doganore Berat në shumën 25,489,160 lekë dhe penalitet në shumën 76,467,480 lekë.
Ky vendim është njoftuar me shkresën nr.210//1, datë 14.02.2013, marrë dijeni në datën 18.02.2013.
-Dega Doganore ka nxjerrë VRFB me Vendimin nr.46, datë 27.04.2013 është njoftuar me shkresën nr.524/1 datë 27.04.2013.
Kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit është kryer me nr.735, datë 21.05.2013 drejtuar Gjykatës së rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykata me Vendimin nr.175, datë 30.05.2013 ka lëshuar Urdhrin e Ekzekutimit.
Me Vendim nr.741 regj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka marrë Vendim për sigurimin e padisë datë 29.04.2013 dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit.
Gjykata Adminsitrative e Apelit me Vendimin nr. 2557, datë 14.09.2016 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së shoqërisë ndaj Degës Doganore Berat.
Me shkresën nr.642, datë 14.06.2019, drejtuar Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Berat është kërkuar ekzekutimi i detyrueshëm i Urdhrit të ekzekutimit me nr.175, datë 30.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.
Në dosje administrohen kërkesat e bëra nga Dega e Doganës Berat si më poshtë:
-Shkresë nr.1097, datë 06.11.2019 drejtuar ASHK-së Berat;
-Shkresë nr.1095, datë 06.11.2019 për pezullim NIPT-i drejtuar QKB-së;
-Shkresë nr.1096, datë 06.11.2019 drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë.

Gjithashtu nga Dega e Doganës Berat me shkresë nr. 2384 datë 18.11.2024 "Kërkesë për informacion" drejtuar Zyrës Përmbarimore Gjyqësore Berat është kërkuar informacion për situatën aktuale të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

***Konkluzion***
Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*.
Në kundërshtim me pikë 2.3. *"Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor"*, konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet se *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës"*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

**4. Subjekti "E" sha me NIPT "LK"**

Detyrimi për këtë rast ka lindur sipas Vendimit nr.8 prot.79, datë 18.01.2014 të Degës Doganore Berat në shumën 47,379,648 lekë dhe penalitet në shumën 188,906,944 lekë.
Ky vendim është njoftuar me shkresën nr.79/1, datë 18.01.2014, marrë dijeni në datën 21.01.2014.
-Dega Doganore ka nxjerrë VRFB me Vendimin nr.761, datë 20.06.2018, me ***4 vjet vonesë***, i cili është njoftuar me shkresën nr.761/1 datë 20.06.2018, si dhe kërkesa për shpallje publike nr.190 datë 19.02.2019, drejtuar Bashkisë Kuçovë dhe nr.217, datë 26.02.2019 drejtuar QKB-së.

Kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit është kryer me nr.525, datë 13.05.2019 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe Gjykata me Vendimin nr.311, datë 08.07.2019 ka lëshuar Urdhrin e Ekzekutimit.
Lajmërimi për ekzekutim vullnetar të urdhrit të ekzekutimit është kryer me shkresën nr.677, datë 29.06.2019.
Me shkresën nr.719, datë 08.07.2019 drejtuar Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Berat është kërkuar ekzekutimi i detyrueshëm i Urdhrit të Ekzekutimit.
Në dosje administrohen kërkesat e bëra nga Dega e Doganës Berat si më poshtë:
-Shkresë nr.1097, datë 06.11.2019 drejtuar ASHK-së Berat;
-Shkresë nr.1095, datë 06.11.2019 për pezullim NIPT-i drejtuar QKB-së;
-Shkresë nr.1096, datë 06.11.2019 drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë.
Nga përmbaruesi janë referuar shkresat nr.16124, datë 27.12.2019, *"Lajmërim për ekzekutim vullnetar"* dhe Vendimi nr.3851 datë 16.06.2020, *"Për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të Urdhrit të Ekzekutimit"*.

Gjithashtu nga Dega e Doganës Berat me shkresë nr. 2384 datë 18.11.2024 "Kërkesë për informacion" drejtuar Zyrës Përmbarimore Gjyqësore Berat është kërkuar informacion për situatën aktuale të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

***Konkluzion***

Nga Dega Doganore nuk ka komunikim të brendshëm në dosje për vendosjen e sekuestros konservative në bashkëpunim me njësitë e specializuara në DPD, sipas kërkesave të pikës 2.2.1 të kapitullit IX të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*.

Në kundërshtim me pikë 2.3. *"Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor"*, konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet se *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sektuestos Ekzektuive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës"*

Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.

Nga Dega Doganore Berat me shkresë nr. 22/12 datë 12.06.2025 janë përcjellë observacione mbi Projekt Raportin ku është parashtruar:

**Pretendimi i subjektit:**

-Sipas pikës 2.3.3. të udhëzimit, nga struktura e DPD nuk ka njoftim ër pjesëmarrje në bashkëpunim me Antikontrabandën, apo të pasurive të identifikuara

-për rekomandimin 18.1, ligji dhe udhëzimi japin qartë afatin e ankimitmit prej 30 ditë.

-për rekomandimin 19.1 për afatet e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, janë paraqitur po të njejtat argumenta si në akt konstatime të cilat janë marrë në konsideratë.

-për rekomandimin 20.1 është kërkuar në gjykatë informacionmbi statusin....

***Qëndrimi i grupit të auditimit:*** *Në përgjigje të këtyre observaioeve sqarojmë se janë marrë në konsideratë argumentat për disa vonesa dhe konstatime mbi evidencën që për shkak të shumave të përfshira dhe veprimeve pas periudhës objekt auditimi faktojnë detyrimet e arkëtuara, Observacionet janë të njejta me fazën e akt konstatimeve dhe qendrimi për marrjen e masave sipas pikës 2.3.3. të udhëzimit është i njejtë nga ana e grupit të auditimit.*

## IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave:

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se në fund të vitit 2024 rezulton një nivel i detyrimeve të papaguara doganore në shumën 48,588,510 mijë lekë, e përfaqësuar nga 4684 raste. Nga krahasimi i të dhënave të detyrimeve doganore të papaguara në krahasim me një vit më parë rezulton se borxhi doganor ka një rritje prej 994,940 mijë lekë ose 2.1%. Gjithashtu edhe në numër rastesh, sipas përmbledhëses së hartuar nga DPD, borxhi doganor rezulton në rritje nga 4495 raste në fund të vitit 2023, në 4680 raste në fund të vitit 2024, me një rritje prej 185 rastesh më shumë. Në fund të vitit 2024 rezultojnë debitorë 3196 subjekte, me një rritje prej 185 subjektesh debitorë, nga 3011 subjekte debitorë që rezultojnë në fillim të vitit.
Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, rritja më e madhe e detyrimeve të papaguara doganore ka ndodhur në vitin 2019 si rezultat i transferimit të detyrimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), në zbatim të Udhëzimit të MFE-së nr. 9, datë 11.03.2019 *"Mbi modalitetet e transferimit pranë Administratës Doganore të të dhënave për subjektet e akcizës të cilat rezultojnë me detyrime të papaguara".* Rreth 29% të shumës së detyrimeve të papaguara ose 13,892,579 mijë lekë, të trashëguara deri me 31 Dhjetor 2024, janë detyrimet e papaguara të transferuara nga DPT në vitin 2019.
Peshën më të madhe specifike në borxhin doganor në raport me totalin konstatohet se e kanë Dega Doganore Tiranë 39%, Fier 31%%, Durrës 16.4%, Lezhë 4% dhe Berat 2.8%. Vlerë të konsiderueshme në përbërjen e detyrimeve doganore përbëjnë penalitetet me rreth 55% të cilat janë mbi vlerën e detyrimit kryesor që përbën 27% si dhe kamatëvonesat paraqiten në vlera përfaqësuese me rreth 18%.
Konstatohet se vazhdon të paraqitet një trend rritës i detyrimeve të papaguara. Rritja më e madhe në vlerë e debitorëve evidentohet në Degën Doganore Durrës në shumën 348,398 mijë lekë, Degën Doganore Tiranë në shumën 509,742 mijë lekë dhe Degën Doganore Fier në shumën 262,483 mijë lekë. Vetëm në Degën Doganore Pogradec evidentohet rënie në vlerën 50,311 mijë lekë të debitorëve si pasojë e arkëtimit të detyrimit të një subjekti në vlerë përfaqësuese ndaj totalit të borxhit të kësaj dege doganore. Gjatë periudhës 1 Janar-31 Dhjetor 2024, detyrimet e papaguara të reja sipas vendimeve të vitit 2024, janë rritur me **334,003 mijë lekë** ose 0.7% e totalit**..** Në këtë rritje peshën kryesore e kanë Dega Doganore Tiranë rreth **47%,** Durrës me **33**%, Elbasan rreth **7**%, Kakavijë **5%,** Fier **4%**, Shkodër, Pogradec, Kapshtica, dhe Vlora me rreth 4**%. Pjesa tjetër e shtesës për vitin 2024 vjen nga shtesat nga kamatëvonesat, duke marrë parasysh efektin e pakësimeve të borxhit nga vitet e kaluara si pasojë e pagesave të kryera në vitin 2024.** Përsa i përket llogaritjes së kamatëvonesave, nga auditimi konstatohet se ato zënë një peshë të konsiderueshme me rreth 18% mbi totalin e detyrimeve doganore të vitit 2024, duke qenë në rritje të vazhdueshme me rreth 1 miliard lekë në vit. Kjo situatë shton borxhin doganor pa një kufi kohor të mire përcaktuar në kuadrin ligjor për përllogaritjen e tyre duke sjellë vështirësi shtesë në mbledhjen e tyre.
Në lidhje me pakësimin e detyrimeve të papaguara doganore përgjatë vitit 2024, shlyerja e detyrimit nga subjektet rezulton të jetë në shumën 403,742 mijë lekë ose 0.84% e totalit të detyrimeve të papaguara doganore, çka tregon një mungesë efektiviteti në rikuperimin e stokut të detyrimeve të krijuara gjatë viteve. Nga shuma totale e pakësimeve si më sipër, shuma prej **292,052 mijë lekë** (ose sa **72%**) i përket pakësimeve të detyrimeve doganore për vendime administrative

të marra gjatë vitit 2024, ndërsa pjesa tjetër në vlerën 111,710 mijë lekë i përket pagesave të kryera në vitin 2024 për llogari të detyrimeve doganore të mbartura nga viti 2011-2023. Kjo tregon që veprimet administrative të organeve doganore rezultojnë të jenë efektive përkundrejt detyrimeve të reja të konstatuara, por janë të papërfillshme në lidhje me detyrimet e mbartura nga vitet e kaluara.
Evidentohet se raporti i detyrimeve të pakësuara mbi detyrimet e shtuara për vitin 2024 rezulton 28.8%, ndërsa për vitin 2023 rezultonte 40%. Pra kemi ulje të këtij raporti si rezultat i uljes së detyrimeve të arkëtuara në raport me detyrimet e shtuara gjatë vitit.
Nga auditimi konstatohet se detyrimet e papaguara doganore mbi 5 vjet nga momenti i lindjes së detyrimit janë në vlerën 44,048,161 mijë lekë ose në masën 90% mbi totalin e stokut të detyrimeve. Duke qenë se më shumë se gjysma e detyrimit të trashëguar në vite është mbi 5 vjet, situata paraqitet jo efektive mbi mënyrën e rikuperimit me forcë të detyrimeve të papaguara doganore nga ana e strukturave të doganës me pasojë rritjen e riskut të parashkrimit të mbledhjes së tyre.
*(Më hollësisht trajtuar pikën III.2.2 faqe 21-26 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të analizojë situatën e krijuar përsa i përket rritjes së stokut të detyrimeve të papaguara doganore vit pas viti, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore me qëllim rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore në shumën prej 48,588,510 mijë lekë, si dhe duke marrë masa për parandalimin e rritjes së mëtejshme të tyre.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka lidhur akt marrëveshje nr. 1435 datë 19.06.2018 me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për rikuperimin e detyrimeve doganore të papaguara. Në pikën 7 të nenit 6 përcaktohet që Sektori i Monitorimit të Borxhit në DPD menjëherë duhet të nisi me format elektronik pranë Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë në DPT, kërkesën për pezullimin e aktivitetit ekonomik të subjektit debitor. Nga grupi i auditimit u kërkua informacion në sektorin e monitorimit të borxhit mbi korrespondencën me DPT për nisjen në format elektronik të kërkesës për bllokim për rastet e përzgjedhura për auditim për vitin 2024 në degët doganore për të cilat është nxjerrë Urdhri i Ekzekutimit. Nga sektori i Monitorimit të Borxhit është referuar se *"Vetë Degët doganore dërgojnë herë pas here për subjektet debitor, kërkesë për informacion Degëve Rajonale të Tatimeve. Rajoni Tatimeve Qendër na bën me dije se kanë kërkuar informacion Degët doganore".* Konstatohet se marrëveshja e bashkëpunimit me DPT nuk është zbatuar sipas parashikimeve për komunikimin e sektorit të monitorimit të borxhit, ku komunikimi bëhet i qendërzuar në mënyrë që të përputhet me nenin 1 "Qëllimi", me synim rritjen e performancës për mbledhjen e të ardhurave, nëpërmjet uljes së kohës së procedurave të shërbimit, kontrollit dhe kostove respektive.
Gjithashtu nga auditimi konstatohet se nuk ka programe pune të përbashkëta përsa i përket mbledhjes së detyrimeve të papaguara midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në kundërshtim me pikën 5 të nenit 6 të marrëveshjes së bashkëpunimit midis DPD-së dhe DPT-së së datës 19.06.2018
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 faqe 12-21 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**2.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të merren masa të menjëhershme për dërgimin e listave të debitorëve për të cilat është lëshuar urdhri i ekzekutimit në mënyrë që të bëhet pezullimi i aktivitetit ekonomik nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

**Menjëherë**

**2.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të iniciojë kërkesën për programe pune të përbashkëta me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në kuadër të zbatimit të marrëveshjes dypalëshe.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave bashkëpunon me institucione të tjera në kuadër të ekzekutimit të Urdhrave të Ekzekutimit për mbledhje me forcë të borxhit, konkretisht zyrat përmbarimore, sipas kërkesave të Kreut IX *"Ekzekutimi i Urdhrit të Ekzekutimit",* të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Sipas pikës 1.3 të Kreut IX "Ekzekutimi i Urdhrit të Ekzekutimit", të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* konstatohet se nga Degët Doganore jo në çdo rast ka informacion për statusin aktual të çështjeve të dërguara në përmbarim. Nuk ka dokumentacion provues për përmbushjen e detyrimeve të kreditorit sipas kontratës tip me përmbaruesin ku në nenin 4 "Detyrimet e kreditorit", pika 7 përcaktohet *"Kreditori merr përsipër të nënshkruajë procesverbalet që dokumentojnë veprimet përmbarimore nga shoqëria përmbarimore".* Janë konstatuar praktika të përzgjedhura për auditim në degë doganore për të cilat, gjatë vitit 2024, nuk ka dokumentacion që provon komunikimin të vazhdueshëm me përmbaruesit gjyqësore. Nga ana e DPD ky proces nuk rezulton të jetë i monitoruar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 faqe 12-21 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*

**3.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Degët Doganore, t'i kërkohet informacion zyrave përmbarimore në të cilat janë dërguar për ekzekutim të detyrueshëm urdhrat e ekzekutimit dhe të analizohet situata e debitorëve rast pas rasti me qëllim vlerësimin e statusit aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se ndër masat të cilat janë parashikuar për rikuperimin e detyrimeve doganore të lindura pas vendimmarrjes së autoriteteve doganore, është edhe prekja e garancive sipas parashikimeve të pikës 7 të kapitullit VI "Njoftimi i vendimit", të udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018*"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, në momentin e njoftimit të vendimit. Në pikën 2.2.1."Ekzekutimi i detyrueshëm i urdhrit të ekzekutimit nga autoritetet doganore" të kapitullit IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit", të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018*"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* është përcaktuar e njëjta masë në një moment të mëvonshëm procedural të mbledhjes me forcë të borxhit. Për sa më sipër konstatohet se procedurat e prekjes së garancisë janë parashikuar në dy momente kohore të ndryshëm procedurale nga udhëzimi (në momentin e parë të daljes së vendimit dhe në momentin e mëvonshëm të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit) dhe drejt strukturave të ndryshme përgjegjëse në DPD për të njëjtën mase për rikuperimin e detyrimeve doganore.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 faqe 12-21 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*

**4.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të sigurohet prekja e garancive të vendosura për qëllime të regjimit doganor në momentin më të hershëm, me qëllim rritjen e efektivitetit të masave të marra për rikuperimin e detyrimeve doganore të papaguara dhe në të njëjtën kohë të merren masa për shmangien e përsëritjeve procedurale të panevojshme të mësipërme nëpërmjet ndryshimeve në udhëzim.

**Në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se ndër masat të cilat janë parashikuar për rikuperimin e detyrimeve doganore të lindura pas vendimmarrjes së autoriteteve doganore është edhe bllokimi i veprimeve në sistemin elektronik doganor sipas përcaktimeve të pikës 2.6 të kapitullit VII "Ekzekutimi i vendimit i shpalljes debitor" të udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, në momentin e njoftimit të vendimit. Në pikën 2.2.1."Ekzekutimi i detyrueshëm i urdhrit të ekzekutimit nga autoritetet doganore" të kapitullit IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit", të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* është përcaktuar e njëjta masë në një moment të mëvonshëm procedural të mbledhjes me forcë të borxhit. Për sa më sipër konstatohet se procedurat e bllokimit në sistemin doganor janë parashikuar në dy momente kohore të ndryshëm proceduralë (në momentin e parë të njoftimit të vendimit të rikuperimit me forcë dhe në momentin e mëvonshëm të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit) nga udhëzimi dhe drejt strukturave të ndryshme përgjegjëse në DPD për të njëjtën mase për rikuperimin e detyrimeve doganore.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 faqe 12-21 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**5.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të sigurohet bllokimi i veprimeve në sistemin elektronik doganor në një moment më të hershëm, me qëllim rritjen e efektivitetit të masave të marra për rikuperimin e detyrimeve doganore të papaguara dhe në të njëjtën kohë të merren masa për shmangien e përsëritjeve procedurale të panevojshme të mësipërme nëpërmjet ndryshimeve në udhëzim.

**Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave përgjatë vitit 2024, sipas evidencës së vendosur në dispozicion grupit të auditimit ka vepruar në drejtim të garancive të paraqitura në 14 raste, në shumën 6,036,644 lekë. veprimet me garancitë përgjatë vitit 2024 janë kryer në formën e çlirimit të garancisë (për rastet kur ankimimi i subjektit është pranuar), është prekur (për rastet kur ankimi është rrëzuar) dhe është kaluar në llogarinë 466 "Mjete në ruajtje" (për rastet kur është rrëzuar ankimi nga Drejtori i Përgjithshëm i DPD, por çështja vazhdon në rrugë gjyqësore në gjykatat kompetente administrative). Në fund të vitit 2024, sipas evidencave të përcjella nga Sektori i Pagesave, Garancive dhe Kontabilitetit të të Ardhurave rezultojnë të depozituara 12 garanci me afat vlefshmërie përtej vitit 2024 në shumën 26,345,511 lekë. Konstatohet se 2 garanci janë të prekura përgjatë vitit 2025, dhe për 10 garancitë e tjera konstatohet se qëndrojnë në ruajtje nga DPD, duke qenë brenda afatit të vlefshmërisë (në pritje të përfundimit të procesit gjyqësor). Nga auditimi konstatohet se në 5 raste në shumën 22,493,331 lekë të cilat janë gjendje në fund të vitit 2024 garancitë qëndrojnë në ruajtje nga DPD, duke qenë brenda afatit të vlefshmërisë (në pritje të përfundimit të procesit gjyqësor), megjithëse pika 2.3 dhe 3.3 e kapitullit X *"Ankimi administrativ"* e Udhëzimit nr.15, datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, parashikon prekjen e tyre të menjëhershme pas rrëzimit të ankimimit nga Drejtori i Përgjithshëm i DPD-së dhe kalimi në llogaritë e thesarit.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 faqe 12-21 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**6.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kryhet në mënyrë të menjëhershme prekja e garancive dhe kalimi i tyre në llogari të thesarit për të gjitha rastet e identifikuara me rrëzim ankimimi nga vendimmarrja e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për garancitë e ankimimit administrativ apo garancitë e vendosura për qëllime të përfitimit të regjimit doganor, në sistemin kontabël nuk ka asnjë informacion mbi gjendjen e tyre në fund të vitit ushtrimor, qoftë duke pasqyruar një të drejtë të mundshme për të arkëtuar, apo dhënien e informacioneve në shënimet shpjeguese sipas pasqyrave financiare. Procesi i depozitimit të garancive për paraqitjen e ankimimit administrativ nuk rezulton të jetë i rregulluar për qëllime të raportimit financiar, por vetëm procesi i çlirimit apo prekjes së garancisë, i cili rezulton të mos jetë pasqyruar në tepricat e llogarive që reflektojnë prekjen e garancisë për rastet e vendimmarrjeve që janë shoqëruar me garanci për të cilat janë përmbushur kushtet për prekjen e tyre.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 faqe 12-21 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**7.1. Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të merren masa për përfshirjen e të drejtave për të arkëtuar nga garancitë të cilat kanë përmbushur kushtet e disponimit nga autoriteti doganor në sistemin kontabël dhe informacionet e pasqyruara në pasqyrat financiare vjetore.

**Në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se në pikën 2.3.11 të Kreut IX "Ekzekutimi i Urdhrit të Ekzekutimit", të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* është përcaktuar që Dega Doganore gjatë procedurës së sekuestrimit mund të kërkojë mbështetje nga Departamenti Operativ Hetimor, Departamenti Administrativ, Departamenti Teknik dhe i akcizës dhe Departamenti i Analizave dhe Aposteriorit. Në kundërshtim me pikën 2.3. *"Vendosja e sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga Autoriteti Doganor"*, konstatohet se nuk është vendosur sekuestro ekzekutive dhe as kryerja e ekzekutimit të saj nga autoriteti doganor ku përcaktohet se *"2.3.1.Dega Doganore nxjerr Urdhrin për Vënien e Sekuestros Ekzekutive.... 2.3.2.Urdhri për vendosjen e Sekuestros Ekzekutive nxirret nga Kryetari i Degës Doganore..... 2.3.5. Sekuestrimi i pasurisë bëhet nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontabandës".* Nga auditimi i dosjeve të subjekteve debitore në degët doganore objekt auditimi, konstatohet se në asnjë rast nuk ka bashkëpunim ndërmjet degëve me strukturat e brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për sekuestrimin sipas dokumentacionit të kërkuar sipas pikës XV, gërma l), ll) të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Në konkluzion konstatohet se administrata doganore nuk ka vepruar sipas përcaktimeve të pikës 1, kapitulli XI të Udhëzimit nr.15 përsa kohë ka mbivlerësuar ekzekutimin nëpërmjet përmbarimit përkundrejt ekzekutimit nga vetë autoritetet doganore në kundërshtim me nenin 280 të Kodit Doganor.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 faqe 12-21 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**8.1. Rekomandimi:** Nga Degët Doganore të merren masa për vendosjen e urdhrit të sekuestros dhe të kërkohet bashkëpunimi me strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me qëllim sigurimin e efikasitetit dhe sigurisë për mbledhjen e shumës së detyrimeve të papaguara. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të monitorohet ky proces dhe të kryhet ekzekutimi i titujve ekzekutivë edhe nga strukturat e mbledhjes me forcë të detyrimit pranë administratës doganore duke shteruar procedurën deri në konfiskim të pasurive të debitorëve.

**Në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se sipas pikës 2.2.2 *"Bashkëpunimi me institucionet e tjera për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit"* të kapitullit IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, me qëllim ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit, Dega Doganore bashkëpunon me institucione të tjera ku përfshihen:
-DPT për bllokim aktiviteti tregtar
-QKB për bllokim veprimi tregtar që ka lidhje me debitorin
-bankave të nivelit të dytë, për bllokimin e sekuestrimin e menjëhershëm të vlerave monetare
-zyrave të regjistrimit të pasurive të luajtshme për vendosjen e sekuestros ndaj tyre.
-zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për vendosjen në hipotekë në favor të administratës doganore.
Nga auditimi konstatohet se DPD ka marrëveshje bashkëpunimi vetëm me DPT, ndërkohë që me institucionet e tjera të mësipërme të parashikuara për rikuperimin e detyrimeve doganore nuk ka marrëveshje bashkëpunimi, duke rezultuar gjithashtu në mungesë efektiviteti mbi këtë proces, ndërkohë që sipas pikës 3 të nenit 48 të Kodit Doganor është parashikuar që me qëllim që të sigurohet zbatimi korrekt i legjislacionit doganor, autoritetet doganore bashkëpunojnë me organizma publikë ose privatë, shqiptarë ose të huaj.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1 faqe 12-21 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**9.1. Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të iniciohen kërkesa për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizma publike dhe privatë me qëllim rritjen e efektivitetit të rikuperimit të detyrimeve doganore të papaguara për të aksesuar në kohë reale informacionin mbi statusin/pasuritë e debitorëve doganore dhe për të marrë masa të menjëhershme në kuadër të vendimeve për shpallje debitor nga administrata doganore.

**Në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Procedurat për kryerjen e kontabilizimit të detyrimeve doganore janë përcaktuar në kapitullin V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* ku përcaktohet se kontabilizimi i shumës së detyrimeve bëhet në zëra të veçantë. Nga auditimi konstatohet se në të gjitha degët doganore, kontabilizimi i shumave në sistemin kontabël alpha kryhet në total për rast vendimi, pa e ndarë në detyrim, penalitet dhe kamatëvonesa, sipas përcaktimeve të mësipërme, megjithëse në format excel paraqitet i ndarë në evidencën e borxhit.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**10.1. Rekomandimi:** Nga ana e Degëve Doganore të merren masa për kontabilizimin e ndarë të detyrimeve, penaliteteve dhe kamatëvonesave në sistemin kontabël për çdo vendimmarrje për shpallje debitor dhe nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të monitorohet ky proces në rast të vlerësimit të kësaj situate në përputhje me udhëzimin e borxhit përveç evidencës në excel, duke marrë në konsideratë edhe faktorin e kohës dhe ngarkesës përveç cilësisë së informacionit financiar.

**Në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se, në 6 raste në shumën totale 566.4 mijë lekë[9] në degët doganore Fier (një rast), Lezhë (një rast) dhe Tiranë (katër raste), llogaritja e kamatëvonesave nuk është kryer nga momenti i lindjes së mos përmbushjes së detyrimit doganor për ato mos përmbushje të trajtuara sipas neneve 74-77 të Kodit Doganor, por është kryer nga data e njoftimit të vendimit, duke qenë jo sipas përcaktimeve të pikës 4.2. b) ii) të kapitullit V "Kontabilizimi i detyrimeve të papaguara dhe raportimi" të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Mos përllogaritja e saktë e këtyre kamatëvonesave të evidentuara nga përzgjedhja e auditimit si dhe të tjera përtej zgjedhjes së auditimit në të gjitha degët doganore krijon kushtet për pasaktësinë e shumave të raportuara në evidencën e borxhit në fund të vitit 2024.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**11.1. Rekomandimi:** Nga ana e Degëve Doganore të merren masa për llogaritjen e saktë të kamatëvonesave për rastet e identifikuara me problematika në momentin e lindjes së detyrimit sipas praktikave të përzgjedhura për auditim dhe për rastet e tjera, duke pasqyruar vlerën e saktë në evidencën e borxhit dhe nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të monitorohet ky proces.

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi evidencën e detyrimeve doganore të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, konstatohet se është e përbërë nga lista analitike e debitorëve në formë regjistri për masat e marra si dhe të dhëna të përgjithshme në nivel analize të borxhit. Nga përpunimi i të dhënave analitike të paraqitura në evidencë konstatohet se për detyrimet doganore deri në 31.12.2024, për 2678 raste në shumën 30,598,283,631 lekë janë të mbuluara me urdhër ekzekutimi të lëshuar nga gjykatat respektive. Pjesa tjetër prej 2087 (duke përfshirë edhe rastet me vlerë 0) raste në shumën 17,990,226,518 lekë paraqitet pa shënim ose me shënimin "kthyer/refuzuar" në kolonën e urdhër ekzekutimit. Megjithëse janë prezantuar në evidencë si raste të pambuluara me urdhër ekzekutimi, nga auditimi janë konstatuar 4 raste në shumën 26,090,351 lekë në të cilat ka shënime në kolonat e evidencës për dërgimin e tyre në përmbarim.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**12.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Degët Doganore respektive të merren masa për saktësimin në evidencën e borxhit të rasteve të konstatuara pa urdhër ekzekutimi por të dërguara në përmbarim dhe të monitorohet saktësia e të dhënave të paraqitura në evidencën e borxhit.

**Në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi evidencën e detyrimeve doganore të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Doganave, konstatohet se pjesa më e madhe e detyrimeve (të pambuluara me urdhër ekzekutimi) paraqiten të jenë në proces gjyqësor me rreth 16,336,945 mijë lekë, ndjekur nga raste të tjera në shumën 1,396,614 mijë lekë të cilat paraqiten në procedurë mbledhjeje. Në disa raste, konstatohet se kanë shënimin e akt marrëveshjes së pagesës me këste, e cila është konfirmuar edhe nga auditimi i zhvilluar në Degën Doganore Tiranë. Marrëveshjet e pagesës me këste janë lidhur me subjektet referuar shkresës nr. 22449/1 datë 29.09.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD *"Në lidhje me shlyerjen e borxhit me këste"* për një subjekt specifik. Nga

[9] Në degën Doganore Fier, subjekti K në shumën 79,215 lekë, në Degën Doganore Tiranë, subjekti 4 në shumën 239,557 lekë, subjekti K në shumën 53,229 lekë, subjekti D në shumën 31,282 lekë dhe 31,279 lekë dhe në Degën Doganore Lezhë subjekti C në shumën 131,843 lekë.

auditimi konstatohet se akt marrëveshjet e evidentuara sipas tabelës përmbledhëse të borxhit doganor janë nënshkruar pa pasur një bazë ligjore mbi të cilën të jenë parashikuar kushtet, kriteret, modalitetet mbi të cilat aplikohen lehtësitë për shlyerjen e detyrimeve doganore, në një kohë që Kodi Doganor dhe Udhëzimi nr. 15 datë 03.12.2018 parashikon rikuperimin e menjëhershëm të detyrimeve, penaliteteve dhe kamatëvonesave.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**13.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kryejë mbledhjen e detyrimeve doganore nëpërmjet marrjes së masave duke aplikuar kushtet, kriteret, modalitetet mbi të cilat aplikohen lehtësitë për shlyerjen e detyrimeve doganore bazuar në parashikimet e Kodit Doganor.

**Menjëherë**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi evidencën e detyrimeve doganore të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Doganave, konstatohen të paktën 613 raste në shumën 13,976,212,926 lekë ose 28% e totalit të borxhit në vlerë (pa përfshirë muajin dhjetor 2024 dhe vlerat nën 1,500 lekë), për të cilat, nuk ka të shënuar në evidencën e borxhit të dhëna mbi marrjen e Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, megjithëse referuar afateve dhe shumave të detyrimit, janë përmbushur kushtet ligjore për rikuperimin me forcë të këtyre borxheve doganore dhe nuk ka informacion të rifreskuar për situatën faktike të gjendjes së këtyre debitorëve, por vetëm shënimin në proces gjyqësor. Problematikat më të mëdha konstatohen në Degën Doganore Tiranë e cila përbën 99% të rasteve. Ky konstatim rezulton si pasojë e ekzistencës së shumave në kolonën e detyrimit dhe penaliteteve të detyrimit doganor sipas rastit dhe mungesës së marrjes së Vendimeve për Rikuperimin me Forcë të Borxhit sipas përcaktimeve të pikës 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Megjithëse kryerja e veprimeve procedurale të mësipërme është në përgjegjësi të degëve doganore, konstatohet se nga ana e DPD ka munguar monitorimi i duhur për shmangien e këtyre parregullsive.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**14.1. Rekomandimi:** Nga Degët Doganore të merren masa të menjëhershme për nxjerrjen e Vendimeve për Rikuperimin me Forcë të Borxhit për rastet kur janë përmbushur kushtet dhe afatet dhe ky proces të monitorohet nëpërmjet evidencave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**Menjëherë**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi evidencën e detyrimeve doganore të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Doganave, konstatohet se megjithëse kanë kaluar vite nga data e Vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, ende nuk është kryer kërkesa në gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Kjo konstatohet në të paktën 840 raste në shumën 2,470,270,806 lekë (pa përfshirë muajin dhjetor 2024 dhe vlerat nën 1,500 lekë). Nga ana e autoriteteve doganore mungon ndjekja e hapave të mëtejshëm procedurale për rikuperimin e mëtejshëm të borxhit doganor pas nxjerrjes dhe njoftimit të VRFB, në kundërshtim përcaktimet e bëra në pikën 1 të kapitullit VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit". Megjithëse kryerja e veprimeve procedurale të mësipërme është në përgjegjësi të degëve doganore, konstatohet se nga ana e DPD ka munguar monitorimi i duhur për shmangien e këtyre parregullsive.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**15.1. Rekomandimi:** Nga Degët Doganore të merren masa të menjëhershme për dërgimin e kërkesës në Gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, për rastet kur janë përmbushur kushtet

dhe afatet dhe ky proces të monitorohet nëpërmjet evidencave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**Menjëherë**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se megjithëse nga gjykata janë lëshuar urdhrat e ekzekutimit, nga Degët Doganore ende nuk është vepruar për dërgimin e tyre në përmbarim apo masa të tjera në kompetencë të autoritetit doganor, kjo konstatohet në të paktën 105 raste në shumën 404,347,092 lekë, (pa përfshirë muajin dhjetor 2024 dhe vlerat nën 1,500 lekë). Këto veprime konstatohet se janë në kundërshtim me Kapitullin IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Megjithëse kryerja e veprimeve procedurale të mësipërme është në përgjegjësi të degëve doganore, konstatohet se nga ana e DPD ka munguar monitorimi i duhur për shmangien e këtyre parregullsive.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**16.1. Rekomandimi:** Nga Degët Doganore të merren masa të menjëhershme për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, për rastet kur kanë dalë urdhër ekzekutimet dhe ky proces të monitorohet nëpërmjet evidencave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**Menjëherë**

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi evidencën e përmbledhur të borxhit në fund të vitit 2024, konstatohen të paktën 765 raste në shumën 14,284,686,504 lekë, ku megjithëse urdhër ekzekutimet janë dërguar për ekzekutim zyrës së Përmbarimit Shtetëror/privat, në asnjë rast nuk janë marrë masa nga vetë autoriteti doganor për rikuperimin e detyrimeve të papaguara për bllokim NIPT, llogarish bankare, asete të tjera sipas kërkesave të pikës 2.2.2 *"Bashkëpunimi me institucionet e tjera për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit"* të Kapitullit IX "Ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".* Megjithëse kryerja e veprimeve procedurale të mësipërme është në përgjegjësi të degëve doganore, konstatohet se nga ana e DPD ka munguar monitorimi i duhur për shmangien e këtyre parregullsive.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**17.1. Rekomandimi:** Nga Degët Doganore të merren masa të menjëhershme në kompetencë të autoritetit doganor, për rastet e mësipërme dhe ky proces të monitorohet nëpërmjet evidencave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**Menjëherë**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të detyrimeve të papaguara të krijuara në vitet 2022-2023 për Degën Doganore Berat dhe përgjatë vitit 2024 për Degët Doganore Fier, Lezhë dhe Tiranë është konstatuar se në disa raste Vendimi mbi Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor nuk është nxjerrë VRFB brenda afatit të parashikuar në pikën 2.1 të kapitullit VII të Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës".*
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**18.1. Rekomandimi:** Nga Degët Doganore nën monitorimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të merren masa për nxjerrjen në kohë të Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve doganore pas mbarimit të afatit 10 ditor nga marrja dijeni mbi njoftimin e vendimit.

**Menjëherë**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të detyrimeve të papaguara të krijuara në vitet 2022-2023 për Degën Doganore Berat dhe përgjatë vitit 2024 për Degët Doganore Fier, Lezhë dhe Tiranë është konstatuar se që kërkesa për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit drejtuar Gjykatës është kryer jo në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin nr.15 datë 03.12.2018, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*, pika 1 e kapitullit VIII *"Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit".* Kjo është konstatuar pasi kërkesa drejtuar gjykatës nuk është kryer menjëherë me marrjen dijeni mbi VRFB, duke shkaktuar diferenca kohore dhe përbën shkak për uljen e efektivitetit të masave të marra për rikuperimin e detyrimeve doganore.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**19.1. Rekomandimi:** Nga Degët Doganore nën monitorimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të merren masa për kërkimin në Gjykatë për lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit menjëherë nga marrja dijeni mbi Vendimin për Rikuperimin me Forcë të Borxhit.

**Menjëherë**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në Degë Doganore konstatohet se llogaritja e interesave mbi detyrimet është kryer në baza 6-mujore me dy fletë llogaritje mbi detyrimet ndërkohë që referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës",* llogaritja e interesave duhet të kryhet mbi baza mujore duke qenë se sipas pikës 5 të kapitullit V të udhëzimit citohet që *"Specialisti – Jurist/Specialist borxhi pranë Zyrës/Sektorit të Administratës dhe Shërbimit në degën doganore raporton në DPD (Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave) çdo muaj mbi gjendjen e detyrimeve të papaguara".* Për rrjedhojë, evidencat mujore të paraqitura nga Dega e Doganës nuk janë të sakta përsa i përket shumës së kamatëvonesave të paraqitura me pasojë edhe në shumën totale të borxhit doganor, me përjashtim të muajit Dhjetor kur janë reflektuar në shtesë të gjashtëmujorit të dytë.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**20.1. Rekomandimi:** Nga Degët Doganore të kryhet llogaritja e kamatëvonesave mbi baza mujore dhe të dërgohen evidencat e sakta mujore në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave e cila të monitorojë procesin e përllogaritjes së saktë mujor.

**Në vijimësi**

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të detyrimeve të papaguara të krijuara në vitet 2022-2023 për Degën Doganore Berat dhe përgjatë vitit 2024 për Degët Doganore Fier, Lezhë dhe Tiranë është konstatuar se megjithëse nga Degët Doganore është dërguar kërkesa në Gjykatë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, nga gjykata nuk ka vendim për pranimin e kërkesës për lëshimin urdhrit të ekzekutimit. Për këto raste nuk ka informacion në lidhje me arsyen e mos lëshimit të urdhrit të ekzekutimit apo refuzimin/kërkesën për plotësim nga gjykata megjithëse ka kaluar kohë e konsiderueshme nga data e kërkesës për disa prej tyre në vlera të mëdha të borxhit doganor të përfshirë në objektin e ekzekutimit të detyrueshëm. Konstatohet se nuk janë dokumentuar hapat proceduralë të ndjekura nga autoriteti doganor dhe nuk janë paraqitur sipas kërkesave të pikës 4 dhe 5 të kapitullit VIII "Nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"* ku citohet *"Dega Doganore është përgjegjëse për dërgimin sipas ligjit të akteve të mësipërme në Gjykatë dhe nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit. Në të gjitha rastet,*

*kërkesa për nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit, Urdhri i Ekzekutimit i nxjerrë nga Gjykata si dhe çdo akt tjetër i gjykatës bëhen pjesë e dosjes së debitorit.".*
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**21.1. Rekomandimi:** Degët Doganore në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të dërgojnë kërkesa zyrtare për informacion pranë Gjykatave Kompetente dhe strukturave të ngarkuara me qeverisjen e sistemit gjyqësor për statusin e kërkesave për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për ato kërkesa që janë në proces. Degët Doganore të plotësojnë kërkesat e gjykatës dhe përfundojnë procedurat gjyqësore për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit në rastet e kërkesave të dërguara në gjykatë.

**Në vijimësi**

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohen 23 raste për të cilat Dega e Doganës Fier nuk ka dijeni për borxhin se në cilën zyrë përmbarimore është duke u ndjekur detyrimi doganor i papaguar, duke mos pasur informacion dhe duke mos marrë masa për arkëtimin e detyrimeve doganore. Këto raste si dhe të tjera janë konfirmuar edhe në shkresën nr. 2804 datë 12.08.2024 me lëndë "Relacioni nr.5" drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave duke cituar "....ekzistojnë të hedhur Urdhrat e Ekzekutimit lëshuar nga Gjykatat, por nuk janë të hedhura në cilën zyrë përmbarimore janë adresuar për ekzekutimin e detyrueshëm. Gjithashtu në dosjet personale të këtyre vendimmarrjeve nuk gjenden as origjinal dhe as fotokopje të këtyre Urdhrave Ekzekutiv.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4.3 faqe 69-99 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**22.1. Rekomandimi:** Dega e Doganës Fier në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa për dërgimin e kërkesave për informacion në Drejtorinë e përgjithshme të Përmbarimit në mënyrë që të kryhet identifikimi i praktikave se në cilën zyrë përmbarimore janë dërguar për ekzekutim urdhrat e ekzekutimit.

**Menjëherë**

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi evidencën përmbledhëse të detyrimeve doganore të konsoliduar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave janë konstatuar disa problematika në plotësimin e fushave me informacion sipas kërkesave të formatit, të mbartura nga evidenca e dërguar në nivel dege doganore me efekt mungesë unifikimi në metodologjitë e përdorura gjatë përpunimit dhe raportimit të të dhënave të cilat përfshijnë si më poshtë:
- paraqiten 85 raste në të cilat vlera e detyrimit doganor është 0 lekë, të cilat në fund të vitit 2024 nuk duhet të ishin pjesë e rasteve me detyrime pasi detyrime që lindin nga këto raste janë shlyer nga debitorët.
- Fusha e strukturës konstatuese nuk është me vlera të paracaktuara për raportimin e saj të përmbledhur dhe të dhënat nuk janë në formatin e duhur dhe te standartizuar me qëllim përpunimin e informacionit dhe paraqitjes së tij drejt përdoruesve në kohën dhe formën e duhur për vendimmarrje për rastet e vendimmarrjeve që kanë krijuar borxh doganor përpara vitit 2024. Këto problematika bëjnë të pamundur që të përpunohet informacioni dhe të krahasohet me burimin e lindjes së borxhit.
- Për disa prej subjekteve në numër të konsiderueshëm nuk ka informacion ID, që krijon riskun e informacioneve të pasakta apo për ndjekjen në kohë reale të gjendjes së tyre, nëse janë aktiv apo jo. Paraqitja e informacionit përsa i përket statusit të debitorit evidentohet se ka dublikime dhe e bën përmbledhjen e tij të papërpuneshme. Plotësimi i fushës nuk është me të dhëna unike të standardizuara në mënyrë që të analizohen të dhënat dhe të mbulohet vendimmarrja menaxheriale me informacion të saktë dhe të dobishëm për ndjekjen e borxhit doganor.

Përsa më sipër, u konstatua se mungon një metodologji e standardizuar dhe funksionale për përpunimin, pasqyrimin dhe analizimin e të dhënave mbi borxhin sa i përket edhe llojit të shkeljes me qëllim kryerjen e analizave të borxhit.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**23.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të merren masa për eliminimin e rasteve të vendimeve nga evidenca të cilat janë shlyer dhe ti kërkohet degëve doganore të plotësojnë saktë autoritetin konstatues sipas një klasifikimi të standardizuar së bashku me të dhëna të sakta në lidhje me statusin e debitorit në bazë të numrit unik (individ apo biznes) me informacione te sakta analitike.

**Në vijimësi**

**24. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në Degën e Doganës Fier dhe Lezhë, për rastet e përzgjedhura për tu audituar nga vendimet e vitit 2024, është konstatuar se nuk ka gjurmë të mos marrjes dijeni për njoftimin e vendimit nga subjekti sipas shënimeve mbi kthimin apo refuzimin e marrjes dijeni. Mos mbajtja e njoftimeve mbi marrjen dijeni të vendimit është jo në përputhje me pikën 3.b) të udhëzimit nr. 15.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**24.1. Rekomandimi:** Nga Dega e Doganës Fier dhe Lezhë të merren masa për dokumentimin e marrjes dijeni ose jo të njoftimeve të akteve administrative për lindjen e borxhit duke e bërë pjesë të dosjes së borxhit.

**Në vijimësi**

**25. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në Degën Doganore Fier dhe Lezhë mbi dosjet e përzgjedhura me peshën më të lartë ndaj totalit të borxhit doganor është konstatuar se pjesë e dosjeve nuk është dokumentacioni i plotë sipas evidencës periodike të borxhit të plotësuar në disa raste që përfshijnë Vendimin nr.189 datë 17.06.2015 për subjektin D Sha në Degën Doganore Fier, Vendimin nr.236 datë 11.09.2015 për subjektin D në Degën Doganore Fier dhe Vendimin nr.69 datë 22.07.2013 për subjektin A në Degën Doganore Fier dhe Vendimin nr. 15 datë 12.03.2019 për subjektin B në Degën Doganore Lezhë. Gjithashtu, nga auditimi rezulton se Dega Doganore Fier nuk ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit dokumentacionin dhe dosjen e borxhit në dy raste për Vendimin nr.24 datë 07.02.2018 për subjektin Idhe Vendimin nr.72 datë 19.05.2016 për subjektin A në lidhje me vendimmarrjen si dhe masat e marra më qëllim vjeljen e detyrimeve doganore me pretendimin se *dosjet nuk ndodhen në* Degën Doganore Fier. Mungesa e dokumentacionit dhe dosjeve të mësipërme sipas detyrimeve të përcaktuara në evidencën e borxhit dhe të kontabilizuara në të drejta për të arkëtuar, është në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kapitullin XV "Dokumentacioni për detyrimet e papaguara" të Udhëzimit 15 datë 03.12.2018 *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4 faqe 29-130 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
**25.1. Rekomandimi:** Nga Dega e Doganës Fier dhe Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të plotësohen dosjet e evidentuara me mangësi me dokumentacionin që mungon rast pas rasti dhe të ndërmerren hapat procedurale për rikuperimin e detyrimeve që rrjedhin nga këto vendime për shpallje debitor.

**Menjëherë**

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi kontabilizimin e debitorëve për vitin 2024 në sistemin kontabël është konstatuar se të gjitha vendimet e vitit 2024 për shpalljen debitor janë regjistruar të plotë. Në Degën Doganore Tiranë në fund të vitit 2024, konstatohet diferencë e debitorëve midis zyrës së financës dhe zyrës së borxhit është në vlerën prej 36,851,485 lekësh. Kjo diferencë është shpjeguar nga Dega Doganore Tiranë në një pjesë të saj me trajtimin kontabël të gjobave në llogarinë e mjeteve në ruajtje 466, apo debitorëve për çështje që nuk lidhen me detyrimet doganore. Zyra e Financës mban njëkohësisht dhe llogarinë 468 si e drejtë për të arkëtuar mjetet monetare dhe llogarinë 466 si detyrim për t'i kthyer mjetet monetare subjekteve përkatëse nëse finalizimi i procesit gjyqësor është në favor të subjekteve. Nga auditimi konstatohet se gjendja e debitorëve në 31.12.2024 i raportuar nga financa në shumën 19,043,712,712.5 lekë sipas llogarisë 468 të marrë nga programi kompjuterik i kontabilitetit, është rezultat i tepricës debitore në shumën 19,070,469,796.69 lekë me tepricën kreditore në shumën 26,757,094.1 lekë. Nga auditimi konstatohet se në 31.12.2024 ekzistojnë 68 raste në sistemin kontabël me tepricë kreditore të llogarisë 468 në shumën 26,757,094.1 lekë, të cilat përfaqësojnë pagesa të kryera më tepër se detyrimi duke humbur konceptin e të drejtës për të arkëtuar nga Dega Doganore Tiranë drejt këtyre subjekteve pasi përfaqësojnë një detyrim, dhe jo një të drejtë. Përsa më sipër, konstatohet se kontabilizimi dhe raportimi i debitorëve paraqiten me diferenca për shkak të trajtimit jo të saktë të arkëtimeve më tepër dhe diferencave në trajtim për penalitetet e garantuara të cilat trajtohen ndryshe nga borxhi dhe ndryshe nga financa.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4.2 faqe 35-69 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*

**26.1. Rekomandimi:** Nga Dega Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të merren masa për sistemimin e diferencave që rrjedhin nga kontabilizimi në llogarinë 468 të pagesave të kryera më tepër se detyrimi i kreditorëve duke i sistemuar në llogarinë e mjeteve në ruajtje 466.

**Në vijimësi**

**27. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se Zyra e borxhit doganor në Degën Doganore Tiranë (DDT) funksionon sipas strukturës së miratuar me VKM nr. 355 datë 26.05.2022 '*Për personelin e administratës doganore'*, në të cilën evidentohen dy pozicione pune për specialist borxhi. Nga auditimi u konstatua se zyra ka funksionuar me vetëm një punonjës dhe një pozicion ka vijuar të mbetet vakant, vakancë kjo e cila sikurse është pasqyruar në gjetjet e auditimit mbi Degën Doganore Tiranë ka cënuar mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin në përmbushjen e detyrave të zyrës së borxhit, si pasojë e ngarkesës dhe numrit të madh të subjekteve nën mbikëqyrje të Degës Doganore.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4.2 faqe 35-69 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*

**27.1. Rekomandimi:** Nga ana e Degës Doganore Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të merren masa për plotësimin në mënyrë të menjëhershme të vendit vakant në pozicionin e specialistit të borxhit në Degën Doganore Tiranë.

**Menjëherë**

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT